



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

Disertacion doktorate në temë:

**KONCEPTET FILOZOFIKE-POLITIKE TË
ARBËN XHA FERIT NË SHTETNDËRTIMIN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

Mentori

Prof. Dr Etem Aziri

Kandidati

Mr. Sc. Flakron Bexheti

Tetovë, 2019

Mentor:

Prof. dr Etem Aziri

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Komisioni:

Prof. dr Etem Aziri

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Prof.dr Zemri Elezi

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Prof.dr Hasan Jashari

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Prof.dr. Agron Rustemi

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore

Prof.dr Alba Dumi

Universiteti Ismail Qemali-Vlorë

Deklaratë

Unë Flakron Bexheti, doktorant në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, nën përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj se ky disertacion doktrate është rezultat i punës sime kërkimore-shkencore me përjashtime të pjesëve që janë të cituara dhe të regjistruara në fusnotat përkatëse.

Flakron Bexheti

Abstrakt

Teza e Doktoratës „Konceptet filozofiko-politike të Arbën Xhaferit në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut”, kap një shtrirje të gjerë të veprimtarisë politike, me theks veçantë në përmasën e këtij intelektual mendimtar, që politikën e kuptonte, përveç tjerash edhe si dije filozofike, të bazuar në mendime të thella dhe njohuri teorike mbi konceptin e demokracisë konsensuale. Veprimtaria e tij e gjithanshme mbi këtë bazë, këtë politikan dhe filozof e dallon nga shumë të tjerë, për nga qasja e fenomeneve shoqërore dhe mënyra e trajtimit të tyre. Meqë kjo tezë është e përqendruar në pikëpamjet e tij për shtet ndërtimin e shtetit të ri të Maqedonisë së Veriut, ky punim është i orientuar në këtë drejtim. Gjithsesi pikëpamjet e tij për organizimin politik të këtij shteti reflektojnë në një dimension më të gjerë, sepse të flasësh për një shtet me shoqëri multietnike, siç është Maqedonia e Veriut, ku dy etnitetet më të mëdha janë maqedonasit dhe shqiptarët, patjetër duhet edhe qasje për përfshirje më të gjerë të fenomenit shqiptar. Në kreun e parë, punimi përfshin zhvillimet politike nga koha kur Arbën Xhaferi e filloi angazhimin politik në Maqedoni, aktivitetin e partive tjera politike shqiptare, Kushtetutën diskriminuese për shqiptarët, të vitit 1991 dhe kërkesat e shqiptarëve për përmirësimin e statusit juridik të tyre. Në kreun e dytë bëhet fjalë për kompromiset që duhet bërë mes dy etniteteve më të mëdha, që do ishin në interes për zhvillimin e shtetit të përbashkët. Në kreun e tretë theksi bie në idetë e Arbnit, për tolerancën e tij fetare, për definicionin që ka për kombin dhe shtetin. Në këtë kapitull flitet edhe për pavarësinë e Kosovës dhe impaktin pozitiv për stabilizimin e Maqedonisë. Në punim është përfshirë edhe angazhimi i tij politik para dhe gjatë konfliktit në këtë shtet, si pjesëmarrës në qeverisjen e shtetit dhe jashtë saj. Angazhimi politik, i bazuar në filozofinë e mendimit, më tepër është i përqendruar në rolin e tij për ardhmërinë paqësore të Maqedonisë, si rezultat i Marrëveshjes paqësore të Ohrit, që sipas tij nuk u realizua në kohë, madje edhe u keqinterpretua . Ajo që vlen për t’u theksuar me këtë rast, është qëndrimi konstruktiv i Arben Xhaferit lidhur me konfliktin e vitit 2001. E një rëndësie të veçantë, është edhe Marrëveshja e Prizrenit, ku u nënshkrua dokumenti i përbashkët mes liderëve legjitim politikë shqiptarë dhe atyre të krahut të Luftës. Kjo ngjarje ishte e një rëndësie të veçantë, edhe për sa i përket unitetit brenda shqiptarëve, që njëherit e përgatiti terrenin politik për

Marrëveshjen e Ohrit, me të cilën edhe u ndërpre konflikti ndëretnik, që mund të merrte përmasa katastrofale. Idetë e tij për barazinë mes komuniteteve, tolerancën fetare, dhe ndëretnike, janë bazë për ndërtimin e një shteti multi-etnik. Në kreun e katërt janë përfshirë pikëpamjet e tij në raport me fqinjësinë e mirë me Bullgarinë, Greqinë dhe tejkalimin e kontestesteve historike, që ishin pengesë për integrimin e Maqedonisë, në strukturat veri-atlantike. Skica e komunitetit shqiptar, si qasje e re për zhvillim të gjithmbarshëm të shqiptarëve në rajon, është e një rëndësie të veçantë dhe model i ri zhvillimor i tyre, sidomos i avancimit të veçorive identitare. Në kreun e pestë theksi bie mbi Demokracinë konsensuale të rregullimit të shtetit dhe angazhimin e tij për themelimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe atyre shkencore e kulturore të shqiptarëve. Marrëveshja e re politike, mbi bazë të një konsensusi të plotë mes dy komuniteteve më të mëdha, maqedonasve dhe shqiptarëve, me të gjitha të drejtat e komuniteteve tjera, ishte përcaktimi i tij i vazhdueshëm. Punimi përfundon me pjesën empirike, përmes hulumtimit anketues të qytetarëve, lidhur me vlerësimet e tyre për personalitetin e Arben Xhaferit si politikan dhe burrështetas.

Fjalë kyç: shtetndërtim, parti, program, politikë, barazi, konsensus, tolerancë, marrëveshje, religjion, etnitet, zhvillim, integrim, dialog.

Abstract

The PhD thesis, "Arbën Xhaferi's Philosophical-Political Concepts in the State-Building of North Macedonia" encompasses a wide range of political activity, with particular emphasis on the dimensions of this witty intellectual who understood politics, among other things, as philosophical knowledge, based on deep thinking and theoretical knowledge of the concept of consensual democracy. His versatile activity on this basis makes this politician and philosopher different from many others in terms of the approach to social phenomena and the way they are dealt with. As this thesis is focused on his views on the state-building of the new state of North Macedonia, this paper is also oriented in this direction. However, his views on the political organization of this state reflect a broader dimension; speaking of a state with a multiethnic society, such as North Macedonia, comprised of two largest ethnicities such as Macedonians and Albanians, a wider approach including the involvement of the Albanian phenomenon has to be considered. In the first chapter, the paper covers the political developments since the time Arben Xhaferi began his political engagement in Macedonia, the activity of other Albanian political parties, the 1991 Albanian Discriminating Constitution, and the Albanian demands for the improvement of their legal status. The second chapter deals with the compromises that must be made between the two largest ethnicities, which would be of interest to the development of the common state. In the third chapter, the emphasis is on Arbën's ideas, on his religious tolerance, on his definition of nation and state. This chapter also talks about Kosovo's independence and its positive impact on Macedonia's stabilization. The paper also includes his political engagement before and during the conflict in this country, as a participant in state governance and outside this context. The political commitment, based on the philosophy of thought, is more focused on his role in Macedonia's peaceful future as a result of the Ohrid Peace Agreement, which he said was not timely implemented, and was even misinterpreted. What is worth noting here is Arbën Xhaferi's constructive stance on the 2001 conflict. Of particular importance is also the Prizren Agreement, where a joint document was signed between legitimate political leaders and those of the then Albanian armed forces. This event was of particular importance, even in terms of unity among the Albanians, which at the same time prepared the political grounds for the Ohrid Agreement, which ended the interethnic conflict that could have disastrous consequences. His

ideas for equality between communities, religious and inter-ethnic tolerance are the basis for building a multiethnic state. Chapter four includes his views on good neighborly relations with Bulgaria, Greece and the overcoming of historical disputes that were an obstacle to Macedonia's integration into the North Atlantic structures. The outline of the Albanian community, as a new approach to the overall development of Albanians in the region, is of particular importance and represents their new development model, especially in terms of the advancement of their identity features. In the fifth chapter, the emphasis is on the consensual democracy of state regulation and his commitment to the foundation of Albanian higher education institutions as well as scientific and cultural institutions. The new political agreement, based on a complete consensus between the two largest communities, Macedonians and Albanians, with all the rights of other communities, was his continued determination. The paper concludes with the empirical section, through citizen surveys, on their assessments of Arben Xhaferi's personality as a politician and statesman.

Keywords: state building, party, program, politics, equality, consensus, tolerance, agreement, religion, ethnicity, development, integration, dialogue.

Апстракт

Докторската теза „Филозофско-политичките концепти на Арбен Џафери во градењето на државата Северна Македонија“ доловува широк спектар на политичка дејност, со посебен акцент на величината на овој мислител интелектуалец, кој политиката ја разбираше, меѓу другото и како филозофско знаење, засновано на длабоки мисли и теоретско знаење за концептот на консензуална демократија. Неговата целокупна дејност врз оваа основа, овој политичар и филозоф го издвојува од многумина други во однос на приодот кон општествените појави и начинот на нивното третирање. Бидејќи оваа теза е фокусирана на неговите гледишта за градење на новата држава Северна Македонија, трудот е насочен во овој правец. Секако, неговите ставови за политичката организираност на државата се одразуваат на поширока димензија, бидејќи да зборуваш за држава со мултиетничко општество каква што е Северна Македонија каде што двата најголеми етникуми се Македонците и Албанците, неопходна е поширока застапеност на албанскиот феномен. Во првото поглавје на трудов, опфатени се политичките случувања уште од времето кога Арбен Џафери го започна политичкиот ангажман во Македонија, активноста на другите албански политички партии, дискриминаторскиот Устав за Албанците од 1991 година и барањата на Албанците за подобрување на нивниот правен статус. Второто поглавје се однесува на компромисите што треба да се направат помеѓу двата најголеми етникуми, а што би било од интерес за развојот на заедничката држава. Во третото поглавје, акцентот е ставен на идеите на Џафери, неговата весрка толеранција, неговата дефиниција за нацијата и државата. Во ова поглавје се зборува и за независноста на Косово, како и за нејзиното позитивно влијание врз стабилизацијата на Македонија. Во трудот, исто така опфатен е и неговиот политички ангажман, пред и за време на конфликтот во државата, како учесник во управувањето со државата и надвор од неа. Политичкиот ангажман, заснован врз филозофијата на мислата, е повеќе фокусиран во неговата улога за мирна иднина на Македонија како резултат на Охридскиот мировен договор, кој според него, не беше навремено спроведен, а дури и погрешно протолкуван. Она што вреди да се потнцира е конструктивниот став на Арбен Џафери за конфликтот во 2001 година. Од особено

значење е и Призренскиот договор, каде беше потпишан заеднички документ помеѓу легитимните политички лидери и оние од военото крило. Овој настан беше од особено значење и во однос на единството помеѓу Албанците, кои истовремено го подготвија политичкиот терен за Охридскиот договор, со што беше ставен крај на меѓуетничкиот конфликт кој можеше да земе катастрофални размери. Идеите на Џафери за еднаквост меѓу заедниците, верската толеранција и меѓуетничка припадност се основа за градење мултиетничка држава. Четвртото поглавје ги опфаќа неговите ставови за добрососедските односи со Бугарија, Грција и надминувањето на историските спорови кои беа пречка за интеграцијата на Македонија во северноатлантските структури. Скицата на албанската заедница, како нов пристап кон севкупен развој на Албанците во регионот, е од особено значење и нивен нов развоен модел, особено на унапредувањето на идентитетските особености. Во петтото поглавје, акцентот е ставен на консензуалната демократија на државната регулатива и неговата заложба за основање албански високо образование и научно-културни институции. Новиот политички договор, врз основа на целосен консензус меѓу двете најголеми заедници, Македонците и Албанците, со сите права на другите заедници, беше негова постојана определба. Трудот завршува со емпирискиот дел, преку анкетно истражување на граѓаните, во врска со нивните оценки за личноста на Арбен Џафери како политичар и државник.

Клучни зборови: градење на државата, партија, програма, политика, еднаквост, консензус, толеранција, договор, религија, етникум, развој, интеграција, дијалог.

Përmbajtje e shkurtë

KAPITULLI I : ORGANIZMI POLITIK I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË SË VERIUT NEVOJË DHE DOMOSDOSH MËRI

KAPITULLI II: PËRÇARJET NË PARTINË PËR PROSPORITET DEMOKRATIK DHE PARAQITJA E ARBËN XHA FERIT NË SKENËN POLITIKE

KAPITULLI III: PROFILI INTELEKTUAL I ARBËN XHA FERIT DHE PIKËPAMJET E TIJ PËR FUNSKIONIMIN E SH TETIT

KAPITULLI IV: ROLI I ARBËN XHA FERIT PËRTEJ KUFINJËVE TË MAQEDONISË

KAPITULLI V: OFERTA E ARBËN XHA FERIT PËR NDËRTIMIN E NJË MAQEDONIE ME PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE

KREU VI: ANALIZA EMPIRIKE NË LIDHJE ME QËNDRIMET FILOZOFIKE DHE POLITIKE TË ARBËN XHA FERIT

Përmbajtje

Hyrje	13
Lënda e hulumtimit	13
Qëllimet e hulumtimit	14
Hipotezat.....	15
Metodologjia e hulumtimit	16
Rëndësia e punimit.....	17

KAPITULLI I : ORGANIZMI POLITIK I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË SË VERIUT NEVOJË DHE DOMOSDOSHMËRI

1.Formimi i partive politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut.....	19
2.Organizimi politik i shqiptarëve, domosdoshmëri	22
3.Qëllimet kryesore të partive politike shqiptare	24
4.Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1991 dhe elementi diskriminues për shqiptarët.....	25
5.Zgjedhjet e para parlamentare në Maqedoni dhe pjesëmarrja e partive politike shqiptare në to	28
6.Raporti politik i partive politike shqiptare dhe maqedonase në bashkëqeverisje dhe kërkesat politike shqiptare	33

KAPITULLI II: PËRÇARJET NË PARTINË PËR PROSPORITET DEMOKRATIK DHE PARAQITJA E ARBËN XHAFERIT NË SKENËN POLITIKE

1.Shkaqet që sollën deri te përçarja e Partisë për Prosperitet Demokratik.....	41
2.Statutet dhe programet e partive politike shqiptare në raport me kërkesat politike dhe juridike të shqiptarëve.....	46
3.Paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në Maqedoni	48
4.Vështirësitë e kompromiseve në raport me kërkesat e shqiptarëve	57

KAPITULLI III: PROFILI INTELEKTUAL I ARBËN XHAFERIT DHE PIKËPAMJET E TIJ PËR FUNSKIONIMIN E SHITETIT

1. Idetë e Arbën Xhaferit për politikën dhe shqiptarët.....	60
2.Pikëpamjet e Arbën Xhaferit për çështjet fetare (toleranca dhe intoleranca fetare) ...	68
3. Përkufizimet politike të Arbën Xhaferit për shtetin dhe funksionimin e tyre	76
4.Kombi,identiteti sipas Arbën Xhaferit.....	84

KAPITULLI IV: ROLI I ARBËN XHAFERIT PËRTEJ KUFINJËVE TË MAQEDONISË

1.Roli i Arbën Xhaferit në çështjen e Kosovës	94
2.Pavarësia e Kosovës dhe impakti pozitiv për stabilizimin e Maqedonisë	104
3.Arbën Xhaferi për raportet problemet dhe konsensualitetin e Maqedonisë, me Greqinë dhe Bullgarinë për tejkalimin e kontesteve historike	107
4.Skica për komunitetin shqiptar sipas Arbëbn Xhaferit	114

KAPITULLI V: OFERTA E ARBËN XHAFERIT PËR NDËRTIMIN E NJË MAQEDONIE ME PERSPEKTIVA EURO-ATLANTIKE

1. Roli politik dhe diplomatik i Arbën Xhaferit në Luftën e 2001-shit	120
2. Marrëveshja e Prizrenit, hap i madh drejt pajtimit.....	130
3. Kontributi i Arbën Xhaferit për Marrëveshjen e Ohrit dhe vlerësimet e tij të mëvonshme për te	134
4. Demokracia konsesuale.....	146
5. Kontributi i Arbën Xhaferit në krijimin e institucioneve të larta arsimore dhe atyre shkencore e kulturore.....	153
6. Marrëveshja e re politike maqedonase shqiptare në kohë paqe për një kohezion të përhershëm politik	159

KAPITULLI VI: ANALIZA EMPIRIKE NË LIDHJE ME QËNDRIMET FILOZOFIKE DHE POLITIKE TË ARBËN XHAFERIT

1. Përshkrim i kampionit.....	162
2. Përshkrim i rezultateve.....	172
3. Komentim i rezultateve kundrejt hipotezave	202
Përfundime	205
Literatura	210
Shtojca	215
Të tjerët për Arben Xhaferin.....	215

Hyrje

Lënda e hulumtimit

Shtet ndërtimi i Maqedonisë së Veriut, ka pasur faza të ndryshme gjatë historisë. Përtej aspektit historik, rëndësi të veçantë ka patur edhe aspekti demografik dhe strukturor i popullatës së Maqedonisë, që mund të paraqitet një model jo i zakonshëm i rajonit. Multietniciteti i Maqedonisë ku jetojnë popuj dhe kombësi të ndryshme, si: maqedonase, shqiptare, turke, rome, vllahe, sërbe boshnjake etj, ka imponuar rrethana tjera të shtet ndërtimit, ku në bazë të organizimit politik ky realitet është dashur të reflektojë edhe në praktikë, nëpërmjet organizimit politik.

I tillë ka qenë edhe angazhimi i politikanit, filozofit dhe liderit Arbën Xhaferi përmes ideve dhe koncepteve të tija për shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut, duke paraqitur ide dhe argumente politike dhe filozofike në shërbim të gjetjes së një modeli të kapshëm demokratik në interes të kohezionit të përbashkët të dy etnitetëve më të mëdha, atë maqedonas dhe shqiptar në Maqedoninë e Veriut.

Edhe pse idetë e tij janë përtej kufijve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të bazuara në filozofi, koncepte demokratike dhe liberale, se si duhet të ndërtohet një shtet mbi bazën e demokracisë konsensuale. Në këtë temë do të hulumtohen idetë dhe konceptet e tij në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut.

Në këtë punim do të analizohen pikëpamjet teorike por edhe praktike të Arben Xhaferit, duke iu referuar qëllimeve të tija për shtet ndërtimin e Maqedonisë.

Si temë kryesore e këtij punimi do të hulumtohen idetë e Arbën Xhaferit dhe angazhimit të tij në praktikë mbi Demokracinë Konsensuale në Maqedoninë e Veriut, mes dy komuniteteve më të mëdha, atë të maqedonasve dhe shqiptarëve, si një model i qëndrueshëm në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut për një stabilitet të përhershëm politik.

Edhe pse perceptimi për figurën e Arben Xhaferit cilësohet si politikan dhe lider që në radhë të parë është angazhuar për kauzën kombëtare shqiptare nëpërmjet demokracisë konsensuale, mendimit politik dhe ideve të tyre në funksionimin e një shtetit si Maqedonia e Veriut, ka reflektua edhe përtej kufijve të Maqedonisë së Veriut.

Konceptet filozofike – politike të Arben Xhaferit kanë dhënë një impuls në jetën politike të Maqedonisë së Veriut duke sjellë një mënyre ndryshe të menduarit në sferën e politikës.

Qëllimi i hulumtimit të kësaj teme është që nëpërmjet ideve të Arben Xhaferit të trajtohen mënyrat dhe format e reja politike në gjetjen e zgjedhjeve dhe situatave konfliktuoze me të cilat shpeshherë përballëj Maqedonia e Veriut.

Nëpërmjet mendimit filozofik dhe veprimit të tij politik për më tepër se dy dekada, Arben Xhaferi ka lënë gjurmë në rrugën e shtet ndërtimit të Maqedonisë së Veriut dhe si ide e koncepte politike paraqesin edhe më tutje një vizion filozofik dhe politik për rindërtimin e mëtutjeshëm të Maqedonisë së Veriut.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimet e hulumtimit të këtij punimi mbi konceptet filozofike dhe politike të Arben Xhaferit janë që të analizohen rrethanat politike në Maqedoninë e Veriut nga e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Përmes hulumtimeve dhe analizave do të dihet se sa këto koncepte janë jetësuar politikisht në sistemin politik të republikës së Maqedonisë së Veriut, në interes të objektivave politike të Maqedonisë, qytetarëve dhe posaçërisht të shqiptarëve si objekt dhe qëllim primar i Arben Xhaferit në jetën politike në Maqedoni.

Përmes këtij qëllimi mund të realizojmë këto objektiva:

E para: hulumtimi duhet të ofroje qasjet ndryshe të funksionimit të sistemit politik në Maqedoninë e Veriut sipas koncepteve të Arben Xhaferit. Ndryshe thënë se do të tentojmë me fuqinë e argumenteve të dëshmojmë anët pozitive dhe negative të koncepteve të Arben Xhaferit në raport me shtet ndërtimin e Maqedonisë dhe sistemit politik.

E dyta: nëpërmjet këtij hulumtimi lexuesit t'i ofrohen edhe të dhëna burimore nga literatura e shkruar mbi personalitetin filozofik dhe politik të Arbën Xhaferit si një pasqyrë e pikëpamjeve të tija për funksionimin e Maqedonisë.

E treta: si qëllim i hulumtimit do të jetë oferta e Arbën Xhaferit nëpërmjet ideve të tij, që do jenë pjesë kryesore e këtij hulumtimi të cilat mund të shfrytëzohen si ide për të rindërtuar kapacitet dhe strategjitë politike edhe sot, që mund të shfrytëzohen në interes të kompromisit, marrëveshjes mes dy komuniteteve me mëdha, shqiptarëve maqedonasve, si dhe formimit të perspektivës euro- atlantike të Maqedonisë.

Përkufizimi i koncepteve filozofike dhe politike të Arbën Xhaferit për shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut si nocione kryesore për një paqë të qëndrueshme dhe perspektive euro-atlantike të maqedonasve dhe shqiptarëve si dhe komuniteteve tjera të Maqedonisë së Veriut.

Gjetja e dallimeve të koncepteve të Arbën Xhaferit për shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut nga mendime të ndryshme të qytetarëve të komuniteteve të ndryshme

Hipotezat

Me Hulumtimin e qëndrimeve të ndryshme të qytetarëve, analistëve, politikanëve ndaj koncepteve filozofike dhe politike të Arbën Xhaferit në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut do iu përgjigjemi disa pyetjeve hulumtuese kërkimore:

Hipoteza Kryesore:

Pikëpamjet e Arbën Xhaferit ofronin alternativë të qëndrueshme në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut?

Hipotezat ndihmëse:

1. Koncepti i Arben Xhaferit për shtetin multietnik ishte pro perëndimor?
2. Demokracia konsensuale që proklamonte Arbën Xhaferi ishte në përputhje të plotë me konceptet bashkohore mbi demokracinë?
3. Bashkjetesa, multikulturalizmi, multilingualizmi dhe multikonfeksionalizmi ishin pjesë përbërëse e ideve të Arbën Xhaferit për ndërtimin e një shteti me perspektiva të qëndrueshme euroatlantike?

4. Evoluim të qëndrimeve politike të Arbën Xhafer, ishte si rezultat i ndodhive konkrete në Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë.

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë punimit të tezës së doktoratës do të shfrytëzohet disa metoda standarde që janë të domosdoshme në shkrimin e disertacion të doktoratës edhe ato.

- Metoda Historike
- Metoda Statistike
- Metoda Krahasuese
- Intervistat dhe anketimi

Metodat Historike, do të vijnë në shprehje sidomos në pjesën hyrëse ku do të analizohet dhe studiohet zanafilla e sistemit politik në Maqedoninë e veriut, si dhe fazat zhvëllimore të sistemit dhe organizimit, ku edhe do të analizohen edhe kontestet kohore të paraqitjeve të ideve të para të Arbën Xhaferit në lidhje me funksionimin e sistemit politik të Maqedonisë së veriut në periudha të ndryshme kohore.

Metodat Krahasuese do të vijë në shprehje gjatë hulumtimit ku do të bëhen krahasimet me personalitete tjera të jetës politike në Maqedoni, që kanë lider të komuniteteve shqiptare dhe maqedonase si dhe protagonist, dhe udheheqës politik dhe shtetëror të Maqedonisë së veriut. Gjithashtu do të behet edhe krahasimi i sistemeve, kushtetutave të ndryshme, qeverive për të marrë hulumtimi një trajtë me sakte të koherave politike.

Metodat statistikore do të vijnë në shprehje sidomos kur do të analizohen se sa pikëpamjet, dhe konceptet politike – filozofike të Arbën Xhaferit, kanë arritur të jetësohen në raport me qëllimet që ai i ka paraqitur edhe si lider partie edhe si filozof.

Intervistat dhe vëzhgimi (individual) do të jetë një pjesë e rëndësishme e këtij Hulumtimi ku do të ofrohen pikëpamjet e personaliteteve me kompetence që e kanë njohur perceptimin politik dhe filozofik të Arbën Xhaferit në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut. Do të intervistohen personalitete nga jeta politike, akademike, të komuniteteve të ndryshme, poashtu edhe të faktorit ndërkombëtar

Anketa e cila do të jetë e formuluar në formë pyetsori do të jetë kryesisht e tipit kuantitativ duke zbatuar nje pyetësor gjysëm të strukturuar. Gjatë formulimit të pyetjeve do të kemi parasyshë edhe shkallën e Rensis Likertit e cila është ofruar si shkallë për matjen e e qëndrimeve të një cështje.

Rëndësia e punimit

Rëndësia e punimit do të varet shumë nga ajo se sa në bazë të hulumtimit do ta arrijmë a vërtetojmë hipotezën kryesore dhe hpotezat ndihmëse të punimit.

Si punim, në përgjithësi besoj të ketë një rëndësi të veçantë teorike –shkencore nga fakti se në Maqedoni nuk ka literaturë të mjaftueshmë ose ka shumë pak, mbi figurat politike të kalibrit të Arbën Xhaferit, për rolin e tij në politikbërje në Maqedoni, për periudha të caktuara kohore, dhe shpresoj që ky punim te jetë një kontribut të veçantë.

Rëndësia praktike e punimit ndërlidhet edhe me nevojat e qytetarëve dhe faktorëve politikë ta njohin sa ma mirë figurën e një politikanit, burrështetasi në lidhje me përpjekt e tij, konceptet politike – filozofike për shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI

ORGANIZMI POLITIK I SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË SË VERIUT NEVOJË DHE DOMOSDOSHMËRI

1. Formimi i partive politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut
2. Organizimi politik i shqiptarëve, domosdoshmëri
3. Qëllimet kryesore të partive politike shqiptare
4. Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1991 dhe elementi diskriminues për shqiptarët
5. Zgjedhjet e para parlamentare në Maqedoni dhe pjesëmarrja e partive politike shqiptare në to
6. Raporti politik i partive politike shqiptare dhe maqedonase në bashkëqeverisje dhe kërkesat politike shqiptare

1. Formimi i partive politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut

Shikuar në aspektin historik, territori i shtrirjes gjeografike të Maqedonisë në Ballkan, ishte çështje komplekse me rrënjë të thella që në antikitet. Interesat e shumë popujve që jetonin në këtë territor, apetitet e tyre se kush më shumë e kush më pak ka hise në këto hapësira dhe luftrat e ndryshme për interesa strategjike të fuqive të mëdha, e karakterizojnë këtë territor, që me formimin e Jugosllavisë së Titos u formua si Republika Popullore e Maqedonisë, si njësi federale e Jugosllavisë. Ky territor i njohur si Maqedoni, që në kohën antike e deri në ditët e sotme, ishte arenë e konflikteve dhe mosmarrëveshesh mes popujsh, të nxitur edhe nga faktorë jashtë këtij territori. Epilogu i këtyre luftërave përfundoi në Konferencën e Bukureshtit në vitin 1913, ku Maqedonia e imagjinuar antike u nda në tre pjesë. Hisen më të madhe e mori Greqia (51%, Maqedoninë e Egjeut), pastaj Serbia(39%, Maqedoninë e Vardarit) dhe pjesën më të vogël Bullgaria (10%, Maqedoninë e Pirinit).¹

Maqedonia deri sa ishte pjesë e barabartë e federatës Jugosllave, gjatë kohës sa zgjati ajo Jugosllavi, nuk pati probleme me Greqinë për çështjen e emrit, meqë ajo republikë jugosllave me e kufijt e njohur ndërkombëtarisht, ku mungonte emri „Maqedoni”, nuk llogaritej nga Greqia me pretendime për shtrirjen e saj në jug, në pjesën e Maqedonisë së Egjeut. Me pavarësimin e kësaj republike si shtet sovran me emrin Maqedoni, që e trashëgoi nga emri i territorit, Greqia këmbënguli që assesi ky shtet i ri, i dalë nga Federata jugosllave, nuk duhet të njihet ndërkombëtarisht me këtë emër. Në këto rrethana të kontestimit të emrit, Maqedonia, që ndërkombëtarisht njihet si IRJM, përvrç disa shteteve që e kishin njohur me emrin kushtetues, e vazhdoi rrugëtimin e shtet ndërtimit, duke mos i respektuar kërkesat e arsyeshme të shqiptarëve të cilët shuarjen e sistemit të vjetër komunist nga i cili vuajtën më së shumti nga të gjithë, e pritën me shpresa të mëdha. Në rrethana të paqarta për ardhmërinë e fatit të tyre, shqiptarët i formuan

¹ Arbën Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë 2017 f.143

partite politike, përmes të cilave mendonin se të drejtat e tyre të nepërkëmbura nga po kjo republikë ish jugosllave, do i fitojnë përmes kërkesave që tani më ishin edhe pjesë programore e partive të tyre.

Organizimi politik në Maqedoni përmes partive politike, përveç qasjes publicistike dhe vlerësimeve të vet partive, deri vonë nuk pati ndonjë vlerësim nga ekspertë për analiza shkencore, ku do zbërtheheshin fenomenet që sollën deri te jeta politike plurale, në çfarë rrethanash u shpërbë sistemi njëpartiak, dhe si u përjetua ndarja nga shteti i përbashkët. Fillimisht, kur ende nuk ishte e sigurtë se përfundimisht shpërbëhet Jugosllavija federative, edhe pse të vetëdëshën se po përfundon sistemi njëpartiak, në Maqedoninë e atëhershme u formuan degë të partive me orientim jugosllav, siç ishte edhe ajo e Ante Markoviqit, që arriti të mbledh rreth vetes mjaftë anëtarë dhe simpatizantë dhe ajo e LKJ-jës, së reformuar, që për një kohë të shkurtër e ndërroi disa herë emrin, gjithsesi me program të ri që i përgjigjej një realiteti të ri historik, por pa u shkëputur ideologjikisht nga paraardhësja e saj. Në këtë kohë shqiptarët mendonin gjithashtu për një organizim politik të vetin, në shtetin që ende nuk e kishte shpallur pavarësinë e vet, edhe pse e kishin vështirë ta kuptojnë realitetin e ri, që çonte drejt ndarjes me Kosovën. Fati i njëjtë i shqiptarëve në Jugosllavinë e Ttitos dhe solidarizimi i tyre me Kosovën, meqë gjatë kohë kishin pasur rrugë të përbashkët për përmirësimin e kushteve politike e ekonomike, i kishte lidhur fortë mes veti, prandaj, në atë kohë kur shqiptarët e Kosovës kishin nisur organizimin e jetës politike, përmes LDK-ës, të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, edhe në Maqedoni u formuan degë të kësaj partie shqiptare. Kjo parti me seli në Prishtinë, përveç se në Kosovë, me degët e veta u shtri në të gjitha rajonet e hapësirave shqiptare edhe jashtë Kosovës. E kaluara na mëson se çdo lëvizje politike në Kosovë, si bie fjala, Demonstratat e vitit 1968, 1981, dhe 1989, përhapeshin edhe në Maqedoni, në qytetet ku jetonin shqiptarët. Mirëpo nga ana tjetër edhe sllavët e jugut, maqedonasit, serbët e malazezët që bashkëjetonin me shqiptarët kishin koordinim strategjik në planifikim dhe veprim.²

Këtu edhe qëndron dallimi mes shqiptarëve, që ndarjen nga kosova, kur po shpërbëhej Jugosllavia e përjetuan jo edhe pa dhembje emocionale, përkundër nostalgjikëve

² Arbën Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë 2017 f. 148

jugosllavë që ende nuk besonin se mund të jetojnë si të ndarë nga familja e madhe e përbashkët jugosllave. Shqiptarët e shpërndarë në disa shtete ballkanike pa dëshirën e tyre, tani përimitësoheshin edhe më tepër në shtetet më të vogla siç ishte edhe Maqedonia. Gjendja e krijuar e rrezikonte bindshëm qenien kombëtare shqiptare dhe vetvetiu imponoi një organizim politik i cili u vu në shërbim të mbrojtjes së çështjes kombëtare, konform rrethanave të krijuara.³ Me krijimin e Jugosllavisë së vjetër të pëbërë nga sllovenër kroatët e serbët, Maqedonia e Vardarit nga serbët njihej si Sërbi e Jugut, ose Banovina e Vardarit.

Gjatë periudhës kohore brenda viteve 1981-1990, shqiptarët e Maqedonisë, e përjetuan diskriminimin në të egër se kurrë më parë, duke i humbur madje edhe ato pak të drejta të trashëguara që i kishte fituar me Kushteturen e vitit 1974, mbi bazat e së cilës, Kosova u avansua në nivelin e njësisë konstituive të Fedratës jugosllave, ndërsa shqiptarët si kombësi, bashkë me turqit, e fituan të drejtën e shtetformësisë. Nga vet fakti se statusi i shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Kosovës u avansua me të njëjtën kushtetutë, atë të vitit 1974 dhe po në të njëjtën kohë edhe u suprimuan ato të drejta, tregon aleancën antishqiptare të serbëve dhe maqedonasve, bashkëpunim ky i kahershëm me strategji historike antishqiptare, që e dëshmon edhe bashkëpunimi rreth realizimit të planit të shpërnguljes në Turqi, kur „visikat” (vizat) mërreshin në Konsullatën turke në Shkup. Fushata e ashpër antishqiptare në Maqedoni e cila mori hov pas Demonstratave të Kosovës, të vitit 1981, u bë e padurueshme kah fundi i viteve të tetëdhjeta të shek të kaluar, që kulmoi me ndryshimet kushtetuese 1989. Meqë Kushtetuta e vitit 1974, i siguronte disa të drejta, edhe pse nuk u realizuan asnjëherë ashtu siç duhej, qarqe antishqiptare të politikës zyrtare maqedonase, ashtu si në Kosovë, edhe pse jo nën kërcënim me tanksa, në masë të madhe e zhveshën këtë Kushtetutë përmes amandamenteve, që prekën atje ku dhembte më shumë, në suspendimin e nenit që e garantonte gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare, bashkë me maqedonishten dhe turqishten. Të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe pushteti i atëhershëm e kishte ndaluar edhe para këtyre ndryshimeve kushtetuese. Mbyllja e shkollave në gjuhën shqipe nën maskën e paraleleve të përziera, përjashtimi i shumë shqiptarëve nga puna, sidomos i arsimtarëve, masa të ndryshme kundër prindërve për emërtimin shqip të fëmijëve të

³ Etem Aziri, Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni, Skup 2004, f.63

tyre, madje edhe me detyrim që disa t'i ndërrojnë edhe emrat e fëmijve, tani më të rritur, ishin veprime ndër më të egrat e më primitivet, që kishin përjetuar ndonjëherë shqiptarët, në këtë Republikë, si pjesë e Federatës. E tërë kjo shtypje ndaj shqiptarëve, si rezultat i një politike albanofobe dhe solidarizim me politikën represive serbe në Kosovë, pa asnjë bazë juridike, u legalizua me Kushtetutën e vitit 1989, kur nga preambula u fshin fjalët :Dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në te, që hapën rrugë për të vazhduar akoma më ashpër me politikën antishqiptare. Me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe paraqitjes së sistemit shumpartiak demokratik, masat represive kundër shqiptarëve, të planifikuara për kohë shumë të gjatë, mbetën pa veprimin e planifikuar. Shpërbërja e Jugosllavisë bashkë me sistemin komunist dhe pluralizmi politik, për shqiptarët sollën shpresën dhe optimizmin më të fuqishëm së kurrë më parë, se po krijohen kushte kur shqiptarët përmes organizimit politik të pavarur e të çliruar nga ideologjia komuniste politike, do mund të vendosin për fatin e vet. Kjo shpresë se në kushte e rrethana të reja do mund lehtë të realizohen ëndrrat e shqiptarëve, u thye që në fillimet e organizimit politik, kur me Kushtetutën e vitit 1991, u kufizuan mundësitë që shqiptarët t'i realizojnë ato ëndrra.

2.Organizimi politik i shqiptarëve, domosdoshmëri

Shqiptarët, si kombi i dytë më i madh në Maqedoninë e atëhershme, gjithsesi ishin më të interesuarit për formimin e partive politike, me shpresën së si të organizuar politikisht, në kushte demokratike, më së miri do i realizojnë të drejtat e tyre të nëpërkëmbura shekuj me radhë. Jorastësisht Partia e parë politike e shqiptarëve të Maqedonisë, PPD njëherit ishte edhe e para e shqiptarëve në përgjithësi, e regjistruar sipas Ligjit për Partitë Politike. Krahas kërkesave që tani më shqiptarët do i shtronin në mënyrë legjitime dhe institucionale dhe shpresës së madhe se erdhi koha aq shumë e pritur, me paraqitjen e partive nacionaliste maqedonase, mori hov disponimi ende më i egër antishqiptar, që në kushte demokratike ata t'i llogarisnin vetëm si pakica me të drejta shumë më të kufizuara se ç'kishin pasur në Jugosllavinë e dikurshme, që ishte në proces shpërbërjeje. Programet e tyre partiake, flitnin vetëm për maqedonasit dhe të kaluarën e tyre në shtetin e përbashkët dhe për gjoja diskriminimin e tyre. Edhe partia trashëgimtare e asaj të LK-jës apo LKM-ës, që në kushte demokratike fitoi emërtim të ri, në

programin e tyre parashihnin reduktim serioz edhe të pak atyre të drejtave të shqiptarëve, të trashëguara nga e kaluara, të garantuara me Kushtetutën e vitit 1974. Në këto kushte shqiptarët duke u gjendur mes shpresës për fitore të plotë të të drejtave aq kohë të nëpërkëmbura dhe një fushate të ashpër kundër tyre që paralajmëronin partitë maqedonase, të majta e të djathta, me kohë e kuptuan zhgënjimin se edhe në kushte demokratike, liria e plotë do jetë kafshatë e lehtë.

Në këto rrethana u formua Partia për Prosperitet Demokratik, pikërisht më 16 prill 1990, në fshatin Xhepçisht, me kryetar Nevzat Halilin, që u legalizua pasi hyri në fuqi Ligji për Partitë politike, me 25 maj 1990.⁴ Edhe pse kjo Parti u themelua për shqiptarët, për të drejtat e shkelura të tyre, nuk u regjistrua si parti etnike me program kombëtar, ashtu si partitë dhathtiste të Maqedonisë së atëhershme, madje për sekretar partie u zgjodh një avokat maqedonas. Pëcaktimi kryesor partiak bazohej në interesin e qytetarëve: *Partia për Prosperitet Demokratik është parti qytetare. Ajo është parti e qytetarëve të përkatësisë kombëtare shqiptare muslimane, turke, maqedonase, vllehe, rome...*⁵ Anëtarësia e kësaj Partie përbëhej kryesisht nga intelektualë shqiptarë, shtresash të ndryshme sociale, ku nuk mungonte edhe përkrahja e një pjese të muslimanëve, romëve, madje dhe turqive, kur ato ende nuk kishin formuar partitë e veta. Në radhët e Partisë, krahas frymës së moderuar, vepronin edhe ato të krahut më radikal që nuk e parapëlqenin orientimin qytetarë, me arsyetimin se me këtë politikë nuk do arrihen qëllimi i formimit të Partisë dhe se opsioni qytetar për momentin nuk do jetë efikas dhe i sksesshëm në realizimin e kërkesave të shqiptarëve. Edhe pse PPD-ja fillimisht pati një përkrahje të madhe nga popullata shqiptare, saqë shumë shpejt u shdërrua në një lëvizje mbarëkombëtare, me instalimin e disa njerëzve, edhe pse në numër të vogël, të cilëve më tepër u interesonin kolltuqet në udhëheqësinë e lartë, dhe në ato të Kuvendit dhe të Qeverisë së shtetit. Shumë shpejt pas partisë së parë shqiptare, më 23 qershor, 1990, u formua edhe ajo e dyta, Partia Demokratike Popullore, fillimisht me kryetar Dr. Jusuf Rexhepin, të cilin shumë shpejt e zëvendësoi Iljaz Hlimi. Kjo Parti që në aspektin programor nuk ndryshonte shumë nga e para, me disa përjashtime me theks më të fortë në kërkesat me interes kombëtar. Këto dy parti politike shqiptare, u formuan në kohë kur shpërbërja e Jugosllavisë federative ishte ende në proces, ndërsa fryma pluraliste ende ishte

⁴ Zeqirija Rexhepi, Zvillimet Politiko-Shoqërore të Shqiptarët në Maqedoni 1990-2002, Tetovë 2005, f.22

⁵ Programi i PPD-së, i miratuar në Kongresin e Parë, Arkivi i PPD-se, Tetovë

mes dilemës se duhej të vazhdonte bashkëjetesa në një lidhje më të butë me republikat ish jugosllave, apo të shkohet drejt pavarësisë së Maqedonisë së atëhershme. Pas formimit të PPD -ësë PDP-ësë, u paraqitën edhe disa parti minore të cilat në asnjë mënyrë nuk e legjitimuan vetveten para trupit zgjedhor shqiptar, prandaj mendojmë se nuk duhet të zgjerohemi në veprimin politik të tyre⁶. Këto parti që mëtuan të jenë partitë me peshë të madhe kombëtare për shqiptarët e Maqedonisë, ishin: Lidhja Demokratike Shqiptare-Partia Liberale, Partia e Unitetit , Aleanca Demokratike dhe Partia Republikane.

3.Qëllimet kryesore të partive politike shqiptare

Për dallim nga disa parti politike maqedonase, të pashkarkuara nga nostalgjia e jetës së përbashkër jugosllave, përjashtuar partitë djathtiste me elementin nacionalist shumë të theksuar, siç ishin MAAK dhe VMRO-DPMNE, partitë shqiptare, e pranonin integritetin e Maqedonisë, brenda së cilës shqiptarët duhej t'i realizojnë të drejtat e tyre. Edhe pas formimit të partisë së dytë shqiptare, PDP-së, që lindi si rezultat i pakënaqësisë me politikën e Partisë së parë, me bindjen se udhëheqësia e saj nuk është aq e vendosur në realizimin e programit, që në fokus e kishin zgjidhjen e çështjes shqiptare, vazhduan fërkimet brenda partiake mes fraksionit të politikës që u konsiderua si më radikale, e koncentruar më tepër në degën e Tetovës, dhe pjesës tjetër, si krah më i butë që mendonte se me veprime të moderuara më lehtë do arriheshin synimet programore. Formimi i partive politike shqiptare, edhe pse asnjëra nga këto parti në programet e veta nuk ishte e përqendruar vetëm në çështjen shqiptare, kishte për qëllim avansimin e të drejtave të shqiptarëve, që ishin nëpërkëmbur vazhdimisht. Në programet e tyre mbisundonin kërkesat për një status shtetformues, të barabartë plotësisht me maqedonasit, për gjuhë zyrtare shqipe në nivel shtetëror dhe lokal, për shpërndarje të mjeteve buxhetore në mënyrë të barabartë, për përfaqësim të drejtë në të gjitha organet e pushtetit qendror e lokal, për të drejtë në shkollim në gjuhën amtare, nga ai fillor, i mesëm dhe i lartë, kërkesa këto që pas një decenie do përfshihen edhe në Mrrëveshjen e Ohrit, që erdhi si rezultat i konfliktit ushtarak

⁶ Etem Aziri, Organizimi Politik i Shqiptarëve në Maqedoni, Shkup 2004 f.

të vitit 2001. Disa nga partitë më të vogla, në programet e tyre kishin kërkesa ende më radikale, siç ishte edhe kërkesa për federalizim të Maqedonisë, kërkesë kjo që mbeti vetëm në letër, ashtu si edhe rezultati i Referendumit të shqiptarëve për Autonomi territoriale e politike të shqiptarëve, që përvrç injorimit nga Qeveria e Maqedonisë, mbeti në sirtarët e Partisë së parë shqiptare, pa ndonjë këmbëngulje për ta jetësuar këtë kapital të dalë nga vota e popullit. Çdo kërkesë e shqiptarëve përmes partive të tyre politike, si legjitime që buronte nga programet partiake legale dhe të regjistruara për të vepruar konform ligjeve dhe Kushtetutës së shtetit, mbaronte pa sukses sepse mungonte mekanizmi i konsensusit, që do e detyronte palën maqedone të pajohet me këto kërkesa, për të cilat ishin formuar. Injorimi i kërkesave të shqiptarëve përmes përfaqësuesve të tyre politikë, ishte më i theksuar në miratimin e ndryshimeve kushtetuese të vitit 1991, kur shqiptarët, në pritje të avancimit të të drejtave të tyre, u zhveshën edhe nga ato pak të drejta të trashëguara.

4.Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1991 dhe elementi diskriminues për shqiptarët

Se Kushtetuta e vitit 1991, ishte gjeneratori kryesor i krizave në Maqedoni, sidomos i konflikteve ndëretnike mes maqedonasve dhe shqiptarëve, është realitet i pamohueshëm, pavarësisht se një pjesë e madhe e politikanëve dhe etnitetit maqedonas, ende këtë realitet nuk e konsiderojnë si të tillë. Kjo Kushtetutë u miratua pikërisht në kohën kur shqiptarët shpresonin se në kushtet e pluralizmit politik dhe të demokracisë, ka ardhur momenti kur me lehtësi do i realizojnë të drejtat e tyre përmes kërkesave që ishin edhe pjesë programore e partive shqiptare të cilat përmes zgjedhjeve të para demokratike, përfaqësoheshin në Parlamentin e Maqedonisë. Kushtetuta e re e Reoublikës së Maqedonisë që pas debateve të pa suksesshme mes shqiptarëve dhe maqedonasve, si në seanca të komisioneve të veçanta, ashtu edhe në debate plenare, u miratua me 17 nëntor të vitit 1991.⁷ Shpërfillja politike e fjalës së shqiptarëve gjatë debateve përmes amandamenteve të tyre, çoi deri te mbivotimi i tyre dhe në këtë mënyrë, në vend të

⁷ Arbën Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë 2016, f. 302

avancimit të shqiptarëve , pozita e tyre u kthye mbrapa, madje duke ia suprimuar edhe të drejtat e trashëguara. Kjo Kushtetutë ishte e ndërtuar sipas frymës së viteve 80-ta, të periudhës që shënonte variantin më të pashpresë ku shqiptarët prej hisenikut të paevitueshëm, u shndërruan në problem politik dhe ekonomik.⁸ Mënyra e këtillë e miratimit të një kushtetute që mëtonte të jetë bazë e themelimit të shtetit të ri demokratik, jo që nuk të ishte e atillë, por përkundrazi ishte paralajmëruese se shqiptarët në të ardhmen do i përdorin të gjitha mjetet për ta rrëzuar këtë burim krize, gjë që u bë edhe realitet në vitin 2001. Pas miratimit të kësaj Kushtetute, duke i injoruar në mënyrën më brutale kërkesat e deputetëve shqiptarë, pala maqedonase kërkesës së vazhdueshme për të drejtat e shqiptarëve u përgjigjej me arsyetimin se Kushtetuta aktuale nuk e mundëson një gjë të këtillë. Është e njohur deklarata e Kryetarit të parë të Parlamentit të Maqedonisë, Stojan Andovit, se këto të drejta mund të fitohen vetëm me luftë. Kjo deklaratë e tij, shikuar nga këndvështrimi i sotëm del si reale dhe largpamëse. Edhe pse ai deklaroi kësisoj, as që kishte menduar se edhe mund të ndodhte një gjë e tillë. Për këtë Kushtetutë, si gjenerator krize, që e ndali rrugëtimin drejt demokracisë, u shpreh edhe Arbën Xhaferi, kur po zbërthente fenomenin e identifikimit të qytetarit me shtetin dhe etninë. Kjo Kushtetutë, sipas tij, jo vetëm që nuk e pranoi frymën e barazisë, por në fakt e thelloi krizën, ngaqë nuk i pranoi vlerat e sistemeve evropiane. Në analizën që ai i bëri kësaj Kushtetute dhe pasojave të mundshme nga ky segregacion „që vinte ndesh jo vetëm me standardet e formacioneve evropjane shoqërore, por edhe me kategorinë e të drejtave të trashëguara të shqiptarëve”, vjen te këto përfundime:

- Një Kushtetutë e këtillë, pas analizave krahasimore që dëshmonin marginalizimin ekstrem të shqiptarëve në sistem, filloi të prodhojë krizën.
- Kjo Kushtetutë ishte ekzemplar paradigmatic i diskrepancës ndërmjet përbërjes etnike të shoqërisë së formës politike.
- Kushtetuta e vitit 1991, Kushtetuta e periudhës demokratike e Maqedonisë, jo vetëm që nuk e pranoi frymën e barazisë, por në fakt e thelloi krizën ngaqë nuk i pranoi vlerat e sistemeve demokratike evropjane.⁹

⁸ Po aty

⁹ Arbën Xhaferi, po aty, f. 303

Këto konstatime të Arbën Xhaferit ishin të bazuara në teoritë filozofike të mendimit politik të tij, bazuar në veprimin praktik të shumicës parlamentare që mendon se ka të drejtë të nëpërkëmbë e të mospërfillë kërkesat legjitime të deputetëve shqiptarë. Duke vlerësuar se „kjo psikologji posesive ndikoi që Kushtetuta të përceptohet dhe trajtohet si një thesar ku mund t'i merret gjithçka tjetrit, ai edhe njëherë ia përkujtoi klasës politike maqedonase se veprime të këtilla mospërfillëse çojnë drejt konflikteve ndëretnike, prandaj ndërrimi i kësaj Kushtetute sa më parë që të jet e mundur, do krijonte klimë më të përshtatshme politike që duhet të përmbillet me konsensus. Konsenzusi mes du komuniteteve më të mëdha të përfaqësuar përmes deputetëve në parlament do ishte zgjidhje afatgjate dhe do e pamundësonte konfliktin që mund të radikalizohej deri në nivel lufte. Kjo tendencë e shumicës maqedonase që përmes kushtetutës t'i disiplinonë shqiptarët që kërkesat e tyre t'i kufizojnë vetëm në nivel që lejon kjo Kushtetutë, vetëm sa e zgjati përgjumjen e një politike antishqiptare në Maqedoni, e assesi ta ta mbyll problemin sipas kutit të tyre. Kjo ofertë politike jashtë kornizave të modelit demokratik e stërzgjati pazarin joparimor mes shqiptarëve që vetëm kërkonin dhe maqedonasëve që u përgjigjeshin se vetëm kaq u takon, sepse kushtetuta nuk lejon më tepër, edhe pse kërkesat e shqiptarëve ishin të drejtpërdrejta, konkrete dhe të arsyeshme. Nuk ka dyshim se për një gjendje të këtillë, fajtorë kryesorë janë shteti maqedonas dhe Kushtetuta e Maqedonisë, e cila u soll pa votën e deputetëve shqiptarë dhe pa vullnetin politik të tyre, megjithate, nuk duhet harruar edhe faktin se në masë të madhe ka munguar edhe sensi i partisë politike shqiptare, pjesëmarrëse në qeveri.¹⁰ Edhe gjatë periudhës kur në Maqedoni vepronin vetëm dy parti shqiptare, ajo e PPD-ës dhe PDP-ës, ekzistonin dallime mes tyre përse i përket kërkesës së realizimit të të drejtave të shqiptarëve. PDP-ja angazhohej për realizimin e së drejtës për vetvendosje të popullit shqiptar në hapësirat e Ish Jugosllavisë, si e drejtë e patjetërsuar natyrore që i takon çdo populli.¹¹ Për ndryshimin e kësaj Kushtetute u ndërmor një hap më serioz, pas Referendumit të shqiptarëve për Autonomi Politike Territoriale, kur dy partitë aktuale shqiptare morën një nismë për ndryshimin e saj.

¹⁰ Etem Aziri Organizimi Politik i Shqiptarëve të Maqedonisë Shkup 2004 f. 96

¹¹ Programi dhe Statuti i PDP, Tetovë 1992

Në dokumentin e kërkesës për këtë qëllim u theksua nevoja e ndryshimeve në Kushtetutë sepse ky shtet ishte heterogjen në shumë aspekte, siç është ai nacional, konfencional, dhuhësor, kulturor tj., dhe si i tillë nuk i përgjigjet kësaj Kushtetute. Edhe kjo kërkesë, si hap serioz dhe në pajtueshmëri të plotë me partitë shqiptare nuk u përfill fare nga pala maqedonase dhe kështu vazhdoi thellimi i krizës ndëretnike, ndërsa kjo iniciativë mbeti vetëm një dëshirë e parelizuar deri në kohën kur këto kërkesa u radikalizuan në konflikt të armatosur¹². Ky propozim i inicua nga dy udhëheqësitë e dy partive politike shqiptare, PPD dhe PDP, dhe Grupit parlamentar, më 3 Maj 1992. Dokumenti mban vulat e dy partive politike shqiptare.¹³ Me Këtë propozim shqiptarët e Maqedonisë përmes procedurës parlamentare, kërkonin ndërrimin e karakterit nacional të Maqedonisë, me çka do barazohej pabarazia institucionale e të gjitha nacionaliteteve që jetonin në këtë shtet të posaformuar.¹⁴ Kërkesa bazë e këtij dokumenti ishte kërkesa për Parlament dydhomësh, mekanizëm ky që do mundësonte barazi për të gjithë, duke eliminuar mbivotimin e pakicës ose shumicës më të vogël, siç ishin shqiptarët, në raport me maqedonasit.

5.Zgjedhjet e para parlamentare në Maqedoni dhe pjesëmarrja e partive politike shqiptare në to

Zgjedhjet e para parlamentare demokratike në Maqedoninë e kohës, ashtu si edhe në republikat tjera jugosllave, u zhvilluan në rrethana dhe atmosferë me shumë të panjohura. Partitë e posaformuara, ende pa i konsoliduar radhët e veta dhe të papërgatitura për modelin e zgjedhjeve sipas kriterëve të një shoqërie plurale e demokratike, këto zgjedhje i pritën me dilemën e madhe se çka do sillnin ato rezultate për ardhmërinë e kësaj republike që ende nuk ishte shkëputur nga Beogradi. Partitë shqiptare, përveç entuziazmit dhe dëshirës se megjithatë erdhi koha për të zgjedhur drejperdrejt përfaqësuesit e vet në organet shtetërore, nuk kishin ide kreative se si do veprojnë në kushtet e reja sapo të krijuara që e kishin përgatitur terrenin drejtë

¹² Zeqirija Rexhepi, Zvillimet Politiko-Shoqërore të Shqiptarët në Maqedoni 1990-2002, Tetovë 2005, f.66, dokumenti me nr 0202-312/1

¹³ Arkivi i PDSH, Tetovë

¹⁴ Arkivi i PDSH Tetovë

një gare politike e cila që në fillim u pa se planifikon hile për partitë shqiptare, madje qysh në Ligjin zgjedhor, kur sipas 120 njësive zgjedhore, për një deputet shqiptar duheshin shumë më tepër vota se sa për ato maqedonas, madje në disa njësi zgjedhore mund të ishin dyfishi apo trefishi i numrave të votave për një deputet maqedonas. Për këto zgjedhje, rezultatet e tyre dhe epilogun përfundimtar se kah do ia mbajë kjo Republikë, drejt rrugës së pavarësisë, nëse do fitonin forcat nacionaliste djathtiste apo vazhdimet të jetës së „vëllazërim bashkimit” në një lidhje pak më ndryshme se ajo e Jugosllavisë së Titos, ende ekzistonin dilema të mëdha. Qarqet demokratike, të brenshme dhe të jashtme shpresonin se me këto zgjedhje Maqedonia si shoqëri multietnike do reflektojë për një shtet të barabartë të të gjithëve, ndërsa ato me ide nacionaliste dëshironin një shtet maqedonas, me shqiptarë të marginalizuar dhe pa ndonjë ndikim në jetën e organizimit politik. Në të këtilla rrethanash, kur të gjithë pritnin një të ardhme më të mirë, u organizuan Zgjedhjet e para parlamentare, pasi Parlamenti i ish sistemit të kësaj njësie federale, më 20 shtator 1990 i votoi amandamentet e Kushtetutës së RM, që u hapën rrugë këtyre zgjedhjeve historike.

Me këtë zgjedhje përfundoi monopoli politik i Partisë komuniste që sundoi një gjysëm shekulli. Kjo përmbysje e madhe ndodhi pikërisht më datë 11 nëntor, kur për herë të parë zhgjedhësit u drejtuan drejt kutive të votimit për t’i votuar të zgjedhurit e vet legjitimë. Megjithatë këtë arritje që e solli koha, këto fillime demokratike u keqpërdorën nga shumica maqedonase, të djathtë e të majtë, duke manipuluar me zgjedhjet në dëm të shqiptarëve sepse gjatë periudhës moniste 50 vjeçare ishin mësuar që shqiptarët t’i shohin në margjinat e jetës politike. Përveç zhgënjimit të shqiptarëve pas zgjedhjeve sepse ndryshimet ishin vetëm formale, ndërsa në esencë politika antishqiptare mori përmasa më të ashpra, me jetën politike plurale nuk ishin të kënaqur madje as një pjesë e madhe e maqedonasve. Edhe pse u krijua Parlamenti demokratik shumpartiak, si bazë për shtet ndërtimin e Maqedonisë së re, përveç oligarkisë udhëheqëse, klasa e mesme dhe ajo e ulëta filluan të varfërohen gjithnjë e më tepër. Privatizimi i shumë ndërmarrjeve shoqërore e shtetërore, më shumë i ngjasonte një plaçkitjeje klasike, sepse ato u bënë pronë e politikanëve qeveritarë, familjarëve, miqëve e bashkëpartiakëve të tyre. Në sferën politike e shoqërore, sidomos në rrafshin e demokratizimit të shoqërisë ku vend të rëndësishëm duhej të zinte përparimi i lirive individuale dhe kolektive, nuk u arrit asgjë që

meriton të veçohet, ndërsa kundërthëniet ndëretnike në shumë momente e arritën pikën e vlimit duke u shndërruar në konflikte të hapura ndërmjet shtetit dhe kolektivitetit shqiptar të organizuar në parti politike.¹⁵

Atmosfera parazgjedhore ishte e tensionuar nga shkaku se partitë politike pa përvojë dhe me dallime të theksuara programore me njëra tjetrën, kundërshtarin politik e shihnin jo si oponentë politik por si armik. I tërë ky mosbesim mes dy taborreve të bllokut maqedonas, vinte nga shkaku se ende nuk ishin të profilizuar dhe të përcaktuar se çfarë shteti do të ndërtojë fituesit. Partia që trashëgonte ish Partinë e LKJ-jës, edhe pse e reformuar, nuk ishte shkëputur definitivisht nga e kaluara e përbashkët, gjë që u dëshmuo edhe në pyetjen e Referendunit për pavarësinë e shtetit, ku nuk u përjashtua edhe lidhja e mundshme me njërën nga republikat jugosllave. Partia VMRO-DPMNE ishte për shtet të pavarur dhe shkëputje të çdo lidhjeje me ish Jugosllavinë, ndërsa shqiptarët ende shpresonin për një shtet plotësisht të barabartë ku do jenë shtetformues, që do i eliminonte barrierat kufiuese të të drejtave të shqiptarëve, siç ishin, mbyllja e shkollave të mësme shqipe përmes të ashtuquajturave paralele të përziera, mospërzierje e organeve administrative në emërimin e fëmijëve të posa lindur, përdorimi i toponimeve në gjuhën shqipe, përdorimin e gjuhës shqipe në dokumentacionin pedagogjik dhe administratën shkollore etj. Të gjitha këto ndalesa dhe kufizime të atyre pak të drejtave të trashëguara, në prag të zgjedhjeve ishin pjesë e fushatës parazgjedhore të partive politike shqiptare, që nga partitë nacionaliste maqedonase konsideroheshin si provokime me elementë nacionalistë. E tërë kjo atmosferë ndiqej edhe nga faktori ndërkombëtarë, të cilët ishin gjithashtu të shqetësuar se do jenë apo jo këto zgjedhje demokratike e të lira. Këto zgjedhje do mbahen mend te shqiptarët për një solidaritet të paparë deri atëherë mes tyre. Ardhja masive e shqiptarëve të diasporës për të votuar, krijoi atmosferë festive për fitore që konsiderohej edhe si historike, ndërsa i tërë ky solidaritet mes veti, te maqedonasit shihej si kërcënim për ekzistencën e tyre dhe të shtetit që e konsideronin vetëm të vetin.

Pas raundit të dytë, u zgjodhën gjithsej 120 deputet, nga të cilët 93 maqedonas 23 shqiptarë, 2 romë, 1 jugosllav dhe 1 muslimanë.¹⁶ Sipas rezultateve përfundimtare, në këto

¹⁵ Etem Aziri, Organizimi Politik i Shqiptarëve të Maqedonisë, Shkup 2004 f. 103

¹⁶ Po aty, faq 208

zgjedhje fuan këto parti politike, koalicione dhe kandidatë të pavarur: VMRO-DPMNE, 38 deputetë

- Lidhja e Kunistëve të Maqedonisë-artia për transformim Demokratik,31 deputetë;
- Partia për Prosperitet Demokratik, 17 deputetë;
- Lidhja e Forcave Rreformuese, 11 deputetë;
- Lidhja e forcave Reformiste, Partia e Re Demokratike, 6 deputetë;
- Koalicioni: PPD-PDP, 5 deputetë;
- Partia Socialiste e Maqedonisë, 4 deputetë;
- Partia Jugosllave e RSM, 2 deputetë
- Partia Demokratike Popullore, 1 deputetë
- Partia për emacipimin e plotë të Romëve, 1 deputetë;
- Koalicioni: Lidhja e Forcave reformuese- Partia e Re Demokratike dhe Partia Socialiste e Maqedonisë, 1 deputet;
- Kandidatë të pavarur, 3 deputetë¹⁷

Shqiptarët në këto zgjedhje fituan 23 deputetë, edhe pse realisht duhej të fitonin më tepër. Për shkak të Ligjit Zgjedhor, që nuk ishte në favor të shqiptarëve dhe manipulimeve të natyrave tjera, shqiptarët humbën disa deputetë. Edhe pse me numër më të vogël deputetësh, sipas numrit të përgjithshëm të votuesve shqiptarë, forcat nacionaliste maqedonase, fitoren e deputetëve shqiptarë e konsideronin si kërcënim për palën maqedonase. Këto forca me mentalitet nga e kaluara nuk mund të pajtoheshin me 23 ulëset që u takonin shqiptarëve në Parlamentin e Maqedonisë, madje ato në mes dy raundeve zgjedhëse organizuan protesta me parullat fyese dhe denigruese për shqiptarët, duke kërkuar të anulohen zgjedhjet. Përmes demonstratave të organizuara kundër rezultateve ata shprehën pakënaqësinë nga procesi zgjedhor, nëpër rrugët e Gostivarit, Tetovës dhe disa vendeve tjera me parulla antishqiptare dhe antidemokratike.¹⁸

¹⁷ Zeqirja Rexhepi, Zhvillimet politik-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990- 2001, Tetovë 2018, f.29

¹⁸ Flaka e Vëllazërimit, Kërkohej përsëritje e Zgjedhjeve Shkup, 14 Nëntor 1990

Pas rezultateve përfundimtare, në afatin e paraparë me ligj, u formua Qeveria e parë jopartiake, me kryeministër Nikolla Klusevin, e përbërë nga tre nënkryetarë, pesëmbëdhjetë ministra me resor, ndër të cilët tre shqiptarë dhe katër ministra pa resor. Kjo Qeveri ishte jetëshkurtër, duke e mbaruar misionin me mosbesim nga Parlamenti. Formimi i Qeverisë politike nuk arriti të formohet në afatet e parapara, pasi mandatarin e dytë të partisë me më tepër deputetë VMRO-DPMNE, nuk arriti ta formojë qeverinë duke ia kthyer mandatin Kryetarit të shtetit i cili ia dha përfaqësuesit të dytë sipas numrit të deputetëve, Petar Goshevit i cili gjithashtu e ktheu mandatin, për ta marrë përfaqësuesi i të njëjtës parti, Branko Cërvenkovski, duke e anashkaluar partinë e tretë me numër deputetësh PPD-në. Nga vet fakti që Qeveria e parë mbipartiake, nuk e mbaroi as gjysmën e mandatit, ndërsa ajo ploitike pati probleme të formimit të saj, nënkuptohet mungesa e përvojës demokratike, fërkimet mes partive dhe mungesa e vendosmerisë se për çfarë shteti ishin përcaktuar. Për këto mosmarrëveshje të formimit të një qeverie, që gjithsesi duhej të jetë e koalicionit, si duket, shkaktarë ishin të zgjedhurit shqiptarë, që duhej të ishin pjesë e qeverisë, e që nuk ishin të mirëpritur në bashkëqeverisje. Pikërisht kjo ishte arsyeja që mandatarin e dytë, Petar Goshev, ia ktheu Kryetarit të shtetit, Gligorovit mandatin për formimin e Qeverisë.

Siç dihet, bashkë me zgjedhjet e para parlamentare, në Maqedoni, u zhvilluan edhe ato vendore. Edhe në këtë nivel të ciklit të parë zgjedhor, kur shqiptarët në komunat me shumicë shqiptare pritnin se do i fitojnë disa të drejta përmes vetqeverisjes lokale, sërish u zhgënjyen. Rezultatet e këtyre zgjedhjeve, përmes të cilave shqiptarët i zgjedhën kryetarët shqiptarë dhe shumicën e këshilltarëve komunalë, nuk u pritën mirë nga forcat nacionaliste maqedonase, prandaj me direktiva të pushtetit qendror, autoritetet lokale të mëparshme, të emëruar nga regjimi komunist, nuk i përfillën rezultatet zgjedhore demokratike dhe duke mos i njohur të zgjedhurit e popullit, vazhduan t'i udhëheqin komunat dhe këshillat ekzekutivë, sikur nuk ka pasur fare zgjedhje në kushte pluraliste. Ata nuk donin t'i lëshojnë hapësirat e objekteve të komunave, të sigurtë se për mosnjohjen e realitetit të ri, nuk mund të përgjigjen penalisht sepse kështu donte edhe qeveria, që ishte zgjedhur në mënyrë demokratike. Këshilltarët shqiptarë, që e përbënin shumicën dhe kryetarët e këtyre komunave, të zgjedhur në mënyrë demokratike, vepronin jashtë objekteve zyrtare në të cilat ishin instaluar Këshillat e ashtuquajtur të

përkohshëm, që udhëhiqeshin nga individë jolegjitim, të emëruar nga Qeveria. Me këto veprime joligjore dhe antidemokratike, Qeveria e Maqedonisë i shkeli rëndë parimet demokratike dhe votën e lirë që i legjitimoi përfaqësuesit e vet pët të udhëhequr me komunat ku kishin fituar, ashtu si edhe komunat tjera të përziera me shumicë maqedone. Me rastin e konstituimit të Kryetarit dhe këshillit të Komunës së Tetovës dhe Gostivarit, partitë maqedonase e lëshuan mbledhjen dhe i zgjodhën organet paralele të kësaj Komune. E tërë kjo anarhi e krijuar pikërisht kur më së tepërmi duheshin respektuar ligjet dhe kushtetuta, edhe ashtu siç ishte, çoi deri te emërimi i udhëheqjes teknike në Kunën e Tetovës, që veprroi në mënyrë joligjore. Në komunat ku shqiptarët ishin në numër të konsiderueshën, gjatë procesit të konstituimit të organeve komunale, as që u morën parasysh propozimet e këshilltarëve shqiptarë.

Elita politike maqedonase, e vetëdishme se me ngulfatjen e demokracisë deri në këtë masë, që kulmoi me suspendimin e organeve komunale, të zgjedhura në mënyrë demokratike, të vetëdishëm së më këtë opolitikë restriktive më së shumti dëmtohet vet shteti dhe ardhmëria e tij demokratike, lëshuan pe në këtë drejtim dhe komunat shqiptare vazhduan veprimtarinë e tyre në kushte pluraliste, realitet ky që vështirë gëlltitej nga nacionalistë maqedonas , të cilët mendonin se edhe në këto kushte shqiptarët mund t'i detyrojnë ta mbyllin gojën. Kjo politikë restriktive për shqiptarët do vazhdojë të veprejë në mënyrë më të sofistikuar, me disa lëshime të vogla që atyre u lejonte të drejta të një pakice, edhe pse shqiptarët kurrë nuk e pranuan se në këtë shtet janë pakicë. Edhe sot, pas shumë ngjarjeve e proceseve politike që çuan deri te konflikti i armatosur dhe si pasojë, u organizua Marrëveshja e Ohrit, shqiptarët për maqedonasit janë pakicë, madje e shprehur në përqindje.

6.Raporti politik i partive politike shqiptare dhe maqedonase në bashkëqeverisje dhe kërkesat politike shqiptare

Qeveritë e Maqedonisë, që nga koha e themelimit të saj, si pjesë e Federatës jugosllave, e deri në ditët e sotme, për asnjë moment nuk e kanë qeverisur vendin pa shqiptarë, edhe pse prania e tyre më tepër ka pasur karakter dekorativ e asnjëherë vendimmarrës. Në periudhën e ish Jugosllavisë, as që ka pasur mundësi t'i dëgjohet zëri, madje as edhe kundër

politikës shtypëse, kur udhëheqja komuniste e kësaj ish Republike, në mënyrë të vrazhdë i shkelte edhe ato pak të drejta të shqiptarëve që i garantonte kushtetuta, sidomos ajo e vitit 1974. Pjesëmarrja e shqiptarëve në bashkëqeverisje në sistemin e kaluar ishte më tepër një formalitet për ta promovuar vëllazërim bashkimin, se sa të përkujdesen për të drejtat e shqiptarëve, meqë sipas politikës së LKJ-së, këto të drejta i gëzonin në mënyrë të barabartë të gjitha kombet dhe kombësitë e Jugosllavisë.

Shembjen e sistemit komunist, bashkë me shpërbërjen e Jugosllavisë, në kohën kur në skenën politike ishte paraqitur Millosheviqi, që Jugosllavinë e konsideronte si pronë të veten dhe çdo tendencë që çonte kah ndarja e saj, si kërcënim ndaj Sërbisë, shqiptarët e Maqedonisë e pritën me një shpresë se po afrohet koha ku përmes votës së lirë për të parën herë do i zgjedhin përfaqësuesite vet . Ashtu siç u theksua më parë, që në fillimin e funksionimit të sistemit shumpartiak, me zgjedhjet e para, Deklaratën e Pavarësisë dhe Referendumin për Pvarësinë e shtetit, shqiptarët në vazhdimësi injoroheshin, bashkë me kërkesat e tyre, gjë që në vazhdimësi e thellonte hendekun mes maqedonasve dhe shqiptarëve të cilët në prag të demokracisë, me Kushtetutën e vitit 1998, i humbi edhe ato të drejta formale, që shqiptarët dhe turqit i konsideronte pjesë konstituive e shtetit. Partia e parë shqiptare dhe më e madhja, PPD-ja që gjatë kohë qëndroi në bashkëqeverisje, me gjithë kërkesat e vazhdueshme për avansimin e të drejtave të shqiptarëve që i përfaqësonin, statusi i tyre vazhdonte të trajtohet si pakicë, ndërsa të drejtat e tyre, madje edhe ato që u ishin të trashëguara, mezi se ktheheshin, për t’u konsideruar si ndonjë e arritur e madhe e partisë në pushtet. Në praninë e shqiptarëve në Qeveri, u injoruan rezultatet e Zgjedhjeve lokale në komunat shqiptare dhe u kurdisën shumë afera përmes proceseve të montuara politike në dëm të shqiptarëve, duke nisur nga

- Ngjarjet e Ldaorishtës së Strugës;
- Sulmet brutale të Policisë maqedonase në Bit Pazar të Shkupit;
- Sulmet brutale policore kundër ngritjes së Universitetit në gjuhën shqipe, në Tetovë;
- Afera e armëve;
- Sulmet brutale të policisë në Gostivar dhe Tetovë, në korrik të vitit 1997’

- Proceset e montuara politike kundër udhëheqësve shqiptarë të komunave të Tetovës dhe Gostivarit.¹⁹

Përmes kësaj kronologjie të zesë për shqiptarët, shihet se çfarë raportesh kishin shqiptarët me maqedonasit gjatë bashkëqeverisjes së tyre për këtë periudhë kohore. Edhe pse ministrat shqiptarë dhe udhëheqës të disa drejtorive dhe institucioneve, që krahasuar me numrin e përgjithshëm të shqiptarëve, ishin simbolike, nuk kishin asnjë fuqi për t'i parandaluar këto sulme brutale të Qeverisë, pjesë e së cilës ishin edhe vet. Kjo politikë antishqiptare u paralajmërua që në hapin e parë të shpalljes së Maqedonisë si shtet të pavarur, që ishte Deklarata e Pvarësisë së Maqedonisë, që u soll me 25 janar 1991.²⁰

Kjo deklaratë që Maqedoninë e përcaktonte si shtet nacional vetëm të maqedonasve, duke i përjashtuar shqiptarët, hasi në veshë të shurdhër të pjesës më të madhe të partisë shqiptare në pushtet, PPD-së, duke e konsideruar atë vetëm si dokument politik, pa ndonjë pasojë juridike, vlerësim ky që u bë publik në Konferencën e dytë të kësaj partie, që u mbajt në Shkup, më 19 maj, 1991. Me këtë rast në raportin e Kryesë së Partisë thuhet: „Deklarata duhet të trajtohet si akt politik e kurrësi kushtetues, ajo përmban thënie parimore dhe nuk është vendim. Kjo, popullit maqedonas nuk i jep të drejtë të vendosë për popujt tjerë të Maqedonisë, veçanërisht për shqiptarët”.²¹ Vlerësimi i Kryesisë së Partisë ishte shumë i dëmshëm për të ardhmen e shqiptarëve në këtë shtet që sapo krijohet. Ky qëndrim ishte gabimi i parë serioz i të zgjedurve të popullit, mbase edhe si rezultat i mungesës së përvojës politike dhe mosnjohjes mirë të akteve juridike, apo veprimi i vetëdijshëm për pasojat që do t'i kishte për shqiptarët, por që siguronte jetë më të gjatë në qeverisjen e përbashkët. Sidoqoftë, maqedonasit me këtë mosreagim të shqiptarëve dhe me përkrahjen e tyre, e panë se nuk do e kenë vështirë me to deri në rrumbullakësimin e plotë të shtetformimit të Maqedonisë. Të gjitha këto sjellje brutale, qeveritare në praninë e shqiptarëve të cilët në vazhdimësi ishin pjesë e saj, zhvilloheshin nën patronatin e Kryetarit të parë të Maqedonisë së pavarur, Kiro Gligorov, një politikan me përvojë të madhe politike, komunist që diti t'u përshtatej rrethanave të reja të kohës në Maqedoni dhe

¹⁹ Zeqirija Rexhepi, Zvillimet Politiko-Shoqërore të Shqiptarët në Maqedoni 1990-2002, Tetovë 2005, f.37

²⁰ Flaka e Vëllazërimit, Deklaratë për Sovrantetin e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 27 Janar 1991, f.2

²¹ Shih te Zeqirija Rexhepi, „Koha”, Konferenca e dytë e Partisë për Prosperitet Demokratik, Prishtinë, 22 maj, 1991. F.23

kundërshtar i pavarësisë së Kosovës. Politika e tij, kinse paqësore që edhe Maqedoninë e shndërroi në „oazë paqeje”, deri diku e bindte edhe faktorin e huaj se gjoja ai është një strateg politik dhe objektiv kur flet për bashkëjetësenë në harmonizim të plotë mes qytetarëve të saj, si rezultat i së cilës, Maqedonia e fitoi pavarësinë në mënyrë paqësore. E tërë kjo politike joobjektive e tij që nuk e pasqyronte realitetin e kohës, por që përmes manipulimesh, Maqedoninë e paraqiste vendin më stabil në Ballkan, i amortizonte kërkesat e shqiptarëve, duke e bindur edhe faktorin e jashtëm se shqiptarët janë shumë lojalë ndaj politikës së kohës që udhëhiqej në Maqedoni, dhe se ngjarjet e Kosovës nuk mund të reflektohen në këtë „oazë paqeje”

Me këtë lloj politike të ashtuquajtur të ekuidistancës, ai angazhohej ta minimizojë problemin shqiptarë, duke dashur që shqiptarët e Maqedonisë t’i paraqesë si të painteresuar për tërë atë që ngjante në Kosovë dhe si lojalë ndaj Maqedonisë, sipas të cilit ato i paskan të gjitha të drejtat. Qëndrimet e tij kundër pavarësisë së Kosovës dhe aleanca e fshehtë me Millosheviqin, shihet qartë në planin tinëzar të tij, që shqiptarët e përzënë me dhunë nga politika shfarosëse serbe, përmes një korridori t’i drejtjohë drejt Shqipërisë, gjë që u pamundësua nga faktori politik shqipar në Qverinë e atëhershme të koalicionit VMRO-PDSH, të udhëhequr nga Arbën Xhaferi dhe Lubço Georgievski. Këto dy forca politike qeveritare, e luhatën në masë të madhe të ashtuquajturin kohabitacion mes Kryetarit të shtetit dhe Qeverisë së atëhershme. Ai si mik i Sërbisë që ishte, në kohën e luftës në Kosovë, u mundua ta pengojë logjistikën e trupave të NATO-S në Maqedoni, por edhe kësaj radhe Qeveria e Kalicionit ia pamundësoi planet proserbe. Këto qëndrime mbështetëse për Serbinë e Millosheviqit, Glogorov nuk mund t’i maskojë, prandaj në librin e tij „Makedonija e Sve sto Imame”, të botuar më 2002 në Shkup, me rastin e vizitës së Kryeministrit të përkohshëm të Kosovës, Hasim Thaçi në Shkup dhe Kryeministrit Lupço Georgievskit në Prishtinë, shprehet: „Vizita e Hashim Thaçit në Shkup, në cilësinë e Kryeministrit të përkohshëm të Kosovës dhe vizita e Kryeministrit të Maqedonisë, Lupço Georgievski në Prishtinë, si dhe synimi i hapjes së përfaqësisë maqedone në Kosovë, është negative. Sipas tij, këto qëndrime e llogarisin Kosovën si fqinj të pestë të Maqedonisë. Në tërë politikën e

Georgievskit, ka një prapavijë të thellë, në të cilën ndikim të madh në Qeveri ka faktori shqiptar, përmes partisë së Arbën Xhaferit, e cila haptazi insiston për Kosovën e pavarur, konsaton ai.²²

Kërkesat e fazës së parë të shqiptarëve, ishin për kthimin e disa të drejtave që i kishin humbur në dhjetëvjetshin e fundit të sistemit komunist, sidomos kah viti 1984, kur intensiteti i ngulfatjes së të drejtave që zhvillohej në kuadër të diferencimeve politike, kishte marrë përmasë të padurueshme. Kulminacioni i kësaj politike ishte mbyllja e shkollave në gjuhën shqipe dhe ndalesa e shkrimit të kësaj gjuhe, kudo ku ishte përdorë më parë. Me gjithë këto kërkesa të vazhdueshme të shqiptarëve, autoritetet qeveritare as që donin të merreshin më këtë problematikë, madje edhe në kohën kur shqiptarët vepronin të organizuar politikisht dhe ishin pjesë e Qeverisë. Fillimisht, edhe pse jo me vullnet të mirë, gjatë qeverisjes së përbashkët, të fillimeve të pluralizmit politik disa kërkesa u plotësuan, siç është rikthimi i paraleleve me mësim në gjuhën shqipe, lirimi i disa arsimtarëve nga përgjegjësitë për vepra kundërvajtëse që nuk e kishin zbatuar ligjin për administratën shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik dhe ndonjë punësim të shqiptarëve në administratën publike, krejt simbolike. Pas një sërë ndryshimesh, dhe aktiviteteve, si: Zgjedhjet e para parlamentare, Miratimi i Kushtetutës, Deklarata e Pvarësisë dhe Shpallja e Pvarësisë së Maqedonisë me emrin kushtetues, shqiptarët pas një sërë kërkesash, që nuk ndryshonin shumë nga ato që u përfshinë më vonë në Marrëveshjen e Ohrit, por që kurrë nuk u plotësuan, vendosën për një kërkesë të përgjithshme, në kuadër të së cilës do zgjidhej definitivisht çështja shqiptare në Maqedoninë e atëhershme, e ajo ishte Autonomia Politike-Territoriale, që do njihej si Republika autonome Ilirida, edhe pse në pyetjen për Referendum, nuk figuronte emri Republikë e as Iliridë.²³

Me këto kërkesa të shqiptarëve, madje të vërtetuara edhe zyrtarisht përmes dy partive shqiptare që vepronin njëra në opozitë, PDP dhe tjetra në Qeveri PPD, as që merreshin autoritetet përgjegjëse, siç ishte edhe Kryetari i shtetit. Në dokumentin e subjektit politik shqiptar PPD, që i drejtohet Kryetarit të Shtetit, Kiro Gligorovit, në të cilën si kusht për daljen e popullit shqiptar, në plebishit, kërkohet: Rihapja e paraleleve në gjuhën shqipe për shkollat e mesme, anulimin e dënimeve për punëtorët e arsimit për mbajtjen e evidencës pedagogjike, konstituimin

²² Kiro Gligorov, Makedonija e sve sto imame, Shkup 2002, f.463

²³ Shih Zeqirja Rexhepi, f.55, „Zëri”, Ilirida, Republika e tretë shqiptare në Ballkan, prishtinë, 1 prill, 1992, f. 14

dhe fillimin e funksionimit të kuvendeve komunala të Terovës dhe Gostivarit, sipas rezultateve të zgjedhjeve. Një tjetër dokument gjithashtu i rëndësishëm për kërkesat e shqiptarëve është shkresa që përmban deklaratën e grupit parlamentar të PPD –së dhe PDP –së, për status të barabartë të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë.²⁴

Pas një sërë ndryshimesh, dhe aktiviteteve që ndodhën në Maqedoninë pluraliste si: Zgjedhjet e para vendore e parlamentare, Miratimi i Kushtetutës, Deklarata për Pavarësinë e Maqedonisë dhe shpallja e Pvarësisë së Maqedonisë, duke mos u përfillur shqiptarët dhe kërkesat e tyre, ato vendosën për një kërkesë globale , në kuadër të së cilës do zgjidhej përfundimisht çështja shqiptare në Maqedoni, e ajo ishte Autonomia Politike Territoriale, që do bëhej pjesë e Kushtetutës me emrin „Republika Autonome Ilirida”, edhe pse në pyetjen për referendum, nuk figuronte emri Republikë e as Ilirida. Për fat të keq, kjo kërkesë, që përmes Referendumi të mori edhe verdiktin e popullit shqiptarë të Maqedonisë, e organizuar nga dy partitë shqiptare të kohës, PPD dhe PDP, Kryetarëve shqiptarë të komunave dhe të zgjedhësve të popullit në nivel lokal dhe qendror, të shpallur dhe të udhëhequr nga Kuvendi i Referendumi, i formuar po nga këta subjekte, hasi në vesh të shurdhër, jo vetëm nga Qeveria e Maqedonisë, por edhe nga ndërkombëtarët të cilët autoritetet më të larta shetërore i kishin keqinformuar se rezultati i Referendumi është joobjektiv dhe i falsifikuar. Referendumi për Autonomi Politike e Territoriale u organizua nga kuvendi i Autonomisë, i dalë nga partitë shqiptare, më 11 e 12 janar 1992, që erdhi edhe si rezultat i Referendumi për pavarësinë e Maqedonisë, të mbajtur më 8 shtator 1991, me pyetjen: „A jeni për Maqedoninë si shtet sovran me të drejtë që të hyhet në Lidhjen e shteteve sovraane të Jugosllavisë?

Edhe pse Referendumi shqiptar në Republikën e Maqedonisë ishte mirë i organizuar dhe me rezultat pozitiv afër qind për qind të deklarimit të qytetarëve shqiptarë, si duket do mbetet ngjarje historike ndër më seriozet për shqiptarët e këtushëm, që nuk u realizua edhe përshkak të plogështisë politike të përfaqësuesve të popullit, të zgjedhur në Zgjedhjet e para parlamentare. Subjekti politik shqiptar, pjesëmarrëse në Qeveri me gjithë kërkesat drejtuar asaj Qeverie për ndryshimin e Kushtetutës, arsyeshmërisë për këto ndryshime dhe ndryshimin e


²⁴ po aty, f. 46

Preambullës, nuk arriti më tepër në jetësimin e kësaj kërkesë plebishitare të shqiptarëve. Mosharmonizimi i mendimit politik i faktorit shqiptar, kundërthëniet mes tyre që këtë kërkesë ta shtyjnë përpara dhe indiferentizmi i një pjese të madhe të autoriteteve partiake, nga njëra anë dhe veprimet më këmbëngulëse të anës tjetër të faktorit politik shqiptar, që kërkonin jetësimin e Referendumit, çoi deri shenjat e para që paralajmëronin përçarje serioze.

KAPITULLI



PËRÇARJET NË PARTINË PËR PROSPORITET DEMOKRATIK DHE PARAQITJA E ARBËN XHAFERIT NË SKENËN POLITIKE



- 1.Shkaqet që sollën deri te përçarja e Partisë për Prosperitet Demokratik
- 2.Statutet dhe programet e partive politike shqiptare në raport me kërkesat politike dhe juridike të shqiptarëve
- 3.Paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në Maqedoni
- 4.Vështirësitë e kompromiseve në raport me kërkesat e shqiptarëve

1.Shkaqet që sollën deri te përçarja e Partisë për Prosperitet Demokratik

Ashtu siç në shumë parti politike në sisteme pluraliste paraqiten fraksione brenda për brenda partisë, e që shpesh përfundojnë me ndarje, madje edhe bashkime të dy partive politike, në raste përputhjeje të programeve partiake, edhe PPD, pas disa plasaritjeve si shkak i mosharmonizimit të disa ideve për veprim ppolitik dhe i mendimit ndryshe për çështje madhore e me interes kombëtar, çoi deri te formimi i dy fraksioneve brenda saj, e më vonë deri te ndarja përfundimtare. Për shkaqet e kësaj ndarjeje të Partisë së parë shqiptare në Maqedoni, janë dhënë vlerësime të ndryshme nga analistë, opinionistë dhe studiues të shumtë. Në disa vlerësime individësh me ngjyrim partiak, për këtë fenomen politik, vërehen qëndrime joobjektive, me konstatimet se Partia e parë shqiptare si një lëvizje gjithkombëtare, mund ta rrezikonte politikën antishqiptare të Qeverisë së porsa formuar të shtetit. Sipas vlerësimeve të kësaj kategorie analistësh, një pjesë e të cilëve ishin larguar nga kjo forcë politike kur PPD po dobësohej dhe po e humbëte përkrahjen në popull, mendonin se pushteti duke e parë si rrezik për konceptin e tyre të organizimit monoetnik të këtij shteti, këtë Parti e përçanë përmes shërbimeve të brendshme dhe të jashtme, tezë kjo që në njëfarë mënyre, nuk përjashtohej edhe nga qarqe të ndryshme shtetërore, për t'i njollosur forcat e reja fraksioniste që çuan deri te përçarja. Për këtë përçarje ekzistojnë edhe shumë mendime tjera, që nuk bazohen në vlerësimin vetëm bardhë e zi, por në mënyrën e organizimit të kësaj force politike, që në momente kyçe, kur po ndërtohej ky shtet vetëm si maqedonasve, nuk kishte guxim, vullnet e as dije t'i kundërvihen këtij modeli te shtet ndërtimit duke i eliminuar shqiptarët.

Që historia e përçarjes së këtij subjekti politik të qartësohet tërësisht, gjithsesi duhen analiza më të thelluara, duke nisur që nga themelimi i Partisë, që nuk ka dyshim se ishte rezultat i pritjes së gjatë për këtë moment historik për shqiptarët, individët që e udhëhiqnin Partinë, në mesin e të cilëve edhe shumë shqiptarë që ishin në gjendje edhe të flijonin për kauzën shqiptare, e deri te mosrespektimi i kreut të Partisë nga një pjesë e grupit parlamentar. Këto lëshime me, apo pa dashje të një pjese të Kryesisë së PPD-së, në momente kur çdo lëshim, vështirë se mund të përmirësohet, i sollën plasaritjet e para brenda Partisë. Për këto defekte të veprimit politik

dhe organizativ, të Kësaj partie, prof. Etem Aziri, në tekstin e vet universitar „Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni”, ndër të tjera konstaton se logjika e veprimit politik jep shumë prova se në disa momente më frytdhënës është uniteti i rrejtshëm se sa ndarjet, por në disa rrethana tjera, pa dyshim ndarjet janë shumë më të dobishme se uniteti i rrejtshëm.²⁵ Për rastin konkret në momentet e caktuara, mendoj se kjo plasaritje, që çoi deri te ndarja është më e mirë se uniteti i rrejtshëm, sepse me fshehjen e realitetit, në emër të unitetit që nuk mund t’i bënte ballë makinerisë politike të partive maqedonase, që herë njëra e herë tjetra e udhëhiqnin Qeverinë, futej huti edhe te faktori ndërkombëtarë për pozitën e nënshtruar, të drejtat politike dhe statusin juridik të etnitetit shqiptar. Në të njëjtën vepër, autori i radhit disa arsye për këtë përçarje, duke nisur që nga themelimi i Partisë dhe i qëllimit të mirë të ngrëzve të sinqertë të cilët e përkrahën këtë opcion politik, meqë e kishin kuptuar se organizimi politik në kushte pluralizmi ishte e vetmja shpresë që shqiptarët vet të vendosnin për ardhmërinë e tyre. Një grupacion tjetër që u inkuadruan në këtë lëvizje, nëse mund ta quajmë kështu, ishin me prejardhje të sistemit të mëhershëm totalitar, disa nga të cilët, me sinqeritet e përkrahën këtë model të veprimit politik, për t’u ndarë gjithmonë nga e kaluara e tyre. Nuk munguan as edhe ata të cilët kishin qenë të persekutuar nga ish sistemi. Një kategori njerëzish që u inkuadruan gjithashtu ndër të parët në këtë Parti dyshoheshin se ishin personat e infiltruar nga shërbimet e ndryshme. Sidoqoftë, ky fillim i jetës politike i një etape të re, shënon hapin e parë historik të veprimtarisë organizative pluraliste.

Partia e parë shqiptare, që organizimin e vet e filloi me një strukturë heterogjene, përballë dy partive maqedonase; VMRO-DPMNE-së, nacionaliste dhe trashëgimtares së LKJ-së, që tani më kinse e reformuar, me emrin LSDM, e kishte vështirë ta realizojë programin e vet partiak, që i artikulonte kërkesat e shqiptarëve. PPD-ja, edhe pse në Qeveri, e pak më vonë edhe PDP-ja opozitare, ishin gjithmonë të mbivotuara në Parlamentin e Republikës, nga deputetët e dy partive maqedonase, njëra me orientim të djathtë e tjetra me orientim të majtë, por gjithmonë me pikpamje të përbashkëta në qëndrimet e tyre kundër kërkesave shqiptare. Arbër Xhaferi, qysh në fillimet e tij të aktivitetit politik në këto hapësira, sapo i kishte njohur orientimet

²⁵ Etem Aziri, Organizimi Politik i Shqiptarëve të Maqedonisë, Shkup, 2004, f.171

antishqiptare të këtyre dy partive, edhe pse me qasje të ndryshme nga njëra tjetra, pat deklaruar: „VMRO-DPMNE “ kultivon një nacionalizëm transparent që shihet dhe që të lë kohë të mbrohesh nga ai. Ndërkaq LSDM-ja kultivon një nacionalizëm tinëzak, ose të kamufluar, që synon të vërë në gjumë si faktorin shqiptar ashtu edhe ate ndërkombëtar”. Ky vlerësim i tij, i vërtetuar dhe i pranuar edhe nga shumë të tjerë si i tillë, për dy partitë më të mëdha të bllokut maqedonas, në një rën anë dhe mungesa e bashkëpunimit të partive shqiptare, për t’i koordinuar veprimet për interesa madhore, përballë politikës antishqiptare, për fat të keq vazhdoi për një kohë shumë të gjatë. Edhe pse partitë shqiptare, kishin programe dhe statute që i përfshinin kërkesat e përfaqësuesëve të vet, atyre u mungonte një platformë unike me metodologji unike, që do i zgjidhnin disa nga kërkesat më të rëndësishme shqiptare.²⁶

Mungesa e veprimit konkret politik e PPD-së për t’i përdorë të gjitha mjetet demokratike të mundshme, pa e përjashtuar edhe bojkotin, si të drejtë demokratike dhe tendenca e saj për amortizimin e kërkesave të krahut më të vendosur, që vazhdimisht ua prishte rehatinë në Parlament e Qeveri, e detyroi krahun “radikal”, që të tregojë padëgjueshmëri dhe të vetëorganizohet nëpër degë e nëndegë përmes aktiviteteve politike, paralel me ato të organeve „legjitime”. Këto çarje, që dita ditës vinin duke u shndërruar, në hendek të thellë, kulmin e arritën në Kongresin e dytë të jashtëzakonshëm të Partisë, që u mbajt në Shtëpinë e Kulturës në Tetovë, më datë 12 dhe 13 shkurt 1994. Këto fërkime ideologjike dhe mospajttime, mes dy rry mash që në këtë Kongres përfunduan me ndarjen në dy pjesë të Partisë, zanafillën e kishin shumë më herët, qysh në Kongresin e Parë të kësaj Partie, të mbajtur më 8-9 shkurt, 1992, pas Referendumit për Autonomi politike e terroriale të shqiptarëve në Maqedoni. Gjatë këtyre diskutimeve që morën kahe të kundërta lidhur me aktualitetin e politikës në Maqedoni dhe veçmas të mungesës së një politike parimore shqiptare me stragjedi afatgjatë për kërkesat jetike të tyre, dolën në shesh shumë të panjohura deri atëherë për publikun. Grupacioni i krahut më të butë politik, që nuk e kishte guximin të përballet më aleatët e vet qeverisës, zgjodhi variantin oportunist të (mos) veprimit politik. Kjo vijë politike nuk e kundërshtonte Deklaratën Kushtetuese, e përkrahte Referendumin për shpalljen e Pavarësisë së Maqedonisë, edhe pse të bojkotuar nga shqiptarët

²⁶ Arbën Xhaferi, Vepra 05. Intervista 1995-2005, Tiranë, f. 99

të cilët i përfaqësonin, ashtu siç e përkrahte edhe miratimin e Kushtetutës, të cilën nuk e votuan në Parlament. Këtë veprim praktik politik të grupit lojal ndaj pushtetit, edhe pse nuk e shprehnin aq haptas, e kundërshtonte në vazhdimësi krahu që rrugëdaljen nga kjo krizë e politikës shqiptare, nuk e shihte në veprimet gjysëm të fshehta të këtij grupimi të bashkëpartiakëve. Ishte gati e pritshme që të gjitha këto vlime të brendshme, si rezultat i mospajtimeve për çështje kaq madhore, një ditë do përfundojnë me ndarje, prandaj kur i kemi parasysh të gjitha këto arsye, teza se ata që u bënë shkaktarë për përçarjen e PPD-së, ishin njerëz të shërbimeve të ndryshme, nuk kanë asnjefarë baze. Nëse dikush është i prirur të mendojë kështu për ndarjen, atëherë, cili do ishte qëndrimi i tij për bashkimin sepse ato që në një moment historik u ndan, më vonë u bashkuan me një parti tjetër të shqiptarëve- PDP-në, që ashtu si PDSH-ja më tepër qëndruan në opozitë. Pas një periudhe kohore të bashkëveprimit opozitar të këtyre dy partive që në plan të parë i kishin kërkesat e shqiptarëve, bazuar në programet e tyre, u pa e arsyeshme se këto dy forca politike, të udhëhequra nga Arbën Xhaferi dhe Iljaz Halimi, duhej të bashkohen në një subjekt politik. Ky bashkim ndodhi në Kongresin e përbashkët, që u mbajt në Tetovë, më 6 korrik 1997, nga i cili doli partia e vetme PDSH, me kryetar Arbën Xhaferin. Edhe me këtë rast, Arbën Xhaferi në fjalën e vet falënderuese, pas zgjedhjes Kryetar i Partisë së bashkuar, u shpreh se kjo Parti assesi nuk do ketë qëndrim armiqësor kundër PPD-së, përkundrazi, do bashkëpunojë me pjesën e shëndosh të saj, për t'i çuar proceset përpara e në interes të shqiptarëve. Me këtë rast po shkëpusim një pjesë të fjalës së tij: *Në asnjë mënyrë nuk do të insistojmë ta shkatërrojmë PPD-në, por do të tentojmë t'i rrëzojmë ato struktura, ato bastione kundërshqiptare që janë të inkuadruara në këtë sistem që nga viti 1945, e që janë vënë në shërbim kundër shqiptarëve. Qëllimi im është të formojmë një bazë të fortë të strukturave politike shqiptare dhe për këtë do kërkojmë edhe ndihmën e PPD-së. PDSH-ja tërë potencialet e veta do t'i vë në funksion të krijimit të sintezës institucionale në Maqedoni, duke nxitur kështu energjinë pozitive dhe ndërtuese në të gjitha hapësirat kombëtare.*²⁷ Ideja e Arbnit për formimin e sintezës institucionale në Maqedoni, që do i nxiste energjitë pozitive dhe ndërtuese në të gjitha hapësirat kombëtare, i ngjante një programi të përgjithshëm që do ishte me interes mbarëkombëtarë. Mbase kjo ide e tij, që i kaloi

²⁷ Etem Aziri, Organizimi Politik i Shqiptarëve të Maqedonisë, Shkup, 2004 f.88

kornizat e ngushta partiake u shtri në tërë hapësirat shqiptare, duke shërbyer si shembull uniteti, pikërisht në kohëra të vështira.

Gjatë periudhës para përçarjes së PPD-së, por në kohë të ftohjes së marrëdhënieve mes dy rrymash të kësaj Partie, ndodhi edhe Marrëveshja për largimin e Ushtrisë jugosllave nga Maqedonia, pa e publikuar se çka është biseduar mes udhëheqjes maqedonase dhe kreut ushtarak jugosllav. Ishte periudha kohore kur nga njëri krah partiak kundërshtohej koncepti „gligorovian”, ndërsa tjetri vazhdonte të merrte pjesë në Qeverinë aktuale maqedonase si partner i koalicionit qeveritar. Ishte koha kur manipulohesh me popullatën shqiptare me rastin e Referendumit të shqiptarëve.²⁸

Në Kongresin e Dytë të jashtëzakonshëm të PPD-së, pas një kohe të gjatë të kundërshtimeve politike, në mungesë të një platforme të përbashkët dhe harmonizimin e dokumenteve të Kongresit, ndodhi ndarja, ende pa filluar Kongresi punët, meqë delegatët e krahut më të moderuar nuk u futën në sallën e caktuar më parë të Shtëpisë së kulturës, për të vazhduar Kongresin në Sallën e Komunës. Për një periudhë kohore, dy krahët e ndarë, e vazhduan aktivitetin e tyre politikë me të njëjtin emër PPD, edhe pse Kongresi i përgatitur me kohë, që u mbajt në sallën e Pallatit të Kulturës, ku kryetar u zgjodh Arbën Xhaferi ishte ai legjitimi. Organet e politizuara gjyqësore të shtetit, të drejtën për trashëgimin e emrit të Partisë ia dhanë krahut të dalë nga salla e Komunës së Tetovës, ku kryetar ishte zgjedhur Xheladin Murati. Partia e udhëhequr nga Arbën Xhaferit, nuk kishte rrugë tjetër të veprimit politik, përveç që të pajtohet me ndryshimin e emrit, nga PPD, në PPDSH, që edhe i përshtatej një partie me program dhe orientim kombëtar dhe opozitë e mirëfilltë, që synim kryesor e kishte realizimin e programit partiak. Pikëpamjet politike të Kryetarit Arbën Xhaferit, të bazuara në dijet e tij teorike dhe në koncepte të një filozofie tjetërfare dhe të panjohura më parë në këto hapësira, filluan të shpalohen që në fjalën falënderuese pasi u votua për kryetar, ku nuk harroi ta përmend edhe vet ndarjen që ndodhi aty. Për këtë hap politik, ishte i përgatiturnur, meqë si mendimtar, filozof dhe publicist, që ishte, i njihte rrethanat shoqërore, dhe zhvillimet e kaheve të ndryshme më të hershme dhe ato të kohës. Me këtë rast ai deklaroi: *Këtë detyrë të vështirë dhe me përgjegjisi të*

²⁸ Shih Zeqirija Rexhepi, *Zvillimet Politiko-Shoqërore të Shqiptarët në Maqedoni 1990-2002, Tetovë 2005*, f.64,65

*madhe e mora me një brengë për shumë shkaqe, por do t'i përmendi vetëm disa: detyra e Kryetarit të partisë vjen në një kohë kur shumë procese politike kanë marrë fund. Kanë marrë fund për shkak se shumë aspekte si në kushtetutë dhe pranimi i disa shteteve kanë ngushtuar hapësirën e veprimit politik. Mirëpo kjo, megjithatë shton motivin për punë dhe shpresoj se ka hapësirë se mund të ndryshohen shumë gjëra. E dyta, për shkak se këtu sonte ndodhi një përçarje për shkaqe, të them procedurale. Ne gjithmonë përçahemi për çështje të vogla e jo për platforma programore. Kur e aprovuam programin të gjithë ishin unanim dhe të gjithë ishin njëmend që të punojmë për atë program. Unë me siguri nuk mund t'ju pretoj shumë, por do të pretoj se Partia nuk do të jetë në shërbim të personave që e drejtojnë atë, por ne, me siguri edhe unë, do të jemi në shërbim të Partisë.*²⁹

2.Statutet dhe programet e partive politike shqiptare në raport me kërkesat politike dhe juridike të shqiptarëve

Me themelimin e dy partive politike shqiptare më 1990, PPD-së, që krahas kërkesave të shqiptarëve, paraqitej edhe si qytetare dhe PDP-së, që në skenën politike u paraqit pak më vonë, si reflektim i pakënaqësive me PPD-në, ku nuk përjashtohet edhe pakënaqësia e disa personaliteteve që mbetën jashtë organizimit politik, kërkesat e shqiptarëve, tani më të përfshira në programe partiake i zyrtarizuan, por pa ndonjë sinjal nga Qeveria, Parlamenti dhe Kryetari se

²⁹ Arben Xhaferi u lind në Tetovë, në vitin 1948. Pasi e kreu shkollën fillore dhe gjimnazin në qytetin e lindjes, vazhdoi studimet në Universitetin e Beogradit, ku studioi filozofinë. Nga Beogradi kthehet në Prishtinë ku për gjashtëmbëdhjetë vjet punon në Rdiotelevizionin e Prishtinës, si redaktor i programit të kulturës. Gjatë kohë është marrë edhe me veprimtari publicistike, ku u afirmua si analistë i veçantë me mendimet e thella për vlerësimin e fenomeneve të ndryshme shoqërore, që në kohën e Jugosllavisë së përbashkët, në fillimet e shembjes së sistemit komunist e deri te formimi i partive demokratike të Kosovës. Meqë gjatë kohë punoi në Televizion, e përjetoi edhe kohën e vështirë me kërcënimet e politikës shoveniste serbe të Millosheviqit, deri në largimin nga puna, ashtu sumë kolegë të tij, pa e ndalë kurrë veprimtarinë publicistike me shkrimet analitike, gjithmonë në zbërthim të fenomeneve të ndryshme, aktuale për kohën. Aktivitetin e tij për çështjen kombëtare e kishte filluar si i ri, në moshën njëzetvjeçare, kur ishte edhe njëri nga organizatorët e Demonstratave të Tetovës, të vitit 1968. Në vitin 1993 nga Prishtina kthehet në Tetvë, për të vazhduar veprimtarinë politike në kushte pluraliste, kur së paku funksiononte fjala e lirë e të shprehurit. Në Kongresin e Dytë të jashtëzakonshëm të PPD-së, zgjidhe Kryetar Partie, duke filluar edhe aktivitetin politik praktik, pa u largua asnjëherë nga krijimtaria publicistike, ku trajtonte dhe zbërthente tema nga më të ndryshmet, që lidheshin me çështjen kombëtare globale, sepse gjithmonë ishte kundër parcializimit dhe trajtimit të çështjes përmes veprimeve lokale sepse edhe coptimi i trojeve shqiptare kishte nisur nga globalja dhe si e tillë u gjet në tryezën e fuqive të mëdha, për ta cunguar, ndarë e përçarë.

ato do plotësohen. Pushteti aktual duke e keqpërdor sundimin e shumicës, bllokonte çdo kërkesë të shqiptarëve. PPD-ja në Qeveri, që herë vepronte si lëvizje kombëtare e herë si parti e moderuar e qytetare, as që kishte kapacitete t'i tealizojë objektivat programore dhe kërkesat e shqiptarëve. PDP-ja opozitare ishte zëri më i fuqishëm në Parlament, duke e detyruar edhe Partinë shqiptare në pushtet që ta rishqyrtojë veprimin e vet politikë, për të zgjedhur lojalitetin ndaj pushtetit ku bënin pjesë, apo këmbëngulësinë në realizimin programit partiak. Në momentet kur PPD po bindej dita ditës se proceset politike u rrumbullakësuan, ndërsa shqiptarët mbetën qytetarë të dorës së dytë të këtij shteti, bashkë me partinë tjetër opozitare, vendosën që të organizojnë Referendumin e shqiptarëve për Autonomi territoriale e kulturore. Këtë hap të shqiptarëve, maqedonasit, madje edhe ndërkombëtarët e llogaritnin si radikal, madje një veprim që nuk e kishin në programet partiake, e as në statutet e tyre, që do e rregullonin mënyrën e funksionimit dhe jetësimin e kësaj kërkesë konkrete, që do i bënte të barabartë shqiptarët në territorin brenda autonomisë edhe përmes statusit juridik të tyre, si njësi e barabartë me maqedonasit. Për jetësimin e këtij projekti aq serioz parashikohej një periudhë kalimtare, gjatë së cilës do pësonte ndryshime edhe Kushtetuta e Maqedonisë. Kuvendi i Autonomisë hartoi propozimin për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së atëhershme të Maqedonisë. Në pjesën e parë të këtij dokumenti shtrohen shkaqet për ndryshimin e Kushtetutës, me kërkesën kryesore, barazinë e popullit shqiptar dhe pozita e papërshtatshme juridike kushtetuese të tij në Republikën e Maqedonisë, ndërsa në pjesën e tretë të këtij dokumenti propozohet ndryshimi i Preambullës së Kushtetutës dhe disa nene të saj.³⁰

Në fund të këtij dokumenti thuhet: *Po qe se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nuk e aprovon propozimin për ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë dhe nuk i përcakton dhe garanton kërkesat për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, do të detyrohemi që ta avancojmë përcaktimin tonë politik në përputhje me të drejtën natyrore, etnike dhe historike të popullit shqiptar për vetvendosje.*³¹

³⁰ Shih Zeqirija Rexhepi, Zhvillimet Politico-Shoqërore, në Maqedoni 1990-2001, f.60

³¹ Po aty, f. 61

Edhe pse fillimisht u pajtuan partitë politike shqiptare për këtë hap të madh, brenda partisë në pushtet pati mospajtime, duke mos qenë seriozë në veprimet e mëtejshme, prandaj ky projekt madhështor për shqiptarët e Maqedonisë mbeti vetëm në letër, pa u realizuar asnjëherë, madje as edhe pas Luftës së 2001-shit. Këtu edhe zu fillë përçarja e subjektit më të madh shqiptar, për të cilën kemi bërë fjalë më lartë.

3.Paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në Maqedoni

Ardhja e Arbën Xhaferit në Tetovë dhe angazhimi i tij i drejtpërdrejt në politikë, në momentet kur shumë procese në shtetin e posaformuar , por ende me probleme lidhur me emrin, kishin marrë fund, siç është edhe Kushtetuta e vitit 1991, që gjatë kohë ishte burimi kryesor i krizave. Kjo Kushtetutë që u miratua para syve të deputetëve shqiptarë, duke e pasur për bazë edhe Deklaratën e pavarësisë, që i hapi rrugë shpalljes përmes referendumit të pavarësisë së shtetit, të njohur nga shumë anëtare të OKB. me emrin IRJM, vazhdoi të gjenerojë kriza ndëretnike, mes maqedonasve shumicë dhe shqiptarëve jopakicë. Arbën Xhaferi, i vetëdijshëm se pala maqedonase do arsyetohet se Kushtetuta e vendit nuk e lejon realizimin e kërkesave të shqiptarëve, insistonte në ndryshimin e saj, por kërkesa e tij dhe e Partisë që e udhëhiqte, tani më me emrin PPDSH, si opozitë që ishte, nuk mund të bënte gjë në këtë drejtim, përveç aktualizimit të problemit para faktorëve të jashtëm, me të cilët në kontakt të vazhdueshëm ishte edhe Kryetari Gligorov, i cili mundohej t'i bindë ato se shqiptarët në këtë vend, i kanë të gjitha të drejtat. Me gjithë rrumbullakësimin e këtyre proceseve, për filozofinë politike të Arbën Xhaferit, edhe në këto udhëkryqe, publicisti dhe miku i Arbnit, Veton Surroi, në parathënien e librit të Enver Rubellit, „Në Tetovë, në kërkim të kuptimit“, përvrç tjerash ,do shprehej: „ Për më tepër, ai, këtë ide, do ta çojë te vet esenca e shtetit: Maqedonia ka legjimitet nëse funksionon harmonizimi i interesave politikë, gjegjësisht, vetëm nëse me këtë pajtohen edhe shqiptarët. Arbën Xhaferi e çoi këtë proces natyral në një stad të ardhshëm, po aq të natyrshëm: nëse ekziston interesi politik shqiptar, e me këtë kundruall tij edhe interesi politik dhe etnik maqedonas, atëherë qeverisja e vendit duhet të bëhet në harmonizimin e këtyre dy

interesave.”³² Ky konstatim i Surroit për hapat që do i bënte Arbën Xhaferi, flet mjaftë për idenë afatgjatë të njeriut që e sfidoi kohën duke kërkuar shtigje për të dalë ashtu i kompletuar në skenën politike që t’u bëjë ballë politikanëve maqedonas me përvojë të madhe, siç ishte Gligorov me tërë makinerinë e tij, që kishin krijuar rrethana të disfavorshme juridiko-kushtetuese për bllokimin e ecjes përpara të shqiptarëve. Shqiptarët assesi nuk pajtoheshin me statusin e tyre, edhe në kohën kur pritnin se në kushte demokratike do i realizojnë synimet e veta. Një hendikep tjetër për shqiptarët ishte edhe përfaqësimi i tyre në pushtetin ligjdhënës dhe ekzekutiv, pa ndonjë fuqi vendosëse ose parandaluese, meqë mungonte vullneti i palës maqedonase për konsensus, që do zgjidhte disa çështje të rëndësishme për kërkesat e tyre. Për Gligorovin, shumicën parlamentare dhe Qeverinë e kohës, ishin të papranueshme kërkesat e shqiptarëve për avansim të statusit të „pakicës”, në status shtetformues, kërkesë kjo e papranueshme edhe sot, madje edhe pas tetëmbëdhjetë viteve pas konfliktit të armatosur dhe Marrëveshjes së Ohrit.

Ardhja e Arbën Xhafërit në vendlindjen e vet, tani më si politikan që njërin krah të partisë atë më të fortin, siç u bë traditë të quhej, e ktheu në parti të mirëfilltë kombëtare, për Tetovën dhe tetovarët ishte lajm i mirë që e ktheu shpresën se gjërat do lëvizin nga pika e e vdekjes. Organet gjyqësore të politizuara skajshmërisht, pas një periudhe kohore të veprimit, emrin PPD, që duhej të mbetet në këtë lëvizje frakcioniste, ia la krahut të mbetur që doli nga një pjesë e Kongresit, të mbajtur në sallën e Komunës së Tetovës. Partia që padrejtësisht mbeti pa emrin fillestar, këtij emri ia shtuan shkronjën SH, që edhe i përgjigjet një partie shqiptare, pa u larguar nga emërtimi që mbeti emblemë simbolike e nismës së organizimit politik të shqiptarëve në këto hapësira. Prania e Arbnit në skenën politike dhe në postin e kryetarit, ishte risi në politikbërje, pikërisht përshkak të bagazhit intelektual dhe filozofisë së re politike, që dëshmohej me retorikë të veçantë. „, i quajtur radikal prej disa shqiptarëve dhe prej shumë mediave maqedonase, ai do të fliste për Rusonë dhe kontratën sociale. i ardhur në krye, si lider, në valën e kundërthënies, solli fjalorin e tij intelektual, dhe me një model të cilin filluan ta admirojnë politikanët e rinj shqiptarë të Maqedonisë, disa prej të cilëve do të shkojnë në burg për shkaqe që sot duken banale, çfarë është ngritja e flamurit kombëtar shqiptar në ndërtesën e komunës.

³² Enver Robelli, Në Tetovë në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2011, f. 15

Në vend të betimit të përhershëm për shtetin e Maqedonisë, që duhej ta bënin deri dje, politikanët e rinj filluan të flasin për konceptin: çka ofron shteti për qytetarët e vet, çka ofron Partia si koncept politik, çka i ofron individit Partisë si vlerë të veten të shtuar. Me Rusonë Arbën Xhaferi solli një ndryshim epokal, jo vetëm për politikën shqiptare në Maqedoni, por në politikën shqiptare në tërësi”.³³ Edhe ky konstatim i publicistit të dalluar, intelektualit të madh dhe i politikaniit, Veton Surroi për fillimet e angazhimit politik të Arbnit në Maqedoni, flet shumë për veçoritë e tij që nuk i gjeje te politikanët tjerë. Ky njeri që u fut në betejën politike në momente kur shumë procese ishin përmbyllur për shqiptarët e Maqedonisë, por shpresat rriteshin vazhdimisht se do vijë diçka e mirë, nuk u prit si politikan i zakonshëm nga klasa politike e maqedonase, por si radikal, që mund ta ndryshonte kursin politik të shqiptarëve të këtushëm të moderuar. Ky shqetësim i tyre ishte edhe nga shkaku se vinte nga Kosova, që për shumë maqedonas edhe llogaritej si burim krizash. Politika maqedonase, në atë kohë, e pa shkëputur nga aleanca me Serbinë dhe Millosheviqin, madje e trashëguar shumë më herët nga Jugosllavija e Titos, nuk e përkrahte Kosovën në rrugën e vet drejt pavarësisë, gjë që u vërtetua edhe në hezitimin për njohjen e saj, pas pavarësimit. Në bazë të deklaratave të tij politike që epiqendër e kishin një marrëveshje historike të shqiptarëve dhe maqedonasve, si dy komunitete më të mëdha, që mund të arrihej me konsensus të plotë, politika e Arbën Xhaferit kuptohej si e rrezikshme për unitarizmin e shtetit, e që çonte drejt një shteti binacional.

Arbën Xhaferi duke e njohur mirë politikën e Kryetarit Gligorov i cili asnjëherë në agjendën e tij politike nuk e kishte barazinë reale të shqiptarëve me maqedonasit dhe dy partitë kryesore maqedonase që vetëm në disa nuanca dallonin mes veti për sa u përket të drejtave të shqiptarëve, nga njëra anë dhe politikën defanzive të pjesës së mbetur të PPD-së, që vazhdonte të jetë pjesë e Qeverisë, i vetëdijshëm se vetëm me votën e tyre dhe të opozitës shqiptare, nuk fitohet beteja në Parlament, këmbëngulte në një marrëveshje historike që do garantonte stabilitet politik, ekonomik dhe paqe afatgjate e siguri në rajon. Veprimi politik i tij, edhe pse nga opozita, ishte me ndikim jo vetëm brenda anëtarësisë së partisë që e udhëhiqte por edhe më gjerë sepse kur e donte nevoja dilte jashtë kornizave të ngushta partiake, duke zbërthyer

³³ Veton Surroi, Parathënia e librit „Në Tetovë, në kërkim të kuptimit”, më aurore Enver Robelli, Prishtinë 2011, f.14

fenomene që kishin të bëjnë me politikën globale shqiptare, madje edhe me çështje historike me rëndësi të veçantë edhe për këtë kohë, që në mënyrë indirekte ndikonin në vetëdijësimin dhe ngritjen e ndërgjegjës kombëtare edhe në rrethanat aktuale sepse sipas konceptit të tij, pa njohjen e temave të mëdha shoqërore, si procese historike, vështirë se mund të zgjidhen ato më konkretet, që kanë të bëjnë me kërkesat e shqiptarëve dhe ndërtimin e një shteti shumetnik, siç është Maqedonia. Fati i shteteve multietnike është ngushtë i lidhur me aftësinë për harmonizimit të interesave ndëretnike, e nëse kjo nuk arrihet, atëherë vetvetiu hapen tema të mëdha në çdo shtet të botës, që ka përmbajtje heterogjene të popullatës, konstatonte Arbni. Këto aspekte teorike të Arbën Xhaferit, që në shikim të parë duken se janë larg jetësisimit praktik të kësaj filozofie politike në kushte e rrethana të caktuara, prodhojnë rezultate pragmatike e në interes të zgjidhjeve politike edhe brenda organizimit politik në një shoqëri, si Maqedonia. Ai me kohë e kishte kuptuar se në Maqedoni mungonte guximi politik, intelektuel e moral për t'u ballafaquar me katër probleme strategjike, me të cilat ballafaqohej ky shtet: problemi i emrit të shtetit, i gjuhës, ai i mosnjohjes së kishës ortodokse dhe ai më i rëndësishmi, moszgjidhja e çështjes shqiptare. Angazhimi i tij për zgjidhjen e shumë çështjeve të hapura në këtë shtet, e dëshmon se mendimi politik i tij është i një spektri më të gjërë të zgjidhjes së problemeve, gjithsesi duke menduar se kësaj më lehtë do zgjidhej edhe çështja shqiptare. „Ne do vazhdojmë me politikën tonë konstruktive, që nënkupton një sens të lojakecit ndaj çështjes maqedonase, por njëkohësisht kurrë nuk do heqim dorë nga kërkesat normale të shqiptarëve për barazi të plotë. Energjitë tona në këtë rrugë do të jenë të pa shtershme, do deklaronte Arben Xhaferi në një intervistë, dhënë „Balkan Insight” në Tetovë, më 09.04.2006.

Politikani, filozofi e mendimtari, Arbën Xhaferi, edhe pse nga qarqe të ndryshme, të nxitura nga konjuktura nacionaliste maqedonase, etiketohej si radikal dhe shumë i rezikshëm për Maqedoninë e kohës dhe i papranueshëm për një pjesë të madhe të politikanëve serbë, ai me veprimtarinë e vet teorike dhe praktike, një pjesë të mirë të kundërshtarëve politikë, i bindi se të punosh për të mirën e popullit që i takon, pa e dëmtuar tjetrin, nuk është asnjëfarë radikalizmi, por vlerë, që proceset i çon përpara. Ai si intelektual që ishte, me dije të thelluara nga shumë sfera të shoqërisë, si publicist i mirëfilltë dhe filozof, edhe veprimtarinë politike e zhvillonte nga pozitat e politikanit jo të zakonshëm, pra, atij të depolitizuar. Radikalizmi që i mvishej atij nuk

kishte mbështetje, mbase Arbni, si njeri shumë atraktiv që ishte për gazetarët më të njohur shqiptarë e të rajonit, vazhdimisht ishte në tregun publik me deklaratat që priteshin me interesim, përmes të cilave u jepte përgjigje të gjitha pyetjeve dhe jo vetëm politike. Një kohë si lider i PPDSH, e më vonë, pas bashkimit edhe i PDSH-së, mendimtari i kalibrit universal të politikanit, siç ishte Arbën Xhaferi, në politikën shqiptare të Maqedonisë solli një frymë të re, e cila sipas tij do kishte sukses të plotë vetëm pas një marrëveshjeje historike, që do bazohej në zgjidhjen e mirëfilltë konsenzuale. Veprimimi i tij praktik e teorik aq transparent, në politikëbërje, shumë shpejt filloi të përkrahet edhe nga faktori ndërkombëtar që në atë kohë ishte aq i pranishën më Maqedoni, në Kosovë e në shumë vende tjera të ish Jugosllavisë. PPDSH-ja e udhëhequr nga Arbni që angazhohej për Maqedoninë si shtet juridik me mekanizma që e kontrollojnë pushtetin, konsiderohej si krah radikal i PPD-së, si parti parlamentare.³⁴ Kjo parti angazhohej gjithashtu të zbatohet koncepti i demokracisë konsensuale me sistem parlamentar dydhomësh.³⁵

Me bashkimin e dy partive shqiptare, asaj të PPDSH-së dhe PDP-së, Arbën Xhaferi e vazhdoi udhëheqjen e këtij subjekti, të njohur që më parë, nga koha kur këto dy subjekte vepronin më vehte. Me këtë rast po shkëpusim një pjesë të Platformës politike të kësaj Partie, që në fokus e ka kritikën drejtuar pushtetit të atëhershëm të Maqedonisë, që vepronte si shtet monoetnik: *Republika e Maqedonisë përkundër strukturës së theksuar binacionale dhe multikulturore, është përkufizuar si shtet kombëtar i maqedonasve, ku shqiptarëve u garantohen të drejtat qytetare, teknike si gjithkund në botë. Në Maqedoni vërehet një shpërputhje thelbësore ndërmjet konceptit etnocentrik të shtetit dhe strukturës multi-etnike. Kjo shpërputhje duhet të korrigjohet, ngaqë konflikti mund të jetë i paevitueshëm.*³⁶

Ky konstatim se një politikë e këtillë diskriminuese mund të nxisë edhe shkallëzime radikale, doli i vërtetë, mbase konflikti i armatosur i vitit 2001 erdhi pikërisht nga pakënaqësia e shqiptarëve me statusin juridik të tyre. Me programe dhe platforma politike të ngjashme më vonë u formuan edhe parti tjera, që nuk arritën të bëhen forcë me relevancë, që mund t'i artikulonin

³⁴ Etem Aziri, Organizimi Politik i Shqiptarëve në Maqedoni, Shkup viti 2004 faq. 97

³⁵ Programi i PPDSH

³⁶ Platforma politike e PDSH-së, që ruhet në arhivin e Partisë

kërkesat e shqiptarëve në Parlamentin e Maqedonisë. Ashtu si më parë, si udhëheqës i PPDSh-së, Arbën Xhaferi edhe pas bashkimit, vazhdoi t'i paraqesë në mënyrë publike idetë e veta për ndryshime të mëdha në politikën e Maqedonisë, sidomos duke i artikuluar kërkesat e shqiptarëve, si të drejta elementare. Me retorikën e tij të njohur, tani më për publikun, e cila bazohej në mendime racionale, që shpesh për politikën maqedonase konsideroheshin edhe si radikale, ai fitoi besim të plotë ndër shqiptarë, madje jo vetëm për anëtarë e simpatizantë të partisë që e udhëhiqte. Me analizat e thukta të tij, që ishin edhe rezultat i sintezës politike në vend, në rajon e më gjerë, nga qarqe të ndryshme afirmohej edhe me epitelin e liderit mbarëshqiptar, gjë që është dëshmuar disa herë edhe në deklaratat e lidshpimit të Kosovës dhe Shqipërisë. Filozofia e tij politike e rrafshit mbarëkombëtarë bazohej në balancimin e forcave politike, pa anuar asnjëherë nga njëra ose pala tjetër, qofshin të djathtë apo të majtë. Prania e tij në medime përmes deklaratave të ndryshme, intervistave dhe shkrimeve të vazhdueshme, reflektonte pozitivitet në krijimin e atmosferës për zgjidhje të shumë çështjeve të hapura në vend dhe në rajon. Me të drejtë, idetë e tij politike gazetarja e afirmuar në botën shqiptare, Rudina Xhunga, i konsideron si porosi. Në librin „12 porositë e Arbën Xhaferit”, ajo në parathënien e librit ndër të tjera do shprehej: „Pata privilegjin ta intervistoj dhe ndiej përgjegjësinë të ndaj me lexuesin këtë libër, ku përfshihen opinionet, mendimet, idetë, vizionet, ëndrrat e Arbën Xhaferit, shpërndarë nëpër 12 intervista të rralla. Ai flet sikurse njeriu që vendos flamurin e kuq, që alarmon një rrezik dhe është i ndërgjegjshëm, se snajperët janë në të gjitha anët. Këto intervista janë flamuri i tij, janë modeli, besimi dhe ëndrra e një njeriu, që jo vetëm e njihte mirë, por edhe dinte ta donte bukur Shqipërinë”.³⁷

Këto vlerësime për njeriun që politikën asnjëherë nuk e interpretonte të zhveshur nga vlerat tjera kulturore, historike, filozofike e sociologjike, janë rezultat edhe i përmasës së tij intelektuale, që rezatonte gjithandej në botën shqiptare. Ai si teoriticien i pajisur me dije, të fituara nga burime të shumta, përfshirë edhe sistemet dhe organizimet politike të kohërave dhe sistemeve të ndryshme, krahas deklaratave politike, jepte edhe spjegime për nocione të ndryshme politike, që sipas tij, shpeshherë kuptoheshin dhe interpretoheshin gabimisht. Dilemën

³⁷ Rudina Xhunga, 12 porositë e Arbën Xhaferit, Tiranë 2012, f. 7

për shoqëri apo shtet multietnik, ai e spjegonte shumë mirë, edhe në mënyrë shkencore, duke dashur t'ua heq maskat shumë politikanëve maqedonas, kur mundoheshin që shoqërinë multietnike, që edhe ishte reale, ta paraqitnin edhe si shtet multietnik, duke dashur kështu që para ndërkombëtarëve të arsyetohen se në atë shtet janë të gjithë të parabartë. Shoqërinë multietnike ai e spjegonte si përshkrim të mjedisit, ku ka shumë kombe, shumë kultura dhe shumë gjuhë. Për t'u shndërruar shoqëria multietnike në shtet multietnik duhej mekanizma që do i garantonin diversitetin dhe funksionimin e diversiteteve të ndryshme në Maqedoni, shprehej shpesh Aben Xhaferi, i vetëdëshëm për mundësinë e manipulimeve duke i ngatërruar këto nocione. Ai edhe pse jo shumë i ri në moshë, në politikë u radhit krah për krah politikanëve të gjeneratës që karrierën politike e filluan në kushte pluraliste, sepse, siç shprehej edhe vet, as që do ishte i përshtatshëm për kohën e sistemit njëpartiak komunist. Edhe pse ardhja e tij në politikë më tepër ishte nxitje nga pasioni se sa dëshirë për këtë profesion, ai në këtë skenë u paraqit me njohuri të thella politike, madje edhe nga koha e monizmit jugosllav, duke i njohur mirë edhe politikanët e prodhuar nga shkollat komuniste me të cilët ballafaqohej shpesh gjatë veprimtarisë politike. Në njërën nga pyetjet që ia drejtoi Rudina Xhunga, e që lidhej me fjalën e Branko Cërvenkopvskit, me rastin e zgjedhjes së tij për Kryetar Shteti, ku ndër të tjera tha: „ *Ajo që maqedonisë nuk i nevojitet dhe që mund të shkaktojë dëme katastrofale, kundër së cilës do të luftoj institucionalisht, është ekstremizmi dhe radikalizmi me gjithë kapacitetin*”, ai u përgjigj se Cërvenkovski është pinjoll i një gjenerate politikanësh që janë edukuar në referate të kabineteve politike i cili nuk njih fare fenomene sociologjike apo teorinë politike dhe këto janë vetëm etiketa njollosëse me të cilat dëshiron t'i eliminojë kundërshtarët e tij politikë.

Veprimi i tij politik në një ambijent të kontaminuar me ide nacionaliste dhe tendenca të falsifikimeve të historisë nga segmente të caktuara të politikës së kohës, mbështetej në „analiza të mirëfillta që mund të maten, që mund të konstatohen lehtë me argumente të mbështetura në hulumtime empirike dhe teriko politike”.³⁸ Te një politikan i cili veprimet pragmatike politike, nuk i bën ndaras nga fenomenet tjera shoqërore sociologjike, filozofike, kulturore e konfesionale, ndoshta rezultatet nuk vijnë shpejt, por në periudha afatgjata

³⁸ Rudina Xhunga, 12 porositë e Arbën Xhaferit, Tiranë 2012, f.48, 49

garantojnë ardhmëri të sigurtë e të qetë, si për shtetin, ashtu edhe për shqiptarët, që vazhdimisht konsideroheshin si qytetarë të dorës së dytë . i tillë ishte Arbën Xhaferi, i qetë në fjalë, i thellë në mendime dhe i giximshëm në vendimmarrje. „Negociatat për te ishin një stërvitje intelektuale, në të cilat ai mbronte një qëndrim konceptual, atë të kontratës së shqiptarëve me etnikumet tjera të shtetit”, do shprehej intelektual i dhe publicisti, Veton Surroi në fjalën e vet hyrëse të librit të Enver Robellit. Ai here-herë, në momente të padurueshme për shqiptarët, nuk kursehej as nga deklarata të pa njohura më parë për oponentët e tij politikë, e as nga klasa politike maqedonase. Në momente kur partia që udhëhiqej nga ai, pas çarjes së PPD-së, nga pushteti nuk njihej, shantazhohej e pengohej të funksionojë, madje tentohej që t’i merrej e drejta për zgjedhje, ai do deklaronte: *Do të bëjmë çmos të dalim në zgjedhje, vetëm e vetëm që t’i japim shans një varianti tjetër të politikës shqiptare në Maqedoni... Nëse parapengohemi që të dalim në zgjedhje, do të jemi të detyruar ta kërkojmë votën e popullit për parlament të vet, i cili do të quhet Kuvend e jo Sobranie.*³⁹

Bashkimi i dy partive, PPDSH-së dhe PDP-së, pas një bashkëpunimi të mirëfilltë e të sinqertë, sidomos mbas formimit të grupit të përbashkët parlamentar, dhe funksionimi i tyre si një parti që do udhëhiqej nga Arbën Xhaferi, këtë lider e obligonte edhe më tepër, që me përgjegjësinë më të madhe ta vazhdojë luftën politike drejt realizimit të kërkesave të shqiptarëve, që tani më ishin pjesë e programit të përbashkët. Për këtë bashkim, pati edhe individë që këtë akt politik nuk e konsideronin si pozitiv, por këto mospajtime as që patën ndonjë ndikim në funksionimin e organizimit politik të kësaj partie, që u bë zëri më i theksuar i shqiptarëve të Maqedonisë, e që u dëshmuua me vepra konkrete, sidomos si pjesë e qeverisë, bashkë me VMRO- DPMNE, që udhëhiqej nga lubço Gjeorgjievski. Ky bashkim i faktorit politik shqiptar, u përshëndet dhe u prit mirë nga shqiptarët, kudo që jetonin ata, në Shqipëri, Kosovë, në hapësirat tjera shqiptare të ish Jugosllavisë dhe në diasporë. Ishte zëri i Arbën Xhaferit ai, që këtë hap historik të kohës e arsyetonte si vendim konsensual mes shqiptarësh që paraqiste hap serioz të një force politike me synime të qarta për zgjidhjen e shumë çështjeve të hapura të kësaj pjese të kombit. Gjithsesi ky veprim fisnik që më tepër ishte privilegj për shqiptarët se sa për

³⁹ Etem Aziri, Organizimi Politik i Shqiptarëve në Maqedoni, Shkup 2004 f. 183

ruajtjen e pozitave individuale të disa personave, u përkrah nga anëtarësia e gjerë, simpatizantët dhe populli, me shpresën se gjërat do lëvizin përpara në drejtim të duhur, pas një bllokade jo edhe të shkurtër që bënte pushteti maqedonas i kohës me gjithë aparaturën shtetërore që i qëndronte pas.

Qeveria e udhëhequr nga Cërvenkovski, e përkrahur edhe nga struktura tjera shtetërore, këtë bashkim të forcave politike shqiptare e shihte si rrezik për politikën etnocentriste të qeverisjes së tyre dhe dobësim të unitarizmit shtetëror maqedonas, prandaj edhe e planifikoi skenarin e 9 Korrikut, me qëllim të nxitjes së një konflikti ndëretnik, që do ta shuante me përdorimin më të egër të dhunës policore. Viktima të kësaj dhune të paparë ishin qytetarët shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe shumë të rinj, aktivist të Partisë së posaçëformuar, tek e cila Qeveria e Maqedonisë shihte rrezik. Edhe në këtë rast, si zakonisht në këso rrethanash të jashtëzakonshme, pjesë e Qeverisë ishin edhe shqiptarët e përfaqësuar nga PPD-ja, reagimi i të cilëve ishte tepër i kontrolluar dhe i butë, duke ia hudhur fajin për këtë masakër ndaj shqiptarëve, më tepër Kryetarit të Komunës së Gostivarit, Rufi Osmanit dhe Partisë së re të bashkuar të udhëhequr nga Arbën Xhaferi. Me këtë rast u vranë tre të rinj shqiptarë, u plagosën dhe u burgosën me qindra të tjerë. U Arrestua dhe u dënua me burg Kryetari i Gostivarit, Rufi Osmani dhe Kryesuesi i Këshillit, Refik Dauti, e më vonë edhe Kryetari i Komunës së Tetovës, Alajdin Demiri me Kryetarin e Këshillit, Vebi Bexhetin. Ky sulm barbar i forcave policore maqedonase, si shkas e shfrytëzoi ngritjen e flamurit kombëtarë në shtizat para objekteve të këtyre dy komunave dhe shumë të tjerave ku zgjedhjet lokale i kishte fituar PDSH-ja e përbashkët, e udhëhequr nga Arbën Xhaferi. i tërë ky skenar kishte për qëllim zbrapsjen dhe frikësimin e shqiptarëve nga partia që ishte e vendosur në realizimin e përcaktimeve programore, duke i shfrytëzuar të gjitha masat demokratike, përfshirë edhe bojkotin, duke i tërhequr të gjithë këshilltarët, deputetët dhe kryetarët e komunave, për të h'ur hapur rrugë demonstratave gjithëpopullore. Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Arbën Xhaferi, si udhëheqës i këtyre proceseve, në një rast pat deklaruar: *Kjo është politikë e prezantuar në platformën politike të Partisë Demokratike Shqiptare.*⁴⁰, ndërsa për dënimet drakonike të udhëheqësve të Komunës së Gostivarit, lideri i atëhershëm i opozitës

⁴⁰ „Koha ditore”, 18 shtator 1997, f.3

maqedonase, VMRO-DPMNE, Lubço Georgievski, deklaroi „*Procesi gjyqësor në Gostivar dhe dënimet që u janë shqiptuar kryetarit të Komunës së Gostivarit, Rufi Osmanit dhe Kryetarit të Këshillit komunal, Refik Dautit, janë dënime skandaloze të cilat do të kenë edhe reperkusione negative në vet shtetin maqedonas.*⁴¹

Marrja e mandatit të deputetit nga Parlamnti i shumicës së LSDM-së, ishte edhe një veprim hakmarrës ndaj Arbën Xhaferit dhe partisë që e udhëhiqte. Ai edhe në këtë rast mbetet i vendosur në synimet që i pretendonte. Sipas Kodit zgjedhor të asaj kohe, u organizuan zgjedhje vetëm për atë njësi zgjedhore, ku Arbni kandidohet dhe fiton sërish për t'iu i rikthyer mandati i deputetit, që e dëshmoi edhe njëherë se verdikti i popullit nuk mund të shkilet aq lehtë, qoftë edhe nga shumica parlamentare maqedonase.

4.Vështirësitë e kompromiseve në raport me kërkesat e shqiptarëve

Kërkesat e shqiptarëve të Maqedonisë për rregullimin njëherë e përgjithmonë të statusit të tyre juridik, që do i përfshinte të gjitha të drejtat e tyre, me synim barazinë e plotë, deri në element shtetformues, e kishin historinë e vet, shumë më të hershme se koha kur u pavarësua ky shtet, si rezultat i shpërbërjes së Ish Jugosllavisë komuniste. Elitat politike maqedonase, të cilit krah qofshin ato, duke i njohur përpjekjet e shqiptarëve për përmirësimin e gjendjes së tyre juridike, që në kohë shumë të hershme, madje kur në fillimet e zhvillimit të demokracisë, ende vepronin politikisht personalitete të kohës së Jugosllavisë, siç ishte Gligorov, por edhe të tjerë, as që u shkonte ndërmend të bëjnë kompromise me shqiptarët për të drejtat e tyre. Në përceptimin e tyre, shqiptarët ende konsideroheshin si element destabilizues, pavarësisht se tani më vepronin të organizuar politikisht, përmes partive të tyre. Klasa politike maqedonase me veprimt e tyre politike, të bazuara edhe në programet partiake, jo që nuk i përfillnin kërkesat e shqiptarëve për status plotësisht të të barabartë me maqedonasit, si dy komunitete më të mëdha në vend, por me kalkulimet e tyre politike, në emër të demokracisë

⁴¹ „Koha ditore”, Georgievski: Dënime skandaloze me reperkusione negative, 18 shtator 1997.

sipas kutit të tyre, assesi nuk mund të llogariten si popullatë, jashtë kornizës së pakicave tjera, sepse , sipas tyre, u bëheshka padrejtësi nacionaliteteve tjera. Këtë koncept, që në vazhdimësi e kundërshtonte Arbën Xhaferi si opozitar, por edhe Partia shqiptare në qeveri, që mund të bënte më tepër, por nuk kishte kapacitete e guxim, partitë politike maqedonase, qofshin ato në qeveri apo në opozitë, e realizuan me sukses, madje janë duke e realizuar edhe sot, edhe pas 18 viteve nga konflikti i armatosur dhe Marrëveshja së Ohrit. Një kohë të gjatë, edhe pas pavarësimit të Maqedonisë dhe njohjes së saj me emrin e përkohshëm IRJM, krahas veprimit politik të shqiptarëve dhe angazhimit të tyre t'i realizojnë kërkesat programore, qëndrimi zyrtar i Maqedonisë, Kosovën ende e konsideronte si vatër krizash që zjarrin e luftës dashka ta sjell edhe në Maqedoni. Me gjithë këtë qëndrim përjashtues dhe injorues të Maqedonisë zyrtare, me ideologun Kiro Gligorov, ndaj luftës së drejt të Kosovës, që reflektohej negativisht në raportet mes shqiptarëve dhe maqedonasve, në periudhën e qeverisjes së Arbën Xhaferit dhe të Partisë PPDSH, me VMRO-në e Kryeministrit Lubço Gjorgjevskit, ky kurs armiqësor ndaj Kosovës dhe luftës së drejt të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, ndryshoi në drejtim pozitiv madje gjatë kësaj qeverisjeje, me këmbënguljen e Arben Xhaferit dhe të mirëkuptimit në këtë drejtim nga partneri i koalicionit, Madedonia u shndërrua në vend të sigurtë për liderët politiko- ushtarak të Kosovës, të cilët në këtë vend edhe takoheshin me liderë të klasës politike e shtetërore të Shqipërisë, ndërsa kalimi i armatimit për Luftën e Kosovës me aq lehtësi, nga Shqipëria, nëpër Maqedoni, është temë në vehte, që mund të trajtohej si e veçantë. Disa nga keto kompromise, jo edhe aq për t'u nënçmuar, që nuk ishin të lehta, sidomos në arritjet e marrëveshjeve të partnerëve të koalicionit, për vende udhëheqëse në nivel të Qeverisjes lokale, por të prekshme edhe në nivelin qëndror, ishin në interes të shqiptarëve, falë politikës konstruktive të Partisë shqiptare në pushtet, PDSH-së, të udhëhequr nga Arbën Xhaferi dhe VMRO-së së Georgievskit. Gjatë periudhës së këtij koalicionimi, në nivelin e qeverisjes lokale, shqiptarët edhe në qytetet ku asnjëherë nuk kishin pasur ndonjë vend udhëheqës, fituan disa pozita udhëheqëse, madje edhe në Mnastir, ku edhe pas instalimit të sistemit demokratik parlamentar, as që mund të paramendohej një gjë e këtillë. Kjo atmosferë e relaksur politike në Maqedoni u kontaminua në kohën kur shpërtheu konflikti më 2001, kur Kryetari i Qeverisë dhe partneri i koalicionit, Georgievski, e akuzoi Arbën Xhaferin për veprim tinëzar, me sintagmën „Thikë pas shpine”.

KAPITULLI



PROFILI INTELEKTUAL I ARBËN XHAFERIT DHE PIKËPAMJET E TIJ PËR FUNSKIONIMIN E SHTETIT

1. Idetë e Arbën Xhaferit për politikën dhe shqiptarët
2. Pikëpamjet e Arbën Xhaferit për çështjet fetare (toleranca dhe intoleranca fetare)
3. Përkufizimet politike të Arbën Xhaferit për shtetin dhe funksionimin e tyre
4. Kombi, identiteti sipas Arbën Xhaferit

1. Idetë e Arbën Xhaferit për politikën dhe shqiptarët

Veprimi praktik në politikë të Arbën Xhaferit i paraprinë njohuritë teorike për funksionimin e shtetit, që nga kohët më të hershme e deri në ditët e sotme. Ai duke i njohur rrethanat historike dhe funksionimin e shoqërive gjatë historisë, nuk e kishte vështirë të zbërthejë edhe fenomenet që kanë të bëjnë me shoqërinë shqiptare, zhvillimet, pengesat, sfidat dhe synimet e shqiptarëve drejt rrugës për formimin e shtetit dhe ardhmërisë evropjane. Duke i njohur proceset e zhvillimeve shoqërore, përpjekjet e popujve për liri, pavarësi e dinjitet, e pati lehtë t'i përkufizojë nocionet kryesore që kanë të bëjnë me multietnizmin e shoqërisë dhe të shtetit. Ai me kohë kishte konstatuar dallimin e shoqërisë multietnike me shtetin multietnik, prandaj kur flet për shqiptarët, që mbetën jashtë shtetit shqiptar, angazhohet për shtet multietnik sepse shoqëria multietnike si kategori mund të jetë reale si e tillë, por pa mekanizmin e shtetit që t'u garantojë të drejta të barabarta popujve jo shumicë, në një shoqëri multietnike gjithmonë do jenë të marginalizuar dhe me të drejta shumë të kufizuara, krahasuar me popullatën shtetformuese. Mendimi i tij për mundësinë e të jetuarit të shqiptarëve në një shoqëri multietnike, pa këtë mekanizëm që do i garantonte të gjitha të drejtat, për t'u bërë të barabartë, ka evaluuar duke anuar kah shtetet kombëtare. Ai edhe kur fliste për Evropën dhe familjen e madhe evropjane, ku do integroheshin të gjithë shqiptarët, reflektoonte një dozë pesimizmi se në këtë mënyrë do realizohej ëndrra e baskkëkambasve të tij, nëse në këtë familje do hynin si të ndarë e të përçarë. Edhe kur ai angazhohej për Evropën madhe, madje për këtë përcaktim në një rast u citua edhe nga gazeta gjermane, „Zydojçe cajtung“ (Suddeutsche Zeitung), jep sqarime shtesë duke u arsyetuar se deklaratat e asaj natyre janë në funksion të sqarimit të një proci të gjatë historik me një të ardhme qytëtuuese, që nuk e nënkupton edhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes kombëtare. Sipas Arbën Xhaferit, shqiptarët pas shumë përvojash të hidhura, vrasjesh, shpërnguljesh, burgosjesh e keqtrajtimesh, kërkojnë shpëtim dhe siguri të bashkimi kombëtar, ashtu si e bënë gjermanët dhe Italianët paraprakisht, sepse të qenit anëtarë të këtij Unioni, do të pengojë çfardo ideje të bashkimit. Në parim Arbni pajtohet me idenë e

bashkimit qytetëruës me UE-në, por jo edhe me argumentin që këto punë të rënda t'i lëmë kur të bëhemi anëtarë të Unionit⁴²

Për idetetë e Arbën Xhaferit lidhur me politikën shqiptare dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje në përgjithësi, u morën shumë analistë, publicistë, politikanë dhe intelektualë të sferave të ndryshme, pa u shkëputur nga sharmi i tij i veçantë intelektual, të vetëdijshëm se thellësia e mendimit politik i tij, nuk do ishte i asaj përmase, pa vetitë emancipuese të kalibrit të madh intelektual. Edhe pse qëndrimet, pikëpamjet dhe qasjet e tyre për t'i hyrë në brendi veprës së tij teorike e praktike mund të ndryshonin në formë, ato në thelb kishin një pikë të përbashkët: Arbën Xhaferi ishte ndër shqiptarët e rrallë që në mënyrë të shkëlqyeshme punoi në projektin e madh kombëtar, duke u bërë simbol i bashkimit të shumë mendjeve dhe kundërshtarë i përçarjes. Ai duke vepruar gjithanshëm për kauzën kombëtare, përmes zbërthimit të shumë fenomeneve shoqërore në mënyrën e vet specifike, ishte i paluhatshtëm kur ishte në pyetje çështja madhore e kombit. Ashtu, i qetë dhe i pazhurmshëm, në një farë mënyre arriti të jetë në qendër të vëmendjes, për të gjithë ata që merreshin me politikë, ose për ata që merreshin me politikanë. Ai një ndikim të theksuar kishte edhe të një pjesë e rinisë shqiptare në Maqedoni, Kosovë e Shqipëri, gjithsesi i përkrahur edhe nga klasa politike mbarëkombëtare, orientimesh të ndryshme ideologjike që veprimtarinë e tij atdhetare politike, e shihnin nga pozita të ndryshme, por gjithmonë si pozitive. „Për socialistët ai ishte tepër liberal, e për liberalët ishte tepër konservator, për konservatorët ishte tepër postmodern, e për postmodernët ishte tepër romantik, do shprehej Albin Kurti, në një shkrim të tijin, me rastin e ndarjes nga jeta të Arbnit. Idetë dhe mesazhet e tij gjithmonë ishin të kompletuara, të menduara mirë, ato ishin porosi e këshilla për të gjithë, kudo dhe përherë. Ai veprimin politik gjithmonë e fisnikëronte me ide të thella teorike, të bazuara në fuqinë intelektuale, por pa ambicje për t'u afirmuar, pa vrapuar pas moderatorëve dhe gazetarëve të ndryshëm, sepse nuk kishte nevojë për një gjë të tillë, përkundrazi, ata vraponin pas tij, ata dhe kontributet e tyre, si rezultat i një bisede me te, e fitonin vlerën e shtuar.

⁴² Enver Robelli, Në Tetovë në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2012, f. 125-126

Të gjithë ata që ishin të prirur të merren me veprën e tij teorike dhe veprimin politik praktik, në rrethana të disfavorshme për jetësimin e ideve të tij, sepse ai vepronte në shtigje të gjata, duke mos bërë politikë ditore, më tepër ndaleshin në fuqinë intelektuale të tij dhe pasionin atdhetar. Ai mendimet e veta, nëpër debate të ndryshme, televizive, edhe pse nuk i preferonte, dhe sidomos në shkrimet e tij, qoftë duke trajtuar tema nga më të ndryshmet, qoftë si rezultat i përgjigjeve për gazetarët, në intervistat, tani më të nohura të tij, i shprehte ndryshe, sipas specifikave të modelit të tij shprehës, të rrallë, ose shumë pak të njohur për publicistikën shqiptare. Kjo veçori e tij model, ishte rezultat i njohjes së gjerë për çështjet e pazgjidhura shoqërore, me theks për shqiptarët, i vetëdijshëm se me këtë formë të politikbërjes së klasës politike në Maqedoni, dhe në mbarë hapësirat shqiptare, retorika e tij politike, nuk mund të japë rezultate të shpejta, meqë nuk bazohej në politikat e ditës, por që rrënjët i kishte në historinë e përbashkët të shqiptarëve, në fatin e njëjtë të kombit. Pikërisht këtu edhe qëndronte keqkuptimi i një pjese të vogël të individëve që kishin guximin të mërreshin me veprën e tij, pa e njohur në tërësi atë vepër, duke e analizuar sipërfaqësisht. Ndoshta përqëndrimi i tij aq i vendosur në problematikën e përgjithshme kombëtare, që sipas tij, mund të zgjidhej përfundimisht me bashkimin e kombit, e zbehu aktiviteti politik praktik, si lider i një partie legjitime të shqiptarëve në Maqedoni, nga i cili priteshin rezultate spektakulare për të drejtat e shqiptarëve, të drejta këto që për t'u arritur, duhej tejkaluar shumë barriera ligjore e kushtetuese, pengesa këto, për eliminimin e të cilave, nuk mjaftonin votat e shqiptarëve në Parlamentin e Maqedonisë. Kërkesat e drejta dhe legjitime të shqiptarëve në Maqedoni, kundërshtoheshin nga shumica maqedonase.

„ Nuk është se donte një komb të përkryer që e kishte krijuar në kokën e vet e për hesap të vet; nuk është se s'i njihte dështimet historike dhe limitet e kombit tonë. i njihte që ç'ke me të, ashtu si pakkush këtej nga anët tona, por nuk donte që energjitë e shqiptarëve të përqëndroheshin tek evidentimi e denoncimi i veseve, huqeve, prapambetjes sonë, sidomos kur ky evidentim e denoncim kishte për synim, por edhe për pasojë, përçarjen e sektarizmin. Sikur të varej prej tij, nuk do ishte çudi të binte dakord t'u bëhej censurë atyre që theksonin me vend e pa vend identitete tribale, në dëm të identitetit nacional, fjala vjen, atyre që vinin në diskutim standardin e shqipes. Mund të veçohen plot gjera kur flitet për te, por këto dy cilësi binin në sy prej së largu;

e binin në sytë e gjithkujt. Arbën Xhaferi ishte intelektual dhe patriot, me shokë të rrallë në çdo rast”⁴³.

Mendimet e Arbnit, thellësia e tyre dhe analizat rreth fenomeneve për kombin, për shtetin, për fenë, dhe sidomos për rrjedhat e zhvillimeve politike në Maqedoni e Kosovë, pa e anashkaluar edhe çështjen kombëtare në përgjithësi, nga një shtresë e popullatës edhe nuk kuptoheshin, pikërisht nga shkak se ishin të thella në brendi, e assesi e turbullta, siç tentonin ta paraqisnin, një pakicë politikanësh, apo edhe analistësh të cilët funksiononin të politizuar edhe në momente kur duhej të vepronin jashtë saj, siç vepronte shpesh Arben Xhaferi. Jorastësisht për këtë tip specifik të intelektualit, nga analistë të ndryshëm u dhanë edhe vlerësime specifike, që njëherit e hudhnin poshtë tezën se në Maqedoninë e fillimeve të demokracisë nuk pati politikanë të ditur e të përgatitur për veprime në kushte e rrethana të reja e të paparashikueshme, kur shqiptarët në këtë vend duhej të ishin të vendosur në kërkesat për ardhmërinë e tyre dhe mbijetesën si komb, dhe shtetformues në shtetin e ri të dalë nga shpërbërja e Jugosllavisë. Për fat të keq, fillimet e shtet ndërtimit të këtij shteti, që funksiononte pa emër, pra si Ish Republika e Maqedonisë, ishin në kundërshtim me kërkesat e shqiptarëve dhe të partive politike të tyre. Këto shpresa të shqiptarëve se me rënien e komunizmit dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, do realizoheshin në kushte e rrethana të reja, u thyen, që me miratimin e kushtetutës së re, „demokratike” që shqiptarët i konsideronte si pakicë, madje me pozita më të disfavorshme se në Jugosllavinë e Kushtetutës së vitit 1974. Arben Xhaferi, në Maqedoni erdhi në kohën kur ishin kryer disa procese, të cilat as që mund të riktheheshin. Në rrethana të këtilla, ky lider që si atillë u afirmua shpejt, me gjithë aftësitë e bërjes politike me interes kombëtar, por si opozitarë që ishte, nuk kishte si të vijë deri te rezultatet e dëshiruara të shqiptarëve dhe të partisë që e udhëhiqte. Sukseset e tij në drejtim të arritjes së disa të drejtave të shqiptarëve, u dukën, me hyrjen në koalicionin qeveritar, të udhëhequr nga Gjeogjievski. Gjithsesi të arriturat në interes të shqiptarëve do ishin shumë më të mëdha nëse edhe rezultatet e zgjedhjeve do ishin më të favorshme për këtë forcë politike, që lindi si fraksion i partisë së parë shqiptare, PPD-së, pikërisht si pasojë e pakënaqësisë nga anëtarësia e saj për ngecje në avansimin e të drejtave të

⁴³ Mustafa Nano <https://www.shqipëria.com/shqip/opinionart/aID/1664/Tek-Arben-Xhaferi-rrinin-tok-intelektuali-dhe-patrioti>

shqiptarëve. Me të gjitha aftësitë intelektuale e politike, por jo me përkrahjen aq sa meritonte, ky personalitet i dha një shtytje politikës shqiptare të Maqedonisë së atëhershme, duke u bërë shpresa e vetme se me këtë lider me tipare tjetërfare nga të tjerët, do lëvizin gjërat përpara edhe për shqiptarët, siç dihet, një lider me këto tipare duhet edhe të votohet në mënyrë masive, që ta kompletojë figurën e një lideri intelektual, dhe kështu përmes këtij kapitali që buron nga sovranit, nuk do mungonte edhe suksesi.

Poeti dhe analisti Preç Zogaj, duke i njohur tiparet e politikanit intelektual të Arbnit, këtë figurë politike e paraqet, të paprekur intelektualisht. Ai pasi flet për Vasllav Havelin, politikanin tipik intelektual, që përveç tjerash, për shqiptarët do mbetet si njeriu që bëri shumë për to,⁴⁴ dhe për Ibrahim Rugovën si një lider të dashur, që nuk lëshoi pe asnjëherë në qëndrimet e veta për realizimin e vizionit që kishte, për Kosovën dhe pavarësinë e saj, jep mendime edhe për Arbër Xhaferin, duke e theksuar aspektin intelektual të tij, si model politikani i cili krahas veprimtarisë në fusha të ndryshme, duke rrahur tema nga më të ndryshmet shoqërore filozofike, u mor edhe me politikë praktike në Maqedoni, në kohën kur shqiptarët e atjeshëm ishin në kërkim të një lideri të asaj përmase. Këtë treshe të njerëzve intelektualë dhe politikanë, ky analistë dhe njëherit poet, i merr si shembull se politika megjithatë mund të udhëhiqet, madje edhe më mirë edhe nga intelektualë, tek sa për Arbnin do shprehej: „Ky ishte Arbën Xhaferi, një lider i përditjes intelektuale, që doli dhe ëndroi në krye jo si disa që zënë kreun të ndihmuar nga rrethanat dhe nuk e lëshojnë pa i shkuar flaka në qiell, por si prijës i arsyes, i asaj arsyeje që nuk ka nevojë për banda, nuk ka nevojë për xhungëll, nuk ka nevojë të çirret. Arsyes të cilën Monteskie e identifikonte me vrytitin politik, i mjafton zëri i ulët dhe e folura e matur si ajo që përcolli trajektoren prej meteori të Aben Xhaferit në politikën shqiptare”⁴⁵

Figura dhe vepra e tij, nuk ishte imun edhe ndaj kritikës së herëpahershme i drejtoheshi atij, edhe pse jo rrallëherë edhe me pa të drejtë. Për te ishin të mirëseardhura edhe

⁴⁴ Shqiptarët nuk mund ta harrojnë se Havel është i vetmi kryetar shteti në Evropën e re që dërgoi një avion special për të marrë në Tiranë bashkatdhetarët tanë që u futën në Ambasadën e Çekoslavisë në verën e vitit 1990 dhe i vetmi gjithashtu që përshkoi më këmbë si pelegrin në verën e vitit 1999 rrugën e kthimit në shtëpi të refugjatëve të dëbuar kosovarë, pas çlirimit të Kosovës nga trupat e NATO-s dhe forcat e UÇK-së

⁴⁵ Preç Zogaj, Një fenomen intelektual në politikë, <http://arbën.blogspot.com/2012/08/nje-fenomen-intelektual-ne-politke.html>

kritikat e mospajtimeve. Këto polemika dhe mendime ndryshe, për të konsideroheshin të mirëseardhura dhe të shëndetshme për zhvillimet e shoqërisë shqiptare. „Shkrimet dhe prononcimet e Arbnit kanë pasur influencë të madhe dhe shpesh kanë ngjall debate dhe polemika, të cilave ai nuk u ikte, sepse besonte se shoqëria nuk mund të lëvizë dhe të zhvillohet pa konfrontime dhe konkurrencë mendimesh. Por ndihej nevoja që ato të ribotohen të përmbledhura për të kuptuar më mirë tërësinë, shtresimet dhe peshën e jashtëzakonshme jo vetëm politike të mendimit të tij.⁴⁶

Me rastin e ndarjes nga jeta të Arben Xhaferit, radio „Dojce Ėele” në gjuhën maqedonase, përveç tjerash konstatonte se përkundër perceptimit se ky politikan angazhohej vetëm për kauzën shqiptare, ai megjithatë përmes demokracisë konsensuale dhe ndarjes së pushtetit në mënyrë të barabartë mes maqedonasve e shqiptarëve, dhe ndërtimit të shtetit multi-etnik, preferonte një shtet të barabartë për të gjithë.⁴⁷ Ky konstatim, sipas kësaj radioje, bazohet në shumë deklarata dhe reagime nga ekspertë të ndryshëm politikë. Githsesi veprimi politik i Arbnit, pa u shkëputur në asnjë moment nga orientimi intelektual dhe mënyra tjetërfare e kuptimit të politikës, në Maqedoni solli një frymë të re në politikbërje. „Politikani i kalibrit siç ishte Arbën Xhaferi, solli impuls të ri në jetën politike të Maqedonisë, dhe mënyrë të re të zgjidhjes së konflikteve dhe problemeve me të cilat ballafaqohedj vendi”, do shprehej politikani Naser Zyberi, duke theksuar gjithashtu se filozofia e mendimit të tij politikë la gjurmë në këtë shtet, në 15 vitet e fundit. Aktiviteti i tij politik, në Maqedoni, nga një pjesë e maqedonasve, ekspertë të politikës, profesorë të të ndryshëm, madje edhe politikanë, më tepër u kuptua si veprim i një lideri etnik, se sa i një demokrati të madh, tezë kjo që kundërshtohet nga disa intelektualë tjerë, siç është edhe profesoresha Mirjana Maleska, e cila po në „Dojce Ėele”, kur flet për personalitetin intelektual dhe politik të Arbnit, ndër të tjera thotë: „Në takimet me të për qëllime hulumtuese shkencore, pajtoheshim me Xhaferin për sa i përket rregullimit të shtetit. Ai mendonte se modeli i demokracisë konsensuale me ndarjen e pushtetit mes maqedonasve dhe shqiptarëve, do ishte zgjidhje e mirë për Maqedoninë. Një profesoreshë tjetër,

⁴⁶ Shkëlzen Maliqi, Arbën Xhaferi, Vepra 04, Tiranë 2016, f.9

⁴⁷ Dojce Ėele, 16.08.20120

dhe njëherit analiste, për këtë personalitet, do shprehej: Xhaferi ishte lider i madh etnik, e më pak demokrat i madh.⁴⁸

Idetë e Arbën Xhaferit për politikën dhe shqiptarët, hasen në shumë intervista dhe shkrime të tij, të hapësirës shqiptare dhe më gjerë, ato janë të qëndrueshme dhe të bazuara në dijen e tij për nocionet „politikë” dhe „shtet”, në të shumtën e rasteve, në kontekst të shqiptarëve në të kaluarën, aktualitetin dhe të ardhmen e tyre. Popujt e ndarë e të përçarë në disa shtete, sidomos atje ku konsideroheshin si pakicë, sipas tij, ndryshojnë në mentalitet, duke fituar edhe veti e mendësi të popujve sundues shumicë. Kjo dukuri ngjau edhe me shqiptarët, që gjithmonë jetonin me ideale se një ditë do bashkohen, edhe pse këto ideale mbetën vetëm dëshirë e tyre. Këtë fenomen ai e sheh edhe te popujt tjerë, prandaj Arbni ka prirje që problemin e çështjes shqiptare, përveç tjerash ta sheh edhe në prizmin e globales dhe sidomos rajonales. Kjo ngjau edhe me shqiptarët e Kosovës, por jo në atë masë si te ato të Maqedonisë dhe të viseve tjera të Ish Jugosllavisë. Derisa në shtetit amë, shqiptarët u ballafaquan me probleme të natyrës tjetër, e jo me urrejtjen ndëretnike sepse ky problem atje nuk ekzistonte, shqiptarët jashtë Shqipërisë jetonin mes urrejtjes dhe ëndrrës se kur di vijë dita që do i bashkonte ato në një shtet të përbashkët. Shqiptarët e viseve jashtë shtetit amë, konstatonte Arbën Xhaferi, tregonin distancë ndaj vlerave kulturore sllave apo greke, për dallim nga shqiptarët brenda Shtetit shqiptar, nga se ato jetonin në rrethana krejt tjera në raport me këto vlera kulturore që assesi nuk mund ta rrezikonin qenien e tyre. Kur merret me çështjet e përgjithshme shqiptare, ai e trajton edhe raportin me shtetin, me ligjin dhe respektimin që shqiptarët duhet ta kenë për shtetin, ashtu siç i trajton edhe çështjet e pazgjidhura të tyre „në raport me shtetet ku jetojnë: „Popujt që kanë ndërtuar shtete ku funksionon dhe respektohet ligji, kanë traditë dhe përvojë të gjatë, shprehet ai, në njërën nga përgjigjet e pyetjes së Enver Robellit. Shqiptarët, konstaton Arbni, janë në fillim të krijimit të shtetit dhe kanë vështirësi për ta kuptuar rëndësinë e thellë të ligjit në procesin e ndërtimit dhe funksionimit të shtetit.⁴⁹ Akuzave për gjoja ekstremizmin shqiptar në Maqedoni, ai

⁴⁸ Radio Dojce Vele, 16.08.2012

⁴⁹ Enver Robelli, Në Tetovë në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2012, f. 71

i përgjigjet se ky ekstrimizëm vjen pikërisht nga pala maqedonase, që ofron koncept të gabuar për funksionimin e shtetit multietnik dhe në kundërshtim me realitetin shqiptar, që e quan „kauzë shqiptare”. Për politikën shqiptare, ai konstaton gjithashtu se është duke u zhvilluar si e ndarë, në të këqinj dhe të mirë, apo në miq e armiq. Ky polarizim i skajshëm është shkatërrues dhe nuk ndihmon në preceset zhvillimore të shoqërisë shqiptare, prandaj kjo mënyrë e qëimit të hesapeve përmes fjalorit fytes e denigrues, për kundërshtarin politik, është i papranueshëm për te. Një mangësi tjetër negative që e sheh te shqiptarët, është defetizmi kolektiv, që çon nga idetë e mëdha kombëtare në ide parciais. Ai është për politikë nacionale shtetërore. Shqiptarët, thot ky lider, „duhet ta kuptojnë se pa politikë nacionale, nuk mund të krijohet kohezion i brendshëm, brenda një shoqërie”.⁵⁰

Arbën Xhaferi kur fliste për politikën që lidhej me çështjen shqiptare, me shpërbërjen e Jugosllavisë, rënien e komunizmit dhe paraqitjen e pluralizmit politik në këto hapësira, dhe për mundësinë e mbijetesës së shteteve multietnike, gjithmonë i kishte parasyshtë zhvillimet historike, në bazë të cilave e ndërtonte filozofinë e mendimit politik, të rezistueshëm për periudhë afatgjatë. Duke i njohur rrethanat historike, gjithmonë të disfavorshme për shqiptarët, por edhe dukuritë shoqërore e politike në rrethana plurale, vjen te përfundimi se „pluralizmi në këto hapësira u shfaq si pluralizëm etnik, me ngjyrimet nacionaliste, shoveniste diku-diku edhe naciste”⁵¹. Në këso rrethanash dhe parime, as që priste ndonjë sukses spektakular në avansimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Demokracia liberale aq e pritur, që do duhej t’i rregullojë raportet ndëretnike mbi bazën e konsensusit të plotë, ku do përfitonin edhe shqiptarët, në rrethana kur represioni mëtonte t’i shfaros kundërshtarët etnikë, as që pritej se do rregullohen punët në dobi të shqiptarëve. Në mungesë sistemit të vlerave, konstatonte Arbni, ndërrimi i doktrinave, asaj komuniste moniste me atë demokratike dhe pluraliste, nuk u përcoll më ndërrimin e mendësisë dhe sistemit të vlerave sepse se jotoleranca ndaj tjetrit, vazhdon të mendojë Arbni, dhe ekskluziviteti, janë emruesi i përbashkët i kësaj mendësie. Mbi baza të represionit as mund të lejohen projekte që do i shtynin proceset përpara, e ku do përfitonin edhe shqiptarët, prandaj Arbni është skeptik se mund të mbijetojë gjatë kohë një shoqëri multietnike

⁵⁰ Rudina Xhunga, 12 porositë e Arbën Xhaferit, Tiranë 2012, f.116

⁵¹ Arben Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë 2016 f.187

në një shtet etnocentrik. Duke mos pasur rrugë tjetër për dalje nga kjo hapësirë e kontaminuar, aso kohe lideri i PDSH-së kërkoi një marrëveshje historike mes shqiptarëve dhe maqedonasve, që nuk u përkrah nga klasa politike e shumicës maqedonase, i ndihmuar edhe nga oportuniteti shqiptar, i instaluar në atë Qeveri.

Thellimi i hendekut të mospajttimeve që ndante maqedonasit me shqiptarët, në njërin anë, dhe refuzimi i ofertës së Arbnit për një marrëveshje historike, i hapi rrugë një konflikti, që erdhi si shprehje e mosfunksionimit të kodit identifikues të shtetit, edhe pse në atë kohë, me koalicionin PDSH-VMRO-DPMNE, zhvillimet politike dhe raportet ndëretnike ishin në rrugë të mbarë, ndërsa të arriturat e shqiptarëve ishin evidente në shumë sfera të jetës politike e shoqërore . *Ai kur flet për shqiptarët në rrafshin gjithpërfshirës, shpesh flet edhe për qëndrimet e shqiptarëve në raport me fenë, tolerancën ndërjetare të shqiptarëve të Shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve që mbetën në trojet e tyre, por nën pushtete të huaja sllave, të cilët „për shkaqe politike kultivojnë një distancë ndaj besimit fetar të popullit me të cilin një kohë të gjatë janë në konflikt me sllavët ortodoksë „⁵²*

2.Pikëpamjet e Arbën Xhaferit për çështjet fetare (toleranca dhe intoleranca fetare)

Arbën Xhaferi, si intelektual, mendimtar e politikan, në asnjë moment nuk i ka ikur as edhe temave më të ndjeshme, siç është edhe çështja e fesë, dhe e rolit të religjionit në përgjithësi dhe te shqiptarët në veçanti. Për t'i trajtuar temat që kanë të bëjnë me religjionin, në mjediset shumëkonfesionale, siç janë edhe ato shqiptare, gjithsesi duhet dije e njohuri paraprake, guxim intelektual dhe mënyrë specifike e trajtimit të këtyre temave. Arbni, njeriu të cilit nuk i mungonin këto aftësi, në shumë raste i trajtoi këto tema, duke nisur që nga zanafilla e religjionit, koha kur lindën vendet e shejta, roli i tyre në shoqëri të ndryshme, karakteri edukativ i tyre gjatë historisë, përhapja nëpër vende e popuj, e deri te keqpërdorimi i fesë nga qarqe të ndryshme, dhe ekstremizmat fetarë. Feja, sipas tij, nuk mund të jetë burim krizash dhe të mbjellë urrejtje mes

⁵² Shih : Enver Robelli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2011,f.66

njerëzve, por aspektet tjera religjioze, nacionale, politike, ideologjike që e instrumentalizojnë ate, për të dominuar mbi të tjerët. Duke u nisur nga këto parime, ai edhe kur fliste për tema krejtësisht tjera, zbërthente edhe fenomenet religjioze, duke e theksuar shpesh se shqiptarët, edhe pse u takojnë tri apo më shumë feve, në asnjë priudhë kohore ato nuk sollën përçarje , përkundrazi, ndërtuan një bashkëjetësë të shkëlqyeshme me respekt reciprok , që edhe sot merret si shembull se si duhet respektuar fetë e njëri tjetrit. Çdo shmangie nga parimet fetare bazë, të cilësdo fe qoftë, shumë shpejt kalohet në ekstrimizëm dhe keqpërdorim të fesë për interesa nga më të ndryshmit, do shprehej ai në një Konferencë shkencore , mbajtur në Tiranë. Ai edhe kur merrej me fe, në ndonjë rast, mbase ishin pjesë e përditshmërisë, ate e trajtonte në suaza reale, që duhej të ishte në shërbim të njeriut, e assesi kundër njerëzimit . Të merresh me këto çështje, edhe në rrethana të keqpërdimit dhe të instrumentalizimit të fesë nga qarqe interesash të ndryshme, është edhe përgjegjësi, ashtu si edhe obligim. Në kushtet e sotme feja keqpërdoret në masë të madhe, thotë Arnën Xhaferi, madje këto keqpërdorime sjellin edhe luftra të ndryshme. Gjeneratori i shumë krizave dhe i konfliktit nuk është feja, do pohonte ai, por konceptet për shtetin, pa marrë parasysh a vijnë ato nga kleri apo konjunkturat politike që synojnë ta instrumentalizojnë fenë për qërim të hesapeve me kundërshtarin. Në shtetet multinacionale duhet me kujdes të madh të kultivohet koncepti laik, sekular i shtetit, ashtu si edhe koncepti qytetar, mendon ai, sepse po e shpalle një shtet ortodoks, islamik, katolik apo të ndonjë religjioni tjetër, pjesëtarët tjerë të shtetit që nuk janë të atillë, shndërrohen në qytetarë të rendit të dytë dhe konfliktet bëhen të pashmangshme.

Arbën Xhaferi sa herë i trajtonte këto tema, në epiqendër të konceptit për fenë e kishte edhe çështjen shqiptare, besimin në tri fe të tyre, tolerancën dhe orientimin proevropian, duke e ndjerë më se të nevojshme respektimin, standardet evropiane dhe njëherit duke e respektuar secili fenë e vet dha ate të njëri tjetrit, sepse edhe pse qytetërimi evropian është i ndërtuar mbi baza sekulare, ai nuk është antireligjioz. Edhe çështjen e kombit në relacion me fenë, ai e spjegon në mënyrën që assesi mos të përzihen më njëri tjetrin, që don të thote se shqiptarët e konfesionit islam, i obligon feja e vet por, „kursesi konceptet civilizuese, nacionale e shoqërore, të mpleksura në korpusin islamik, ngaqë ato i ka të vetat, apo të mjedisit, ku ka jetuar më mijëra vjet”. Sipas tij shpeshherë politika përmes religjionit dëshiron t’i realizojë synimet e

veta, duke e kompromentuar kulturën e vlerave fetare, për të nxitur urrejtje me „pretekst ndëshkimi”. Një tendencë e kësaj natyre të keqpërdorimit kohëve të fundit vërehet në instrumentalizimin e Islamit. Ky fenomen i keqpërdorimit të fesë nga qarqe të ndryshme, sipas tij, vjen nga dy shkaqe: për ta kompromentuar një kulturë që integrohet në një sistem më të gjerë vlerash që shpallet i rrezikshëm për të tjerët, për të krijuar kështu pretekstin për ndëshkim, ose për të krijuar aleatë në luftën me kundërshtarë politikë.⁵³ . Këtë mënyrë të politizimit të fesë, Arbni e vëren, madje si të theksuar në të gjitha hapësirat shqiptare të ish Jugosllavisë, e sidomos në Maqedoni, ku tanimë vërehet një tendencë e akulturimit, të përqendruar vetëm në aspektin religjioz të tyre, me tendencë të zbehjes së kodit civilizues të vlerave kombëtare, që nuk i përgjigjen trashëgimisë historike dhe vlerave evropjane. Këtë mënyrë të akulturimit të tyre ai e sheh si të rrezikshëm, madje si formë perfide të gjenocidit, që na përkujton edhe kohërat jo shumë të largëta kur shqiptarët ishin viktimë e planeve ugurzeza të politikës serbe, për t’i larguar ato nga tokat stërgjyshore për në Turqi.

Për këto fenomene të relacioneve fe-komb, dhe instrumentalizimit të tyre ai i flet, edhe kur e spjegon zanafillën e konflikteve në ish Jugosllavi, që gjithsesi ishin edhe rezultat i urrejtjes fetare, që më së shumti ndikoi në konfliktin mes boshnjakëve muslimanë dhe serbëve ortodoksë, përfshirë edhe kroatët katolikë. Edhe në Kosovë, konstaton Xhaferi, lufta mes shqiptarëve çlirimtarë dhe serbëve, pushtues të kahmoçëm të këtyre trojeve, mori dimensione religjioze, me qëllim që të shtohet urrejtja edhe në planin religjioz, në këtë pikë të ndjeshme të palëve ndërluftuese. Shqiptarët, edhe pse më herët ishin më pak të shkolluar, i kishin në kujtesën e vet porositë e rilindësve tanë, të cilët, si përfaqësues të tri feve, në epiqendër e kishin kombin, të vetëdijshëm se gjeneratat që do vinin t’i kenë model se si duhet ruajtur ai edhe në mjedise shqiptare me më shumë besime fetare. Për fat të keq, kjo bashkëjetesë fetare, kohëve të fundit zbehet dukshëm edhe në Shtetin shqiptarë, mendon ai, për ta vazhduar mendimin e vet se „Kundër këtyre sfidave të sofistikuara të shqiptarëve tash për tash reagohet me emocione. Shqiptarët sot, kudo që të jenë identifikohet me ortodoksin Fan Noli, me katolikun Gjergj Fishta ose me muslimanin Naim Frashëri. Mirëpo kjo nuk mjafton. Intoleranca fetare mund të mbillet

⁵³ Arben Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë 2016, f.13

edhe në mjediset puro shqiptare siç është Shqipëria. Për këtë mjafton të ndërtohen kode të ndryshme civilizuese, pastaj automatizmi e bën të veten. Përgjegjësinë më të madhe për ta penguar këtë e kanë shqiptarët e konfesionit islam, ngaqë janë shumicë. Rilindasit e dinin se Shqipëria gjendet në Evropë, se shqiptarët janë arianë, por ne a e dimë vallë? ⁵⁴.

Pikëpamjet e Arben Xhaferit për religionin, politikën dhe shqiptarët, tani më janë të njohura përmes shkrimeve të tij. Nga njohuritë e thella të tij për këto raporte, të bazuara në realitete historike mësojnë të gjithë, madje edhe ata që në këtë drejtim nuk e konsiderojnë si të tillë. Argumentet e tij, me fakte e shembuj nga historia, që vështirë se mund të kontestohen edhe nga njohësit më të mëdhenj të religjioneve, sot duhet të jenë mësim për të gjithë. Këto mendime, madje edhe me peshë filozofike të tij, në kohën kur në shtetet postkomuniste, janë shpeshtuar polemikat, kërcënimet e ndryshme, që çojnë drejt konflikteve në baza edhe fetare, duhet të kuptohen drejt dhe pa prapavi ideologjike apo fetare. Teoritë, përmes të cilave ai i zbërthen fenomenet religjioze, mbështeten edhe në konceptet e dietarëve të ndryshëm që merren me këtë problematikë, nga të cilët i preferon Osëald Spenglerin me librin e tij „Rënia e perëndimit“, „Fransis Fukujama me librin „Neriu i fundit dhe fundi i historisë“ dhe Hantingtonin me librin „Përplasja e qytetërimeve“, për të cilët mendon se janë nën ndikimin e filozofisë së Hegelit. Parashikimet e Samjuel Hantingtonit, për konfliktet religjioze, konstaton Arbni janë tepër sqetësuese edhe për shqiptarët e tre besimeve fetare, edhe pse „Shqipëria dhe populli shqiptar nuk njihin antagonizma të kësaj natyre, por të kundërtën, harmoninë do të thoshim paradoksale, unike që befason, intrigonkureshtjëm dhe ushqen Shpresën“.⁵⁵ Këtë veti të shqiptarëve, që nuk njohin konflikte në baza religjioze, ai e sheh në formimin e identitetit të shqiptarëve mbi bazën e përkatësisë etnike, e jo fetare, siç kemi rastin e boshnjakëve të Bosnjës, apo edhe të tjerëve në atë hapësirë, që hynë në konflikte religjioze. Se në shqipëri nuk ka pasur asnjëherë projekte për konflikte ndërjetare, madje edhe në momente të tronditjeve më të mëdha siç ishte „viti i mbrapsht“ i '97-tës, kur megjithatë, sipas Xhaferit, krahas tragjedisë, ndodhi një mrekulli „Populli

⁵⁴ Arben Xhaferi, Toleranca dhe intoleranca fetare, Tiranë, 15-17 shtator 1993, botuar në revistën „Thema“ Prishtinë dhe në librin „Arben Xhaferi, Vepra 02, f.13/14.

⁵⁵ Arben Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë. 2016, f. 16/17

grabiti armët nga depotë, por nuk ndodhi asnjë vrasje, qoftë dhe grindje mbi baza religjioze, etnike, politike apo rajonale”⁵⁶

Duke njohur fenomenet historike të ndarjeve e të përçarjeve, të botës islame dhe jo vetëm, ai konstaton se këto konfrontime me përmasa të mëdha, vazhdojnë të ripërtërihen edhe sot. Këto konflikte vërehen edhe nëpër xhamitë tona, shton Xhaferi, ku kemi përçarje edhe të xhemateve e imamëve. Ajo që befason, sipas tij, është fakti se këto dukuri negative po ngren krye edhe në Shqipëri dhe kështu, ngadalë dhe sigurtë „këto valë, këto dilema, e këto mosmarrëveshje dalëngadalë, si rrathë të koncentruar do t’i rrezatojnë edhe hapësirat tona”. Kur flet për islamin dhe shqiptarët, ai mendon se spikatja e rolit të religjionit në ndërtimin e identitetit kombëtar, është kundër interesit kombëtar, veçmas për kombet me shumë religjione, si edhe shqiptarët. Ndërtimi i identitetit kombëtar, në bazë fetare, mendon ai, është përfundim absurd i qasjes së këtillë, përndryshe në botë duhej të kishte kombe aq sa ka fe. Të gjitha këto keqpërdorime të religjioneve bëhen për interesa të natyrave të ndryshme për interesa individuale, grupe e politike dhe në emër të zotit. „Thirrja në Zot, për të bërë krim, për të vrarë krijesat njerëzore të vetë Zotit është blasfemi e llojit më ateist, mendon Xhaferi, për të vazhduar më pastaj se kjo blasfemi ka dy forma të shfaqjes: „Në emër të zotit krijohet fatkeqësia, tragjedia kundër njerëzve të tjerë, ose në mënyrë sa arrogante, po aq edhe qesharake merret në mbrojtje Zoti nga të tjerët”.⁵⁷ Xhaferi kur flet për shqiptarët, për besimin e tyre në fenë islame, si shumicë që janë, për islamistët e instrumentalizuar, për fanatikët e manipuluar dhe rrezikun islamist, që për disa qarqe do të katapultohet nga Shqipëria dhe Bosnja, është shumë i kujdesshëm në analizat e veta, pa lënë hapësirë për ta kapur dikush për fjale, përveç atyre qëllimkëqinjve, të cilat nuk duan të pajtohen me realitetet e bazuara në shumë argumente, sepse janë të prirur t’u qëndrojnë besnik ideologëve të tyre që duan të përfitojnë nga tragjeditë njerëzore. Shqiptarët nuk ka pse të përzihen në ato ujëra të turbulltë, po çka se një pjesë e madhe e tyre janë muslimanë. Shqiptarët asnjëherë nuk duhet të bëhen pjesë e skemave të tilla, që shpeshherë janë dhe në interes të hegjemonisë serbe. Në këtë drejtim, veprimet e shqiptarëve, kudoqofshin

⁵⁶ Arbën Xhaferi, Vepra, 02 Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë, 2016 f.21

⁵⁷ Po aty, f.39

ata, duhet të jenë shumë të matura, përndryshe, etiketimet e tyre për gjoja islamizëm ekstrem, që mund ta rrezikojnë rajonin, do marrin hov shumë më të madh. Ja me ç'farë shembujsh Xhaferi e ilustron këtë mendim: „Mjafton një reagim i vogël në shtypin shqiptar kundër ngritjes së Katedrales katolike në Prishtinë, mjafton një manifestim pompoz i përkatësisë fetare, mjafton një sfilatë në rrugë me garderrobë arabe, tanimë e shndërruar në modë, apo manifestime të tjera të ngjashme, për t'u dhënë shkas strategëve të hegjemonisë sllave që t'u bien këmbanave dhe ta amplifikojnë rrezikun”.⁵⁸ Të këtilla etiketimesh, për shqiptarët, vetëm se i takojnë fesë islame, konstaton ai, paraqiten edhe në hapësira tjera, siç është edhe Maqedonia, me tendenca të vazhdueshme për përvetësim të figurave shqiptare me peshe historike, e humane, si Nënë Tereza dhe shumë të tjerë, vetëm pse i takuakan fesë krishtete, dhe refuzimit të tyre që këto vlera mund të jenë shqiptarë. Madje në emër të këtij projekti, thot ai, formulohet misioni për kontestim të të gjitha vlerave dhe figurave që vënë në dyshim orientimin e pandalshëm „islamist” të shqiptarëve.

Qasjen e imponuar, tani më, që shqiptarët të shihen nga prizmi i dimensionit islamist e jo besimtarë të fesë islame, Arbni e sheh si imponim nga qendra antishqiptare me qëllim zbehjen e simpatisë së politikës perëndimore, madje duke shkuar edhe më larg, që gjoja perëndimorët edhe për sulmet e NATO-së, në caqet ushtarake serbe në Kosovë e Serbi, qenkan penduar. Këto lojëra të fliqura në emër të religjioneve, ai i sheh me sy të mprehtë prej analisti të thellë, me begroud të një mendimtari filozof, që nuk mund të kontestohet në asnjë moment, përveç tendencës për ta njollosur edhe për mënyrën e zbërthimit të fenomenit religjioz, në raport me çështjen shqiptare. Të gjitha këto shpifje, denigruese për gjoja dominimin e elementit islamist të shqiptarëve, e jo të ndërgjegjes kombëtare e dashurisë për liri, deri diku patën ndikim në disa mjedise e individë, edhe pse jo shumë të rëndësishëm në politikën globale të Evropës dhe SHBA-ve. Edhe këtë tezë Arbni e mbështet në praktikën diplomatike të tij, që krahas politikës e ushtronte në mënyrë të shkëlqyeshme, sa hrë takohej me diplomatë të niveleve të ndryshme: „Para disa ditësh në një takim me diplomatë të rangut të lartë evropian u hodh vlerësimi se faktori ndërkombëtar nuk di ç'të bëjë me Kosovën, dhe Bosnjën. Po ashtu në një darkë me një

⁵⁸ Arbën Xhaferi, 02, Vepra Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë, 2016 fq 51

politikan të rangut më të lartë evropian, në insistimet e mia që paraprakisht të njihet pavarësia e Kosovës, që pastaj të realizohen obligimet e tjera, ai me sinqeritet pushtues m'u përgjigj se nuk kanë kujt t'ia besojnë pavarësinë"⁵⁹.

Për fat të keq, kësisoj mendimesh, jo në favor të shqiptarëve, qarkullojnë gjithandej mendon Xhaferi, prandaj ai përmes paraqitjes së tij nëpër media të ndryshme, në Maqedoni, në hapësirat tjera shqiptare e më gjerë, angazhohet për ta paraqitur anën tjetër të medales, atë të favorshmen të shqiptarëve. Kufizimi i veprimit politik i tij vetëm në një Maqedoni, që për mendimin e tij politik e filozofik, ishte tepër e vogël, edhe pse me probleme të mëdha për shqiptarët e atjeshëm, në atë rast do vinte në kundërshtim me tezën e njohur të tij se çështja shqiptare duhej zgjidhur në paket dhe në çdo hapësirë, sipas specifikave që i ofronin kushtet aktuale, por gjithmonë duke pritur kohëra më të volitshme dhe përkrahje më të madhe ndërkombëtare për bashkimin e aq pritur kombëtar. Shqiptarët, mendon ai, duhet të jenë të vetëdijshëm se gjithë veprimet e tyre, sidomos të klasës udhëheqëse politike, janë në mbikqyrje të vazhdueshën nga faktori ndërkombëtar me peshë të madhe për shqiptarët. Në kushte krejtësisht tjetërfare, kur po flaket në themel ideologjia komuniste dhe ka përfunduar lufta kundër „udbashve“, armiqtë e përbetuar të shqiptarëve, duhet ta vazhdojnë betejën, madje edhe më të fuqishme e të pakompromis kundër vlerave antiperëndimore, siç janë fundamentalizmi ekstrem fetar, korrupsioni, krimi, prostitucioni dhe të tregojnë zotësi për vendosje të paqes dhe rendit, thënë shkurt, do shprehej Arbni, të dëshmojmë se kemi kapacitet për shtetformim“. Çdo kohë, kërkon forma specifike të veprimeve politike, prandaj shqiptarët në kohët e sotme, shigjetat duhet t'i drejtojnë edhe në drejtime tjera, duke i njohur armiqtë e rinj të politikës shqiptare, që bashkë me ata të vjetrit tradicionalë bëhen gjithmonë e më të rrezikshëm: „ Ata fshihen para projekteve religjioze apo projekteve të tjera ideologjike për t'i kontrabananduar intresat kombëtare, grupe, financiare të faktorëve të ndryshëm, të cilët nuk çajnë kokën as për religjion, as për fatin e popujve që kanë qenë viktime tragjike të hegjemonizmave.“⁶⁰

⁵⁹ Arbën Xhaferi, 02 Vepra Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë, 2016 fq 52

⁶⁰ Arbën Xhaferi, Vepra 02, Kauza Shqiptare në Maqedoni, Prishtinë, 2016 fq 52

Arbën Xhaferi, me njohuritë që i ka për këto çështje, jep spjegime në këtë drejtim edhe për rregullimin e raporteve të shteteve evropiane me religjionet, përmes zbatimit të politikës së ndarjes së shtetit nga feja. Kjo mënyrë e ndarjes bazohet në parime teologjike, të sanksionuara sipas Shën Augustinit, dhe në ate politikë që e kanë bërë shtetet evropjane, gjithmonë duke pasur kujdes që të mos preken ndjenjat fetare të popullatës së atjeshme. Duke u nisur nga parimi i moscënimit të të drejtave të, tjetrit, nënvizon ai, hartuesit e kushtetutës së re evropiane refuzuan që në preambullë të përmendet kontributi i besimit kristian në ndërtimin e identitetit evropjan. Modeli i shoqërisë së hapur evropiane, konstaton mëtutje Arbni, kur bën fjalë për fenomenet religjioze dhe tolerancën që popujt duhen ta kenë për fenë e njëri tjetrit, nuk e kufizon asnjë popull ta praktikojë fenë e vet sipas parimeve të saj, përkundrazi në shtetet evropjane sot janë ndërtuar shumë xhami. Te këtilla objekte fetare, ku secili i lutet zotit në mënyrën e vet ka gjithandej, si psh., siç thonë disa, Xhamitë më të bukura të kohës së sotme gjinden në SHBA, madje edhe në Bondstil të Kosovës, janë ndërtuar hapësira për xhami. Arben Xhaferi i përmend të gjithë këto shembuj për ta forcuar idenë se feja dhe religjionet kanë kuptim vetëm nëse janë në shërbim të zotit, e assesi në shërbim të së keqes, që vjen si rezultat i urrejtjes, minimizimit apo i majorizimit të njëres apo tjetres fe, kur mungon vetëdija e plotë „për të drejtat e njeriut për shfaqje dhe kultivim të bindjeve fetare. Ldhur me gjithë këtë që e tham, gjithmonë duke u bazuar në filozofinë e mendimit universal të Arbnit, përfshirë edhe çështjet religjioze, ai për perëndimorët shprehet: „ Perëndimorët krenohen me tolerancën e tyre. Kjo është e vetmja rrugëdalje për këtë çështje. Rrugdalje të tjera nuk ka, veçmas për shqiptarë, sidomos ata kosovarë. Të Drejtën për shtet ata do ta fitojnë vetëm nëse në te do të respektohen standardet e shoqërive të hapura prendimore. Standardi kryesor gjithësesi do jetë respektimi i diversitetit etnik, fetar dhe kulturor. Këtë shqiptarët e kanë zbatuar gjatë historisë së tyre dhe tash kur shumëçka varet nga ky standard dikush e turbullon ujin.”⁶¹

Kur flet për fetë dhe religionin në përgjithësi, ai në analizat e veta gjithmonë fenomenet i zbërthen në kontekstin historik, sepse vetën duke e njohur zanafillën e problemit në rrethana të caktuara historfike dhe zhvillimet deri në ditët e sotme, vjen deri te përfundimi. Ai

⁶¹ Po aty, f. 57

duke i njohur zhvillimet shoqërore, por edhe identitetet fetare, që sipas tij shumë më herët ende nuk kishin strukturë të fortë religjioze dhe dallimet ndërmjet besimeve nuk ishin aq radikale, vjen deri te konstatimi se sot kemi disa lloje përceptimesh fetare. Këtë ai e vërteton me këtë shëmbull: „Të bardhët e përceptojmë Jesu Krishtin me tipare të njeriut të bardhë, bjond dhe sykaltër, zezakët me tipare të njeriut të zi, ndërkaq tajvanezët si përfaqësues të racës së verdhë.”⁶² Në këtë kontest ai i jep përgjigje edhe pyetjes se si erdhi deri te konvertimi i shumicës shqiptare në muslimanë. Ai edhe për këtë çështje ka qasje të qëndrueshme, gjithsesi të mbështetur në sqarimet sociologjike. Për këtë çështje të pasqaruar mirë deri më tani, ai do shprehej kështu: „Të gjitha këto përjasje nuk marrin parasysh një fakt elementar: Formimi i shtetit konsolidon religjionet, në rënd të parë për shkak të rolit pozitiv mobilizues të religjionit. Shtetet i konsoliduan religjionet për t’i shfrytëzuar ato në funksion të ndikimit të tyre në masë, duke filluar prej kohës së Konstantinit të Madh e deri te Sllobodan Millosheviqi. Mjerisht shteti shqiptar u krijua me vonesë dhe nuk pati kohë që ta instrumentalizojë një religjion përmes të cilit do të ushtronte ndikim politik në masë”.⁶³

3. Përkufizimet politike të Arbën Xhaferit për shtetin dhe funksionimin e tyre

Në shkrimet e prononcimet e formave të ndryshme të shfaqes së mendimit politik, ku trajtohen aspekte të natyrës historike, shoqërore, sociale e filozofike, të Arbën Xhaferit, një vend të rëndësishëm zënë edhe çështjet që kanë të bëjnë me kombin, shtetin dhe identitetin, ku gjithsesi në qendër të vëmendjes janë shqiptarët dhe fati historik i tyre, që nga koha ilire e deri në ditët e sotme. Në një hapësirë aq të gjatë historike, ku binin perandori, krijoshin shtete etnike, multietnike, krijoshin koloni dhe bëheshin luftëra për liri e pavarësi, të analizosh shkaqet dhe pasojat e gjithë atyre interesave gjeostrategjike, për t’u ndalur te çështja shqiptare, lufta për liri e pavarësi e tyre, ruajtja e gjuhës, e kulturës në përgjithësi, deri te formimi i shtetit, nuk është gjë e lehtë, por as e pamundshme për penën e mpeftë të tij. Ai, siç thotë Shkëlzen Maliqi, njëri

⁶² Enver Robelli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, prishtinë 2011, f. 35

⁶³ Po aty

ndër redaktorët e botimit të kompletit të librave 5 vëllimësh, kushtuar veprës së tij, që në rini ka qenë i interesuar për çështjen shqiptare dhe statusin e tyre në Maqedoni dhe Jugosllavi. Për këto qasje ai ka pasur qasje akumuluese njëzet e sa vjeçare, dhe vetëm kur kriza jugosllave dhe e Kosovës e pati arritur kulmin, ai doli në skenën publicistike si një intelektual dhe mendimtarë politik i pjekur që shkruan dhe flet me kompetencë dhe argumente.⁶⁴ i krijuar, i edukuar kësisoj, dhe i preokupuar me më shumë çështje, nuk e pati vështirë të shkruajë edhe për shtetin, historinë dhe tipet e shteteve, pa hequr dorë asnjëherë nga teza se shtetet etnike janë më të qëndrueshme, mbase ato multietnike e kishin vështirë të krijonin kushte për barazi të plotë për të gjithë ata që jetonin aty. Dija e tij e thellë për shtetin dhe funksionimin e tij në kushte normale, kur nuk i mungonte edhe guximi, me kohë ishin vërejtur madje edhe nga vetë njohësit tjerë të kësaj problematike.

Në fillimet e tij të daljes para publikut për t'a trajtuar synimin e Kosovës për pavarësi, në një tribunë të mbajtur në Beograd në vitin 1992, organizuar nga Asociacioni i qarkut të Beogradit, para një audience relativisht liberale, Arbni haptas dhe pa asnjë rezervë e tha të vërtetën për Kosovën dhe kërkesat e drejta të shqiptarëve. Ai ashtu i qetë, dhe i sigurtë në atë që e thoshte, duke trajtuar relacionet serbe-shqiptare, parashtroi njohuritë e shqiptarëve për gjuhën serbe dhe për kulturën e tyre në përgjithësi për fqinjët serb, dhe injorimin total të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare nga sërëbet dhe nënçimin e tyre si popull. Kjo qasje e tij aq në mënyrë të haptë dhe me shumë argumente, i revolttoi të pranishmir serb. Eseu i Arbnit ka qenë i shkurt dhe brilant, në stilin e Franc Fanonit dhe Zhan Pol Sartrit të cilët në kohën e dekolonizimit kritikuan politikën e ngjashme imperialiste, do shprehej Shkëlzen Maliqi, i cili ishte pjesë e këtij debati të organizuar pikërisht në Beograd. Regjisori i famshëm Dushan Makavejev më pati thënë pas tryezës: „Këtyre idiotëve nacionalistë serbë duhet t'u flitet kështu siç ua përplasi në fytyrë Xhaferi”, u shpreh ai.⁶⁵

Ai, që në fillim të kësaj qasjeje për shtetet, e shtron pyetjen se si mund mund të dështojnë shtetet, shoqëritë dhe parimet etike, madje edhe një pjesë e tyre të ndërtuara mbi

⁶⁴ Arben Xhaferi Vepra 01, Kombi, Identiteti, Shtetit 01, Viti 20016 f.11/12

⁶⁵ Arben Xhaferi Vepra, Kombi, Identiteti, Shtetit 01, Viti 20016 f. 12

parime demokratike. Kjo pyetje aq e lehtë, për te, do përgjigje gjithpërfshirëse, që bazohet në shumë rrethana të kontekstit historik. Pasi konstaton se shkaku kryesor për shpërbërjen e shteteve është jofunksionaliteti i institucioneve, bën një retrospektivë, duke u kthyer në histori. Në fillimet e shek. XX, sipas tij, përmes revolucioneve, u rrënuan shtetet perandorake kapitaliste, Rusia Cariste, Perandoria Osmane dhe ajo Austrohungareze, në gërmadhat e të cilave u ndërtuan shtete të reja, si BRSS, Jugosllavia, Çekosllovakia, si dhe shtetet nacionale, Austria, Hungaria, Polonia Shqipëria etj.

Ai kur flet për shtetet komuniste dhe rënien e tyre, që sipas tij kjo rënie ishte shumë më e shpejt se ndërtimi i tyre, flet njëherit për ndërtimin e shtetit mbi parimet liberale që për te, ishte edhe faktori kryesor për shembjen e shteteve komuniste, sepse vetëm shtetet e krijuara në bazë të vullnetit të popullit, konstaton ai, mund të jenë të qëndrueshme, por me kusht që vullneti i votuesve mos të keqpërdoret përmes blerjes, dhe vjedhjes së votave. Kjo aftësi për manipulimet e pushtetmbajtësve, e dëmton demokracinë, prodhon korrupsion, krim të organizuar dhe modifikim të lojalitetit. Kjo aftësi e manipulantëve politikë, mendon ai, në masë të madhe i dëmton edhe shtetet multietnike, kur si rezultat i padrejtësive paraqitet jolojaliteti i bashkësive të papërfillshme ndaj shtetit, ndërsa në shoqëritë njëetnike, kjo dukuri shfaqet përmes jolojalitetit të kategorive të interesit, përfshirë ato familjar dhe partiak. Në kushte të këtilla të funksionimit të shtetit, paraqiten krizat që çojnë edhe drejt konflikteve dhe luftrave. Abni këto kategori shtetesh të dështuara, edhe pse formalisht të ndërtuara mbi bazën e demokracisë liberale, i bazon në përvojën e tij praktike e teorike, duke u mbështetur edhe në mendimet e teoriticienëve të ndryshëm dhe autorëve, veprat e të cilëve, këto fenomene i mbështesin edhe shkencërisht. Qasja e tij në zbërthimin e këtyre fenomeneve të formimit të shteteve mbi baza të ndryshme dhe rënies së tyre, ai gjen mbështetje edhe te politologu amerikan Fukajama, që ndjek rrugën e filozofisë së Hegelit Kzheevit, dhe Osfald Shpenglerit. Në librin „Fundi i historisë dhe njeriu i fundit”, botuar më 1992, Fukajama, pas rënies së komunizmit, erdhi të përfundimi se mes shteteve të modeleve të ndryshme do ngadhënjë koncepti demokracisë liberale, dhe kështu ky proces historik merr fund. Sipas Xhaferit, „autori i këtij spjegimi në mënyrë implicite sugjeron idenë se vetëm qytetërimi perëndimor krijon histori, pro koncepteve për rregullim sa më të përsosur të shoqërisë.” Këto koncepte, vlerëson Xhaferi

ngjallën shumë debate nga klasa intelektuale dhe politike duke konstatuar gjithashtu se mendimi intelektual në Evropë respektohet nga klasa politike shumë më tepër se në vende tjera. I Vetëdijshëm për këtë fakt, ai me tërë peshën e mendimit politik por jo vetëm, e vazhdoi të reflektojë edhe si politikan e mendimtar, pa u shkëputur për asnjë moment nga të menduarit dhe të vepruarit si intelektual e filozof. Nga ky këndvështrim ai edhe kur fliste për shtetet, formimin dhe qëndrueshmërinë e tyre para problemeve të ndryshme, natyrisht i mbështetur edhe në mendimet e dietarëve që u morën me shtetin, kishte sukses në qëndrueshmërinë e tezave për këto fenomene shoqërore, dhe për shtetin. Fenomene, që kanë të bëjnë me shtetin, ai i kategorizon, në mënyrë që t'i paraqesë sa më qartë, sipas kushteve, rrethanave, interesave gjeostrategjike dhe ndikimit të religjioneve. Pas shteteve komuniste, shkëlqimit dhe rënies së tyre, përmes kolapsit të papritur politik, ekonomik e moral, Arben Xhaferi, me die e guxim i qaset grup shteteve të botës islame, që në dekadën e parë të shekullit XXI, i kaploi një krizë e paparë gjatë një periudhe të gjatë kohore. Kjo krizë filloi me Algjerinë, ku, siç konstaton ai, me procedura demokratike verdiktin e popullit e morën forcat politike të proveniencës radikale islamike, që nxiti luftën qytetare, ndërsa regjimet e shteteve të tjera arabe shndërroheshin në monarki trashëguese. Presidentët e zgjedhur nga populli shndërroheshin në monarkë, ndërsa fëmijët e tyre në pretendentë të fronit, konstaton ai në shkrimin me titull, Mutacioni i demokracisë, e botuar gazetën KOHA⁶⁶. Sipas autorit të këtij shkrimi analitik, trazirat në Algjeri, Egjipt, Jemen etj, paralajmëronin një krizë të re, që nuk mund të cilësohet as fetare, as sociale, e as politike. Popullata e pakënaqur që ka dalë në rrugë, sikur nuk e kishin të qartë se çka kërkonin. Trzairat në Libi, as që kishin arsye të jenë të nxitura nga motive sociale, meqë ky shtet ishte i pasur me resurse, siç është nafta, u siguronte një jetë të dinjitetshme. Për këto kriza, konstaton Xhaferi, analistët politikë japin dy arsye të ndryshme; ata me orientime propërendimore vlerësojnë se shkakun qëndron në ndërhyrjen e fesë, ndërsa radikalërt islamistë këto trazira i arsyetojnë me faktin se këto shtete nuk janë në masën e duhur islamike. Pasi ai i konstaton këto dy teza që e kundërshtojnë njëra tjetrën, Arbni e jep edhe mendimin e vet që e mbështet në mungesën e kulturës demokratike, që buron nga mendësia patriarkale autoritare e shoqërisë, që është shumë

⁶⁶ Arben Xhaferi, Mutacioni i demokracisë, KOHA, Shkup, 18 gusht 2012 f. 12

larg demokracisë liberale, për dallim nga mendësia e shoqërive perëndimore që është liberale inkluzive, e që si e tillë është edhe në politikë e praktikim të fesë, e çliruar nga ekskluziviteti.⁶⁷

Edhe kur flet për grup shtetet e rajoneve të tjera dhe krizat e tyre që sollën deri te luftrat, përfshirë: Somalinë Haitin, Kmbokhën, Kongon, Timorin lindor, Avganistanin, por edhe Bosnjën e Kosovën, Xhaferi e mbështet mendimin e autorit Fukujama, të librit „Fundi i historisë”, se kriza e këtyre shteteve qëndron te (pa)aftësia për ndërtim të shtetit.

Edhe te libri tjetër me titull „Ndërtimi i shtetit”, i Fukujamës, ai gjen mbështetje dhe pajtohet me tezat e autorit për mënyrën e ndërtimit të shtetit dhe për rrënimin e tij, nga shkaqe të shumta. Ky autor flet edhe për masat që duhej ndërmarrë, për ta mbrojtur shtetin në rrethana krizash të mëdha, për mospërhapjen e krizës në shtetet fqinje dhe për rindërtimin e ri, duke e theksuar edhe ndërhyrjen e shteteve perëndimore për ndalimin e krizës dhe mospërhapjen te fqinjtë. Sipas Fukujamës, dështimi i shteteve përjeton tri faza, që, sipas tij janë: mosfunksionimi i institucioneve, paaftësia e tyre për ta qetësuar krizën dhe kaosi që përhap krizën në rajon. Për këto raste ai e parasheh edhe ndërhyrjen nga forca ose aleanca perëndimore, që poashtu e ndan në tri faza: ndërhyrje për ta shpëtuar shtetin, rimbëkëmbja e institucioneve dhe ngritjen e një shteti funksional. Sipas teorive për shtetin, dhe njohurive që ka Arbni për ndërtimin dhe funksionimin e tij, sipas specifikave, kuptohet, flet edhe për rastin e Kosovës. Sipas teorisë së Fukujamës, Kosova duhet të trajtohet si shtet në ndërtim e sipër, ku institucionet ende nuk funksionojnë si duhet, do shprehej ai, duke e përmendur edhe dialogun Kosovë-Serbi, rezultati i të cilit do jetë në favor të Kosovës, vetëm nëse pala shqiptare do dijë si ta bëjë dialogun, dhe nuk do pajtohet me kërkesat serbe, që do ta bëjë Kosovën shtet jofunksional: „Ngociatat kosovare duhet ta marrin parasysh faktin e ndryshimit të kontekstit politik. Tanimë vendin e premisë kryesore të legjimitetit ndërkombëtar të shtetit nuk e ka kategoria e respektimit të të drejtave të njeriut, as standardet e Westfalisë (respektimi i integritetit të shtetit, barazia në mes të shteteve, mos ndërhyrja në çështjet e brendshme të shteteve), por funksionimi i shtetit, i institucioneve të tij, pra stabiliteti i tij. Ky ndryshim strategjik është rrjedhojë e konstatimit se terrorizmi, korrupsioni, krimi i organizuar, trafikimi i drogës, ekstrimizmat fetarë radikalizmat etj, janë pasojë

⁶⁷ Arbën Xhaferi, Mutacioni i demokracisë, KOHA, Shkup, 18 gusht 2012 f. 12

e mosfunktionizmit të shtetit. Së këndejmi pala serbe në këto negociata nuk do ta potencojë kërkesën për respektim të standardeve të traktatit të Eëstfalisë, por në mënyrë të pahetueshme do të parashtrijë kërkesa,, teknike”, që do ta bëjë Kosovën shtet jofunksional, burim endemik i të gjitha kqijave të botës moderne. Kjo tashmë është shumë e qartë”⁶⁸

Edhe pse ky shkrim analitik i tij është shkruar tetë vjet më parë, parashikimet lidhur me bisedat Kosovë-Serbi dalin të sakta dhe ashtu të komplikuara nga Kërkesat e Serbisë dhe qëndrimet jo aq sa duhet këmbëngulëse nga pala kosovare, edhe sot e kësaj dite mbeten larg një pajtimi dhe njohjes së Kosovës nga ana e Serbisë. Këto parashikime largpamëse të Arbnit, edhe njeherë e vërtetojnë aftësinë e tij dhe dijet e thella që kishte për këto çështje, madje edhe për një të ardhme më të largët, si rezultat i njohjes së mirë të së kaluarës.

Arbën Xhaferi, si njohës i mirë i rrethanave historike, ekonmomike, politike, religjioze e sociale të shteteteve të ndryshme në rajon, Evropë e më gjerë, nuk e pati vështirë të trajtojë edhe rezistenmcën shekullore të shqiptarëve dhe përpjekjen e tyre për gjuhë, shkollë, komb e një shtet për të gjithë shqiptarët. Kur flet për politikat me appetite pushtuese të shteteve të fuqishme dhe kolonitë e tyre, që gjithmone konsideroheshin si të tilla dhe jashtë territoreve të tyre, e shtron tezën se pushtuesit sllavë asnjëherë shqiptarët dhe tokat e tyre nuk i konsideruan si koloni të huaja, të vtëdishëm se si të tilla një ditë duhet ta fitojnë pavarsinë, por si vendet tyre, si pjesë e kulturës dhe civilizimit të tyre. Përmes kësaj politike perfide, ato mendonin se shqiptarët do i asimilojnë më shpët. Atje ku mendonin se spastrimet etnike mund të realizohen më me pak pengesa, siç janë rrethinat e Nishit, Leskovcit Prokupës, Kurshumlisë etj, përmes presionesh e shtypjes çnjerëzore, arritën t’i spastrojnë këto hapësira nga shqiptarët. Faza tjetër e spastrimeve etnike ndodhi pas Luftës së Parë Botërore, duke përfshirë edhe periudha të pas Luftës së dytë, që ndoshta ishin më masivet për sa i përket shpërnguljes për në Turqi. Të gjitha këto realitete të hidhura të historisë shqiptarëve, dhe përpjekjeve të tyre për të krijuar një shtet real, të vetëm, Arben Xhaferi i mbështet në argumente e historike, siç janë edhe laboratet e hartuara nga Cvijiqi, Çubrilloviqi, Andriqi, Pashiqi, Qosiqi etj. Të drejtën ekskluzive të Serbisë mbi Kosovën, sepse qenka djepi i saj, gjë që sipas tyre argumentohet edhe me kishat ortodokse, Arben

⁶⁸ Arbën Xhaferi, Gazeta KOHA, 03.05.2011 Shkup, dhe Arben Xhaferi Vepra, Kombi, Identiteti, Shtetit 01, Prishtinë 2016, f. 189

Xhaferi e hedh poshtë me vet faktin se ishin shqiptarët që krishtenizmin e pranuan dhjetë shekuj më herët se sllavët, duke shtruar edhe pyetjen se të kujt paskan qenë kishat para krishtërimin të sllavëve? Teza serbe se Kosova është dhjepi i Serbisë, si duket e ka humbur kuptimin edhe për vet serbët, sidomos nga koha kur ky shtet i ri funksionon si i pavarur.

Sipas Xhaferit, ajo që i çon proceset përpara shtë çështja etnike, ose tendencat determinuese, që synojnë të arrijnë barazinë në shoqëri në mes grupeve të ndryshme gjuhësore, religjioze etj. „Këtë faktor që e përshpejton procesin historik, Platoni e quajti „thimos”, ndërkaq te Fokujama e kemi të definuar si nevojë ontologjike të njeriut për barazi, për trajtim dinjitoz ose prestigj.⁶⁹ Kur flet për Bashkimin evropjan në raport me shtetet etnike, ai e përmend një fakt të pamohueshëm kur thotë se 10 shtetet e reja që tani më iu bashkuan Evropë, në esencë janë shtete nacionale. Ai këtij konstatimi ia shton edhe mendimin e vet të thellë e analitik, kur i shpjegon raportet e shumicës së një shteti multi-etnik me të tjerët joshumicë, (që tani më na paraqiten edhe si përqindje, siç e kemi rastin me Maqedoninë e Veriut), duke konstatuar se Evropa i afirmon me xheloz diversitetet, por jo duke krijuar sisteme shoqërore ku janë amalgamuar diversitetet, por duke krijuar sisteme shoqërore, ku janë veçuar diversitetet kulturore, lingjistike, religjioze etj.⁷⁰ Sipas Xhaferit , Evropa i parapëlqen shtetet që plotësojnë kriteret bazë, e që përputhen me standardet e qytetërimit perëndimor evropjan, që siç mendon ai, janë: Kohezioni i brendshëm, mirëqenia ekonomike dhe Demokracia liberale, parakushte këto që vështirë se mund të plotësohen edhe për gjatë kohë. Për sa i përket Maqedonisë, ai me të drejt konstaton se këtij shteti i mungon kohezioni i brendshëm, ku 1/3 e popullatës, në formë të ndryshme manifeston jolojalitet ngaj shteti, i cili vazhdon të privilegjojë vetëm një etnikum, at maqedonas. Deri më tani Maqedonia multi-etnike është ndërtuar si shtet etnocentrik. Arben Xhaferi me kohë kishte konstatuar se shtetet me shoqëri multi-etnike, nuk do funksionojnë, nëse mungon shteti multi-etnik, i barabartë për të gjithë, në të gjitha fushat e jetës.

Arben Xhaferi njohuritë për ndërtimin, funksionimin dhe rënien e shteteve, i bazon në njohuritë e bollshme që ka si toriticent politik, si analist, si mendimtar, por edhe si politikan

⁶⁹ Arben Xhaferi, Shtetet multi-etnike dhe shteti ligjor, Arben Xhaferi Vepra, Kombi, Identiteti, Shtetit 01, Viti 20016 f. 135

⁷⁰ Po Aty, 136

praktik, që udhëhoqi një parti politike shqiptare në Maqedoninë. Jorastësisht, ai kur flet për Maqedoninë, njohuritë teorike i mbështet edhe në përvojën si politikan që veprimi nga pozitë e opozitës dhe pozitës. Duke i pasur parasysh edhe mendimet e shumë filozofëve, sociologëve e politikologëve, të dalë nga shkolla të ndryshme filozofike, nuk e kishte vështirë të depërtojë në analiza të thella të këtyre fenomeneve. Për rregullimin e shumë çështjeve problematike të shteteve, ai mbështet parimet kryesore të disa modeleve, sipas Donald Harovitz dhe Arend Liphard, që janë: 1. Demokracia konsesuale (shembulli i Belgjikës); 2. Autonomia politiko-territoriale (Tiroli jugor apo Alto Adixhes); 3. Federalizimi (Spanja, Italia, Gjermania, SHBA-të, etj, dhe 4. Konfederalizmi (shembulli i Zvicrës)

Pas këtyre vështrimeve, që kanë të bëjnë me shumë tipe shtetesh, mendimtari e politikani Xhaferi e shtron pyetjen se ku gjindet Maqedonia dhe a është i mundshëm funksionimi i shtetit në rrethana jo të favorshme për një gjë të tillë, për ta dhënë përgjigjen të mbështetur fortë në argumentet që i ofron. Mungesa e luajalitetit të një pjese të qytetarëve të vet, si përgjigje e mungesës së kohezionit të brendshëm që do çonte drejt demokracisë liberale, është pengesa kryesore e mosfunksionimit të këtij shteti. Këtë inat dhe kokëfortësi të pushteteve të këtij vendi, që me çdo kusht dëshirojnë ta mbajë „status quonë” sa më gjatë që të jetë e mundur, ai e spjegon me këtë shembull: „Të gjithë e dinë se prej çkajes lëngon pacienti, por gjithashtu kanë filluar të kuptojnë se ai e refuzon edhe terapinë. Ai nuk do të shërohet. Refuzon t’i plotësojë kushtet elementare shëruese, demokracinë konsesuale, e le më autonominë territoriale, federalizmin ose konfederalizmin”.⁷¹ Ky është shkaku kryesor, që ky „pacient” nu don të shërohet. Në këtë rast edhe spcialisti më i madh, si Arbër Xhaferi, nuk ka si ta ndihmojë këtë pacient, përveç se t’i ndihmojë për t’u shëruar jashtë vendit, të cilët do përdorin ndonjë metodë për ta detyruar atë pacient, e nëse edhe ato nuk do kenë sukses, atëherë mund ta konstatojnë jetëgjatësinë e tij. Ky konstatim i Arbnit, kuptohet më qartë përmes këtij mendimi të tij: „Në SHBA-të pak nga pak, pas shumë insistimesh, investimesh, si në planin kombëtar, ushtarak financiar, politik etj, ka filluar të përhapet bindja se disa popuj nuk janë të aftë të ndërtojnë shtet,

⁷¹ Nacionalizmi si faktor shtetformues, Arben Xhaferi Vepra 01, Kombi, Identiteti, Shtetit, Prishtinë 20016 f. 90

ta bëjnë ate funksional, të garantojnë zbatimin e ligjit, etj. Për këto shtete tani përdoret nocioni,, Shtete të dështuara”. Maqedonia pak nga pak rrëshqet drejt në këtë kategori”⁷²

Arben Xhaferi, me kohë kishte konstatuar se shetet etnocentrike, siç është edhe Maqedonia, vazhdimisht prodhojnë kriza, që mund të përfundojnë edhe me konflikte të armatosura ndëretnike, siç ngjau në këtë hapësirë, në vitin 2001. Ai kur flet për këtë konflikt të armatosur, ndërprerjen e shtrirjes në përmasë katastrofale, përmes Marrëveshjes së Ohrit, e sheh si të arritur të madhe që ndërpreu një tragjedi të mundshme njerëzore, ndërsa rezultatet e kësaj marrëveshjeje, përmes zbatimit gjatë një kohe katërvjeçare i konsideron si dështim të plotë. Për mungesën e rezultateve, që dalin nga marrëveshja, ai në mënyrë figurative do shprehej: „Sot kjo marrëveshje funksionon si një vitrinë e plotë me artikuj të ndryshëm, të cilët nuk mund t’i gjesh brenda në dyqan. Maqedonia sërish hyn në dimensionin e krizës për shkak të dinakërive etnike që janë karakteristike e shoqërive dhe shteteve multietnike.

4.Kombi,identiteti sipas Arbën Xhaferit

Arbën Xhaferi në shumë paraqitje të tij publike, përmes shkrimeve të ndryshme analitike dhe intervistave të dhëna brenda hapësirës shqiptare dhe jashtë, është shprehur edhe për çështjet identitare, gjithmonë duke e mbështetur mendimin e vet në filozofinë politike dhe në argumente shkencore. Ai përmes shembujve nga praktika e veprimtarive politike të shqiptarëve gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pozicioneve nënshtruese të disa liderve shqiptarë, karshi politikës serbe, që assesi nuk pajtoheshin të hiqnin dorë nga pozitat e tyre shtetformuese edhe ne hapësirat e ish Jugosllavisë, jashtë Serbisë, në mënyrë bindëse i spjeron fenomenet e të qenit komb shtetformues dhe me identitet të mirëfilltë. Pa elementet identitarë, siç janë: gjuha, historia e përbashkët kombëtare, festat e rëndësishme historike për kombin, flamuri kombëtar, himni etj, nuk mund të ketë identitet real, dhe në përputhje me përkufizimet për këtë nocion, mendon ai. Në këtë drejtim, ai mbështet tezën se duke u angazhuar aq shumë në procesin e shtetformimit të Kosovës, që është shumë e arsyeshme dhe kërkesë

⁷² Po aty

historike e shqiptarëve, u zbeh këmbëngulja për ruajtjen e paprekshme identitare, edhe pse kjo dëshirë e klasës politike kosovare, në rrethanat, fill pas çlirimit, nuk ishte krejtishtë në duartë e tyre. Edhe pse Arbni i vetëdëshëm se faktori ndërkombëtarë, në masë të madhe ndikoi që krahas formimit të shtetit të ri, i cili sipas tyre nuk mund të ishte shtet nacional vetëm i shqiptarëve, por i të gjithë atyre që jetojnë aty, gjen mundësi për veprime më këmbëngulëse të shqiptarëve të Kosovës, në ruajtjen e disa simboleve identitare. Ai i kritikoi haptas edhe veprimet e disa shqiptarëve që pa asnjë ndikim nga faktori ndërkombëtarë, angazhohen për një komb politik shqiptarë, që pas disa viteve, do zëvendësohej me ate kosovar. Individët e këtillë, që mendojnë se në kushte demokratike mund të trillojnë çka të duan, madje të shpikin edhe një komb të ri për shqiptarët, vlerëson Arbni, tentojnë të legalizojnë dhe legjitimojnë projekte për fragmentarizim të identitetit unik kombëtar, mbi baza krahinore, fetare apo ideore.⁷³ . Shpikjen e një kombi politik, atij kosovar, të disa individëve apo edhe grupeve, ai e krahason me kërkesën, ta zëmë, të ndonjë pjese apo rajoni brenda Kosovës, si psh. rugovasit, drenicakët, llapjanët, etj., të kenë të drejtë për veçori të këtilla, e mos flasim për krahina jashtë Kosovës. Arbni kur flet për këto tendenca, që janë të dëmshme për kombin, gjithmonë i ka parasysh edhe idetë rilinësve, të cilët pa marrë parasyshë përkatësinë fetare, krahinore ideologjike e dialektore të shqiptarëve, ato i konsideronin një komb të vetëm. Duke u nisur nga këto parime, ata u angazhuan për një alfabet të njësuar, që u realizua më Kongresin e Manastirit, e shumë më vonë, në atë frymë u arrit pajtueshmëri për themelimin e gjuhës së njësuar letrare, në Kongresin e drejtshkrimit, që u mbajt në Tiranë, më 1972, e që kundërshtohet gjithashtu nga të njëjtët, me arsyetimin se Kosova tani si shtet i pavarur dhe me komb kosovar, duhet të ketë edhe një gjuhë të veçantë, ate kosovare. Këto tendenca, mendon ai, janë në dëm të kombit dhe qenies identitare, me tendencë të përcoptimit të indit kombëtar, ashtu siç është i dëmshëm edhe kodifikimi i një gjuhe të re për shtetin e Kosovës, mbështetur në dialektin geg të së folmes kosovare, tendencë kjo, që si duket nuk ka përkrahje nga pjesa dërmuese intelektuale dhe politike, e as nga shqiptarët jashtë shtetit të Kosovës. Këmbënulësia e Arbnit në këtë çështje dhe qëndrimi i tij kategorik që shqiptarët mos

⁷³ Arben Xhaferi Vepra, Kombi, Identiteti, Shtetit 01, Viti 20016 f. 256

të kthehen sërish në kohëra kur librat shqip botoheshin me gjuhë laramane dialektore, ishte „e meta” e tij, sipas ithtarëve përçarës të çështjes gjuhësore por jo vetëm. Ai ua zë për të madhe gazetarëve dhe shumë individëve tjerë me peshë publike për mosangazhim sa duhet për përdorimin dhe shkrimin e gjuhës standarde shqipe, kur të njëjtët gjuhën angleze e mundohen ta flasin dhe ta shkruajnë pa gabime ose me fare pak gabime.,, Kjo kategori e njerëzve, mendon Arbni tradicionalisht kanë vuajtur nga sëmurja e egzoglosisë. Për ta gjuha shqipe nuk ka qenë asnjëherë e mjaftueshme për t’i shprehur mendimet apo mesazhet e tyre „të thella”. Në kohën e Jugosllavisë, ata shpeshherë përdornin gjuhën serbe për t’i shprehur opinionet e tyre, ndërkaq sot shërbehen me anglishten”⁷⁴

Çështjen e identitetit ai trajton edhe në kontekst historik, përmes shembujve të shumë shteteve e identiteteve të Evropës e më gjerë, për të ardhur deri te kohët e sotme. Në tekstin analitik „Sfida e identitetit”, të botuar edhe në librin e parë të kompletit të veprave, që më vonë u bë objekt polemikash në qarqe e nivele të ndryshme, ai zbërthen shumë fenomene për sa i përket identiteteve, me theks të veçantë për ate shqiptar. Ai këtë problematikë e spjegon duke pasur parasysh dy qasje konceptuale, ate franko- anglez, që kombin e identifikon me shtetin dhe ate gjerman, italian, etj., që kombin e identifikon me prejardhjen etnike. Sipas tij, popujt që shtetin e kanë formuar shumë më herët, me të drejtë kombin e identifikonin me shtetin. Këtë variantë të kombit politik e praktikonin francezët apo edhe anglezët, ndërsa popujt si gjermanët apo italianët që nuk mundën ta bëjnë shtetin e tyre të vetëm me kohë, por ishin të ndarë e të përçarë e ruajtën konceptin e kombit etnik kulturor. Duke i analizuar këto fenomene në kontekst historik, gjeografik dhe politik të kombeve, ai më tepër ndalet te identiteti shqiptar me theks te shqiptarët që mbetën jashtë shtetit amë, të cilët me të drejtë, nuk pranuan kurrë të identifikohen me emrin e shteteve ku jetonin. Shqiptarët e Maqedonisë asnjëherë nuk pranuan të emërtohen si maqedonas, ashtu si edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës, ato të Malit të Zi, apo edhe tyë gjithë shqiptarët e hapësirës jugosllave, që nuk e duronin të identifikohen si jugosllavë. Ky refuzim, sipas Xhaferit ishte plotësisht i drejtë. Nëse Maqedonia dëshironte që të gjithë qytetarët e saj të identifikohen me emrin e hapësirës së Maqedonisë, atëherë, duhej që ky shtet të zgjidhte

⁷⁴ Arbën Xhaferi, Shtetformimi vs kombformimi, shkruar më 30. 05.2008, botuar edhe Arben Xhaferi Vepra 01 Kombi, Identiteti, Shteti, Prishtinë 20016 f. 81

ndonjë emër tjetër me konotacion gjeografik e jo etnik, si Kosova, Zvicra Belgjika etj., ndërsa sllavomaqedonasit të zgjedhin ndonjë emërtim të ri, mendon ai. Variantin e parë, atë të kombit politik si francez, amerikan anglez, etj., ai e sheh si fenomen që çon drejt asimilimit, ndërsa varianti i dytë, ai i kombit etnik, ka diferencimi, prandaj varianti i dytë është më i përshtatshëm për shqiptarët, përkundër dëshirës së popullit shumicë, në ato shtete që shqiptarët i konsiderojnë si pakicë, pavarësisht numrit të tyre. Të vetëdëshëm për këtë refuzim, shtetet ku jetojnë shqiptarët të ndarë nga trangu dhe njëri tjetri, preferojnë që krahas emërtimit të shtetit ku jetojnë ato pakica, ta ruajnë prejardhjen etnike. Ky variant është gjithashtu i papranuesëm për shqiptarët mendon Arbni, sepse në atë rast do kishim sërish fragmentarizim të identitetit kombëtar, si: shqiptarë-shqiptarë, shqiptarë- kosovarë, shqiptarë – maqedonas, shqiptarë serbë, shqiptarë- malazias etj.⁷⁵ . Për gjuhën standarde, respektimin e saj dhe përdorimin me përkushtim, ai ka fol e shkruar shpesh. Vërejtjes se kjo gjuhë është rezultat i imponimit politik të një sistemi totalitar, ai i jep shpjegime të qëndrueshme, kur thot se çdo popull modern në botë për ta rritur kohezionin e brendshëm dhe për ta lehtësuar komunikimin e ndërsjellë e standardizon gjuhën, në përputhje me interesin kombëtar, edhe përmes vendimmarrjes politike. Këtë tezë ai e mbështet në shumë shembuj të kombeve të mëdhenj modern, që me kohë i standardizuan gjuhët e tyre, si: anglishten, frengjishten, italishten spanjishten, greqishten, hebraishten etj, sepse në këtë mënyrë ata e forcojnë identitetin e tyre kombëtar. Nga të gjitha këta kombe, gjuhët e të cilave i përmendëm dhe shumë të tjerë, Arbni mendon se përjashim bëjnë vetëm sllavët, të cilët sipas tij, ata në emër të ekspansionizmit e kanë zbatuar disperzionin gjuhësor, me qëllim të formimit të kombeve vetëm në baza gjuhësore, gjë që kjo mënyrë e kombformimit ka sjall mosmarrëveshje, madje edhe armiqësi e ftohje marrëdhëniesh ndërfqinjësore. Për këto fenomene ai i merr si shembull raportet ftohta mes bullgarëve dhe maqedonasve.

Tendencat e ripërkufizimit të identitetit kombëtar, sipas Xhaferit zhvillohen në mënyrë tinëzare, ngaqë, vazhdon ai, nuk kundërvihen projekte të organizuara kombëtare, prandaj këmbëngulja e tij për ruajtjen e identitetit është i mundshëm, edhe pse sipas rrëfimeve personale të njerëzve që realisht janë me identitete të përziera, e që teorinë mbi identitetin e

⁷⁵ Arben Xhaferi Vepra, Kombi, Identiteti, Shtetit 01, Viti 20016 f. 266-267

parcializojnë dhe e minimizojnë me shembuj individual, që assesi nuk mund ta dëmtojnë përkufizimin e identitetit, sadoqë nuk ka standard të palëkundshëm. Ashtu si zakonisht, mendimtari ynë, kur jep shpjegime për këto fenomene të ndjeshme, mbështetje kërkon edhe te shumë autorë e mendimtarë tjerë, për të ardhur më lehtë deri te një përkufizim fleksibil, por edhe të qëndrueshëm. Në kushte të globalizimit, levizjeve të popujve dhe përdorimit të shumë gjuhëve, si nevojë e ekzistencës, mendon ai, jo vetëm popujt e vegjël por edhe ata të mëdhenjtë brengosën përditë e më shumë për fatin e identitetit të tyre. Nga radhët e mendimtarëve botërorë për këto çështje, Xhaferi e përmend edhe amerikanin S. Hantington me veprën e tij „Kush jemi ne”, i cili e shfaq brengën e rrezikimit të identitetit amerikan nga migrimet e pakontrolluara. Arbni edhe për këto realitete, e ka shpjegimin e vet kur thotë se „nacioni identitet kombëtar ka një domethënie (semantike) të paqëndrueshme ngaqë ndryshon edhe nga interesat jashtkombëtar, siç janë ato politikë, religjiozë, ekonomikë etj., prandaj mendon mëtutje ai, shfaqen polarizime të skajshme sepse disa e relativizojnë çështjen e identitetit, ndërsa disa të tjerë çështjen identitare kombëtare, me konstatimin se nuk mund të gjindet një tipar përcaktues, sepse në qenien e njeriut veprojnë një varg identitetesh, ai etnik, gjuhësor, gjeografik, qytetëruar, fetar politik, kulturor, ndërsa disa të tjerë çështjen e identitetit e absolutizojnë. Ekzistojnë, thot mëtutje ai edhe t’atillë që duan t’ikin nga identiteti i vet. Për këtë dilemë të identitetit për veten, Ai e merr shembull autorin e librit „Identitetet vrastare” të Amin Maalouf-it, kur ai në këtë libër e përmend faktin se ka lindur në Jemen, dhe se gjuhë amtare e ka arabishten, ndërsa fenë e krishtere, me nënshtetësi libaneze dhe më në fund përfundon si francez i natyralizuar. Pas këtyre të dhënave ai vetes ia shtron pyetjen, se kush është ai?. Për këtë rast, kur ai mendon se nuk ka përgjigje, arbni e gjen shumë lehtë atë kur konstaton se nivelet personale e subjektive nuk mund të merren si bazë e një përkufizimi për identitetin.

Nga ata që e absolutizojnë çështjen identitare, madje duke e falsifikuar atë, Arbën Xhaferi i fut edhe ideologët e nacionalizmit serb, pa i përjashtuar edhe maqedonasit. Të parët, sipas tij, Kosovën e trajtojnë si territor t’amshuar serb, ndërsa të dytët, çdo ngjarje që ka ndodhur historikisht në këto hapësira e konsiderojnë vetëm si të veten, duke i përjashtuar të tjerët, sidomos shqiptarët, si popullatë e dytë më e madhe në këtë shtet, të themeluar në vitin 1991. Për këto moskuptime, që e relativizojnë përcaktimin e identitetit, analisti Xhaferi mendon se

burimin e ka në mosnjohjen sa duhet të zbërthimit të nocioneve: etni, popull, , komb, dhe nacion. Ja si i zbërthen ai këto fjalë, që gjatë proceseve historike kanë ndryshuar: Do të doja që fjalën shqipe „komb” ta barazvlerësojmë me fjalën latine „nation”(nasce), me kuptimin „i lindur”, që në gjuhën shqipe e ka kuptimin e prejardhjes „prej një barku”, „prej një oxhaku”. Fjalën „etni”, me prejardhje greke, fillimisht sinonim i fjalës latine „nation” ta kuptojmë si përkufizim i përkatësisë gjenetike të anëtarëve të një bashkësie shoqërore që kanë lidhje gjaku me njëri tjetrin, e që zhvillojnë marrëdhënie të ndërsjella pa pengesa të natyrave ksenofobie që rëndom shfaqen në shtetet me popullsi , heterogjene. Fjala „popull” (latinisht popullus), përkufizon unitetin në nivel më të lartë të fiseve të ndryshme që jetojnë në rrethana të ndryshme politike dhe administrative, ndërkaq me fjalën „komb”, nënkuptohet populli që ka arritur të krijojë shtetin kombëtar (nacional), të pranuar ndërkombëtarisht.⁷⁶

Identitetin etnik, Xhaferi e konsideron si rezultat të nacionalizmit, që rrënjët i ka që në periudhën e Renesansë, atëherë kur qytetarët e Evropës ishin zhgënjyer nga të pavërtetat e librave të shenjtë, që nuk ishin në përputhje me realitetin shkencor. Nga ajo kohë, pohon ai „nacionalizmi luante rolin e bashkuesit. Sipas tij, ky nacionalizëm i kishte edhe të metat e veta, sepse në disa situata e ngushton vlerën e parimeve morale. Ky fenomen vërehet qartë, mendon Arbni te nacionalizmi serb, përmes të cilit, mendon Arbni, Millosheviqi në Fushë Kosovë e tha fjalinë famëkeqe „Askush nuk guxon ta rrahë popullin tim”. Arbni flet edhe për fenë që u bë vegël e nacionalizmit. Vënien e fesë në shërbim të nacionalizmit, mendon ai, nuk e shihnin me sy të mirë edhe vet disa faktorë kishtarë. Këtë përdorim të religjionit për qëllime politike ekspansioniste e shfrytëzoi Millosheviqi deri në atë masë, sa që, i frymëzoi masat shoveniste të bërtisnin edhe „Zoti është sërb”, „Zoti flet sërbiisht.”

Për nacionalizmin tipit frances, Arbni mendon se ai e nxori në sipërfaqe tiparin e identitetit politik nacional, sipas të cilit „Të gjithë qytetarët që janë shtetas të Francës janë të barabartë”, që i përgjigjej edhe slloganit: „liri, barazi, vëllazëri”, që nuk ngjau asnjëherë në Serbi edhe në shtete tjera sllave, siç është edhe Maqedonia, edhe pse në Jugosllavinë e Titos, kryefjala e deklarimeve politike ishte togfjalëshi „Vëllazërim bashkimi”. Për sa i përket identiteti kombëtar,

⁷⁶ Shteti dhe Identiteti, shkruar në Tetovë më 30.10.2008, Arben Xhaferi Vepra 01, Kombi, Identiteti, Shteti, Prishtinë 20016, f. 286

nuk ekziston ndonjë model unik për të gjitha kombet, shprehet ai, sepse, diku faktori kryesor është gjaku, diku, gjuha , diku besimi, diku politika e diku gjeografia, varësisht nga shumë rrethana e faktorë, provinienca të ndryshme. Ai kur merret me zbërthimin e këtyre çështjeve, gjithmonë kthehet te mentaliteti politik sllavë, të cilët pasi i krijuan kombet, krijuan shtete, por meqë këto kombe i krijuan pa tipare të vërteta, e shfrytëzuan religjionin, si faktorë të krijimit të identitetit kombëtarë. Meqë ne shqiptarët, e vazhdon ai mendimin, jetuam afër një shekull me ta , u shfaqën tendenca që edhe shqiptarët ta kenë religjionin bazë për formimin e identitetit kombëtar. Mirëpo kjo mënyrë e formimit të identitetit tonë kombëtarë, do ishte vetshkatërruese, sepse sipas asaj logjike, ne do kishim identitete, aq sa kemi fe, prandaj, thekson ai, se pikërisht rilindësit ishin ata që me kohë e vërejtën këtë rrezik ,prandaj zgjodhën rrugën e nacionalizmit antiklerikal, që e legjitimoi fuqishëm Pashko Vasa me sloganan „Feja e shqiptarit është shqiptaria”, që shërbeu si bazë e fortë për unitet kombëtar dhe model unik i harmonisë, vlerë kryesore kombëtare.

Arben Xhaferi, megjithë këto faktorë që e përcaktojnë identitetin dhe mospajtimet, e ka formulën që përcakton identitetin. Ai e konsideron si fakt mendimin e Amin Maaloufit se njeriu brenda vete ka shumë identitete, por sipas tij, fati i popujve varet nga përcaktimi se cili faktor do bëhet determinues dhe do ketë përparësi. Ai konstaton gjithashtu se qytetërimi evropian për përcaktimin e identitetit i jep përparësi faktorit etnik. Për shqiptarët edhe sot e kësaj dite, mbetet formula e paluhatshme e Pashko Vasos dhe rilindësve tjerë, me gjithë përpjekjet që disa forca më tepër përparësi i japin fesë, doktrinë kjo që u pa si e dëmshme që në Kohën e Rilindjes. Për çështjen identitare u dhanë shumë mendime, thotë Arbni, një nga të cilat e përmend formulën „3Gj”, të Arbëreshit Françesko Altimarit, i cili duke dashur ta thjeshtësojë përkufizimin mbi identitetin, u bazua në tre faktorët kryesorë, që fillojnë me të njëjtën shkronjë „Gj”, e që janë: gjaku, gjuha e gjeografia. Arbni pajtohet me formulën përkufizuese për identitetin kombëtarë të shqiptarëve, bazuar në 3 „Gj”-në e albanologut arbëresh, por duke e plotësuar atë edhe me historinë e përbashkët, kontinuitetin e traditës dhe identifikimin me atë traditë. Duke u nisur nga këto vlera të pakontestueshme të shqiptarëve, pa të cilat sipas tij, nuk do ishte i kompletuar identiteti kombëtar, ai thekson se kohëve të fundit, dalin në sipërfaqe teza skandaloze, madje nga disa skribomanë shqiptarë, që e mohojnë realitetin

e etnogjenezës së kombit që i takojnë. Ai kategorikisht i hudh poshtë këto të pavërteta, me argumentet, tani më të njohura, që janë:

- Shqiptarët janë poull me prejardhje të verifikueshme indo-evropjane;
- Gjuha shqipe është gjuhë indo-evropiane, që i takon nëngrupit satem, por edhe asaj centum. Po ashtu është njëra nga gjashtë gjuhët bazike evropiane;
- Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve. Këtë e pranojnë edhe armiqtë e shqiptarëve. Ideologu serb, që ka shkruar elaborate për shfarosjen e shqiptarëve, historiani Vasa Çubrilloviq, megjithatë në vitin 1974 pohon: „...hulumtimet shkencore gjithnjë e më shumë e verifikojnë faktin se në zonat e Shqipërisë së sotme ka mbetur e pandryshuar një botë ilire “. Etnologu serb, Jovan Cvijiq zbulon faktin se pas vërshimit të sllavëve në Ballkan në shekullin VI-VII Arbanasët janë tërhequr në male dhe bregdetin Arbanas, veçmas në jug të Shkodrës ...dhe në këtë Arbani të ngushtuar etnografike u vendosën serbët ardhacakë. Etnologu tjetër serb Jovan Erdeljanoviç thotë se Arbanasit duhet të jenë popullatë shumë e vjetër në hapësirat e tyre, të cilët kanë kaluar një periudhë të gjatë të zhvillimit etnik...”
- Shqiptarët e pranuan krishterimin nga vetë apostujt dhe janë nga popujt e parë, që e pranuan këtë besim monoteist. Reilogët iliro-arbërorë kanë luajtur rol të rëndësishëm në pajtimin e paganizmit me krishterimin, e më vonë edhe kontributin në zbutjen e fërkimeve ndërmjet Islamit dhe Krishterimit. Bizantologu Dimitri Obolenski thotë se shqiptarët u tërhoqën në male nga dyndjet sllave. Vërshimi i sllavëve në shekujt VI-VII e shfatosi kulturën romake dhe krishtere në tërë territorin e Ballkanit.
- Shqiptarët janë evropianë, popullatë autoktone që nga kohët e lashta. Së këndejmi nuk mund të anashkalohet fakti se kultura shqiptare në vija të trasha buron nga qytetërimi prëndimor.
- Mbështetur në artefaktet e ndryshme, gjurmimet arkeologjike, gjuhësore, të dhënat historike, trashëgiminë gojore, mënyrën e jetesës, kostumet, kodeksin moral, organizimin shoqëror përkundër të gjitha dyshimeve metodike apo shpërfillëse, megjithatë ilirët, arbërit, shqiptarët, qoftë si paganë, të krishterë apo muslimanë kanë pasur dhe kanë arritur t’i ruajnë veçoritë, tiparet e tyre dalluese nga të tjerët

- Vazhdimësia, kultivimi i vlerave të traditës, pastrimi i saj nga huazimet e imponuara, banale janë veprime, jo vetëm legjitime, qytetëruese, por edhe të domosdoshme për ta ruajtur identitetin një popull modern...
- Toleranca fetare është faktor përcaktues i identitetit kombëtar të shqiptarëve. Pa te do shfaqen probleme të papranueshme. Në këtë mes në vend të besimit duhet të shquhet toleranca, ashtu si ka qenë kryesisht në të kaluarën. Ideologët e hegjemonizmit serb e merrnin si shembull modelin shqiptar të tolerancës fetare për t'i sërbizuar kroatët katolikë dhe boshnjakët muslimanë, por dështuan ngaqë realitetet janë të pakrahasueshme. Shqiptarët tolerancën e kanë si pjesë të qenies së tyre kombëtare, ndërkaq serbët si pjesë të ideologjisë ekspansioniste.⁷⁷

⁷⁷ Arben Xhaferi, Shteti dhe identiteti, shkruar më 30.10. 2008, Gazeta,, Koha", Arben Xhaferi Vepra 01, Kombi, Identiteti, Shteti, Prishtinë 20016, f. 291-292

KAPITULLI

IV**ROLI I ARBËN XHAFERIT PËRTEJ
KUFINJËVE TË MAQEDONISË**

-
- 1.Roli i Arbën Xhaferit në çështjen e Kosovës
 - 2.Pavarësia e Kosovës dhe impakti pozitiv për stabilizimin e Maqedonisë
 - 3.Arbën Xhaferi për raportet problemet dhe konsensualitetin e Maqedonisë, me Greqinë dhe Bullgarinë për tejkalimin e kontesteve historike
 - 4.Skica për komunitetin shqiptar sipas Arben Xhaferit

1.Roli i Arbën Xhaferit në çështjen e Kosovës

Mendimi politik i Arbën Xhaferit as që ka qenë i shkëputur ndonjëherë nga Kosova dhe nga çështja shqiptare në përgjithësi. Këtu edhe qëndron specifika e tij si politikan, mendimtar e filozof. Ai me kohë si kishte parapëlqyer zgjidhjen e çështjes shqiptare si tërësi, e assesi si të parcializuar. Teoritë e tij politike bazohen në njohjen e çështjes globale shqiptare, sepse bëhet fjalë për një komb me identitet të palëkundshëm historik, me të gjitha vetitë që e përbëjnë atë. Me gjithë historinë fatkeqe gjatë sundimeve të ndryshme, madje të coptimit të tyre, indi shqiptar mbeti i paprekshëm dhe një, shprehet shpesh ai. Të flasish për shqiptarët, të zbërthesh fenomene dhe të japish mendime e udhëzime për zgjidhjen e problemit kombëtar, është e pamundshme ta anashkalosh Kosovën, madje as edhe serbinë ekspansioniste që edhe sot e kësaj dite nuk don të heq dorë nga dhe assesi të pajtohet me realitetin e ri se e ka humbur ate përgjithmonë. Sipas Arbën Xhaferit, Sërbia, e vetëdëshme për peshën etnike të shumicës së madhe të shqiptarëve, në raport me sërëbët, e shpiku tezën religioze për pretendimet e tyre mbi Kosovën. Fushatës së këtyllë për gjoja ruajtjen e sërëbizmit nga dhuna shqiptare, edhe pse e pabazuar në asnjë argument, i besonin bashkëmendimtarët e saj, mendon Xhaferi dhe kështu kjo tezë fallco mbijeton deri në ditët e sotme. Kjo fushatë antishqiptare e shtetit sërëb u përkrah fuqishëm edhe nga klasa akademike sërëbe , për të marrë përmasë gjenocidiale përmes shpërnguljeve masive të shqiptarëve nga Kosova dhe nga trojet e tyre jashtë Kosovës për në Turqi. Përmes një propagande të këtyllë se po ua prishkan „djepin”shqiptarët, sërëbët këtë falsifikim e shtrin në qindra vepra historike, letrare, e vepra tjera artistike, mendon ai,, për të bindur sa më shumë aleatë, se shqiptarët qenkan ata që bëkan gjenocid ndaj popullatës „mitike” serbe, ashtu si edhe maqedonasit që vetën e quajtën si hyjnorë ose të shënjtë. Arben Xhaferi kur flet për politikën gllabëruese serbe, armikun e përbetuar të shqiptarëve, shkon edhe më thellë në histori, sepse kjo edhe është metoda e tij e punës në këtë drejtim, e jo vetëm politika ditore dhe pa rreze veprimi në thellësitë e kohës dhe në shtrirje gjeografike, duke tentuar t’i arsyetojë më së miri tezat dhe teoritë e tij mbi çështjet globale shqiptare. Ky shtet, vazhdon më tutje ai, që formësohet në pashallëkun e Beogradit, përveç mitit, nuk ka shënuar asnjë ngjarje, nuk kanë bërë asnjë përpjekje për rezistencë kundër Perandorisë osmane, përkundër shqiptarëve që në këtë tokë i

kshin bërë të gjitha rezisencat, lëvizjet e kryengritjet për çlirim dhe pavarësi, që kulminacionin e arritën me Lidhjen e Prizrenit, ngarje historike kjo, kur shqiptarët, ashtu të bashkuar nga të gjitha krahinat u përcaktuan për një shtet shqiptar, si zgjidhje përfundimtare të çështjes shqiptare. Sërbia duke e njohur qëndresën e shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për ruajtjen e përkatësisë etnike, që nga viti 1918, është angazhuar që të shqiptarët të mbjell konceptin politik të identitetit kombëtar, duke e kundërshtuar atë etnik të tyre. Kjo tezë e Arbnit, i cili me kohë e kishte kuptuar qëndrimin e Serbisë dhe angazhimin që shqiptarët t'i zhveshin nga etnia, dhe t'ikonsiderojë si njerëz me identitet politik e jo etnik, është larpamëse dhe paralajmëruese se politika antishqiptare serbe ishte agatgjate dhe më programe të ndryshme në nivel shteti, ku gjithmonë ishin të pranishm, madje hartues të programeve për dëbim nga tokat e veta për Turqi.

Qëndresa shqiptare për të mbijetuar me gjithë atë rrebesh goditjesh, madje deri të demonstratat e nohura të njëpasnjëshme kundër regjimit komunist jugosllav, e më vonë, i lëkundën edhe themelet e Jugosllavisë, konstaton Arbën Xhaferi. Prashikimet e tij, për një të ardhme të shqiptarëve, të Kosovës dhe jo vetëm, dilnin të sakta sepse bazoheshin në intuitën politike të këtij njohësi të këtyre rrethanave. Ai edhe kur flet për çështje që fillimisht duket se nuk ka të bëjnë me shqiptarët, pikërisht atëherë vjen në përfundime se si duhet të zhvillohet politika shqiptare dhe kah t'ia mbajë. Mendimet e tij, që asnjëherë nuk janë të ngurta ultimative, e të shprehura përmes ndonjë fjali të ashpër, për elitën politike serbe dhe maqedonasit, megjithatë konsideroheshin si nacionamliste dhe të rrezikshme për ta. Vlen të përmendet edhe kjo mençuri e tij politike, që rrezatonte urtësi pa e zbehur fare vendosmërinë tij që për të drejtat e bashkëkombasve të vet, kudo që jetojnë ato. Vetëm një mendimtar si ai, me tërë ashpërsinë e vet, që në pamje të parë nuk dukej si i tillë, i vlerësonte gjërat, me butësi dhe mençuri. Qasja e tij për shkaqet e shpërbërjes së Jugosllavisë së Titos, që u reduktua në atë të Millosheviqit, kur kishte filluar procesi i rrënimit të kësaj „perandorie”, edhe pse në pamje të parë është e ngjashme me shumë analistë tjerë, në esencë dallon shumë, sepse ky nuk i shikonte gjërat bardh e zi, siç bënin shumë të tjerë që krahas aktivitetit prej analistësh, kishin edhe pretendime lideriste. Edhe Arbni u fut në politikë, por pa i zbehur aspak vlerat e një mendimtari me thellësi filozofike. Ai edhe kur flet për Kosovën dhe krizën politike që shpejt u shndërrua në luftë shkatërrimtare që i kaploi tërë

hapësirat e ish Jugosllavisë, përdor të njëjtin fjalor dhe retorikë, që në esencë e kanë thellësinë e mendimit, e jo formën dhe reklamën politike.

Politikën e rezistencës paqësore e konsideron si mençuri gjeniale të shqiptarëve të Kosovës, edhe pse ai në shumë raste në paraqitjet e tij publike, sikur e mbante anën e partive të dala nga ish UÇK-ja. Ai këto lëvizje, qoftë ato të rezistencës paqësore, të udhëhequr nga Ibrahim Rugova, qoftë ato që ishin për aktivitete ushtarake, i vlerësonte në këndvështrimin e kohës, kur edhe vepronte si analistë, mendimtarë, filozof, apo edhe si politikan praktik, madje edhe nga pozitrat e një lideri të një partie politike shqiptare në Maqedoni. Edhe në kohën kur partia e tij PDSH, bashkëqeverisi me VMRO-DPMNE-në, në Republikën e Maqedonisë, ai vazhdoi të merret edhe me politikë globale shqiptare, veçmas me Kosovën dhe politikën e udhëhequr nga lidershipi i saj. Deklaratave të shumta të disa personaliteteve me peshë ndërkombëtare se zjarri i luftës në Kosovë, e prish stabilitetin në rajon, ai u përgjigjet po me maturi, por që në thelb të bazuara në realitetin që ndonjëherë edhe bien ndesh me këto deklarata, mbase ndërkombëtarët, edhe pse faktor shumë të rëndësisishën, për ndërprerjen e zjarrit, sipas tij, nuk i njohin mirë rrethanat në mënyrë të detajuar.

Këtyre opinioneve brengosëse që vijnë nga jashtë për ndonjë rrezik të mundshëm për paqen në Maqedoni dhe vende tjera ku jetojnë shqiptarët, ai përmes gazetës liberale të Munihut „Zydojçe Cajtung“ u përgjigjedt me mesazhe të qarta se „ shqiptarër nga Tetova, Shkupi, Gostivari dhe nga hapësira e tyre tjetër etnike në Maqedoni nuk do rrinë duarkryq nëse Beogradi edhe më tutje do të shkallëzojë eskalimet luftarake ndaj popullatës shqiptare të Kosovës“⁷⁸

Lidhur me këto tone pak si qortuese nëse shqiptarët jashtë Kosovës do solidarizoheshin me vëllezërit e tyre kosovarë, ai e citon edhe gazetën tjetër , „Frankfurter allgemeine“, që përmes reporterit të saj ballkanik Matias Ryb, të ketë thënë se „i ashtuquajturi „kosovizim“i Maqedonisë perëndimore është në zhvillim e sipër dhe se ai do të përcaktohet nga kahet e zhvillimeve në Kosovë, por edhe nga sjellja e Qeverisë maqedone.“ Matias Ryb, në shkrimin e vet flet edhe për raportet e shqiptarëve të Maqedonisë me ato të Kosovës, për, për lidhjet e tyre kulturore, ekonomike e familjare. Shqiptarët e Maqedonisë, sidomos intelegjencia

⁷⁸ Arben Xhaferi, Perëndimi dhe kriza e Kosovës, Rilindja, Zvicër, 8.05.1998

shqiptare, shprehet ai, frymojnë kosovarçe, për nga shkollimi e mentaliteti, prandaj është shumë e kuptueshme brenga e tyre për fatin e vëllezërve të vet në Kosovë. (Po aty) Arbën Xhaferi, lideri i PDSH-së, duke u pajtuar plotësisht me mendimin e këtij gazetari, me këtë rast shtoi se për shqiptarët e maqedonisë nuk është krejt njësoj se si si do zhvillohen rrjedhat e luftës atje, sepse bëhët fjalë për një popull të një gjaku. Kjo krizë mund edhe të zgjerohet në Maqedoni, prandaj sipas tij, faktori ndërkombëtarë me kohë duhet t'ia bëjë me dije Beogradit se nuk do e tolerojnë një përshkallëzim të përmasës katastrofale, ndërsa nga Shkupi kërkonte mirëkuptim ndaj kërkesave të ligjshme dhe të drejta të shqiptarëve që do i barazonin me shumicën maqedonase, që nënkupon edhe pozitën shtetformuese të tyre, sepse vetëm kështu mund të ruhet paqja në këtë shtet. Siç shihet, qëndrimi i Arbnit është fare i qartë për çështjen e Kosovës dhe lidhjet e tyre me ato të Maqedonisë. Ai edhe kur i qaset çështjes së Kosovës, nuk largohet për asnjë moment nga bashkëkombasit e vet në Maqedoni, dhe nga fati i vet shtetit të Maqedonisë, që sipas tij, varet nga qëndrimi i këtij shteti ndaj shqiptarëve, dhe barazisë së plotë të të gjithë qytetarëve të saj, sepse vetëm me zhvillime demokratike dhe harmoni të brendshme, mund të ketë ardhmëri të sigurtë.

Demonstratat studentore të vitit 1981, që njëherit , si duket, ishin edhe dridhjet e para seroze që paralajmëruan rrënimin e Jugosllavisë, ai i vlerëson, po në mënyrën e veçantë, me të njëjtën metodologji, duke pasur parasysh gjithmonë kontekstin historik dhe rrethanat e krijuara në rrjedhën e kohës. Ai është mendimtar, para së gjithash dhe si i tillë ngjarjet që kishin të bëjnë me shqiptarët, i paraqet me objektivitet, pa u ikur edhe deklaratave që nuk kishin të bëjnë vetëm me shqiptarët, por që në mënyrë rë tërthortë, ishin të ndërthurur me çështjen shqiptare. Të flasish vetëm për shqiptarët dhe Kosovën, pa i elaboruar edhe planet , qoftë të hapura, qoftë tinëzare të Serbisë, ishte e pakuptimtë, sepse, ashtu siç u detyruan shqiptarët, të jetojnë „ të vëllazëruar e të bashkuar”, me shumë kombe tjera, ato edhe „shkurorëzimin” duhet ta bënin më të tjerët, më konkretisht me sërëbët dhe Serbinë. Ai i kishte parasysh të gjitha këto rrethana, prandaj nuk habit fakti kur fliste për shqiptarët dhe Kosovën, përmes problemit global, të shpërbërjes së asaj Jugosllavie. Në tërë këtë lëmsh problemesh, veprimin apo edhe mosveprimin e shqiptarëve, në momente kur nuk ishin pjekur kushtet, i konsideron si mençuri, edhe pse ato ishin të parët që iu kundërvunë haptas politikës jugosllave duke kërkuar liri e barazi

fillimisht, e më vonë edhe pavarësi. Këtë mençuri të shqiptarëve, përkundër shumë faktorëve që Kosovën e donin në luftë, që në fillimin e krizës jugosllave, madje kur APJ ishte shumë e fortë, ai e bazonte në epërsinë ushtarake të kundërshtarëve. Për luftën që e nxiti Serbia, në kohën kur veten e konsideronte ende Jugosllavi dhe ushtrinë e saj si të veten, Arbni kështu e përshkruan kompromitimin e saj: „Lufta filloi dhe bashkë me të edhe kompromentimi i politikës dhe luftës serbe. Nisi në Slloveni, u ngatërrua në Kroaci, u kompromentua dhe u molis në Bosnjë-Hercegovinë dhe më në fund kur bota e kishte krijuar bindjen se kush është fajtor, nisi në Kosovë. Ky taktizim, në kuadër të strategjisë së gjatë të shqiptarëve për mbijetesë në kushte minimale, ishte veprim poashtu gjenial.”⁷⁹

Kur flet për këtë luftë, ai vazhdon ta argumentojë atë në tërë kompleksitetin e vet, me theks në disponimin ushtarako-policor serb, që mendonin se Kosova dhe shqiptarët do jenë kafshatë e lehtë. Me gjithë përdorimin e arsenalit ushtarak dhe shkeljen e të gjitha normave ndërkombëtare të luftës, duke nxitur shpërngulje masive të popullatës shqiptare, thot Xhaferi, ishin komprometuese, që krijoi opinion të skajshëm negativ për Serbët. Këto dështime serbe sipas tij, u shfrytëzuan nga faktori shqiptar dhe ndërkombëtarë, për t’u mobilizuar që si e si ta ndërpresin hovin e një çmendurie shfarosëse ushtarake, që për qëllim kishte sprastrimin etnik të Kosovës. Për këtë qëndresë të popullit shqiptarë të Kosovës dhe luftën e pastër të UÇK- së së armatosur, bashkë me ndërhyrjen e NATO –s, Arben Xhaferi, në intervistën dhënë publcistit Enver Robelli shprehet: „Ndërtimi i motivit të ndërhyrjes së NATO-s nga ana e politikanëve, por edhe faktorit ushtarak shqiptar ishte poashtu gjenial. Shqiptarët bashkëpunuan kryekëput me faktorin demokratik përendimor, nuk hynin në dimesionin e akteve terroriste, përkundër shumë shpifjeve që hasen sot e gjithë ditën nëpër medime, bënë kompromise të duhura, ndonëse edhe të dhimbshme dhe e bindën opinionin botëror që të mos lejojnë gjenocidin në Evropë.”⁸⁰

Teza e Arbën Xhaferit se politika shqiptare, edhe pse e pakonsoliduar, e pastrukturuar, e paekipuar, i kapitalizoi dështimet serbe, bazohet në pajtimin ndërshqiptar, në momente kur sapo kishin filluar të duken çarjet politike dhe ushtarake, që gjithsesi do ishin në dobi të serbve

⁷⁹ Enver Robelli, Në Tetovë në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2012, f. 61

⁸⁰ Enver Robelli, Në Tetovë në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2012, f. 62

dhe politikës së tyre agresive. Ky pajtim mbarëkombëtar ishte i disa niveleve konstaton ai, duke nisur nga pajtimet e faktorëve politikë me hendekun më të madh në mes, komunist, Fadil Hoxhës dhe Hashim Thaçit, udhëheqësit të PDK-ës, të dalë nga lufta mes UÇK-ës dhe forcave serbe. Ky përafrim dhe pajtim i udhëheqësve të dy ideologjive kundërthënëse, edhe pse Fadil Hoxha në këtë periudhë kishte kohë që kishte pushuar së vepruari politikisht, është tepër i rëndësishëm për politikën mbarëshqiptare, duke pasur parasysh kontekstin kohor që tani më i takonte historisë, prandaj me këtë shtrëngim duarësh, sipas Xhaferit, udhëheqësi i UÇK-ës, Hashim Thaçi ia, njohu meritat e tij atdhetare, duke vlerësuar gjithashtu se ky pajtim, po ashtu e shpëtoi Kosovën nga ngatërresat e rrezikshme dhe hapi rrugën për at epilog të suksesshëm të kësaj epepeje.⁸¹

Me interes të madh për kombin në këtë fazë të kundërthënieve të shumta, si në planin ushtarak e më vonë edhe politik, për te ishte edhe pajtimi mes forcave politike të dala nga lufta, dhe atyre që deri te arritja e qëllimit e kishin zgjedhur rrugën e rezistancës paqësore. Nga kundërthëniet dhe mospajtimet, që fillimisht kishin këto forca politike, u arrit një kompromis i madh, kur dy palët u pajtuan të qeverisin së bashku në Qeverinë e Kosovës. Ky pajtim që i ndërpreu çarjet dhe armiqësitë e blloqeve politike dhe frakcionet luftarake, u forcua edhe më tepër në kohën e sulmeve të forcave të NATO-s kundër çaveve ushtarake policore të Serbisë, konstaton Xhaferi, duke shtuar se në Kosovë populli megjithatë nuk u nda në „partizanë dhe ballistë”, siç ndodhi në Luftën e dytë botërore. Bashkëpunimin e ngushtë të faktorit kosovar me ndërkombëtarët, ai e vlerëson si tepër të mençur dhe frytdhënës.

Ai si një lider i një partie shqiptare, që në periudhën e luftës së Kosovës bashkëqeveriste në Qeverinë e Maqedonisë, luajti rol konstruktiv dhe shumë produktiv në afirmimin e luftës së drejt të UÇK-s, duke e arsyetuar veprimin e tyre ushtarak, para faktorit ndërkombëtar, që ishte i pranishëm edhe në Maqedoni, falë qëndrimit korrekt të Qeverisë së Maqedonisë, e cila në vitin 1998 në seancën e parë votoi dhe lejoi instalimin e trupave të NATO-s në Maqedoni. Kur Arbni flet për logjistikën aq të fuqishme që Kosovës i jepej nga Maqedonia, i ka parasysh edhe rrethanat aktuale në Shqipërinë e vitit 1997, kur nga ngjarjet e kobshme, shteti

⁸¹ Po aty, faq 62

i u gjend buzë greminës dhe në Kosovën, që poashtu gjendej nën dhunën ushtarako-policore të Millosheviqit. Është fakt konstatimi e tij se „në këto kohëra të vështira, për Shqipërinë dhe Kosovën, vendi më i sigurtë për jetën dhe veprimin e shqiptarëve ishte Maqedonia. Në Maqedoni, kishte madje misione të dyfishta pra, jo vetëm ambasadat por edhe të dërguarir specialë të shteteve të ndryshme. Aty, vazhdon ai, ishte edhe UNPREDEP-i, një organizim i lejuar nga OKB, i përbërë kryesisht nga ushtarë skandinavezë.”⁸²

Duke vepruar në këto rrethana të volitshme për ta ndihmuar kauzën shqiptare në Kosovë, nga pozitat e të qenit në Qeveri, ai konstaton se pjesëmarrja e partisë së tij në këtë qeverisje e ndryshoi edhe qëndrimin e këtij shteti ndaj politikës agresive serbe, për t’i ndihmuar shqiptarët e Kosovës përmes përkrahjës së luftës së drejtë për liri e pavarësi. Kjo kthesë e mentalitetit politik të Maqedonisë ndaj Kosovës e cila para këtij koalicioni e përkrahte haptazi Millosheviqin dhe politikën e tij, gjithsesi ndodhi për shkak të politikës konstruktive së Arben Xhaferit, i cili theksonte se stabiliteti i Kosovës është edhe në interes të vetë Maqedonisë, por ai stabilitet mund të arrihet vetëm pa Serbinë në Kosovë. Këto janë fakte që kurdoherë do jenë pjesë e historisë më të re të Kosovës, që nuk mund të mohohen, as edhe nga disa „analistë” politikë, që mundohen ta kundërshtojnë veprimtarinë e përmasës së Arbnit, këtë vepër që s’ishin në gjendje as ta kuptonin.

Vlerësimimin e tij aq pozitiv për elitën politike shqiptare, në krahasim me të tjerët, e bazon në vet faktin se ato me veprimet në fushën politike dhe në ate ushtarake, arritën që ta senzibilizojnë Aleancën më të madhe ushtarake e politike në botë, NATO-n, t’i sulmojë agresorët serbë dhe ta ndërpresë pastrimin etnik, që edhe ishte synimi i tyre, që më pastaj të sjellë popullatë serbe. Me autoritetin që kishte para ndërkombëtarëve dhe respaktin e koalicionit qeverisës në Maqedoni, Arbni ishte edhe drejtues i një logjistike që atë luftë e ndihmonte në të gjitha aspektet. Ai madje luante edhe rolin e njëfarë ndërmjetësi mes autoriteteve ndërkombëtare dhe udhëheqësve të UÇK-s, përmes takimeve edhe në zona të luftës. Për një angazhim të këtillë kaq të ndjeshëm dhe me përgjegjësi, madje në një zonë lufte, padyshim duhej pasur besim të ndërsjell nga të dyja palët. Krahas aktiviteteve politike në Maqedoni, duke qenë

⁸² Rudina Xhunga, 12 porositë e Arben Xhaferit, Tiranë 2012, f.166

njëkohësisht i pranishëm edhe në Kosovë, ai zhvilloi edhe një aktivitet të dendur diplomatik me personalitete të rëndësishme të qendrave vendosëse të SHBA-ve dhe BE-së. Në periudhën kohore sa zgjati kriza në Kosovë dhe rajon, ai u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Lordin Xhorxh Robertson (George Robertson), me përgjegjësin për Politikën e Jashtme dhe Siguri të BE-së, Hvier Sollana (Javier Solana), me Sekretarin e Jashtëm amerikan, Kolin Pauell (Colin Poëell), me Komisionerin për Punë të Ja të BE-së, Kris Pten (Chris Patten), me Ministrin e Jashtëm gjerman, Joshka Fisher (Joschka Fischer), me Kancelarin gjerman, Gerhard Shrder (Gerhard Schroder) dhe me sghumë të tjerë. Arben Xhaferi i kishte këto kapacitete politike, diplomatike dhe njerëzore, dhe si i tillë e kreu me sukses misionin, sa human, aq edhe atdhetar. Ai këto aktivitete i zhvillonte njëkohësisht, edhe si lider partie, edhe si bashkëqeverisës në Qeverinë e një shteti fqinj, si Maqedonia, edhe si politikan, dhe mbi të gjitha si personalitet që i njihte rrethanat në skenën politike në hapësirat shqiptare, në rajon e më gjerë, dhe pasojat për popullatën civile që mund të sjellë një luftë, e cila për qëllim kishte gjenocidin mbi një komb të tërë. „Asnjë popull nuk mund të ketë ndërgjegje të pastër nëse nuk ballafaqohet me të vërtetat lidhur me krimet që janë bërë gjatë dhe pas luftës. Pa këtë përballje nuk mund të ndërtohet një shoqëri e lirë, e hapur dhe e moralshme,” konstaton ai.⁸³

Në kohën kur gjendja e shqiptarëve në Kosovë merrte përmasa katastrofale, partitë politike shqiptare, sidomos PDSH, e shtuan efikasitetin e vet, duke i senzibilizuar shqiptarët që të jenë të përgatitur për ndonjë egzod masiv të kosovarëve, si rezultat i dhunës së egër të forcave serbe, të cilat gjatë sulmeve nga ajri e shtuan agresivitetin në nivelin e një gjenocidi të paparë. „Eskalimin e konfliktit në Kosovë dhe kapërcimin sa më të shpejt të tragjedisë kosovare, PDSH-ja e udhëhequr nga Arbën Xhaferi i përjetonte si obligim moral, njerëzor e mbi të gjitha kombëtar. Vet fakti se kjo parti merrte pjesë në qeveri, nënkuptonte obligime dhe angazhime plotësuese”.⁸⁴

Edhe pse disponimi politik i autoriteteve të Qeverisë së Maqedonisë së atëhershme ishte në favor të zgjidhjes së krizës së Kosovës, falë partnerit shqiptar në qeverisje dhe Arbën Xhaferit, në vetë popullatën maqedonase, të nxitur edhe nga elementë nacionalistë maqedonas, e të frymëzuar nga Presidenti i shtetit, Kiro Gligorov, ekzistonte një disponim antishqiptar dhe

⁸³ Rudina Xhunga, 12 porositë e Arbën Xhaferit, Tiranë 2012, f.63

⁸⁴ Etem Aziri, Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni, Shkup 2004, f.224

antikosovar, me drojën se këta refugjatë shqiptarë do mbeten në Maqedoni, me ç'rast do ndryshonte dukshëm struktura demokrafike. PDSH dhe lideri i saj, me elegancë e tejkaloi edhe planin për koridorin e Gllorovit, duke e menaxhuar këtë krizë në mënyrë të shkëlqyeshme. Vetëm një largpamësi e një strategu politik, si Arbni me të gjitha strukturat partiake, dhe mobilizimin e gjithë shqiprëve, me kohë i mobilizoi ato, duke i senzibilizuar njëherit edhe gjithë shqiptarët që në rast egzodi masiv të shqiptarëve nga Kosova t'i hapnin zemrat dhe shtëpitë për t'i pritur vëllezërit e motrat e tyre të një gjuhe e të një gjaku. Një parashikim i tij për mbrojtjen e Kosovës dhe të shqiptarëve para agresorit të egër serb, dhe i partisë që e udhëhiqte, ishte edhe kërkesa përmes demonstratave të anëtarësisë partiake, simpatizantëve dhe gjithë qytetarëve shqiptarë që e përkrahën idenë që, NATO të vijë në Kosovë. Këtë kërkesë publike përmes demonstratave ai e bëri në kohën kur partia që e udhëhiqte ende nuk ishte në pushtet. Mikpritje shqiptare që iu bë refugjatëve kosovarë, do mbahet mend për solidaritetin vëllazëror të shqiptarëve të Maqedonisë në historinë e shtet ndërtimit të Kosovës, ashtu siç do mbetet i shënuar edhe emri i Arbnit dhe i gjithë elitës politike shqiptare. Ai si personalitet me autoritet të pakontestueshëm që ishte dhe me shumë respekt jo vetëm nga të huajt por edhe nga personalitete shqiptare të skenës politike të shtetit shqiptar dhe të udhëheqjes së UÇK-ës, organizoi disa takime në Maqedoni me interes për Kosovën, në rrugën drejt çlirimit nga okupatori serb, duke krijuar kushte sigurie edhe për lëvizje të autoriteteve Kosovare nga Shqipëria për në Kosovë.

Arbën Xhaferi flet edhe për analistët dhe plitikanët e Kosovës, disa nga të cilet, konstaton ai, dëshirojnë që gjërat t'i shohin „bardh e zi”, duke qenë kështu më të sigurtë duke mos u futur në detaje nga frika se mos gabojnë. Në intervistën e publicistes së njohur Rudina Xhunga, ai për këtë fenomen e merr shembull planin e Ahtisarit, që njëherit ishte edhe bazamenti i pavarësisë së Kosovës, por ende i paqartë sa duhet për opinionin e gjerë, kur shprehet: „Në përgjithësi politikanët e kanë bezdi që të shkojnë në analiza të përimtësuarra dhe kryesisht shkojnë në variantet bardhezi se më pak gabojnë ashtu. Domethënë e mbështesim planin e

Ahtisarit, jemi kundër atyre që nuk e mbështesin dhe në këtë mënyrë përfundon dilema ose evitohet kërkesa që të parashikohet e ardhmja”.⁸⁵

Ashtu si gjithmonë, ai i qetë, me plot ide, racional dhe i përgjrgjshëm për fjalën që e thot, u sugjeron një pjese të politikanëve të Kosovës, që gjithashtu të jenë realë dhe racionalë në politikëbërje, për shtet ndërtimin e Kosovës si shtet të pavarur, sepse në rrethana kur shqiptarët e fituan besimin nga Aleanca më e fuqishme politiko-ushtarake, NATO, është i domosdoshëm bashkëpunimi dhe respektimi i ndërsjellë. Akuzave të ndërsjella mes shqiptarëve se kush e do më shumë pavarësinë e Kosovës, e kush më pak, Arbni u përgjigjet këssoj: „Të kemi kujdes me nihilizmin, të kemi kujdes me kërkesa spektakolare për shkak se jeta është e pamëshirshme. Po të varej statusi përfundimtar i Kosovës prej nesh, me siguri se do të përfundonte ky proces menjëherë.⁸⁶ Për pavarësinë e Kosovës janë të gjithë shqiptarët, kudoqodshin ato, nuk ka shqiptarë, qofshin si individë, si të organizuar politikisht, apo në organizata të ndryshme civile, konstaton ai, që nuk e dëshirojnë këtë, por jetësimi sa më i shpejtë, që do realizonte ëndrat shekullore të shqiptarëve nuk varet nga kjo dëshirë. Të menduarit racionalisht të Arbnit për politika afatgjata por të sigurta, ishin mësim edhe për shumë politikanë e analistë të ndryshëm, që humbin kohë duke e kërkuar çlirimtarin e shqiptarëve të Kosovës dhe më meritorin për pavarësinë e këtij shteti; UÇK-në, apo NATO-n. Arbni me kohë ishte angazhuar për ardhjen e Frcave të Aleancës më të fuqishme në botë, por ndër të parët e ka përshëndetur edhe paraqitjen e krahut ushtarak atje, madje ishte politikani që ndër të parët u takua me krerët e formacioneve ushtarake të Kosovës. Mendoj se ky veprim praktik i tij, është përgjigjia më e saktë se meritat u takojnë dy palëve, por, sipas tij, pa gjakun e derdhur të tyre në betejat me kundërshtarin shumë më të fortë, si trashëgimtare e fuqisë ushtarake të ish Jugosllavisë , pa viktimizimin e popullatës civile, madje flijime edhe të tërë familjes, siç ishte edhe ajo e Jaharajve, ndoshta Forcat ushtarake të Aleancës Veri-Atlantike të udhëhequra nga SHBA-të do mendonin gjatë kohë për të marrë një vendim të këfillë.

⁸⁵ Rudina Xhunga, 12 porositë e Arbën Xhaferit, Tiranë 2012, f.167

⁸⁶ Po Aty

2.Pavarësia e Kosovës dhe impakti pozitiv për stabilizimin e Maqedonisë

Shqiptarët në Jugosllavinë e Titos, ishin të parët që e ngritën zërin kundër padrejtësisë që u bëhej vazhdimisht nga sistemi i shtetit komunist, me model vetqeverisjen mbi baza të „vëllazërim bashkimit”. Edhe pse këto padrejtësi që u bëheshin shqiptarëve, më të thksuara ishin në republikat jashtë Kopsovës si krahinë autonome e Jugosllavisë së atëhershme, por me pjesë të kontrollit edhe nga Serbia, shqiptarët kundër këtyre padrejtësive ishin të bashkuar dhe solidarë mes veti. Arbni në paraqitjet e veta publike çështjen shqiptare e shihte në aspekt global, prandaj ai fenomenet i zbërthen që nga gjeneza, më konkretisht që nga çarjet e para që paralajmëronin shpërbërjen e Jugosllavisë. Në këtë kontekst, edhe kur fliste për Kosovën dhe shqiptarët me përpjekjet e tyre për t’u bërë fillimisht të barabartë , e më vonë edhe si të pavarfur në shtetin e tyre, asnjëherë nuk i lente anash shqiptarët e Maqedonise , të Malit të Zi, të Preshevës, gjithmonë duke e përmendur edhe Shqipërinë dhe qëndrimin e konstruktiv të Qeverive të cilësdo forcë politike në Pushtet. Ai edhe kur fliste për çështjen e Kosovës dhe ate të Maqedonisë, me theks gjithsesi te shqiptarët, në thelb ishte edhe me dozë nacionalizmi pizitiv, me konstatimin se ato zhvillime kërkojnë edhe sakrificë. Përmes njohjes së thellë të rrethanave politike, ekonomike e kulturore për Kosovën deri sa vepronte si analist, publicist, e mendimtar atje, e kishte më lehtë të vepronte politikisht, edhe kur erdhi nga Kosova në Maqedoni, për të udhëhequr një parti shqiptare, e cila luajti rolin historik në dy konfliktet ushtarake, sidomos pasi erdhi në pushtet. Instalimin e partisë së tij në pushtet Arben Xhaferi e arsyeton kështu: Peticipimi ynë në Qeveri legjitimon një politikë të re në Maqedoni që jep shenja se do shkëputet nga kërthiza e vjetër jugosllave, nga infrastrukturat e saj, mbi të gjitha nga ai mentalitet politik që sjell konfrontime mbi baza etnike. Me ndërrimin e këtyre strukturave objektivisht pritet edhe ndryshimi i mentalitetit politik, e me këtë zgjidhen vetvetiu disa kërkesa të shqiptarëve.⁸⁷

Teza e tij se Kosova e pavarur, stabile dhe pa Serbinë do reflektohej pozitivisht edhe në Maqedoni, u tregua si realitet, me gjithë forcat antishqiptare të Qeverisë së mëparshme të

⁸⁷ Arben Xhaferi, Pvarësia e Kosovës e stabilizon Maqedoninë, „Bota sot” e datës 29. 12. 1998

Maqedonisë para koalicionit VMRO-DPMNE-PDSH, dhe sidomos politikës destruktive të kryetarit Gligorov, i cili deklarone haptazi se pavarësi i Kosovës do e destabilizojë Maqedoninë. Në këto relacione të politikbërjes, pasi Arben Xhaferi u bë pjesë e Qeverisë bashkë me partinë e Gjeorgjievskit, ndyshoi dukshëm qëndrimi i Maqedonisë, duke e pranuar si konstruktiv qëndrimin e tij se Kosova stabile dhe e pavarur, nuk do jetë në dëm të këtij shteti të brishtë, që mund të rrezikohet në çdo moment nga jolojaliteti i shqiptarëve, ashtu siç edhe ngjau më vonë, me paraqitjen e kryengritjes së armatosur të shqiptarëve, të cilën në masë të madhe Arbni e faktorizoi, duke e konsideruar si kërkesë të rinisë shqiptare, që u rebelua për t'u bërë plotësisht të barabartë me maqedonasit. Akuzave të ndryshme që në fillimet e këtij rebelimi vinin nga forca të brendshme politike, madje edhe nga vet Kryeministri, i cili për Arbnin u shpreh se i futi thikë pas shpine, dhe atyre nga jashtë, madje nga faktorë të rëndësishëm, siç ishte edhe Sekretari i NATO-s, Robertson, se kinse këta që krisin janë një grup terroristësh, ai iu përgjigj me mençuri të madhe dhe me argumente bindëse se ky organizim ushtarak është autokton, e jo e imponuar nga Kosova. Kjo politikë konstruktive e tij që kur e lypte nevoja shndërrohet në diplomaci, e bëri kthesën e madhe, duke i dhënë luftës kahen e duhur, që u trgua si e suksesshme në Mbledhjen e Prizrenit, të inicuar dhe të organizuar nga ekipi shumë i afertë i Arbnit, ku morën pjesë përfaqësuesi politik i UÇK-së, Ali Ahmeti, Kryetari i PPD-ës Imer Imeri dhe vet Arbri.

Pyetjes së gazetarit të gazetës së Prishtinës „Bota sot” për qëndrimin e diplomatëve perëndimor nëse pavarësi i Kosovës, do ta destabilizonte Maqedoninë, ai i përgjigjet shkurt e qartë: „Pikërisht me pjesëmarrjen tonë në Qeveri deshëm ta eliminojmë këtë segment të diplomatëve perëndimorë. Mesazhi ynë ishte i qartë: jepjani pavarësinë e Kosovës dhe ne garantojmë stabilitetin e Maqedonisë. Mendoj se ky mesazh u lexua shumë mirë”

Takimin e Kryeministrit të Maqedonise, z. Georgievski me liderin e UÇK-së, Hashim Thaçin, Arben Xhaferi më tepër preferon ta quajë takim me Kryeministrin e Kosovës, për t'i dhënë këtij takimi relevancë të nivelit shtetëror të dy vendeve, sepse ai në pozicionin e Kryetarit të Qeverisë së përkohshme ishte në përputhje me marrëveshjen e brendshme të Rambujesë, të përfaqësuesve të tre grupacioneve kryesore politike shqiptare. Ky takim që gjithsesi ishte organizuar nga lobimi i Arbnit, njëherësh ishte rezultat i një fillimi të mbarë të marrëdhënieve miqësore të Maqedonisë me Kosovën, shtetin që sapo kishte lindur, por që i duhej pak kohë që

të njihet ndërkombëtarisht. Nga ky qëndrim miqësor i ish Rpublikës jugosllave të Maqedonisë së asaj kohe, kur adhuresit e Millosheviqit dhe të Serbisë, nuk pajtoheshin me politikën e Georgievskit, duke kundërshtuar çdo afrim me Kosovën, në Shkup dhe Prishtinë flitej edhe për hapjen e përfaqësive zyrtare në dy këto kryeqytete. Për mundësinë e hapjes së këtyre dy përfaqësive ndërshtetërore, ai në intervistën dhënë të përditshmes në gjuhën maqedone „Nova Makedonija”, do shprehej: „Sa i përket fenomenit të hapjes së përfaqësive në Shkup dhe në Prishtinë, konsideroj se ritmi dhe sistemi i ri i marrëdhënieve dhe i vlerave që do të vendoset në rajon do të kontribuojë që edhe këto përfaqësi të përjetohen si një dukuri normale dhe jo si shami e kuqe për frikësim të demave”⁸⁸

Siç vërehet, diskursi i tij politik për sa i përket qëndrimit të një pjese të njerëzve me orientim proserb, shprehet edhe në mënyrë figuratve, duke i konsideruar ato si demat që aq shumë e urrejnë „shamin e kuqe” kur i del përpara. Se Kosova stabile dhe shtet i pavarur, është garancë për stabilitetin e Maqedonisë dhe tërë rajonit, Xhaferi e argumenton me tezën se „Kosova është sjellësja e projekteve evropiane në Ballkan, por edhe e vendosjes së vizioneve bashkëkohore në funksion të një shoqërie të caktuar”⁸⁹. Kur e thotë këtë, e ka parasysh se Kosova, që gjatë kohë ishte në qendër të vëmendjes së ndërkombëtarëve, ishte vendi me shumë institucione ndërkombëtare, nga ai civil e deri te ai ushtarak dhe si e tillë jo vetëm që garanton paqe të qëndrueshme në vetë Kosovën, por edhe në Maqedoni dhe vende tjera të rajonit. Filozofia e tij politike, e bazuar edhe në njohjen e zhvillimeve në rrethanat e krijuara në Maqedoni dhe në rajon, por pa u larguar nga interesi kombëtar, është në interes të të gjithëve, në shërbim të paqjes dhe të zgjidhjes së problemeve në Ballkan. Përqëndrimi i tij në çështjen e përgjithshme shqiptare, nuk lejon veprimtari politike të parcializuar, prandaj ai nuk i shtron problemet e shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë ndaras. Ashtu siç ishte e rëndësishme, Maqedonia si shtet dhe si hapësirë, duke u mundësuar veprim të lirë ndërkombëtarëve për të depërtuar në Kosovën e bllokuar dhe të mbyllur, në rrethana të mëvonshme, gjithsesi një Kosovë e qetë, do e ndihmonte edhe Maqedoninë, edhe pse forcat nacionaliste proserbe e kishin të vështirë që pajtohen me politikën për fqinjësi të mirë, mes Kosovës dhe Maqedonisë. Kësisoi vazhdoi të

⁸⁸ Arben Xhaferi, Kosova duhet të bëhet Republikë e pavarur, „Nova Makedonija”, Shkup, 30.06.1999

⁸⁹ Po aty

mendojë edhe mëtutje Presidenti Kiro Gligorov, derisa ishte në kreun e shtetit, i cili kërkonte që Kosova të mbetet ende si krahinë e Serbisë. Pikërisht për këto qëndrime diametralisht të kundërta për çështjen e Kosovës mes Qeverisë së koalicionit dhe Presidentit, „bashkëjetesa” mes këtyre institucioneve kryesore të shtetit, gati se nuk funksionoi. Të gjitha këto fenomene politike, mes Maqedonisë dhe Kosovës, Arben Xhaferi i ka elaboruar vazhdimisht, madje edhe gjatë dhe pas konfliktit të armatosur të vitit 2001, natyrisht, duke e orientuar politikën në kahet që i determinonin rrethanat e reja.

3.Arbën Xhaferi për raportet problemet dhe konsensualitetin e Maqedonisë, me Greqinë dhe Bullgarinë për tejkalimin e kontesteve historike

Siç dihet, pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pavarësimit të Maqedonisë, marrëdhëniet me fqinjët të këtij shteti të ri, me emrin zyrtar nga OKB si IRJM (Ish Republika jugosllave e Maqedonisë) ishin të ftohta. Këto raporte me fqinjët, ishin rezultat i kontesteve historike, por që u egërsuan në kohën kur sapo ky shtet e fitoi pavarësinë. Greqia ia kontestonte emrin, që sipas tyre , emri Maqedoni është term gjeografik që i takon Greqisë, e assesi etnik, siç mendonin maqedonasit. Bullgaria, madje që nga koha e Jugosllavisë, ia kontestonte gjuhën, ndërsa Serbia ia kontestonte kishën. i vetmi shtet, Shqipëria, e më vonë edhe Kosova, pasi e fitoi pavarësinë, Maqedoninë e pranuan si shtet, me të gjitha këto attribute. Edhe pse kjo problematikë në raport me fqinjët, sidomos me Greqinë, me kohë dha sinjale se ky shtet i ri do ketë pengesa serioze me integrimet në NATO dhe BE, Maqedonia e vazhdoi politikën e vet të „mosnënshtrimit”ndaj Greqisë, madje duke dhënë sinjale provokimi në rrugën për kërkim identiteti në Greqinë antike. Gjithsesi këto raporte jo të mira fqinjësore me Greqinë, nuk i lan të qetë edhe shqiptarët, edhe pse kishte politikanë shqiptarë që mbronin tezën se ky problem nuk i prek shqiptarët, dhe se është kontest mes maqedonasve dhe grekëve. Arben Xhaferi që njëhej për mendimin e vet politik edhe jashtë Maqedonisë, në tërë rajonin, madje edhe më larg, me kohë filloi ta trajtojë dhe analizojë, shkakun e këtij konflikti verbal mes dy shtetesh, të njohur edhe në nivel ndërkombëtar, mbase OKB e obligoi të dërguarin special, Metju Nimic, të ndihmojë

në zgjidhjen e këtij kontesti që zgjati aq shumë, deri në momentin kur Kryeministri Zaev, pati guxim dhe kurajo që të pajtohet për ndërrimin e emrit, që u arrit në Marrëveshjen e Prespës, me Kryeministrin Cipras, në prill të vitit 2019. Qasja e tij për këto mosmarrëveshje të Maqedonisë me Bullgarinë, që vijnë nga historia, bazohet në argumente shkencore historike, prandaj burimin e këtyre mosmarrëveshjeve, sipas tij, duhet kërkuar në realitetin historik. Pyetjes së gazetarit Enver Robeli, se si e komenton ankesën e nacionalistëve maqedonas se vendi i tyre qenka i rrethuar nga katër ujë: Grqia, Bullgaria Serbia dhe Sqiperia, Arbën Xhaferi i përgjigjet duke përmendur fillimisht një bisedë që ai e paska bërë me Kryetarin Kiro Gligorov. Në atë takim i cili ia kishte zënë për të madhe Arbnit për idenë e bashkimit të trojeve shqiptare, Gligorov këtë kundërshtim e shprehu me arsyetimin se edhe Maqedoninë e ndan në tri shtete në Kongresin e Bukureshtit në vitin 1931, gjithsesi duke aluduar edhe në Shqipërinë. Kur me këtë rast Arbni e pyet se cilën Maqedoni e paskan ndarë, ai nuk i kishte dhënë përgjigje të saktë, por sipas Arbnit kishte aluduar në Maqedoninë antike.

i dham këto shembuj për ta argumentuar mendimin politik të Xhaferit se problemet e kësaj natyre të Maqedonisë me fqinjët kanë të bëjnë me historinë dhe gjeografinë e hapësirave ballkanike, dhe ashtu duhet trajtuar, pa i politizuar këto rrethana. Konstatimi i tij se problemet e kësaj natyre për Maqedoninë mund të zgjidhen vetëm atëherë kur ky vend do të trajtohet si nocion gjeografik, që mëpastaj do zgjidheshin edhe kontestet tjera, siç është edhe ai historik. Këtë tezë ai e mbështet me shembullin kur citon historianin dhe ilirologun arbnes të Zarës, Aleksandër Stipçeviqin, cili e spjeron dallimin ndërmjet historisë së një populli dhe historisë së një vendi. Bie fjala, nxënësit e shkollave kroate do të mësojnë për Ilirët si pjesë e historisë së vendit të tyre, ndërkaq shqiptarët si pjesë të historisë së kombit të tyre⁹⁰.

Në këtë kontekst, sipas tij duhet trajtuar edhe kontesti mes Maqedonisë dhe Greqisë, që u zgjat e stërzgjat duke humbur shumë kohë, e që dëmin më të madh e pati vet Shteti i Maqedonisë dhe qytetarët e saj, që aq kohë janë në pritje për t'u integruar në NATO e BE. Kërkesa e Grëqisë për ndërrimin e emrit, sipas tij, nuk është gjë e thjeshtë, ashtu siç dikush mundohet ta trajtojë. Greqia bashkë me ndërrimin e emrit, kërkon të prekë edhe në qenien e identitetit.

⁹⁰ Enver Robeli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2011, f. 139

Përpara kërkesave këmbëngulëse të Greqisë, Maqedonia shumë më herët e ndryshoi flamurin me yllin e verginës, duke pasur synim edhe mohimin e gjuhës dhe shumë vlera tjera që ndërlihen me këtë identitet, ajo nuk pajtohet asesi që një popull sllav të identifikohet me Maqedonasit antikë. Qeveria e Maqedonisë, e veçmas ajo e Gruevskit mendon ai, në vend që të bëjë përpjekje për të arritur ndonjë kompromis, që pikë së pari do ishte në interes të këtij shteti dhe të qytetarëve të saj, ajo përkundrazi përmes provokimeve të vazhdueshme dhe tendencës me çdo kusht të qenit maqedonas antikë, largohet vazhdimisht nga zgjidhja e problemit, edhe pse ndërkombëtarisht njihet me ish emrin e Jugosllavisë që nuk ekziston. Emërtimi i autostradës, Stadiumit e aeroportit, me emrin e Lekës e Filipit dhe projekti „Shkupi 14”, për te janë veprime të pakuptueshme, jo vetëm të garniturës politike të udhëhequr nga Qeveria e Gruevskit, por edhe një pjese të maqedonasve, pa i përjashtuar edhe disa akademikë dhe këshilltarë qeveritarë, që mendonin se historia mund të ndërtohet me dekrete politike. Lideri politik i asaj kohe dhe njëherit edhe kryetar Qeverie, Gruevski, sipas Arbnit kësaj aventure i dha „sharm romanti, duke i mbështetur dy parimet themelore të qëndrimeve maqedonase: Konceptin e Maqedonisë së sotme, si trashëgimtare të Maqedonisë antike, kontributin e Maqedonisë dhe të maqedonasve në Mesjetë në kulturimin e popujve sllavë dhe për identifikimin e sllavishtes së vjetër me maqedonishten e sotme si gjuhë”. Arbnit si politikan, madje edhe si lider pjesëmarrës në Qeveri për më pak se një mandat, dëshironte që ky shtet të jetë në intres të qytetarëve të saj, prandaj edhe ishte për kompromis në zgjidhjen e problemit me fqinjët. Kjo aventurë Qeverisë së VMRO-DPMNE-së Gruevskit, që me çdo kusht sllavomaqedonasit t’i takojnë antikitetit, nuk përkrahej nga fraksioni i kësaj partie, të udhëhequr nga Lubço Gjeorgjievski, partneri bashkëqeverisës i Arben Xhaferit dhe PDSH-së. Qëndrimet konstruktive të Arbnit për fenomenet që kanë të bëjnë me realitetet shoqërore, historike e sociologjike, e që direshin publikisht në çdo kohë e rrethanë, shërbenin edhe si mësim, madje që mund të shërbenin edhe si paralajmëruese edhe për kohën kur ai nuk do ishte gjallë.

Idetë e tij për zgjidhjen e problemeve shoqërore, në rajon dhe Maqedoni, përfshirë edhe kontestin me Greqinë, ai megjithatë e sheh me objektivitet, jo vetëm për t’u shndërruar në një politikan oportunist, por për ta thënë realitetin. Ai nuk i jepte të drejtë politikës me synime të falsifikimit të historisë së Maqedonisë, por as edhe Greqinë nuk e konsideronte të drejtë në

shumë aspekte. Ai edhe kur fliste për tendencën e maqedonasve që veten ta konsiderojnë si popullatë antike, e godiste njëherësh edhe politiken e „Megaloidesë” greke me pretendimet e Greqisë së madhe „ku do të përshiheshin Epiri, Maqedonia, Thrakia, Azia e Vogël ose Turqia perëndimore. Pra ky kontest duket bizar, nga që pozitat e palëve janë ekstreme, megalomane, qesharake që nuk përputhen me realitetin”.⁹¹ Derisa maqedonasit e sotëm kërkojnë t’u njihen të drejtat e tyre qytetëruese që nga koha antike dhe mesjeta, Grekët shprehin apetite për ringjalljen e Perandorisë Bizantine. Ai e konteston gjithashtu insistimin se gjuha e sllavëve maqedonas qenka baza e gjuhës së vjetër sllave (staroslovenski), në të cilën qenka përkthyer edhe bibla. Nëse do ta arrinin këtë, atëherë nuk do të ketë kurrëfarë pengese që përmes faktorit gjuhë të njihet edhe ekzistenca historike e popullit maqedonas, thot Arben Xhaferi, duke shtuar se pas kësaj askush nuk do mund ta ndalojë përvetësimin e ngjarjeve historike dhe personaliteteve, nga Aleksandi i madh, Qirili dhe Metodi, Skënderbeu, Pjetër Bogdani, i cili e mbante nofkën „maqedonas”, e deri te Nëna Tereze.⁹² Në analizat e tij, për këto fenomene, të cilat për shumë të tjerë shihen me dioptrinë bardh e zi, vërehet një seriozitet madje edhe guxim, i vetëdijshëm se para argumenteve që i shtron, tjerët janë të pafuqishëm.

Ky mendimtar e teoricient e jep mendimin e vet edhe rreth çështjes nëse është apo jo e rëndësishme pjesëmarrja e shqiptarëve të Maqedonisë në këto debate. Gjatë kësaj kohe afër 30 vjeçare të këtij kontesti, kemi dëgjuar politikanë dhe analistë të ndryshëm se shqiptarët duhet të rrinë m’anash, sepse nuk paskan ndonjë interes, dhe se kjo problematike është e grekëve dhe maqedonasve. Arbni mendon ndryshe, me tezën kryesore se këto çështje janë të një rëndësie të madhe strategjike për shumë popuj të këtij rajoni, sepse, sipas tij „kemi të bëjmë me tendencën për marrje të licencës për hegjemoni”, që megjithatë e konsideron si joreale dhe qesharake. Shqiptarët thot ai, duhet të mbajnë qëndrim real, që nënkupton të vërtetën historike. Duke i pasur të gjitha këto parasysh, ai zgjidhjen për këtë ngërç e sheh te propozimi i një emrimi të ri, që mund të ishte Maqedonia e Re, ose Maqedonia Veriore, propozim ky i fundit, që u bë realitet pas aq shumë vitesh, me rastin e Marrëveshjes së Prespës. Gjithë këtë humbje kohësh,

⁹¹ Enver Robeli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2011, f. 150

⁹²Po aty

pa e zgjidhur kontestin me Greqinë, ai e sheh në mosgatishmërinë e Maqedonisë për kompromise, që gjithsesi me pak dhembje do sillnin më tepër dobi se sa ky shtet dhe qytetarët e vet të mbetëshin aq vite të bllokuar nga vetoja e Greqisë. Sipas tij, në këtë vend mungoi forca dhe kapacitet intelektual e politike për të krijuar mundësi që të ecet përpara, drejt synimeve evropiane. Katër problemet strategjike si rezultat i kontestit të emrit gjuhës, kishës ortodokse dhe moszgjidhjes së çështjes shqiptare, këtë vend e mbajnë peng dhe të izoluar, thekson ai, ndërsa për qëndrimin e shqiptarëve për këto çështje të pazgjidhura aq gjatë kohë, do shprehej: „Ne do vazhdojmë me politikën tonë konstruktive, që nënkupton një sens të lojalitetit ndaj çështjes maqedonase, por njëkohësisht kurrë nuk do heqim dorë nga kërkesat normale të shqiptarëve për barazi të plotë. Energjitë tona në këtë rrugë do të jenë të pashtershme.”⁹³ Vetëm qëndrimet e këtilla objektive, guximi politik, por edhe gatishmëria për kompromise të vogla nga të cilat dalin përfitime të mëdha me interes të përgjithshëm dhe afatgjatë, do e nxirrnin vendin nga ngërçi disa dekadash. Për Xhaferin është normale frika e Gruevskit nga etiketimi për tradhëti dhe dilema për një vendim që prek në identitet, por nuk është normale sipas tij, sjellja arrogante ndaj Greqisë dhe ndërkombëtarëve të involvuar në këtë proces me qëllim të mirë, duke dashur që ta ndihmojnë paqen dhe mirëkuptimin mes fqinjësh, për t’i hapur rrugë integritimeve evropatlantike. Gruevski në vend që ta marrë përgjegjësinë për vendime të një burrështetasi, meqë populli ia ka dhënë mandatin me vota, në bashkëpunim edhe me opozitën, vazhdon Arbni, ai tentonte të fshihet pas referendumit, duke dashur t’i ikë përgjegjësisë. Për Maqedoninë, sipas tij „nuk është prioritet anëtarësimi në NATO, por identiteti i saj”⁹⁴

Për Kryeministrin Gruevski, ai shprehej se nuk kishte kapacitete, vullnet e as mençuri që ta zgjidh këtë kontekst me Greqinë, madje duke e krahasuar edhe me Millosheviqin kundrejt qëndrimit me Kosovën, sado që herë pas here, përmes politikanëve kompetentë për punë të jashtme mundësonte takime, për gjoja se pala maqedonase bën përpjekje për zgjidhjen e këtij konteksti historik por Greqia nuk lëshon pe. Ai as që donte ta kuptojë se qëndrimet e Greqisë ishin të qarta dhe se zgjatja e marrëdhënieve konfuze mes du shteteve nuk ishte në dëm të Greqisë, sa ishte në dëm të Maqedonisë. Sidoqoftë, Arbni deri sa ishte gjallë dhe merrej me

⁹³ Arben Xhaferi, Të drejta të plota për shqiptarët në Maqedoni „Balkan Insight, Tetovë, 9.04. 2006

⁹⁴ Arben Xhaferi, Problemet strategjike të Maqedonisë, gazeta „Politika”, Sofje, 12.11.2008

politikë aktive, e dha kontributin e vet, edhe për zgjidhjen e këtij problemi, por sukcesi mungoi, nga shkak i politikës kokëfortë, dhe të njëanshme të Kryeministrit Gruevski, i cili në vend të kompromisit e zgjodhi provokimin përmes apetiteve të tij dhe bashkëmendimtarëve, për t'i kërkuar rrënjët e gjenezës të maqedonasit antikë.

Edhe marrëdhëniet acaruese të Maqedonisë me Bullgarinë e kanë historikun e vet. Lidhur me këto raporte të ftohta ndërfqinjësore nga koha e pavarësimit të këtij shteti, që doli si rezultat i Jugosllavisë së Titos, Arben Xhaferi në këndvështrimin e vet, duke u kthyer në historinë më të largët, në mënyrë analitike, i paraqet pikëpamjet e veta, të bazuara në politikën e interesave gjeostrategjike të fuqive të mëdha, duke i përmendur edhe ngjarjet e rëndësishme historike, Marrëveshjen e Shën Stefanit, Kongresin e Berlinit, daljen në skenë të organizatës politike, VMRO, dhe Luftën e Dytë Botërore. Ai flet gjithashtu për qëndrimet probullgare të udhëheqësit Shatorov Sharllo, e zëvendësimin e tij nga komunistët jugosllavë me Llazar Kolishevskin, meqë, i pari nuk i konsideronte okupatorët bullgarë si të tillë, prandaj edhe e pengoi fillimin e luftës partizane kundër pushtuesve. Në këtë vështrimin të vetin historik, Arbni vazhdon mëtutje, deri në formimin e shtetit të Jugosllavisë federative, ku njëra nga njësitë federale ishte edhe Republika Popullore e Maqedonisë, që u „formua me identitet të veçantë etnik të maqedonasve, me vetëdije të re nacionale. Puna e parë në këtë drejtim ishte formimi i një gjuhe të veçantë sllave, që sipas territorit do të emërtohet si gjuhë maqedonase dhe pastaj do i krijonte edhe kushtet për identifikim etnik”.⁹⁵ Kjo është historia e shkurtër e kontestit, mes këtyre dy shteteve fqinje, Maqedonisë dhe Bullgarisë, e cila Maqedoninë nuk e konteston si shtet, por, gjuhën, figurat e rëndësishme historike, kulturën etj. Siç vërehet, Arben Xhaferi nuk e preferon metodën e politikbërjes sipas modelit bardh e zi, por gjithmonë të vështruar në mënyrë të gjithanëshme, prandaj këtu edhe qëndron përmasa intelektuale dhe filozofia e tij politike. Ai asnjëherë nuk u shërbye me ide të gatshme, por ishte vazhdimisht në kërkim të mendimit, të bazuar në fuqinë e argumentit.

Derisa acarimi i marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Greqisë, u paraqit që nga momenti i pavarësimit të shtetit të ri me emrin kushtetues Maqedoni, sepse më herët si njësi

⁹⁵ Arben Xhaferi, Vepra 04, Intervista 2006-2012, Pishtinë, 2016 f. 144

federale e shtetit të Jugosllavisë as që njihej diku me këtë emër, raportet jo të mira me Bullgarinë, duhet kërkuar shumë më herët, që në kohën e formimit të Federatës jugosllave, nga e cila u krijua dhe u njoft si etnitet me gjuhë, kulturë e attribute tjera që e përbëjnë kombin. Në këtë frymë bazohet edhe analiza e Arbnit dhe qëndrimi i tij konstruktiv për çështjen bullgare, që nga koha e pavarësimit të Maqedonisë. Këto raporte mes dy shteteve filluan të zbuten sidomos në kohën e qeverisjes së PDSH-s, të udhëhequr nga ai, me VMRO-DPMNE-në e Lubço Gjeorgjievskit. Gatishmëria e dy vendeve që armiqësitë t'ia lënë së kaluarës, edhe pse me plagë të pashëruara tërësisht, ishte meritë e dy liderëve në qeverisje të vendit, dhe disponimit antiserb të politikave të tyre. Qëndrimet e Sërbisë ndaj Bullgarisë sipas Xhaferit nuk ishin korrekte, madje ajo (Sërbia) i satanizonte bullgarët, për gjoja si të rrezikshëm për Maqedoninë, me qëllim që t'i forcojë pozicionet në këtë shtet, që me ardhjen e VMRO-DPMNE-së, në masë të madhe i kishte humbur. Lideri i atëhershëm i PDSH-së, Arben Xhaferi, pas takimeve me kryeministrin Kostov, me ministren e jashtme, Nadezhda Mihajlova, dhe deklaratave të ndryshme në mediat bullgare, që ishin në interes të dy vendeve, kishte kontribuar në masë të madhe, duke trasuar rrugën e fillimeve për bisedime mes dy qeverve. Pas këtyre takimeve ,të zhvilluara në klimë miqësore, siç thot ai, „u nënshkruan disa marrëveshje ndërshtetërore me të cilat u arrit të kapërcehet problemi i ashtuquajtur gjuhësor dhe të përmirësohen marrëdhëniet ndërshtetërore që kanë rëndësi strategjike për ballanset ballkanike.⁹⁶

Kjo marrëveshje si e plotë u arrit shumë vite më vonë, me Marrëveshjen për fqinjësi të mirë, e që u nënshkrua midis kryeministrave Borisov dhe Zaevit. Gjatë kësaj qeverisjeje, me klimë të zbutur mes dy shteteve, edhe shqiptarët e ndryshuan mendimin për Bullgarinë, sepse siç do shprehej Arbni, „Ne shqiptarëve nuk na kanosej asnjë rrezik, të paktën tash për tash nga bullgarët”.⁹⁷

⁹⁶ Revista „Pasqyra”, Prishtinë 5.07. 1999, btuar edhe në librin nr.04 të veprës për Arben Xhaferin, f.181

⁹⁷ Po aty

4. Skica për komunitetin shqiptar sipas Arben Xhaferit

Pas shumë analizash, trajtesash e debatesh përmes paraqitjes në media mbarëkombëtare e ndërkombëtare, për çështjen shqiptare, rajonale e më gjerë, kah fundi i vitit 2008 Arben Xhaferi para publikut u paraqit me idenë e formimit të një asociacioni të vetëm gjithkombëtar që do merrej me çështjen shqiptare. Kjo mënyrë e re e qasjes së tij për konsolidimin dhe forcimin e frymës mbarëkombëtare, nga shumë qarqe me disponim antishqiptar nuk u prit mirë, duke u konsiderua edhe si tendencë për formimin e Shqipërisë etnike. Është fakt se kjo ide e tij është vazhdimësi e frymës së rilindëve, të cilët fatin e kombit, të ndarë e të përçarë e shihnin vetëm si të bashkuar, por të variantit që u përgjigjet kushteve të kohës dhe mundësive të kufizuara për për t'ia arritur atij qëllimi. Nëse Sami Frashëri në veprën „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet, i qaset historisë së fatit të kombit, në të kaluarën, në kohën e tij, dhe si duhet të jetë në të ardhmen, Abën Xhaferi, duke e njohur të kaluarën, dhe të tashmen, kur kombi funksionon në disa shtete, me idenë e tij të quajtur „Skicë për mbrothësinë e përbashkët”, kishte për qëllim zgjidhjen e problemeve me intetës të përbashkët dhe bashkërenditjen e veprimeve të të gjithë shqiptarëve në shumë sfera të jetës, siç janë:

- Çështjet e identitetit;
- Unifikimin e standardeve kombëtare;
- Demokracia;
- Ekonomia
- Arsimi;
- Barazia gjinore;
- Sekularizmi
- Të drejtat njerëzore;
- Gjqësori;
- Sporti;
- Ndërveprimi;
- Rinia.⁹⁸

⁹⁸ Arben Xhaferi, Skicë për mbrothësinë e përbashkët, Tetove, 1.10.2008, botuar në librin 01 të përmbledhjes së veprës së tij, f. 143

Me termin e bukur shqip, „Mbrothësi”, që parapëlqehet edhe nga rilindësit, nënkuptohet mbarësia e përparimi i kombit, që shpie drejt ardhmërisë e zhvillimit, edhe pse mund të jetojnë në shtete të ndryshme. Sipas tij, kjo mënyrë e ecjes përpara duke i afirmuar vlerat e përbashkëta etnike kulturore, arsimore, ekonomike etj, është e mundshme dhe e realizueshme, përkundër veprimtarisë së këtyre fushave që vështirë se mund të realizohen ndaras, mbase përvoja e deritanishme tregon se një zvillim normal, e i gjithanshëm, kështu të parcializuar, nuk mund të ketë sukses, madje te shqiptarët jashtë shteteve të tyre, zhvillimi normal në këto sfera që i përmend ai, as që është i mundshëm, me gjithë përpjekjet e tyre që përmes partive politike që veprojnë brenda atyre shteteve të arrihen të drejtat e plota që i synojnë. Kur flet për objektivat dhe aktivitetet, ai vlerëson se „Mbrodhësia karakterizohet si organizatë ndërkombëtare që synon t’i zgjidhë problemet me të cilat do të ballafaqohen bashkësitë kombëtare të shkapërderdhura në shumë shtete”.⁹⁹ Përkufizimin e këtij Istitucioni, Arbni e jep kështu: „Mbrodhësia e Përbashkët është organizatë jopolitike vullnetare. Në këtë projekt do të përfshihen shtetet, përkatësisht bashkësitë shqiptare që jetojnë në shtete të ndryshme të botës”¹⁰⁰ Pas përkufizimit, autori i këtij projekti i thekson edhe qëllimet e themelimit, siç janë: interesat e përbashkëta, afirmimi i demokracisë, të drejtave të njeriut qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, të drejtat individuale, barazia, tregëtia e lirë dhe paqja në botë etj. Për këtë institucion, Arbni e parasheh edhe mënyrën e funksionimit përmes organeve. Udhëheqësia do zgjidhet nga anëtarët e organizatës dhe do jetë e depolitizuar, duke pamundësuar ndikime të ndryshme partiake. I pari i kryesisë do jetë Sekretari i Përgjithshëm, i cili do ketë të drejtë ekzekutive, sipas shembullit të Commonelthit, ku udhëheqjen në mënyrë formale apo simbolike e ka mbretëresha. Një mënyrë e ngjashme mund të praktikohet edhe me këtë organizatë, kur rolin simbolik udhëheqës mund ketë oborri mbretëror shqiptar. Për sa i përket anëtarësimit, parashihen disa dokumente të rëndësishme. Struktura udhëheqëse, në krye me Sekretarin, selinë duhet ta ketë në Tiranë, ndërsa degët e „Mbrothësisë” do shtrihen në qendrat tjera ku jetojnë shqiptarët. Sekretari, në bashkëpunim me funksionerë të niveleve të

⁹⁹ Arben Xhaferi, Skicë për mbrothësinë e përbashkët, Tetovë, 1.10.2008, botuar në librin 01 të përmbledhjes së veprës së tij, f. 143

¹⁰⁰ Po aty faqe 142

ndryshme nga radhët e shqiptarëve, organizon mbledhje me interes për kombin, ku do trajtohen çështje të ndryshme politike, ekonomike dhe profesionale në fusha të ndryshme dhe harton programe për realizimin e projekteve që do ndihmonin në tejkalimin e pengesave që mund të paraqiten në shoqëritë shqiptare. Seksionet e sekretariatit udhëhiqen nga Sekretari i përgjithshëm dhe dy zëvendësit e tij. Mandati i Sekretarit zgjat katër vite, me të drejtë të rizgjedhjes. Pjesë e „Mbrothësisë”, do jenë edhe subjekte tjera sekondare që kanë të bëjnë me veprimtarinë arsimore, akademike, sportive, gjyqësore, juridike et, përfshirë edhe institucionet tjera parlamentare.

Kjo ide e Arben Xhaferit, siç konstaton edhe vet ai, është e guximshme, sa edhe vështirë e realizueshme, por shumë e nevojshme, në kohën kur indi i kombit të ndarë në disa shtete po dobësohet vazhdimisht, duke shkuar drejt rrugës së deformimit të qenies kombëtare. Ky projekt gjithkombëtar, i Arbnit, gjithsesi i frymëzuar nga e kaluara historike dhe veprimtaria atdhetare e rilindësve, me gjithë vështirësi dhe pengesat eventuale që mund të vijnë nga qarqe obstruktive të huaja me disponim antishqiptar, është i realizueshëm, sepse për synim ka vetëm unitetin e kombit në aspektin e konsolidimit të vetëdijes kombëtare për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave etno- kulturore, që janë fragmentarizuar aq shumë.

i vetëdijshëm për akuzat që pas hartimit të këtij projekti mund t'i drejtohen atij për ide nacionaliste, madje kinse edhe si nxitëse për rrezikimin e paqes në rajon, Arben Xhaferi, që në hyrje të këtij dokumenti, jep shembuj për raste të ndryshme, kur nacionalizmi i tjetrit kritikohet po nga pozita nacionaliste. Këtë fenomen ai e ilustron me qëndrimet e Ruisë dhe Kinës, fuqi këto që ishin dhe janë kundër pavarësisë së Kosovës, madje duke deklaruar se „në Kosovë mbrohet interesi i tyre nacional, ndërsa kosovarët do i shpallnin nacionalistë, nëse do deklarorin se në Kosovë mbrohen interesat e shqiptarëve.”¹⁰¹

Me këta shembuj ai e arsyeton tezën se nacionalizmi kudo në botë është i anatemuar si luftënxitës, përkundër deklaratave me konotacion pozitiv, për nacionalizmin si mbrojtëse e interesave etnike, sidomos të popujve të vegjël, që e kundërshtojnë, sunduesin okupator. Për

¹⁰¹ Arben Xhaferi, Skicë për mbrothësinë e përbashkët, Tetovë, 1.10.2008, botuar në librin 01 të përmbledhjes së veprës së tij, f. 138

Arbën Xhaferin , çdo lloj rezistence për çlirim kombëtar, dhe mbrojtjen e interesit etnik, nuk duhet llogaritur si luftënxitëse, prandaj ai e thekson se pikërisht Evropa është vendlindja e nazionalizmit, që tani këtë fenomen e konsideron si të rrezikshëm për paqen në rajon dhe më gjerë. Edhe këtë tezë ai e argumenton me shembuj të ndryshëm, duke përmendur shumë shtete të qytetërimit evropian, që konfliktet i tejkaluan, pas zgjidhjes përfundimtare të çështjeve të hapura etnike. Me këtë rast ai e përmend sociologun amerikan Benedikt Anderson, i cili me të drejtë konstaton se, „nacionalizmi u shfaq në skenën historike evropiane në shek. XVI, kur popujt e evropës e humbën besimin në librat e shenjtë, përkatësisht në të „vërtetat“ e shenjta që dolën se ishin lajthitje”.¹⁰² Rrënimi i këtij besimi në relegjion, u dasht që të kërkohet diku tjetër dhe si kompensim u gjet nacionalizmi, dmth, nga hyjnorja kaloi te njerëzorja. Arben Xhaferi të gjitha këto qasje analitike i bën me qëllim që ta arsyetojë projektin e „Mbrothësisë“, karshi të tjerëve se me atë program vetëm sa mbrohet interesi kombëtar shqiptar, pa e dëmtua askend.

Për rolin afirmativ, kur përmes nacionalizmit pozitiv ruhet kombi dhe qenia kombëtare, ai merr shembullin e Francës, ku nacionalizmi kishte rol emancipues dhe çlirues, me ç’rast e formuan shtetin, të cilin e identifikuan me kombin. Shoqëritë heterogjene, apo multietnike, nëse nuk do i nënshtroheshin shtetit juridik për garantim të drejtash tërësisht të barabarta, do shpërbëheshin, astu siç ngjau me Perandorinë Osmane, Austro-Hungarinë, Rusinë, Jugosllavinë, Çekosllovakinë, etj. Për këto çështje, që kanë të bëjnë me nacionalizmin, ai citon edhe një sociolog Zvicërian, Urs Altermat, i cili në librin e tij „Etnonacionalizmi evropian“, me të drejtë konstaton se nacionalizmi në Evropë pat dy lloj funksionesh kontradiktore:

- ndikoi në shpërbërjen e shteteve, perandorive, formacioneve multietnike shoqërore, siç ishte Austrohungaria dhe
- ndikoi në bashkimin e shteteve të vogla feudale në një shtet kombëtar të popujve me origjinë të njëjtë, siç ishin gjermanët apo italianët.

¹⁰² Arben Xhaferi, Skicë për mbrothësinë e përbashkët, Tetovë, 1.10.2008, botuar në librin 01 të përmbledhjes së veprës së tij, f. 143

Fragmentarizimi i indit shqiptar dhe ndarja në disa shtete, pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, atyre asnjëherë nuk u mundësoi zhvillim normal që kanë të bëjë me interesin e përbashkët të sferave që u përmendën. Xhaferi duke e pasur parasysh këtë ngecje, jo me fajin e shqiptarëve, doli me këtë platformë, që është risi në këto hapësira, ashtu siç është e domosdoshme. Kjo mënyrë e organizimit sipas tij, mund të realizohet përmes vullnetit të mirë dhe nevojës së interesit kombëtar. Shqiptarët në Shqipëri, shprehet ai, nuk kanë kufizim të të drejtave, nacionale, ato të Kosovës e kanë gjithashtu lirinë por për momentin jo edhe mëvetësi qeverisjeje, ngaqë sovranitetin e ndajnë me faktorfin ndërkombëstar. Në Maqedoni, siç po shihet shqiptarët edhe shumë kohë duhet të luftojnë për të drejtat e tyre, ndërsa në Luginën e Preshevës dhe Mal të Zi, si duket, do mbeten pakica kombëtare. Në gjendjen si janë sot shqiptarët, e kanë të vështirë t'i realizojnë synimet e veta, prandaj mendon ai „paraqitet nevoja që të gjejnë rrugë të tjera për t'i tejkaluar pengesat që objektivisht e ngulfatin zhvillimin ekonomik, kulturor, atsimor dhe sigurinë e tyre¹⁰³. Te kjo mënyrë e organizimit, e cila mundëson mekanizma që garantojnë zhvillim të sigurtë në këto fusha, ai nuk sheh asgjë të keqe që mund ta dëmtojë tjetrin, përkundrazi, shprehet ai, kombet që kanë krijuar shtetet e tyre kanë arritur që, me kohë ta kenë praktikuar këtë mënyrë të mbrohtësisë së kombit të tyre, edhe pse një gjë të tillë e kanë arritur më lehtë, se nuk ka pasur kush t'i pengojë. Në shumë vende të botës për këto arritje janë bërë edhe luftëra të përgjakshme. Për kështu organizimesh ai si shembull e merr projektin e Frankofonisë, apo Commonëalthit (Kromveltit) , të themeluar nga popujt e qytetëruar, siç janë francezët apo britanikët. „Projekti i parë krijon relacione kohezive me popujt të ndryshëm mbi baza zgjerimit të përdorimit të gjuhës frenge, ndërkaq ky i dyti mbi baza të mirëqenies së përbashkët”.¹⁰⁴ . Sipas këtyre modeleve dhe të ngjashme, shqiptarët, mendon ai, më mirë do mund t'i shfrytëzojnë të gjitha kapacitetet dhe resurset njerëzore, që nuk mund ta arrijnë dot në këtë gjendje të fragmentarizuar siç janë aktualisht, sepse shoqëritë shqiptare nuk janë të standardizuara, dhe në rrethana të tilla, vlerat e popujve tjerë depërtojnë shumë lehtë, fakt ky, që u trguar deri tani se „pa standardizim nuk mund të mbrohet asnjë vlerë, veçmas ato që kanë të bëjnë me identitetin kombëtar”.¹⁰⁵

¹⁰³ Arben Xhaferi, Skicë për mbrohtësinë e përbashkët, Tetovë, 1.10.2008, botuar në librin 01 të përmbledhjes së veprës së tij, f. 140

¹⁰⁴ Po aty, f. 141

¹⁰⁵ po aty, f. 143

KAPITULLI

V

OFERTA E ARBËN XHAFERIT PËR NDËRTIMIN E NJË MAQEDONIE ME PERSPEKTIVA EURO- ATLANTIKE

1. Roli politik dhe diplomatik i Arbën Xhaferit në Luftën e 2001-shit
2. Marrëveshja e Prizrenit, hap i madh drejt pajtimit
3. Kontributi i Arbën Xhaferit për Marrëveshjen e Ohrit dhe vlerësimet e tij të mëvonshme për te
4. Demokracia konsesuale
5. Kontributi i Arbën Xhaferit në krijimin e institucioneve të larta arsimore dhe atyre shkencore e kulturore
6. Marrëveshja e re politike maqedonase shqiptare në kohë paqe për një kohezion të përhershëm politik

1. Roli politik dhe diplomatik i Arbën Xhaferit në Luftën e 2001-shit

Aktiviteti politik i Arbën Xhaferit është i vazhdueshëm. Ai flet gjithmonë, në çdo rrethanë politike, madje edhe atëherë kur bashkëbisedues të tij, përfaqësues të mediave vendore dhe të huaja mendojnë se idetë e tij nuk do jenë në përputhshmëri me situata të ndryshme, të krijuara aty për aty, sepse mendimi politik i tij, përveç se është afatgjatë, reflekton edhe në momente të caktuara, i nxitur nga intuita politike e zhdërvjelltë, që u përgjigjet edhe fenomeneve të ndryshme shoqërore, ndoshta për shumkënd të paparashikuara. Kjo thellësi e mendimit filozofik e tij, nga një pjesë e gazetarëve, publicistëve e analistëve të ndryshëm, nuk kuptohej, keqkuptohej, ose shtrembërohej. Në pyetjen e gazetarit Robelli, autorit të librit „Në Tetovë në kërkim të kuptimit”, lidhur me një deklaratë të tij gazetës gjermane „Zydojçe Cajtung”, ai u përgjigj: Në parim, deklaratat që i jap janë në funksion të sqarimit të një procesi të gjatë historik”. Në frymën e këtij modeli të përgjigjeve, që njëherit ishin edhe analizë edhe mendim, Arbni me elegancën e njohur të tij, jo që dilte nga situata, por ato përgjigje për bashkëbiseduesit ishin njëherit edhe mësim, edhe analizë. Arbën Xhaferi mbetet i tillë edhe në situata, kur shmëkush mendonte se ai „s’ka nga t’ia mbajë”, për ta kuptuar mëpastaj se, megjithatë Arbni ka përgjigje të përshtatshme për kontekstin politik, qoftë i paraqitur edhe në moment. Pati edhe mendime se ky politikan dhe mendimtar, është disi si i paqartë në analizat e fenomeneve të ndryshme, që kinse e kundërshtojnë njëra tjetrën. Në shumë paraqitje të tij, Arbni u cilësua si ithtar i madh i bashkumit kombëtar, ndërsa në disa raste ai konsiderohej si ideolog i një tipi të bashkëjetesës por të mbështetur në parimin e konsensualitetit të veçantë, që do ishte në interes të një Maqedonie të qëndrueshme. Pati momente kur nga disa qarqe , për interesa politike, kuptohet, u akuzua se pajtohej për një ndarje të Maqedonisë, në dëm të shqiptarëve, me kufi në Zhelinë të Tetovës. Është e vërtetë se ideja për ndarje në mënyrë paqësore u bisedua, por nuk është e vërtetë se Arben Xhaferi u pajtua për një ndarje të tillë, ku sërish një pjesë e madhe e shqiptarëve dhe e territoreve të tyre do mbeteshin nën pushtetin maqedonas. Kjo akuzë erdhi pikërisht nga vet ata që në emër të ndarjes dhe të çlirimit të shqiptarëve nga „shkau” edhe e filluan luftën, për ta ridefinuar shumë shpejt qëllimin e luftës, kinse bëheshka për ta ruajtur

tërësinë territoriale të Maqedonisë. Për këto momente, Arbni, dhjetë vite më vonë, në intervistën dhënë Enver Robellit, do shprehej: Para vitit 2001 zhvilloheshin biseda edhe për ndarje të Maqedonisë. Pak nga pak, duke krijuar një klimë të mirëbesimit të ndërsjellë, hapej një shtegdalje tjetër për zgjidhjen e problemeve që prodhonin krizën. Këto veprime sot duken të pamundshme dhe të pabesueshme.¹⁰⁶ Gjithsesi pati edhe kritika se nuk e përkrahu luftën, pikërisht nga individë që pak më vonë kishin nevojë për te, të vetëdëshëm se ky ishte njeriu që e dëgjojnë dhe i besojnë diplomatët e huaj që shkonin e vinin, me të vetmin qëllim ta ndalin luftën ose ta mbajnë nën kontroll përhapjen e zjarrit sepse ai krahas politikës, e bënte edhe diplomatin. Ndërkombëtarët i besonin fjalës së tij edhe kur fliste për paqe, por edhe për kur fliste luftën. Të gjitha këto qëndrime të tij, që duket se e kundërshtojnë njëri tjetrin, edhe pse pak me vonesë, u kuptuan drejt dhe dhe në harmoni me kohën dhe rrethanat që i solli ajo, e në këtë rast edhe luftën, që me gjuhën diplomatike më tepër u konsiderua si konflikt i armatosur. Nëse i analizojmë mirë të gjitha këto veprime politike e diplomatike, gjithmonë me bazë në filozofinë politike të tij, do e kuptojmë drejt Arbën Xhaferin. Edhe pse vet e pranon se lufta e befasoi dhe u nis pa dijen e tij, ai edhe në ato momente kyçe dinte si të veprojë. Në këtë kohë të dilemës hamletiane „Të rrfosh apo të mos rrosh”, ai vendosi që veprimin e vet ta orientojë drejt përkrahjes së kësaj lufte, ashtu siç kishte vepruar me luftën e Kosovës, kur për një kohë të gjatë, përmes këshillave, sugjerimeve e udhëzimeve, përpiquej ta nxirrte strukturën e UÇK-së prej lëvozhgës së konspiracionit, e Kosovën nga nami i dhunës që po e përcillte.¹⁰⁷ Intelektuali dhe publicisti i njohur Veton Suroi, cili në ato momente të ndjeshme të dy luftrave, qëndronte shumë afër me te, kështu e përshkruan qëndrimin e Arbnit, si përgjigje e pyetjes se çfarë qëndrimi do mbajë për luftën, që i kishte dhënë sinjalet e para përmes krismave në Kalanë e Tetovës dhe në Tanushë, ai tha se do qëndrojë në Tetovë, aty ku është, në zyrën e tij, dhe se nuk ka ndërmend të largohet, edhe pse do e ketë vështirë ta menaxhojë ate, sepse, kur fillon lufta, kishte deklaruar ai, ka pak hapësirë për politikë. Ai duke i njohur mirë rrethanat, pothuaj të ngjashme me atë të Kosovës dhe situatën jo të lakmueshme të tij, pat deklaruar se nuk don të vijë në situatën e Ibrahim Rugovës, dhe se nuk është për ndasi mes UÇK-së (ate të Maqedonisë), përkundrazi,

¹⁰⁶ Enver Robeli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Prishtinë 2011, f. 129

¹⁰⁷ Veton Suroi, parathënia e librit Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Prishtinë f.18

është i gatshëm të bisedojë me krahun ushtarak, kudo, e kurdo, sepse nuk dëshiron që të përsëritet skena e Kosovës, në raport mes Rugovës dhe UÇK-së. Me këtë rast vlen të përmendet edhe një vlerësim tjetër i Arbnit, kur thotë se për dallim nga udhëheqësit e luftës në Kosovë, Ai Ahmeti nuk fshihej prapa udhëheqajës kolektive, sepse kishte marrë përgjegjësi të plotë për luftën, duke qenë i përcaktuar që të mos krijohet përçarja. Nga këto qëndrime të tij, që në fillim të konfliktit, Xhaferi ua bëri me dije shqiptarëve se nuk do lejojë të thellohet hendeku mes krahur politik dhe atij ushtarak, edhe pse ai ishte i injoruar, për konsultime të mundshme paraprake, para se të plasë konflikti i armatosur. Meqë u imponua agjenda e luftës, ai ishte i detyruar të heq dorë nga agjenda e vet dhe e partisë së tij, për ta dhënë kontributin diplomatik e politik edhe në kushte tani më të reja. Kjo përkrahje e krahut të luftës, që më tepër ishte nevojë se dëshirë e tij, e hapi rrugën edhe për takimin zyrtar, që u mbajt në Prizren me liderin e luftës, Ali Ahmetin dhe kreun e PPD-së, Ymer Ymerin.

Krahas kontributit në afirmimin dhe afërinë me UÇK-në, ai vazhdonte të veprojë edhe me aktivitete tjera të përgjithshme, duke deklaruar shpesh se pa një marrëveshje konsesuale me shqiptarët, ky shtet e ka të pasigurtë ardhmërinë. Është fakt se në mendimin politik afatgjatë, në funksion të një procesi të gjatë historik, ai nuk i mohon deklaratat e veta për bashkim kombëtar, ashu siç është fakt edhe angazhimi i tij në koalicionin qeveritar, me idenë se Maqedonia duhet të çlirohen nga ndikimi serb dhe t'i kthehet realitetit, duke e pranuar se vetëm me shqiptarët, si popullatë e dytë në numër, mund të mbrohet interesi i këtij shteti. Punuam shumë, shprehet ai, që sa më parë maqedonasit ta kuptojnë se pajtimi me shqiptarët, është interes shtetëror i Maqedonisë, ndërsa simpatitë dhe lidhjet emocionale me serbët dhe Serbinë le t'i takojnë sferës së psikologjisë.¹⁰⁸ Hyrja në Qeveri në atë kohë, e Arbën Xhaferi, si lider i PDSH-së, përveç interesit të vetë shqiptarëve, njëherësh ishte edhe interes i Maqedonisë drejt pavarësisht të mirëfilltë, sepse, siç shprehet në një rast ai, deri në atë kohë, Maqedonia e udhëhequr nga partia e majtë, ishte e pavarur, por me raporte të afërta ekskluzive me Serbinë, që nënkuptonte mohimin e elementit shqiptar, si faktor shumë i rëndësishëm si për brenda, ashtu edhe jashtë këtij shteti. Përvoja e tij, jo edhe e gjatë në praktikën politikëbërëse, përfshirë edhe menaxhimin

¹⁰⁸ Enver Robelli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, f.128

me krizën kosovare, e përgatiti, edhe për menaxhimin e situatës politike e diplomatike gjatë konfliktit të pjesëtarëve të UÇK –së me forcat e mbrojtjes e sigurisë së këtij shteti. Edhe pse ai dhe partia e tij, si subjekt politik, në fillim nuk e përkrahu luftën, por as që e penguan ndonjëherë, atë, përkundrazi, e ndimoi në ndonjëfarë mënyre, përmes politikës dhe raporteve korrekte me partnerin e koalicionit në Qeverinë e atëhershme, Gjeorgjieskin dhe diplomatëve, e politikanëve ndërkombëtarë, me të cilët i lidhte edhe bashkëpunimi nga Lufta e Kosovës.

Me shpërthimin e konfliktit në Maqedoni, ai hoqi dorë nga agjenda e tij politike, në momente kur mirëkuptimi me partnerin bashkëqeverisës po jepte sinjale pozitive duke krijuar klimë relaksuese për marrëveshje konsensuale afatgjate, për ta përkrahur haptas atë, me arsyetimin se ky rebelim i rinisë shqiptare ishte rezultat i shkeljeve elementare të të drejtave të tyre, deklarati kjo që e bëri kthesën e madhe në qëndrimet e faktorit ndërkombëtarë se ata që kanë dalë në mal nuk qenkan grupe terroristësh, por luftëtarë që i kërkojnë të drejtat e veta që u takojnë, madje edhe ato që i kishin humbur me Kushtetutën e re të Maqedonisë së pavarur. Këtë tezë, Xhaferi e trajton realisht duke e bazuar në fakte konkrete. Ai si teoricient që ishte, fenomenet shoqërore i zbërthen përmes metodologjive të njohura për teoritë politike. Sipas konceptit të tij, problemet politike brenda një shteti mund të zgjidhen në mënyrë evolutive e revolucionare. Ai haptas e shpreh mendimin se të arriturat evolutive janë më të ngadalshme por nuk i rrezikojnë rezultatet, e së kaluarës, sado të vogla qofshin ato, ndërsa me revolucion, nëse dështon, i humb edhe ato që i ke pasur më parë. Ai me kapacitetet intelektuale e politike që kishte, por edhe me giximin për t'a thënë drejtë atë që mendonte, fliste njësoj, para faktorit ndërkombëtar edhe para atij, vendor, madje edhe për temat e „nxehta”, që kishin të bëjnë me luftën. Ai për dallim nga politikanë dhe liderë paqësorë të Kosovës, që nuk e përkrahën, madje e kritikuan luftën dhe luftëtarët e UÇK-së, e përkrahu atë fuqimisht, edhe pse ai jetoi me dilemën se cilat ishin qëllimet dhe motivet e luftës. Sipas tij, kjo mungesë e informatës ndikon që të përhapen teoritë e ndryshme komplotiste ose mistifikuese. Përgjigjen për këtë dilemë, ai nuk parapëlqen ta thotë, sepse nuk ishte vet ai që e nisi luftën, prandaj në pyetjen e një gazetari për këto çështje, Arbën Xhaferi do përgjigje: „Siç mund të shihni, po përpiqem të ruaj një distancë ndaj këtij konfuzuoni.”

Për këtë kryengritje dhe paqartësitë e saj, u deklaruan edhe publicistë të huaj, siç janë edhe ato gjermanë, disa nga të cilët mendonin se lufta e UÇK-së, ishte konflikt brenda shqiptarësh, për marrjen e pushtetit. Disa mendonin se ky konflikt lindi si rezultat i mungesës së të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Për të gjitha këto variante të mendimit, për të ardhur deri te e vërteta, Arbni e shpreh mendimin e vet, gjithmonë të bazuar në rezultatet e analizave të të tij.

Ai i sqaron këto dilema një nga një:

- Luftën e nisën njerëz që nuk ishin politikanë as të pozitës e as të opozitë, njerëz të panjohur, që kurrë nuk kishin qenë në pushtet, prandaj bie teza se ky ishte qëllimi i kësaj kryengritje, sepse, mendon Arbni, po të ishte ashtu, këtë konflikt duhej ta nisnin, dy partitë legjitime shqiptare, PPD dhe PDSH
- Koalicionin VMRO-PDSH, nga viti 1998-2001, ai e vlerëson si të suksesshëm në raport me shqiptarët e këtij shteti, madje edhe jashtë vendit. Pjesëtarët e UÇK-së dhe udhëheqësit e tyre, kryengritjen e arsyetonin me situatën e padurueshme për shqiptarët dhe shkeljen brutale të të drejtave kolektive të tyre nga „sllavomaqedonasit”, prandaj ky armik duhej flakur, për t’i mbrojtur trojet shqiptare, dhe për t’i bashkuar ato, motive këto, për të cilat shqiptarët ishin në gjendje edhe të flijonin . Me formimin e partisë së krahut ushtarak, dhe sidomos, hyrja e tyre në Qeveri, ajoi harroi premtimet para popullit, edhe se tani më të gjithë e dinin se kjo kthesë ndodhi , prej kur ky formacion ushtarak ishte ende në mal.
- Është fakt , poashtu se udhëheqësi i kryengritjes Ali Ameti e pati pranuar projektin e Ambasadorit të OSBE-së, diplomatit të shquar amerikan Robert Frouik (Robert Froëick), ku nuk parashiheshin kërkesat politike të organizuesve të konfliktit.
- Është fakt se PDSH-ja filloi me vetiniciativët’i artikulojë motivet e luftës dhe të kërkojë të fillojnë bisedimet politike për ta ndryshuar karakterin etnocentrik të Kushtetutës si dhe të garantohet liria (amnestia) e pjesëmarrësve në këtë konflikt.
- Është fakt se ekziston një antagonizëm programor ndërmjet gjashtë komuniqatave fillestare ku parashikohet bashkim, me deklaratat që jepeshin pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit.

- Është fakt po ashtu se me këtë konflikt u ndërpre procesi i afrimit të Maqedonisë, por edhe të Bullgarisë me faktorin shqiptar.

Arbën Xhaferi, si i zgjedhur legjitim, gjatë kësaj krize pati një bashkëpunim të ngushtë me BE-në, NATO-n dhe SHBA-të, gjithmonë në angazhimin për ndërprerjen e konfliktit, që mund të merrte përmasa katastrofale. Përpjekjet e tij në këtë drejtim patën sukses me Marrëveshjen e Ohrit, që përveç të tjerëve u nënshkrua nga ai e jo nga Ali Ahmeti, për arsye se në atë kohë, faktori ndërkombëtarë nuk shprehte gatishmëri të bisedojë me kreun e kësaj kryengritje, që tani më e kishte humbur këtë atribut sepse e kishte „ulur pazarin”. Këtë më së miri e dëshmon reagimi i ashpër i Javier Solanos ndaj Xhaferit, kur ky i fundit kishte kërkuar që në negociata të përfshihet edhe Ali Ahmeti. Imazhi i keq i ndërkombëtarëve për UÇK-në, ndryshoi, falë politikës racionale të Arbnit me ndërkombëtarët, edhe pse në shumë raste ai akuzohej nga ato për qëndrimet lojale ndaj këtij formacioni ushtarak. Dihet se këto acarime u ashpërsuan më tepër pas Marrëveshjes së Prizrenit, kur nga ndërkombëtarë, atij iu kërkuar ose dorëheqje, nga pozita e kryetarit të Partisë, ose heqje dorë nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Arbn Xhaferi, konstaton se këto dallime në vlerësime të ndryshme, siç edhe fillimi i kësaj lufte, qëndrojnë në atë se vendimi për luftë nuk u mor në institucione legale të kombit, as në pajtueshmëri të krerëve të rëndësishëm shqiptarë. Me gjithë këto të meta të fillimit të kryengritjes së armatosur, Arben Xhaferi, nuk lejoi që të thellohet hendeku mes shqiptarëve, falë pjekurisë së tij politike, që ta përkrahë dhe legjitimojë atë luftë para faktorit ndërkombëtarë, duke i harmonizuar edhe raportet brenda shqiptarëve, pavarësisht qëndrimeve të tyre të ndryshme politike për këtë luftë. Natyrisht, ne nuk kishim mundësi që institucionalisht ta përgatisim luftën, shprehej ai, por e spikas këtë çështje të vendim-marrjes për luftë, jo për të fajësuar dikë, por thjesht përpiqem objektivisht ta shpjegoj befasinë¹⁰⁹. Me gjithë këto dilema, Arbni ishte ai që në emër të mosetikimit në patriotë e tradhëtarë, mori mbi vehte tërë barrën e luftës dhe jorastësisht, në periudhën pas Marrëveshjes së Prizrenit, kur iu vunë tërë ndërkombëtarët që të diastancohet, ai u përgjigj: „Nuk keni të drejtë të kërkonin nga ne që të pajtohemi me maqedonasit dhe të armiqësohemi me shqiptarët”. Kjo ishte ajo thënia që shumë shpejt ua mbylli gojën tërë atyre që mendonin se Arbni me partinë e tij, meqë ishin në

¹⁰⁹ Revista „Koha”, Prishtinë 23.12.2001

pushtet, nuk do e prish komoditetin e vet dhe të partisë së tij dhe se nuk do e përkrahë luftën. Pas këtij konflikti të armatosur, Arbni dhe partia që e udhëhiqte, për dallim nga klima e elektrizuar mes shqiptarëve, në periudhën e pasluftës në Kosovë, nuk vendosi raporte kundërshtuese me luftën, me luftëtarët dhe udhëheqësit e saj, por përskundrazi, u bënë argatë të luftës dhe artikuluese e motiveve, që e nxitën ate. Ai me këtë rast dhe në momente delikate, kur shumë shpejt mund të etiketohesh si tradhëtar, e ruajti imazhin pozitiv që e kishte ndërtuar, që në kohën kur iu kthye Tetovës për t' marrë më politikë të drejtperdrejtë. Për rolin konstruktiv të tij, për luftën, kur ajo po ndizej, flasin vazhdimisht dokumentat, imtivistat, bisedat me faktorin ndërkombëtarë e vendor, por pa hequr dorë nga ideja se ky konflikt ushtarak, ishte reflektim i pakënaqësisë shqiptarëve me politikën e pushteteve maqedonase, edhe pse ai nuk lë pa i përmendur të arriturat e partisë së tij, si rezultat i një marrëveshjeje afatgjate me Gjeorgjievskin si partnerë koalicioni. Arbni në të gjitha paraqitjet publike të tij, lidhur me konfliktin e armatosur në Maqedoni, nuk heziton ta shpreh shqetësimin e tij. Për fillimet e shpërthimit të kësaj lufte, ai është i sqartë dhe as që e imagjinon vehten edhe si lider i luftës, njëkohësisht. Ai shumë herë e pat thënë se kjo luftë plasi pa e ditur faktorët relevantë legjitim shqiptarë, e as ai dhe partia të cilën e udhëhiqte, edhe pse këta faktorë gjatë kohës së luftës së Kosovës, bënë hulumtime e analiza, se mos po përhapet zjarri i konfliktit edhe në Maqedoni. Nga këto deklarata të Arbnit kuptojmë se i gjithë faktori i bashkuar shqiptarë, atë kohë megjithate e përjashtonin mundësinë e shpërthimit të luftes në Maqedoni, duke e konsideruar si prishje të imazhit të shqiptarëve para faktorit ndërkombëtarë, edhe ashtu të dyshimtë nga të huajt si element turbullues në Ballkan. Në kuadër të klasës legjitime, do shprehej Arbni, nuk ekzistonte dijenia dhe përkrahja për një krizë të re, por ja që ajo shpërtheu dhe duhej çdo ditë të merreshin qëndrime, të artikuloreshin motive dhe të menaxhohej situata në përgjithësi.¹¹⁰ Me artikulimin e motiveve, siç shprehet ai, duhet nënkuptuar arsyeshmërinë e shpërthimit të luftës, në mungesë të deklaratave për këtë arsye, përmes komunikatave që e kundërshtonin njëra tjetrën. Meqë Arben Xhaferi ishte i vetëdijshëm se me të këtilla deklarata konfuze dhe jo bindëse për faktorin e huaj, dhe në interes unitetit brenda per brenda shqiptar, e mori për sipër barrën, jo edhe aq të lehtë, që në një farë

¹¹⁰ Gazeta „Fakti“, Shkup 23.12.2002

mënyre të kryejë detyrën e një ndërmjetësi mes luftës e paqjes, me të vetmin qëllim që luftës t'i japë legjitimitet para faktorit të jashtëm, pavarësisht se me qëndrjet e këtilla për luftën, i ngriu marrëdhëniet bashkëqeverisëse me liderin e VMRO-DPMNE-së, Kryetarin e Qeverisë, Lubço Gjeorgjievski dhe e ndërpreu veprimin politik në Qeverinë e Maqedonisë, deri në momentin kur u formua Qeveria e zgjeruar, kur në atë koalicion hyri edhe PPD.

Këtë pozitë jo të lakmueshme të tij si lider i një partie, të cilin lufta e gjeti në qeverinë, që ishte në luftë me UÇK-në, Arbën Xhaferi e paraqet përmes shprehjes frazeologjike shqiptare „hip se t'vrava, zbrit se t'vrava”, thënie kjo që realisht i përgjigjej pozitës tejte të vështirë, jo se nuk donte ta arsyetojë luftën dhe rebelimin e shqiptarëve, por i duhej të mendojë për mënyrën më të mirë të veprimit, që t'i bindë edhe ndërkombëtarët edhe kreun e konfliktit, por edhe udhëheqjen e dy partive më të mëdha maqedonase se pa arritjen e një konsenzusi afatgjatë mes dy komuniteteve më të mëdha, shqiptarëve dhe maqedonasve, ky shtet, nuk do ketë ardhmëri. Duke u gjendur në këtë pozitë, ai hoqi dorë nga veprimet politike të deriatëhershme, kur edhe u shënuan arritjet në avansimin e të drejtave, për të menduar për një takim me udhëheqësin e krahut luftarak të shqiptarëve, që për qëllim do kishte koordinimin e mëtejshëm të faktorit politik dhe dhe atij të rezistencës së armatosur. Për këtë hap, ai ishte i vetëdijshëm se fillimisht do i acaronte marrëdhëniet, jo vetëm me faktorin politik maqedonas, por edhe me atë ndërkombëtar. Arbni vepronte për qëllime afatgjate, i vetëdijshëm se do akuzohet, por edhe i bindur se për momentin prioritet duhej dhënë Ali Ahmetit dhe takimit me te, jo për ta larë vehten nga „mëkatet”, që mund edhe t'i visheshin, meqë ishte në pushtet, por për ti dhënë shans paqjes dhe njëherit t'i bindë faktorët ndërkombëtarë se ai formacion ushtarak nuk është grup terroristësh, të ardhur nga Kosova për ta destabilizuar Maqedoninë. Plani i Arbën Xhaferit u realizua sipas projektit të menduar mirë dhe të dobishëm për faktorin e luftës, atë ndërkombëtarë dhe për paqen e përhershme të vet Maqedonisë, si shtet i përbashkët i maqedonasve, shqiptarëve dhe i të gjithë të tjerëve. Me këto veprime të pjekura politikisht, me peshë edhe diplomatike, ai i rrënoi skemat nga qarqe antishqiptare se kinse shqiptarët janë ato që për qëllim kanë dhunën dhe shkatërrimin, ndërsa të tjerët qenkan viktimë e pafajshme. Këtu edhe qëndron zhdërvjelltësia politike e Arbën Xhaferit, që reflekton gjithanshëm, e që për disa edhe sot nuk është e qartë. Me një politikë të këtyllë syçelë, që synim kishte transparencën,

korrektësinë dhe mençurinë, dhithsesi sukcesi nuk do mungojë. Kjo mënyrë e të bërit politikë edhe në kohëra turbullirash e dilemash të mëdha, është karakteristikë e njerëzve me kapacitete, para së gjithash intelektuale, me përmasë edhe politike e diplomatike. Aben Xhaferi dhe PDSH, e fituan këtë betejë, ngaqë arritën t'i mposhtin tezat për një karakter terrorist të luftës, duke e afirmuar karakterin nacional çlirimtar.¹¹¹

I tërë ky angazhim serioz i liderit politik Xhaferi, doli i suksesshëm, sepse kësaj skeme iu bashkangjit edhe Ali Ahmeti, i cili pas luftës, filloi ta luajë rolin e një personaliteti të moderuar i cili kishte forcë t'i qetësojë shqiptarët, duke thënë se duhet të jemi të gjithë pragmatikë dhe të durueshëm".¹¹² Sipas Xhaferit, dalja nga dimensionimi i luftës njëherë e përgjithmonë është e mundshme vetëm atëherë kur maqedonasit do e pranojnë fajsinë për qëndrimin e tyre armiqësor ndaj shqiptarëve, prej se ekziston Jugosllavija socialiste, Maqedonia si republikë e saj dhe kjo e kohës së pavarësisë. Koncepti i tij për ardhmërinë e sigurtë të Maqedonisë, është pikërisht pajtimi i dy popujve më të mëdhenj të këtij shteti, që gjithsesi shansin më të volitshëm e ka pas konfliktit të armatosur. Meqë maqedonasit dhe elita politike e tyre në këtë kohë, nuk kishin sens për ta kuptuar rebelimin e shqiptarëve si reflektim të arrogancës së politikave të tyre antishqiptare, e kishin vështirë të pajtohen me realitetin, që në tryezën e Marrëveshjes së Ohrit të ulen bashkë me Ali Ahmetin. Arbni i vetëdijshëm për këtë refuzim nga politikanët nervozë maqedonas, këtë gjë e kërkonte nga ndërkombëtarët, të cilët gjithashtu e refuzonin. Kjo politikë postkonfliktuale e Arbnit që arriti ta legjitimojë luftën dhe t'i inkurajojë palët se megjithatë ai është me to, për të vazhduar betejën politike, u kuptua si e drejtë nga një pjesë e madhe e shqiptarëve, përveç skeptikëve që tentonin të mohojnë çdo përpjekje politike të partive legjitime siç ishte ajo e PDSH-së dhe PPD-së. E tërë kjo paqartësi, u kuptua drejtë, pas takimit të Prizrenit, kur me veprime konkrete para botës, liderët legjitim të politikës shqiptare të Maqedonisë, të ndihmuar edhe nga personalitete me ndikim në politikën e Kosovës, u takuan me liderin e krahut të luftës, Ali Ametin. Takimit të Prizrenit dhe marrëveshjes që u arrit atje, i parapriu një takim tjetër i Arben Xhaferit me Ali Ahmetin, që u organizua në Tiranë me ndihmën e personaliteteve me peshë politike dhe zyrtarëve të lartë të shtetit. Sipas rrëfimit të Arbnit në një intervistë dhënë

¹¹¹ Gazeta Fakti, Shkup 23.12.2002

¹¹² Enver Robelli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Tetovë 2011, f.136

gazetës „Fakti”, të datës 23.12.2002, ai i ka dhënë vërejtjet e veta për luftën dhe mënyrën e organizimit të saj, vërejtje këto që ndryshonin nga paraqitjet nëpër media të ndryshme. Ky takim i parë dhe komunikim për së afërmi, krijoi kushte për një takim tjetër me peshë më të madhe, madje historike do thoja, që u mbajt në Prizren.

Për rolin pozitiv të Arbnit dhe ndihmesën e tij për depërtimin e gazetarëve në Maqedoni gjatë kohës së luftës dhe komoditetin e tyre për ta kryer misionin në vend njiçarje, flet edhe gazetari i RTP, Nuhi Bytyçi. Ai takimin me shumë palitikanë e diplomat të huaj në Maqedoni, siç thot në librin e vet, e ka realizuar falë Arben Xhaferit. Përveç kontributit të Arbnit në legjitimimin e UÇK-së, ky autor flet edhe për ndihmesën e tij në lidhje me intervistat që ky televizion me ekipin e vet i ka bërë me shumë autoritete ndërkombëtare më me ndikim, që në atë kohë gjendeshin në Maqedoninë e trazuar. Në pjesën e librit, kushtuar luftës në Maqedoni, për Arben Xhaferin, ndër të tjera Bytyçi shkruan: „ Ai na ka ndihmuar pa asnjë hezitim mua dhe Qaniun për realizimin e disa emisioneve politike dhe për luftën luftën e UÇK-së në Maqedoni. Arbni na ka lidhur me ambasadorin amerikan Laurence Butler në Shkup dhe me përfaqësuesin special të BE-së Alen Le Rua, si dhe diplomatë tjerë në Maqedoni. Në këtë mënyrë na ka ndihmuar t’i realizojmë në mënyrë profesionale emisionet që pasqyronin zhvillimet ushtarake dhe politike në Maqedoni, në vitin 2001. Pa ndihmën e tij, një pjesë e madhe këtyre intervistave me diplomat kryesorë ndërkombëtarë nuk do të mund të realizoheshim. Ai ishte i gatshëm të na mbështeste në çdo kohë. Arbeni ishte politikan modern dhe me ndikim ndërkombëtar. Si Televizion i Kosovës mendoj se e kemi pasur ekranin e hapur për të gjitha zhvillimet në Maqedoni. Kështu që kemi pasur një përparësi në këtë drejtim dhe ekрани i Televizionit të Kosovës ka qënë i hapur për të prezantuar çdo zhvillim në zonat e luftës që kontrolloheshin nga UÇK. Arben Xhaferi na ka ndihmuar për t’i kontaktuar dhe intervistuar ata. Ne kërkuam të realizonim intervistë edhe me ambasadorin amerikan në Shkup, z. Butler. Ai e ka marrë në telefon ambasadorin dhe na ka aranzhuar intervistën, jo në ambasadë por në rezidencën e tij, pasi ka qënë ditë pushimi. Nuk praktikohet që intervistat e tilla të xhirohen në rezidencë private, por Arben Xhaferi kishte

bashkëpunum shumë të mirë me të gjithë diplomatët perëndimorë në Shkup, e ai na e mundësoi këtë. Kemi shkuar dhe kemi realizuar intervistën, jo në ambasadë.¹¹³

2.Marrëveshja e Prizrenit, hap i madh drejt pajtimit

Kudo në botë, konfliktet ushtarake, sado të egra qofshin ato, më në fund përfundonin me ndonjë marrëveshje. Eshtë e vërtetë së Marrëveshja e Ohrit ishte ajo që e ndali luftën, por vështirë se mund të bëhej kjo marrëveshje, në të cilën kishte lehtësues ndërkombëtarë, pa marrëveshjen mes krahut politik shqiptarë dhe atij ushatarak, edhe pse për këtë takim Arbën Xhaferi pati kritika të ashpra nga faktori ndërkombëtar, dhe maqedonas, duke e vlerësuar si tejet negative, ndërsa nga Lubço Gjeorgjieski duke u konsideruar edhe tradhëti. Edhe pse takimi i Prizrenit, që rezultoi me marrëveshje mes shqiptarësh, nuk u prit mirë nga faktori ndërkombëtarë, madje edhe u konsiderua si tejet i dëmshëm për paqën që duhej arritur, për shqiptarët ishte i një rëndësie të veçantë. Me këtë marrëveshje, u zbutën raportet e acaruara mes shqiptarësh të ndarë në krahun e luftës dhe ate politik, duke u kuptuar si një takim historik që edhe zyrtarisht e vërtetoi bashkëpunimin e partive politike legjitime shqiptare me krahun e luftës. Nga ky moment sikur u zbutën raportet disi të acaruara të palëve dhe kualifikimi në „tradhëtarë” dhe „atdhetarë”. Kështu e përshkruan Veton Surri takimin e treshes Xhaferi, Ymeri, Ahmet, të Prizrenit: *Në Prizren, në një fabrikë buke, do të bashkoheshin Arbën Xhaferi, Ali Ahmeti dhe Ymer Ymeri (kryetar i PPD-së), për të nënshkruar Marrëveshjen e Prizrenit, një dokument, në të cilin kisha punuar për të arritur që të unifikohet qëndrimi shqiptar në Maqedoni, parakusht për një proces negociator për t'i dhënë fund luftës e për të siguruar një koncept të ri të shtetit.*¹¹⁴ Kjo ngjarje e legjitimoi më tepër pozitën e Arbnit si kryeiniciator për bashkim të shqiptarëve, aktivitet ky, që bëhej edhe me koordinim e Ali Ahmetit, i cili gjithsesi kishte nevojë për legjitimin e kryengritjes së tij të armatosur, por njëherit edhe për negociata paqësore, që luftën do ia lente historisë. Këto negociata nuk ishin të vështira, ashtu siç ishin edhe të domosdoshme për momentin, por Arbni si palitikan largpamës që ishte, vendimet i merrte pa hezitim, i sigurtë se

¹¹³ Nuhi Bytyçi, Libri i luftës, Prishtinë 2019, f.595

¹¹⁴ Enver Robelli, Në Tetovë, në kërkim të kuptimit, Tetovë 2011,f.20

janë në interes afatgjatë për shqiptarët, por edhe për Maqedoninë, pavarësisht se klasa politike maqedonase „krijonte barriera në konceptin e deriatëhershëm të shtetit”. Reagimet e kundërshtuese të ndërkombëtarëve për këtë hap drejt bashkëpunimit me krahun e luftës, për Arbnin ishin të pritshme për momentin, por ai besonte se qëndrimi i këtillë i tyre do ndryshojë me zhvillimet që do i sjellë koha. Këtë gjakftohtësi të tij, në momente kur faktorin më me ndikim ndërkombëtar e ke kundër, kështu e përshkruan Surroi: *Pas telefonatave alarmi nga Amerika dhe Evropa (Solana ishte shumë i brengosur me këtë gjendje), disa prej të cilave i mora edhe unë, e mora në telefon, për të parë se çka po ndodhte. – Mos u mërzi, më tha. Nesër është ditë tjetër, u dëgjua zëri i tij i butë. Nuk donte të fliste më tej. E imagjinoja të buzëqeshur në veturë, ndërsa kthehej i vetëm me shoferin, me kënaqësinë që kishte ngritur në këmbë diplomacinë amerikane dhe evropiane, duke i sugjeruar vetes pozicion edhe më të mirë negociator.*¹¹⁵

Kështu edhe ndodhi. Nga tërë këto kërcëime që ai ose të largohet nga politika, ose të heq dorë nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Prizrenitë, e zgjodhi variantin e largimit e assesit ta ndërrojë vendimin, që e kishte sjellë me vetëdije të plotë. Qëndrimi i tij i paluhatshëm për çështje madhore dhe me me interes të unitetit të shqiptarëve, e vuri në sprovë tërë faktorin ndërkombëtarë, duke e bindur me politikën e mençur, por edhe me qëndrimin dinjitoz që mbajti në këto çaste të ndjeshme. Zbutja e presioneve nga ndërkombëtarët fillimisht, dhe më pastaj edhe „amnestimi” i plotë i tij, nga „fajet” që i paska bërë, ishte rezultat i vendosmërisë, i vizionit politik dhe i qëllimit të tij, që sa më parë të ndërpritet konflikti, ende pa marrë përmasa katastrofale në njerëz, nga të dyja palët ndërluftuese, dhe të fillojë edhe dialogu. Nëse nuk do bëhej ky takim, ku edhe u nënshkrua një deklaratë e përbashkët e krerëve të dy përfaqësuesve politikë dhe atij ushtarak, kishte gjasa që konflikti të eskalonte edhe brenda vet shqiptarëve. Arbnin ishte i vetëdijshëm se një zënkë sa do e vogël mes shqiptarëve, do ishte tejet e dëmshme për vet shqiptarët dhe do e komplikonte edhe më tepër gjendjen e sigurisë në këtë shtet. Ai gjykonte se nuk duhej përsëritur skemat kosovare, që në vend të bashkëpunimit të thellohet hendeku ndarës, por të zgjidhet rruga integruese brenda shqiptarëve, që ta kenë më lehtë procesin e negociatave, edhe me ndërkombëtarët, por edhe me përfaqësuesit e udhëheqjs së

¹¹⁵ Po aty

partive maqedonase, i vetëdëshëm se kur shqiptarët flasin me një zë, janë më të mençur dhe më të fuqishëm. Tërë këto përpjekje dhe arritja e suksesit me përpilimin e kësaj deklarate, i kthjelloi mendjet e faktorëve të jashtëm, që të mendojnë për takimin e radhës, që u realizua në Konferencën paqësore të Ohrit. Faktori maqedonas edhe më tutje vazhdoi t'i akuzojë pjesëtarët e UÇK-së si terrorist, të ardhur nga Kosova për ta destabilizuar Maqedoninë, përkundër Arbnit, i cili që në shpërthimin e konfliktit, vlerësoi se kjo rezistencë e armatosur i ka rrënjët thellë në padrejtësi, që u janë bërë shqiptarëve, e që u bëhen edhe sot. Edhe deklarata e Prizrenit për to, duhej të shpallet e pavlerë, sepse sipas tyre, e legjitimon dhunën dhe agresionin. Në këtë klimë të ftohtë politike, mes shqiptarëve dhe maqedonasve, Arbni, me gjithë peshën politike, do ndikonte në organizimin sa më të shpejtë të një Konference paqësore me praninë e ndërkombëtarëve, që do njihej si „Marrëveshja Korrnizë e Ohrit”. Ai i ndërmori këto hapa pajtimi, pa u lodhur shumë se si do reagojnë të tjerët, i vetëdëshëm se edhe këto turbullira që po e tronditnin Maqedoninë duhet llogaritur si vazhdim i sindromit jugosllav, e jo si agresion i jashtëm ndaj një shteti sovran, siç ishte Maqedonia, e që mendonte se edhe më tutje do vazhdojë me politikën shtypëse ndaj shqiptarëve, madje duke i reduktuar edhe të drejtat e trashëguara nga ish Jugosllavia.

Marrëveshja e Prizrenit u arrit, përveç vullnetit të palëve, edhe me ndihmën e krerëve udhëheqës të klasës politike të Shqipërisë. Arbni e panon se një ndihmesë të madhe për realizimin e këtij takimi, erdhi nga kryeministri Ilir Meta dhe nga kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi. Ky takim, sipas Arbnit kishte për qëllim që përmes ndarjes së përgjegjësive, të arrihet formësimi i kërkesave politike. Ai e sqaron gjithashtu se zoti Frouik e kishte ndihmuar vetëm procesin që kishte të bëjë me pjesën tekniko-ushtarake, dërsa pjesën e kërkesave politike e hartuan vet shqiptarët, e që ishin: Të ndërpritet lufta; të fillojë procesi i çmilitarizimit dhe të hartohet një platformë politike shqiptare e moderuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Derisa këto kërkesa ishin brenda mundësive reale, në përputhje me normat ndërkombëtare për të drejtat individuale dhe kolektive të një etnie, që duhej llogaritur si krejt normale, meqë me këtë marrëveshje arrihet paqja, ruhet integriteti e uniteti i shtetit dhe kursi properëndimor i Maqedonisë, pala tjetër hudhte gurë duke i konsideruar ato si shkatërrimtare për shtetin që e llogaritnin vetëm si të tyrin. Kjo qasje e Arbnit, që llogarit në arritjen e paqes së

përhershme dhe shansin që ky shtet të ketë ardhmëri të sigurtë, për të gjithë qytetarët e saj, e dëshmon vazhdimisht konceptin e tij për një Maqedoni stabile, prandaj ai nuk ka pse të heq dorë nga një marrëveshje që synon ardhmëri paqësore e në interes të të gjithëve. Edhe pas kundërshtimeve të ashpra nga pala maqedonase, Arbni si iniciatori kryesor i takimit të Prizrenit, i përmbahet parimit politik, që nënkupton se duhet të merren vetëm me çështje objektive, reale, jo gjithaq me përceptime, e këndvështrime të ndryshme që ndërlidhen me mentalitetin ksenofobik që e karakterizon Ballkanin që parapëlqen demonizimin e çështjeve dhe jo t'i kuptojë ato dhe t'i zgjidh përfundimisht.¹¹⁶ Këtë disponim kundër kësaj marrëveshjeje, të palës maqedonase e ngarkonte edhe më tepër loja e rrezikshme në emër të ngritjes së rejtingut partiak të dy partive maqedonase, asaj të LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së, të cilat bënin gara se cila do u japë më pak të drejta shqiptarëve, konstaton Arben Xhaferi. Këto përplasje, ai i konsideron, përveç si mungesë e vullnetit të mirë dhe energjive pozitive për të mirën e shtetit, edhe si mungesë të koncepteve shtetformuese. Të gjitha këto inate, që vinin edhe si rezultat i përfitimeve politike, duke i shfrytëzuar edhe tragjeditë njerëzore, të cilësdo palë, u kptuan edhe nga faktori ndërkombëtar, prandaj ata insistonin që sa më parë të formohet koalicioni i zgjeruar, me spektër të gjerë partish, të cilat do e ndanin përgjegjësinë, por edhe sukseset nëse do arriheshin. Arbni duke i njohur rrethanat e krijuara, kishte vullnet të mirë, që kriza të përfundojë sa më shpejt, prandaj ishte i interesuar që në takime të ndryshme me faktorët relevantë të huaj, siç ishte edhe Javier Solana, të jenë të pranishëm edhe fizikisht përfaqësuesit e UÇK-së, por që për këtë propozim, ata as që donin të dëgjojnë. Edhe pse, përveç dy palëve përfaqësues të partive politike shqiptare dhe krahut të luftës, kuptohet, me praninë e individëve me peshë intelektuale e politike, nga Kosova, faktori i jashtëm dhe pala maqedonase e kundërshtonin këtë mini kuvend të Prizrenit, kjo marrëveshje ishte shumë e rëndësishme edhe për „Marrëveshjen e Ohrit”. Nëse nuk do ndodhnin takimet në vazhdimësi të Arbnit me faktorin ndërkombëtar por edhe me udhëheqësin e guerilës shqiptare, Ali Ahmetin, Marrëveshja e Ohrit, nuk do e kishte peshën që e pati. Me Marrëveshjen e Prizrenit, mendon Arbni, faktori ndërkombëtar, edhe pse fillimisht e kritikoi atë, u bind për seriozitetin politik të shqiptarëve dhe kapacitetin e vullnetit të mirë për pajtim

¹¹⁶ Gazeta „Shekulli”, 05.06.2001)

kombëtar. Arbni, si nënshkrues i kësaj marrëveshjeje, bashkë me Imer Imerin pas takimit të Prizrenit i kishin të harmonizuara qëndrimet me udhëheqjen e UÇK-së, madje edhe gjatë zhvillimeve të Konferencës, ai ishte në kontakt të vazhdueshëm me Ali Ahmetin, i cili ishte i interesuar që kjo Konferencë paqësore të mbarojë sa më shpejt.

3.Kontributi i Arbën Xhaferit për Marrëveshjen e Ohrit dhe vlerësimet e tij të mëvonshme për te

Ashtu si çdo konflikt ushtarak që mbyllet me ndonjë marrëveshje paqësore në tavolinë, edhe konflikti i vitit 2001 mes forcave të armatosura të Maqedonisë dhe UÇK-së, u ndërpre me Konferencën paqësore, të njohur si Marrëveshja e Ohrit. Nuk ka dilema se në takimin e Ohrit, fitorja më e madhe ishte ndërprerja e konfliktit dhe arritja e paqes. Kjo ngjarje e rëndësishme historike, që ndërpreu derdhjen e gjakut në Ballkanin e trazuar, të trashëguar nga Jugosllavia e cila u shpërbë shumë më herët, përveç tjerash do mbahet mend edhe për sa i përket mos zbatimit të saj në jetën praktike. Kjo Marrëveshje që u konsiderua si shumë e suksesshme nga ndërkombëtarët, qysh në fillimet e saj për shqiptarët u mor me rezerva, nga që, ata me këtë dokument do shndërroheshin në përqindje. Për këtë emërtim të shqiptarëve, si duket, kontribuan edhe ndërmjetësit ndërkombëtarë, që në këtë rast u konsideruan vetëm si lehtësues, por me ndikim të fuqishëm në vendimmarrje. Me rastin e dhjetëvjetorit të kësaj marrëveshjeje, ambasadori Xhejms Perdjju, që ishte i pranishëm në Tetovë për ta shënuar këtë jubile, pat deklaruar: *Vera e vitit 2001, ishte një nga ato pikat kritike në histori, në të cilën situata mund të kishte shkuar në këtë ose drejtim tjetër, duke prekur kështu të ardhmen e qindra e mijëra, nëse jo edhe atë të miliona njerëzve. Maqedonia në atë verë ishte e përballuar me një situatë, ku duhej të zgjedhë midis luftës e paqes dhe udhëheqësit e saj zgjodhën paqen. Marrëveshja e Ohrit, sot është një rast klasik për parandalimin e konflikteve dhe unë jam shumë krenar që kam luajtur një rol në arritjen e Marrëveshjes së bashku me homologun tim Evropian, Fransoa Leotar¹¹⁷*. Kur e kemi parasysh se ky vlerësim është dhënë dhjetë vite nga koha e

¹¹⁷ Marrëveshja kornizë e Ohërit, Tetovë 2011, f.21

mbajtjes së konferencës, ndërsa rezultatet lidhur me zbatimin ishin shumë të dobëta, ose mungonin, përveç suksesit se me këtë Marrëveshje u ndal zjarri i luftë, fjalën e zotit Perdju duhet kuptuar vetëm si dedikim i rëndësisë së saj, e jo edhe si vlerësim se sa kjo Marrëveshje ishte zbatuar në jetën praktike. Gjithsesi ai si diplomat që ishte, nuk u ndal te mosuksesi për sa i përket jetësimit, por as që tha ndonjë fjali për suksesin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme, që duhet nënkuptuar se për vonesën aq të madhe të zbatimit të saj, fajtor është faktori i brendshëm, pa i amnestuar politikanët shqiptarë, pjesëmarrës në Qeveri, si faktorë legjitim, të cilët në mungesë të fuqisë politike ose të qëndrimit oportunist të tyre, këtë kontratë politike mes shumë faktorëve relevantë, ku gjithsesi Arbën Xhaferi ishte ndër kryesorët , e lanë nën mëshirën e kohës. Angazhimi i Arbën Xhaferit në organizimin e Konferencës ishte i një rëndësie të veçantë, për disa arsye: Ai si lider i një partie shqiptare, që lufta e gjeti në qeverisje të shtetit ku plasi ajo, kishte përgjegjësi më të madhe se sa pjesa politike e opozitës shqiptare. Ai duke qenë në lidhje të vazhdueshme me udhëheqësinë e UÇK-së, për t'i njohur ato me rrjedhat e punëve të Konferencës, e kishte vështirë gjithashtu të ngulë këmbë për t'i kundërshtuar disa nene që nuk ishin reale dhe në interes të shqiptarëve. Kërkesat e tij dhe të përfaqësuesve tjerë shqiptarë, nuk mund të ishin mbi ata të krahut të luftës, të cilët ishin shumë të interesuar që konflikti i armatosur të ndërpritet sa më parë, dhe mos të pengohet, sipas tyre „për gjëra të imta”.

Me rastin e dhjetëvjetorit të Marrëveshjes së Ohrit, u mbajtën një sërë takimesh shkencore, ku përmes analizave shkencore u diskutua edhe për korelacionin e implementimit të kërkesave të kësaj marrëveshjeje të rëndësishme , si filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik. Nga punimet shkencore të shumë profesorëve universitarë dhe studiues e specialistë të fushave adekuate, për këtë ngjarje të rëndësishme, u konstatua rëndësia e saj, me theks të posaçëm në vonesën për implementim, arsyet e kësaj vonese dhe humbjen nga pesha e saj, që gjithsesi e dëmton këtë ngjarje historike që e ndali konfliktin duke i dhënë përparësi pages. Prof. Blerim Reka në punimin „ Marrëveshja Korrnizë e Ohrit-filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik”, konstaton se me këtë vonesë dhjetë vjeçare , përvrç tjerash mbetën pa realizuar katër pikat më të rëndësishme që ishin edhe esenca e kesaj marrëveshjeje, që janë: *mosimplementimi përfaqësues, mosimplementimi zyrtar gjuhësor, mosimplementimi i*

ndërtimit të besimit dhe mosimplementimi buxhetor. Përveç këtyre konstatimeve të tij, ai e jep edhe një vërejtje serioze edhe për pjesën e të ashtuquajturit *çelës 20%*. Me këtë përkufizim, sipas tij, ky dokument filozofiko-politik u reduktua në një ushtrimore statistikore të numërimit permanent etnik¹¹⁸.

Profesori Hasan Jashari, në hulumtimin e vet, lidhur me opinionin publik për Marrëveshjen e Ohrit, përveç qasjes teorike që ka të bëjë me *mënyrën e hulumtimit, qëllimet e hulumtimit, lëndën e hulumtimit, hipotezat, klasifikimin e të të dhënave të hulumtimit, rëndësinë e hulumtimit, pyetësorin anketues*, etj, konstaton se kjo marrëveshje ishte bazament i ndërprerjes së konfliktit të armatosur. Jemi të vetëdishëm, vazhdon ai më tutje, se ka mjaftë dilema, mjaftë paqartësi, mjaftë tërheqje të litarit, të dhënies apo marrjes, por gjithsesi ne duhet të kemi njohuri që qarta lidhur me atë që ndodh rreth nesh.¹¹⁹

Në mesin shumë analistëve, gazetarëve dhe personaliteteve tjerë me peshë në politikë e publicistikë, që e vlerësuan lartë kontributin e Arben Xhaferit në Marrëveshjen e Ohrit, është edhe gazetari njohur i Radio televizionit të Prishtinës e më vonë Radio televizionit të Kosovës, Nuhi Bytyçi, i cili përveç raportimeve nga betejat e luftës së UÇK-së në Kosovë, këtë profesion e ushtroi edhe në Luftën e Luginës së Preshevës, edhe në atë të Mqedonisë. Ky gazetar në mënyrë të veçantë e përmend kontributin e Arbnit, ndihmën dhe përkrahjen e tij për gazetarët dhe tërë ekipin e këtij televizioni gjatë konfliktit të 2001-shit, për të depërtuar në zonat e luftës. Ai në veprën e vet publicistike, „Libri i luftës”, flet edhe për kontributin e tij në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit. Në këtë vepër voluminoze publicistike, kur flet për Marrëveshjen e Ohrit, ndër të tjera thekson: „Arben Xhaferi si lider i PDSH-së, ka luajtur rol të rëndësishëm në proceset politike që ndodhnin në atë periudhë, deri në arritjen e marrëveshjes Pqësore në Ohër. Në këtë drejtim konsidëroj se ai dhe bashkëpunëtorët e tij kanë luajtur rol të rëndësishëm për bashkimin e faktorit shqiptar”¹²⁰

¹¹⁸ Blerim Reka, Marrëveshja Korrnizë e Ohrit, filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik, 10 vite Marrëveshja Korrnizë e Ohrit, Tetovë 2011, f.13

¹¹⁹ Hasan Jashari me bashkautorë, Hulumtimi i opinionit publik për MKO-në, 10 vite të Marrëveshjes Korrnizë të Ohrit, Tetovë 20011, f.269

¹²⁰ Nuhi Bytyçi, Libri i Luftës, Prishtinë 2019, f.597

Që nga arritja e Marrëveshjes Korrnizë të Ohrit, që megjithatë i përcaktua brenda një korrnizë, me pamundësi të dilet prej saj, Arbni ka dhënë vlerësime në vazhdimësi, duke e përcjellë ecurinë që kishte të bëjë me jetësimin e saj në jetën praktike. Ai është shumë korrekt kur tregon për angazhimin e tij që shqiptarët të fitojnë më shumë, ashtu siç rrëfen edhe për pengesat që vinin në të katër anët, duke filluar nga ndërkombëtarët, të cilët e ndihmuan procesin, por njëherësh më tepër lëshonin pe për kërkesat e palës maqedonase, duke respektuar sidomos qëndrimet e Kryetarit Trajkoski, por edhe të tjerëve. Për qëndrimet e përfaqësuesve maqedonas, që vazhdimisht ankoreshin se me këtë Marrëveshje, ata do ta humbin shtetin, duke e ndarë atë me shqiptarët, Arben Xhaferi i ka vlerësimet e veta, të bazuara në një realitet tjetërfare, nga ai i paraluftës, që e solli koha. Udhëheqësit e politikës maqedonase, si ato të pozitës, ashtu edhe ato të opozitës, shprehet ai, vajtonin nëpër mediat e tyre se po humbin gjithëçka, ndërsa disa analistë shqiptarë, duke u angazhuar që ta japin mendimin e vet për këtë Konferencë, shpeshherë, në ndonjëfarë mënyre, binin pre e këtyre manipulimeve, kinse me të vërtetë maqedonasit janë duke humbur ndërsa shqiptarët fitojnë në dëm të tyre. Duke analizuar rrjedhat e zhvillimit të asaj që ndodhi në Ohër, Arbni në një rast shprehet se me politikën e palës shqiptare, u demaskua edhe dyfytërsia e politikës së përfaqësuesve maqedonas, të cilët ngjashëm me ata të sërbevë të Kosovës, e akuzonin faktorin ndërkombëtar se ata i favorizonin shqiptarët. Sipas strategjisë maqedonase, fajsia u mbetej edhe ndërkombëtarëve, me qëllim që ta kenë më lehtë për t'i zbehur kërkesat e shqiptarëve, ose ato të drejta që dalin nga „Ohri”, të bëhen të perealizueshme, gjë që edhe pati sukses, kur e kemi parasysh vonesën aq të madhe të jetësimin të Marrëveshjes. Në frymën e kësaj, Arbni mendon se pozicionet e shqiptarëve ishin më në favor të arritjes së paqes, se sa pala maqedonase, prandaj ata punonin vazhdimisht që të prodhonin teoritë e konspiracionit për fajsinë e faktorit ndërkombëtar. Gjithsesi këto akuza të përfaqësuesve maqedonas, kundër shqiptarëve dhe deridiku edhe kundër faktorit ndërkombëtar, për pozitën gjoja të palakmueshme të maqedonasve, pas kësaj marrëveshjeje, e ngadalësuan realizimin e saj, madje deri në masë pezullimi. Marrëveshja e Ohrit ishte proces i vështirë sipas Xhaferit, sepse obstrukcionet nga elementë nacionalistë, në vazhdimësi e pengonin këtë proces, duke fituar në kohë, që sa më tepër ta deskreditojnë palën shqiptare. Gjatë këtij procesi, u trilluan lloj lloj aktiviteteve për gjoja stërvitjen e shqiptarëve në Shqipëri, për ta bindur faktorin ndërkombëtar

se ata as që mendojnë për paqe. Një gjë e këtillë u pa para syve të publikut në Ohër, kur Arbni para gazetarëve filloi të flasë shqip, ndërsa Kryeministri Gjeorgievski dhe kryetari i shtetit, Trajkovski, reagueshan ashpër, madje Kryetari Shtetit, u shpreh se me këto (duke aluduar në Arbenin) nuk mund të arrihet asnjëfarë kompromisi për marrëveshje. Siç shihet përpjekjet e arritjes së paqes ishin të vështira dhe plot me ndërkëmbëza për t'u penguar kjo nismë, ose të zhvillohet sipas dëshirës së palës maqedonase.

Një problem i theksuar në përpjekjet për ta mbyllur me sukses marrëveshjen, sipas Arbnit, ishte edhe amnestia e pjesëtarëve të UÇK-së, tani më e nënshkruar edhe nga Kryetari i Shtetit, por që kontestohet sepse faljen nuk e paska nënshkruar Kryetari i Qeverisë. Të gjitha këto analiza për rrjedhën e procesit të negociatave në Ohër, në praninë e dy lehtësuasve ndërkombëtarë, Arbni i bën një vit më vonë nga koha kur u mbajt Konferenca. Ai detektonte këto hamendje të palës maqedonase, që në fillim dhe prej kohësh ishte pesimist se do jetësohen të gjitha këto pika të marrëveshjes, brenda kohës së paraparë. Të gjitha këto konstatime për mospasje vullnet politik për këtë marrëveshje paqësore, ai i bazoi te këto tentativa të palës maqedonase, që do i paraqesim ashtu, pa ndryshuar asnjë fjalë nga mendimi i tij:

- *Tentativa për organizim të referendumit, ku parlamenti do zëvendësohet me popullin. Populli maqedonas do të vendosë për të drejtat dhe liritë e popullit shqiptar. Ky projekt e përgjithëson konfliktin etnik në Maqedoni dhe gjithsesi do të prodhonte kunder referendumin shqiptar.*
- *Tentativa e dytë synon ta pengojë implementimin e Kësaj Marrëveshje kornizë të Ohrit duke ndryshuar domethënien e amandamenteve të marrëveshjes. Çdo ndryshim sado i vogël e prish koherencën juridike dhe logjike të Marrëveshjes së Ohrit dhe rrjedhimisht hap rrugën për negociata të reja.*
- *Tentativa e tretë ka të bëjë me përpjekjet që të ndërrohet përmbajtja e deklaratës për amnesti.*

- *Tentativa e katërt është prodhimi i konfliktit, qoftë përmes hyrjes së parakohshme, qoftë përmes shkaktimit të incidenteve nga ana e paramilitarëve maqedonas në zonat e ndjeshme të krizës¹²¹.*

Siç vërehet, këto konstatime dhe vlerësime të Arbën Xhaferit, si nënshkrues i Marrëveshjes, flasin qartë se kush është për arritjen e paqes dhe të stabilitetit të shtetit, që duhet të ecë drejt së ardhmes, e kush për haosin, vazhdimin e agonisë dhe rikthimin e konfliktit, madje me përmasa shumë më të mëdha. Kjo politikë largpamëse e tij, me kohë ishte kuptuar e drejtë nga ndërkombëtarët, që është në interes të popullatës civile dhe shtetit të Maqedonisë. Të gjitha pikat që i radhit ai, janë në kundërshtim me frymën e Marrëveshjes kornizë dhe me qëndrimet e ndërkombëtarëve, të cilët, megjithatë bënë lëshime në dëm të shqiptarëve. Këto obstrukcione, sipas tij, më tepër vinin nga partia me ideologji majtiste maqedonase e Cërvenkovskit, i cili duke qenë i pakënaqur me këtë kornizë orientuese, i injoronte vazhdimisht qëndrimet që do bëheshin pjesë e Marrëveshjes, duke kërkuar të nënshkruhen marrëveshje tjera ndëretnike, duke qenë i sigurtë se do gjejnë mënyra se si ta pengojnë zbatimin real të saj. Qëndrimin jo korrekt të palës maqedonase ndaj ndërkombëtarëve të pranishëm në këtë proces paqësor, Xhaferi kur po i jepte intervistë gazetarit të „Shekullit”, e krahasoi me kuptimin e kësaj shprehjeje frazeologjike: „pështyhet dora që të ofroi shpëtimin”, edhe pse nga kjo marrëveshje më së tepërmi fituan maqedonasit dhe shteti i Maqedonisë, për liderin e PDSH-së, më e rëndësishmja është pajtimi mes shqiptarëve dhe maqedonasve, sepse pa marrëveshje konsesuale mes dy popujve më të mëdhenj, kuptohet, në frymën e rrethanave të reja, të krijuara pas ndërprerjes së luftës, ligjet nuk mund të kenë efekt pozitiv. Këtë qëndrim të tijin ai e shpjegon sipas parimit, se ligji e ngushton rrethin për veprim, të kufizon, ndërsa marrëveshjet e arritura në bazë të parimeve, dhe respektimit të ndërsjellë, janë afatgjate por edhe fleksibile. Këtu edhe qëndron parimi i tij për zgjidhje konsesuale, që ndryshon nga shumë të tjerë të cilët mendojnë se konsenzusi mund të arrihet nën diktatin e trysnisë. Mendimet politike, diplomatike, madje edhe ato filozofike të Arbnit, ndërtohen mbi këto parime, e jo mbi deklarata që janë në shërbim të politikave ditore. Përmes këtij vizioni, ai e shihte edhe ardhmërinë e Maqedonisë dhe

¹²¹Arben Xhaferi, Tetovë, Gazeta „Shekulli”, 16 .08 2002, Pse ngec implementimi i marrëveshjes së Ohrit

të qytetarëve të saj, e jo përmes shtrëngesash e ligjesh që, do interpretoheshin sipas kutit të shumicës maqedonase.

Gjatë punimeve të grupeve punuese që do shpënin drejt një marrëveshjeje afatgjatë, Arbni nuhaste boshllëqet e krijuara me qëllim manipulimi gjatë jetësimit të ligjeve të dala nga kjo marrëveshje, prandaj këmbëngulte në zgjidhje konsesuale edhe në nivel të bashkëbiseduesve të Marrëveshjes së Ohrit. Ai kur flet për këtë marrëveshje, i ka parasysh edhe ngjarjet aktuale ndërkombëtare, siç është kriza në Afganistan dhe sulmet terroriste të 11 Shtatorit në SHBA., duke zbuluar edhe dëshirën e palës maqedonase që ndërkombëtarët të heqin dorë nga ky problem ndëretnik në Maqedoni, që t'i kenë duartë e lira për të vendosur vetë, sepse sipas tyre faktori ndërkombëtar i favorizua shqiptarët.

Arbni gjatë deklaratave të ndryshme në vlerësimet për Marrëveshjen e Ohrit, dhe të arriturat e partisë së tij, e theksonte në vazhdimësi se gjatë mandatit të tij pati punë me dy luftra, atë të Kosovës dhe të Maqedonisë, por megjithatë partia të cilën e udhëhiqte, veprimin politik e bazonte në platformën programore, nga e cila në masë të madhe ngjasonte edhe kjo marrëveshje. Kjo ngjarje që me ndihmën e faktorit ndërkombëtar dhe faktorit politik shqiptar, me pëlqimin edhe të krahut të luftës, e ndali gjakderdhjen e mëtejshme, por nuk i dha rezultatet e parashikuara e të planifikuara, nga që faktori maqedonas mendonte se implementimi i pikave programore në mënyrë të përpiktë dhe në afate të caktuara mund të ishte katasrofale për Maqedoninë. Nëse Arbni kur flet për fillimet, procesin e punëve gjatë kësaj Konferencë paqësore dhe fillimet e aktiviteteve pas Marrëveshjes, me gjithë elementin obstruktiv që e vërente te pala maqedonase, fliste për një angazhim serioz të përfaqësuesve të dy partive shqiptare, të cilat, edhe pse me shumë vështirësi, i harmonizonin qëndrimet me faktorin ndërkombëtar. Pas kalimit të këtyre fazave, përgjegjës për mosrealizimin e Marrëveshjes, krahas forcave politike qeverisëse maqedonase, e fajsonte edhe partinë shqiptare, si pjesë përbërëse të saj. Shumë vite më vonë, në intervistat e ndryshme, pyetjes së gazetarëve se çka mendon për Marrëveshjen e Ohrit, si nënshkrues që ishte, ai mendon se maqedonasit e lëshuan një shans të volitshëm për të ndërtuar një shtet stabil, dhe me ardhmëri të sigurtë evropiane. Refuzimi i vazhdueshëm i kësaj marrëveshjeje, që nga momenti i nënshkrimit, për fat të keq vazhdoi deri në ditët e sotme, prandaj shikuar dhjetë vite më vonë, vlera e vetme e asaj marrëveshjeje, mbeti ndërprerja e

konfliktit të armatosur. Interpretimet dhe leximet e këtij dokumenti ishin nga më të ndryshmet, nga ato që kjo marrëveshje, maqedonasve u mori çdo gjë, ndërsa shqiptarëve lu dha më tepër se sa u takon, e deri te mendimet se kjo Marrëveshje, duhet shpallur e vdekur.

Arbër Xhaferi, ashtu siç ishte i angazhuar gjatë Konferencës së Ohrit, ku edhe u arrit marrëveshja, ai vazhdoi t'i ndjekë zhvillimet e metejshme, që kishin të bëjnë më realizimin e kësaj saj. Në pesëvjetorin e kësaj ngjarje me peshë të madhe dhe jetike për Maqedoninë, kur ende mendohej se punët do shkojnë mirë, edhe pse kishte sinjale se vonohet realizimi i marrëveshjes, Arbni ende ishte optimist se në Ohër u arrit sukses i madh, që nuk duhet nënçmuar. Në këtë jubile, ai edhe pse nuk ka ndonjë vërejtje serioze për mosimplementim, flet për ndërkëmbëzat tinëzare të Qeverisë dhe mehanizmat e saj me disponim kundër jetësimit, edhe pse në Ohër e nënshkruajtën këtë dokument. Këtë dilemë ai e bazon në konstatimin se pas vitit 2001, te maqedonasit ishin „shtuar ndjenjat ksenofobike dhe se duhet me kujdes t'i qasemi procesit të ndryshimit të mentalitetit, dhe të gjithë së bashku të veprojmë në krijimin e mirëbesimit të ndërsjellë”.¹²² i vetëdëshëm për këtë mentalitet të maqedonasve, të cilët tinëzisht mendojnë për ndonjë lloj kakmarrjeje, Arbni si rrugë të sigurtë drejt zhvillimit të shtetit me qytetarë të barabartë, e sheh jetësimin e Marrëveshjes së Ohrit, duke i respektuar ligjet që dalin nga ato, dhe luftën e ashpër kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo Marrëveshje sipas tij, kishte tre dimensione; ndërprerjen e konfliktit të armatosur, përshtatjen e sistemit me karakterin shumetnik dhe shumkonfesional të shtetit dhe atë „ të ndërtimit e të mirëbesimit të ndërsjellë mes komunitetesh, me theks mes dy komunitetesh më të mëdha, siç janë, maqedonasit dhe shqiptarët. Duke e ndjekur në vazhdimësi procesin e zhvillimeve politike, në këtë shtet, ai i hetonte edhe planet për dredhi, të instuioneve shtetërore dhe individëve, të cilët ngadalësimin e realizimit të marrëveshjes, ose mosrealizimin e konsideronin si sukses dhe rritje të rejtingut të tyre politik për zgjedhjet e radhës. „ Çdo kompromis me ngushtimin e të arriturave sipas kësaj marrëveshjeje, përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, përfaqësimi adekuat, përdorimi i plotë i

¹²² Arben Xhaferi, Pesë vjet nga Marrëveshja e Ohrit, Tetovë 2006, botuar në librin, Arbën Xhaferi, Vepra 02, fq 243

mekanizmit të konsensusit, zbatimi i Ligjit për amnesti etj, do t'i trimërojë edhe më shumë nacionalistët maqedonas që kanë humbur sensin e realizimit"¹²³

Dhjetë vite më vonë, kur po humbnin shpresat e shqiptarëve se Marrëveshja e Ohrit mund të realizohet, edhe Arbni flet me një gjuhë pesimizmi se e tërë ajo që u arrit në Ohër, as për së afërmi nuk është realizuar. Ai, tani më, është plotësisht i bindur se më këtë intensitet të zhvillimeve politike, Kryeministri Gruevski, jo që nuk është i interesuar ta përshpejtojë jetësimin e marrëveshjes por ate „e ka shndërruar në floskulë diplomatike, që në mungesë së temave të tjera , përdoret si uratë apo si mallkim”. Pas atë vitesh nga arritja e marrëveshjes, sipas tij gjërat janë të qarta: Marrëveshja nuk po implementohet, sepse tani më edhe faktori ndërkombëtarë, nuk e ka në agjendën e vet, duke menduar se punët duhet të ecin sipas asaj që u morën vesh në Ohër.

Refuzimi për jetësimin e kësaj Marrëveshjeje gjatë periudhës së caktuar kohore, madje edhe shumë vite më vonë, bëhej në mënyrë perfide, duke i keqinterpretuar pikat programore që kanë të bëjnë me zyrtarizimin e gjuhës shqipe, edhe pse në dokumentin e nënshkruar në Ohër, këto çështje qëndronin ndryshe. Ky manipulim bëhej duke e keqpërdor Ligjin shumë më të hershëm për Vetqeverisje lokale, ku në mënyrë shumë të qartë ishte rregulluar përdorimi i gjuhëve në nivel lokal. Për manipulimet e kësaj natyre flet edhe Arbni, kur thot se te drejtën e përdorimit zyrtar në nivel lokal, shqiptarët e kanë gëzuar edhe para Marrëveshjes Korrnizë të Ohrit. Kjo Marrëveshje, mendon ai dhjetë vite më vonë nga koha e nënshkrimit, në vete përmban konfuzion të qëllimshëm, prandaj ndodh shpesh që parimet kushtetuese nuk janë në përputhshmëri me ligjet. Ky fenomen për qëllime mjegullimi të një realiteti ndryshe, për të hap një dimension tjetër psikologjik, kinse kjo Marrëveshje paska qenë e imponuar, prandaj atë vite e penguan implementimin e saj.¹²⁴ Në këtë drejtim, pati edhe manipulime për sa i përket përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, të punësimit të shqiptarëve në Administratën publike, duke publikuar përbindje më të madhe të punësimit të shqiptarëve se sa ishte real numri i punësimit të tyre. Të gjitha këto manipulime bëheshin, për ta penguar realizimin

¹²³ Arben Xhaferi, Korrniza e Marrëveshjes së Ohrit, Tetovë, 10.08. 2010, botuar në librin, Arben Xhaferi, vepra 02, f.307

¹²⁴ Arben Xhaferi, revista „Forum”, 11.08.2011

e Marrëveshjes, që gjoja u arrit nën presionin e faktorit ndërkombëtar. Kur deklaratat e përfaqësuesve të politiës ndërkombëtare nuk përputheshin me ato që e kishin pritur maqedonasit, atëherë ato sulmoheshin brutalisht, gjë që më vonë reflektohej me mos realizim të asaj, për të cilën nënshkruasit u morën vesh. Ndërkombëtarët, pavarësisht nga imputimet, megjithatë dhanë kontribut madhështor në arritjen e paqes, ruajtjes së integritetit territorial të Maqedonisë dhe ofrimit të një kompromisi të ndershëm, do shprehej Arbën Xhaferi në intervistën, dhënë gazetës „Shekulli”, të datës 16.08. 2002.

Pyetjes së gazetarit të revistës „Forum” në gjuhën maqedonase, se si i komenton të arriturat e BDI-së, në mbylljen e disa çështje të hapura , siç janë rastet e Hagës, përdorimit të flamurit dhe shumë kërkesa të shqiptarëve, të përfshira edhe në Marrëveshjen e Ohrit, dhe ç’bëri PDSH në këtë drejtim Arbni do u përgjigjej me radhë:

- *BDI nuk arriti t’i përmbyllë rastet e Hagës, por i hapi ata. Sipas Ligjit të Amnitisë këto çështje ishin të mbyllura, përkundrazi ata pranuan procesuimin e tyre, që më parë ishin përmbyllur ligjerisht, me amnistinë. Ata katër raste, Gjykara ndërkombëtare as formalisht nuk i përfshiu në procedurë gjyqësore.*
- *Ligji për Amnisti i liroi nga faji të gjithë pjesëmarrësit e luftës së vitit 2001. Kjo ishte çështje e mbyllur, sepse ishte njëri ndër kushtet e arritjes së marrëveshjes së paqes.*
- *BDI, në vend të kontestonte çfarëdo procesimi gjyqësor, u pajtua me kontestimet e Ligjit të amnitisë. Për këto arsye, po them se kjo parti, jo që nuk i përmbylli këto çështje, por i hapi edhe ato që ishin të mbyllura.*
- *Në periudhën e kaluar, patëm rastin që të bindemi se pushteti me vetëdije të plotë po i shkel dispozitat ligjore, i modifikon dispozitat kushtetuese që rrjedhin nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, siç është përdorimi zyrtar i gjuhës e i flamurit, të drejta këto, që i takojnë grupit të të drejtave të fituara në Jugosllavinë e përparshmeetj, nuk është zgjidhje për këto probleme, sidomos jo në sisteme demokratike. E vetmja punë që po arrihet të bëhet është blerja e kohës për rejting politik.*

- *Gjatë kohës së konfliktit, PDSH-ja veproi në pajtim me agjendën e saj politike, ndërsa BDI-ja, si derivat i UÇK-së, fillimisht pati diskurs nacionalist, të cilën, pas etablimit gradual, ndërroi radikalisht, saqë nuk njihej më. Mungesa e vizionit dhe e politikës, por edhe e programit, zgjidhet me anë të përvetësimit të Marrëveshjes Korrnizë të Ohrit.*¹²⁵
- Lidhur me Këtë Marrëveshje, të arriturat në interes të shqiptarëve dhe keqinterpretimet nga Qeveria maqedonase, edhe pse aty bënte pjesë edhe partia shqiptare BDI, me qëllim mosrealizimin e saj, vijmë deri te këto përfundime, që bazohen edhe në analizat e shumta të Arnbit, kur fiste për këtë Marrëveshje që sipas tij u arrit me vështirësi të mëdha:
- Marrëveshja e Ohrit e ndërpreu konfliktin e armatosur në baza etnike, duke i dhënë shansin paqes, mirëkuptimit mes etnive në Republikën e Maqedonisë.
- Për këtë Marrëveshje, që u konsiderua edhe si historike, pati vlerësime të ndara në baza etnike. Pala maqedonase, edhe pse e kishte obligim jetësimin e saj brenda afateve të parapara, që njëherit ishte edhe detyrim ligjor, si shumicë që ishte, nuk kishte vullnet politik për jetësimin e kësaj Marrëveshjeje, gjë që e dëshmon edhe mungesa e saj në programet e tyre partiake.
- Të gjithë shqiptarët ishin të interesuar për jetësimin e Marrëveshjes së Ohrit, që doli si rezultat i një Konference, nën mbikqyrjen e faktorit ndërkombëtar, si kërkesë e tyre, dhe e elitës politike të shqiptarëve, në harmonizim me përfaqësuesit e krahut të armatosur.
- Përgjegjsinë më të madhe për mosjetësimin e Marrëveshjes, sipas planit të paraparë, gjithsesi e ka Partia VMRO-DPMNE, e instaluar për rreth 15 vite në Qeverinë e Maqedonisë, pa e amnestuar edhe Partinë shqiptare, BDI-në, si bashkëqeverisëse gjatë kohë me to, që vazhdimisht e udhëhoqi Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes.

¹²⁵Shih te Revista „Forum”, 11.08. 2011, botuar edhe në librin, Arbën Xhaferi, Vepra 05, f. 419, 420, 421

- Për jetësimin me kohë, e të drejtë të Marrëveshjes së Ohrit, ishte e interesuar edhe Bashkësia ndërkombëtare, e cila në Raportet e progresit për Maqedoninë, në mënyrë të vazhdueshme e theksonte se implementimi i plotë i saj , është kyç për rrugën e sigurtë të këtij shteti, drejt UE-së.
- Statistikat flasin për mospërmbushjen e pikës së përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, të shqiptarëve, edhe pas aq shumë vitesh, nga koha e mbajtjes së kësaj Konference paqësore, madje në shumë drejtori, e institucione qeveritare kjo përqindje sillet nga zero deri 5%.
- Mos angazhimi dhe injorimi me elemente edhe të bojkotit, të elitës politike maqedonase për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, shihet edhe te përqindja ende shumë e ulët e shqiptarëve nëpër ministri, drejtori dhe shumë institucioneve tjera që i udhëheqin ato.
- Ligji për vetverisjen lokale dhe ai për financimin e Komunave, si segment shumë i rëndësishëm, ku popullata jo shumicë duhej t'i realizonte të drejtat, edhe sot e kësaj dite mbeti i disfavourshëm për komunat me shumicë shqiptare.

Arben Xhaferi ashtu siç ishte shtylla dhe ideatori i Marrëveshjes së Ohrit, gjithsesi në pajtim me faktorin e brenshën shqiptar, atë ndërkombëtar dhe kreun e UÇK-së, e kishte edhe të drejtën që ta kritikojë zhagjitjen e pafund të jetësimin të saj. Ai, me tërë potencialin politik dhe diplomatik, bashkë me Partinë që e udhëhiqte, e në bashkëpunim edhe me PPD-në, investoi shumë në arritjen e Marrëveshjes, prandaj mosrealizimi i kërkesave të saj për aq shumë vite, e detyroi atë që ta kritikojë ashpër partinë shqiptare në pushtet, për mosangazhim sa duhet në jetësimin e saj, ose për qëndrime oportuniste, që i jepnin krah partnerit maqedonas të koalicionit, në vetëqeverisje, cilidoqoftë ai. Meqë pala maqedonase doli e pakënaqur nga Marrëveshja e Ohrit, çdo vonesë e implementimit të saj, për ta ishte me interes elektoral para çdo cikli zgjedhor. Arben Xhaferi e ndiqte me kujdes këtë lëvizje të ngadalshme, madje herë-herë edhe të ndërprerë të procesit. Për të gjitha këto vërejtje, të mbështetura në argumente të fuqishme, ai shpesh cilësohej si radikal dhe nationalist. Konstatimin e gazetarit të përditshmes „Dnevnik“, se diplomatët evropjanë po habiten gjithnjë e më shumë me ekstremizmin tuaj e të PDSH-së, ai e komenton kështu: *Fare nuk jam i bindur për ndonjë habitje të diplomatëve evropjanë me*

ekstremizmin tim e të PDSH-së. Konsidëroj se ata janë të habitur nga papërgjegjësia e institucioneve maqedone ndaj procesit paqësor dhe nuk po ndjehen mirë për shkak të pafuqisë së tyre që vazhdimisht po tolerojnë sjelljen hakmarrëse e kapricioze të bartësve të caktuar të pushtetit e të institucioneve. Ndoshta edhe unë po reagoj me ngjyra të zumta, por edhe reagimi i tyre, pavarësisht se janë taktike, janë të ngjashme. Moskuptimi i porosive të këtilla e thëllon krizën¹²⁶.

4. Demokracia konsesuale

Demokracia konsesuale, si formë e qeverisjes, ishte synimi parësor i mendimit politik, i Arbën Xhaferit. E tërë veprimtaria politike e tij bazohet në këtë parim, si forma më e mirë e vendosjes në shoqëritë multietnike, i vetëdijshëm se arrtja e konsensusit të mirëfilltë e të plotë, kërkon vullnet të mirë nga dy palët. Pala maqedonase konsensusin e interpreton sipas interesit të vet, duke mos u pajtue asesi që shqiptarët të jenë të barabartë me ta, si rezultat i një pajtimi me rregullat e reja të lojës, që i impononte kjo marrëveshje. Pa këtë mekanizëm, në asnjë shtet të botës me shoqëri shumëetnike, nuk do arrihej barazia, madje as paqja afatgjate, prandaj Arbni duke u nisur nga ky parim, që ishte edhe shtylla kryesore e programit të partisë që e udhëhiqte, këmbëngulte që një shoqëri multietnike, siç është edhe Maqedonia, pa të drejta të barabarta mes etnitetesh, nuk do ketë stabilitet. Pala maqedonase, që vështirë mund të shkëputej, nga e kaluara, konsensusin e kuptonin si e drejtë e shumicës për të vendosur, përmes fuqisë së votës. Meqë vendosja si rezultat pajtimit të plotë të palëve, gati se është e pamundshme, në shumë shtete me demokraci të zhvilluar u vendosën mekanizma, që më të fortit i merret e drejta të vendosë edhe për të tjerët. Meqë pas pavarësisë, Maqedonia mbeti shtet unitar, status ky që u përforcua edhe me Marrëveshjen Korrnizë të Ohrit, sipas Arbnit, ishte më se e nevojshme që vendimmarrja në të gjitha nivelet e shtetit të bëhej me pajtimin e palëve, duke mos cënuar të drejtën e njëri tjetrit. Pa këtë kohezion të brendshëm, sipas tij, në tipin e shoqërive multietnike, siç është edhe Maqedonia, gjithmonë do ketë problem të natyrës etnike. Për t'u arritur paqe e

¹²⁶ Gazeta ditore „Dnevnik“, Shkup, 9.04.2004

qëndrueshme në këto shtete, „të cilat në teorinë politike trajtohen si shoqëri të segmentuara dhe heterogjene, duhet dhënë të drejta të njëjta, gjithë individëve, pa kurrëfarë segregimi”. Nëse etnitetet e ndryshme do i gëzonin të gjitha këto të drejta, nuk do mungonte lojaliteti ndaj shtetit, nuk do manifestoheshin tubime të ndryshme me kërkesa, që edhe mund të radikalizoheshin deri në konflikte të përmasave katastrofale. Një përvojë e këtillë, tani më u dëshmuar me konfliktin e vitit 2001, që për Shtetin e Maqedonisë duhet të shërbejë si mësim, për të ecur drejt zvillimit të brenshëm dhe rrugëtimit për në BE dhe NATO.

Veprimtaria politike, e pa ndarë edhe nga mendimi teorik politik i Arben Xhaferit, bazohet pikërisht në parimin e konsensualitetit, si vlerë universale, që është treguar e suksesshme në shumë shtete me demokraci të mirfilltë. Nëse në shtete si Maqedonia, nuk do respektohet mënyra e vendosjes me pajtueshmëri të plotë, sidomos kur etniteti shumicë nuk i përfill kërkesat e tjetrit, mendon Arbni, nuk përjashtohet edhe mundësia e ndarjes, që gjithsesi është e dhembshme, sidomos kur edhe ndarje, bëhet përmes konfliktit. Ai si njohës jo vetëm i rrethanave brenda për brenda shtetit, por edhe i fenomeneve politike, në rajon , Evropë e më gjerë, ishte edhe vizionar për të tërhequr vërejtjen se çka mund të sjell e nesërmja, nëse një popull i tërë është i injoruar, llogaritet si qytetar i dorës së dytë. Shqiptarët, sipas tij, gjithmonë kanë pasur të drejtë për ta manifestuar pakënaqësinë përmes lëvizjeve të vazhdueshme, siç janë edhe demonstratat e kohës së Jugosllavisë së Titos, e deri te këto të periudhës së demokracisë. Këto pikpamje të tij, ai i mbështet edhe në të kaluarën historike kur konstaton se perandoritë e mëdha e shumë të fuqishme, me gjithë fuqitë perandorake, nuk patën sukses t’u ruajnë përjetshëm sundimin mbi të tjerët. Me shembujt konkret, që i sillte ai, në vazhdimësi paralajmëronte se një shtet që nuk i ka zgjidhur çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e etnitetëve, nuk mund të ketë ardhmëri. Nëse, sipas tij, mund të shpërbëheshin Prandoritë, më të fuqishme në botë, si mund të qëndrojnë shtetet e vogla ,që nuk kanë vullnet politik për të drejtat e të tjerëve. Zgjidhja sipas konceptit të Arbni është shumë e lehtë. Një shtet mund të jetë i qëndrueshëm, vetëm nëse etnitetin e tjetrit që nuk është shumicë, e konsideron, si element etnik e jo si element politik. Ai është kundër konceptit të kombeve politike, koncept ky, që nënkupton përkatësinë etnike sipas emrit të shtetit, duke hequr dorë nga prejardhja etnike. Kësisoj eksperimentesh, që klasa politike maqedonase mundohet , në mënyra të ndryshme e

perfide t'ua imponojë edhe sot shqiptarëve, si duket nuk ka sukses, por kur mungon konsensusi i mirëfilltë, përveç mekanizmit të vendimmarrjes me „Badenter”, me të cilën manipulohet gjithashtu, problemet mbeten dhe çdo „status quo”, vetëm sa e dëmton këtë shtet. Në mungesë të konsensusit të plotë, sipas tij, problemet e kësaj natyre janë të pranishme madje edhe në disa vende të zhvilluara të Evropës. „Kemi argumentuar se Evropa është stabilizuar vetëm kur është arritur sukcesi që kufijntë etnikë, linguistikë, madje edhe ata religjiozë të jenë të përputhshëm me kufijntë politikë. Madje edhe në Evropë, ku nuk ka përputhje të kësaj natyre, krizat vazhdojnë, do deklaronte Xhaferi në Tetovë më datë 28.12.2004, dhënë një gazete, që nuk e ka shënuar emrin.¹²⁷ Po në këtë burim, Arbni mendon se edhe Maqedonia do ballafaqohet në vazhdimësi me problem të kësaj natyre. Ajo s'ka rrugë tjetër, konstaton ai, ose të jetë shtet multietnik, bazuar në konsensus mës etniteteve, ose nuk do ekzistojë fare. Meqë sipas tij rrugë tjetër nuk ka, shqiptarët janë të gatshëm për dy opsionet.

Teoria politike dhe metodologjia e veprimit e Arben Xhferit, mbështetet në qëndrimin e tij të paluhatshtëm në vendosjen e barazisë së plotë, si rezultat zgjidhjes së kontesteve përmes konsensusit. Në bazë të këtyre parimeve, konstatojmë se angazhimi i tij është koherent dhe korrigjues i të gjitha veprimeve politike që janë në dëm të shqiptarëve. Ai krahas politikës së brendshme të udhëhequr nga qeveritë e këtij shteti, është i interesuar edhe për zhvillimet e politikës së jashtme, i vetëdijshëm se pa afirmimin e elementit shqiptar të këtij shteti, edhe përmes politikës së jashtme, vështirë se do dilet nga marginalizimi brendshëm, që për fat të keq, vazhdon edhe pas Marrëveshjes Korrnizë. Shqiptarët në këtë shtet janë një realitet i pamohueshëm dhe „nga ky përcaktim nuk mund të ikin as shqiptarët, as maqedonasit, e as ndërkombëtarët, konstaton Xhaferi. Në këtë qëndrim ai është i paluhatshtëm, prandaj edhe shprehet: „Nëse dikujt nuk do t'i pëlqejë kërkesa e natyrshme për barazi, atëherë mund ta kërkojë divorcin. Edhe kjo është po aq e natyrshme, në mos edhe më shumë se sa bashkëjetesa e padurueshme, thot ai.¹²⁸ Të gjitha këto forma të zgjatjes e të stërzgjatjes negociatave nga pala maqedonase, konstaton ai, ndodhin vetëm atëherë kur bëhet fjalë për të drejtat e shqiptarëve.

¹²⁷ Arben Xhaferi Vepra 04, Prishtinë 2016, Kthimi i kobshëm, f.401

¹²⁸ Arben Xhaferi Vepra 04, Kthimi i kobshëm, Vepra 04, Prishtinë, f.402

Maks Veber, konsensusin e përcaktonte si diçka që ekziston kur parashikimet tona lidhur me sjelljen e të tjerëve janë realiste, sepse të tjerët zakonisht do t'i pranojnë këto parashikime si të vlefshme për veten e tyre dhe pa ndonjë marrëveshje të lidhur shprehimisht, ndërsa Kavanagh-u dhe Moriss-i, konsensusin e përcaktojnë si një sërë parametrash, që përkufizonin një sërë opsionesh politike që politikanët e lartë dhe funksionarët e shtetit, i shikonin administrativisht të zbatueshme, ekonomikisht të mundshme dhe politikisht të pranueshme.¹²⁹ Edhe Arbën Xhaferi kur flet për konsensusin, pikërisht mendon për një pajtim të palëve lidhur me të drejtat e shqiptarëve, që do sillte barazinë me maqedonasit, në administratë, në ekonomi dhe në politikë. Arend Lipjhart konstaton se në shoqëritë pluraliste, të ndara në linja të ashpra etnike, religjioze e kulturore, siç është Maqedonia, duhet inkuadruar demokracia konsensuale, e cila bazohet në ndarjen e pushtetit. Ky lloj demokracie është e vetmja alternativë për dizajnesit e kushtetutës.¹³⁰ Edhe pikëpamjet e Arbën Xhaferit, janë në përpunueshmëri të plotë me këtë mendim të Lipjhart-it, kur angazhohet për një kushtetutë, ku për shumë çështje vendoset me konsensualitet të plotë. Deri tani, mendon Arbën Xhaferi, në Republikën e Maqedonisë rreth një e treta e popullatës, janë të marginalizuar, nga një popull tjetër me kriza të thella vetidentifikimi. Një Maqedoni e këtillë, shprehet ai, jo vetëm që bie ndesh me interesin shqiptar të këtij shteti, por edhe me tendencën historike. Në këtë drejtim Arbni është pesmist se kjo parazi mund të arrihet, madje bishtënimet, e kësaj natyre me qëllim të mosrealizimit të të drejtave të shqiptarëve, ai kishte zbuluar edhe gjatë negociatave të shqiptarëve dhe maqedonasve në Konferencën paqësore të Ohrit.

Përcaktimet politike të Arbër Xhaferit, në Republikën e Maqedonisë janë të qarta, që në fillimet e tij të politikbërjes, edhe pse disa nga pikat e platformës së Partisë së tij, tani më, ishin më të vështira për realizim, meqë ishin bërë ndryshimet kushtetuese, që për fat të keq, jo që nuk i avansoi të drejtat e shqiptarëve, por përkundrazi, shqiptarët i humbën edhe ato të drejta të trashëguara nga Jugosllavia e Titos, të garantuara me Kushtetutën e vitit 1974. Nga kjo kushtetutë, e miratuar pa votën e shqiptarëve në vitin 1991, dolën edhe ligjet konform saj, që e vështirësuan edhe më tepër realizimin e pikave programore të partisë që udhëheqej nga Arbni,

¹²⁹ Etem Aziri, Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Tetovë 2012, f. 140-141

¹³⁰ Arend Lipjhart, "Constitutional designs for divided societies" *Journal of Democracy*, 152 2004

por megjithate, ai vazhdoi të shpresojë se një ditë, nëse ky me partinë vet do e fitojë besimin e shqiptarëve, do e realizojë programën partiake, që për bazë do e kishte zgjidhjen e problemeve përmes rrugës konsesuale që kishin të bëjnë me të drejtat e shqiptarëve. Për një pajtim të këtillë, gjithsesi sipas tij duhet ndërtuar mekanizma që do i pamundësojnë manipulimet e liderëve politikë maqedonas, të cilët konsesualitetin e kishin kuptuar jo si marrëveshje korrekte mes dy popujsh të barabartë, por vetëm si kompromis nëse do pajtohen apo jo shqiptarët me aq apo me kaq të drejta, që duheshka t' japë pala tjetër. Në platformën zgjedhore të viti 1998, thot ai, vazhdojnë të përsëriten disa nga kërkesat e shqiptarëve të vitit 1990. Për këto zgjedhje, lideri PDSH-së, kishte hartuar këto pika të platformës zgjedhore:

- Maqedonia binacionale
- Shqiptarët element konstituent i Maqedonisë
- Demokracia konsesuale
- Mekanizmi konsensual në vendosje
- Institucioni i nënkryetarit shqiptar të shtetit, që do të mbykqyrë funksionimin e drejtë të shtetit mbi baza etnike.
- Institucionet arsimore, informative, kulturore dhe të tjera kombëtare që do jenë bartës të krijimit të vlerave shqiptare në përgjithësi
- Krijimi i institucioneve për zhvillim rajonal¹³¹

Për të gjitha këto kërkesa krejt normale, Arbni mendonte se mund të vendoseshin me konsensus, e për këtë e kishte zgjedhur rrugën e paqës.

Me kërkesën për Maqedoni binacionale, që nënkupton shtetin e dy etniteteve kryesore, maqedonasve dhe shqiptarëve, ku do i gëzonin të gjitha të drejtat edhe pakicat, e këtij shteti, ai mendon për një shtet stabil politikisht dhe të zhvilluar ekonomikisht, ku përfundimisht do zgjidhej çështja shqiptare dhe kontesti i tyre me maqedonasit, të cilët duheshka t'u japin atyre të drejta aq sa duan vet. Me këtë tip shteti, mendon ai, do eliminoheshin të gjitha fërkimet dhe zënkat e vazhdueshme mes këtyre komuniteteve më të mëdha në numër. Me shtetin e këtyre dy grupeve etnike, nuk do rrezikoheshin të drejtat e pakicave, sepse në komunat ku mund të

¹³¹ Arbën Xhaferi, Mbi Demokracinë konsesuale, gazeta „Zëri”, 15 .04 1998.

jenë shumicë, të drejtat e tyre do realizohen sipas Ligjit për Qeverisje lokale, që nënkupton edhe gjuhën e tyre zyrtare në pushtet lokal. Edhe pas Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarët llogariten si pakica, edhe pse fjala „pakicë” nuk përmendet, por gjithsesi nënkuptohet, si për shqiptarët, ashtu edhe për të tjerët. Arbni me kohë i kishte kuptuar manipulimet e palës maqedonase, të cilët vazhdimisht, kërkesat e shqiptarëve, që nga ajo për zyrtarizimin e gjuhës shqipe, tentonin t’i llogarisnin edhe si kërkesa të tjerëve, duke manipuluar me Ligjin për Qeverisje lokale, që të drejtën e përdorimit zyrtar e kanë të garantuar në nivel lokal, kuptohet nëse i takojnë grupit etnik, me mbi 20%.

Me shtetin binacional, që do përbëhej prej maqedonasve dhe shqiptarëve, për të drejtat e shqiptarëve, si popullatë e dytë, as që do ketë nevojë të diskutohet, sepse këto të drejta të barabarta me maqedonasit, do ishin të garantuara me kushtetutë. Modele të këtilla shtetesh ka mjaftë, prandaj një zgjidhje e këtillë, do ishte më mirë edhe për vet maqedonasit dhe Maqedoninë.

Me shqiptarët si element konstitutiv, ai mëtonte t’i barazojë shqiptarët me maqedonasit, sepse të dy popujt do ishin pjesë e preambullës së kushtetutës së shtetit, me tërë historitë dhe angazhimet e tyre që synim e kishin shtetin nacional, e në këtë rast ai shtet do funksiononte si dy nacional. Nëse këta dy popujt do ishin bartës të sovranitetit të shtetit, në masë të madhe do zbuteshin raportet e ftohta mes tyre, sepse në atë rast, kërkesat e shqiptarëve do ishin zgjidhur me kushtetutë dhe nuk do kishte nevojë të bëheshin në vazhdimësi përmes programeve partiake të partive shqiptare, për çdo cikël zgjedhor.

Me demokracinë konsensuale, që sipas konceptit, të zgjidhjes afatëgjatë të problemeve, të cilat vazhdojnë edhe kaq vite pas Marrëveshjes së Ohrit, Arbni llogaritet bazën demokratike për zgjidhjen e problemeve në pajtueshmëri të plotë mes dy popujve, shqiptarëve dhe maqedonasve, e nëse ndodh ky pajtim, për pakicat tjera, do jetë shumë më lehtë. Gjithmonë kur flitej për të drejtat e shqiptarëve, llogaritej për kërkesa të pakicave, gjë që fuste huti te faktori ndërkombëtar, edhe pse 20%- shi i Marrëveshjes së Ohrit, që me pa të drejtë, vlente për shqiptarët. Arbën Xhaferi për kohën e paqes, nëse nuk i llogarisim dy lutërat dhe menaxhimin e tyre, sepse atij dhe partisë që e udhëhiqte i ra hise, pati suksese të dukshme për sa i përket arritjes së konsensusit për zgjidhjen e disa çështjeve, duke filluar nga vet Marrëveshja e Ohrit, ku siç thot

ai, u imponua platforma e PDSH-së, përparësi i jepte parimit të demokracisë konsensuale dhe të përfaqësimit të barabartë të shqiptarëve ne administratën shtetërore.

Institucioni i Nënkyetarit të shtetit gjithashtu do kontribuonte në zbutjen e raporteve acaruese mes Kryetarit, dhe shqiptarëve, edhe pse deri tani, në të gjitha ciklet zgjedhore, faktori shqiptarë ka qenë vendimtar për fituesin. Kjo ide e tij, nuk ishte në kundërshtim me kërkesën e shqiptarëve, që vendi i shefit të shtetit mund të jetë edhe shqiptar. Në tërë ciklet zgjedhore për kryetar shteti, mes dy ose tre kandidatëve, fituesin e ka përcaktuar vota shqiptare, prandaj me një konsensus paraprak mes koalicioneve, mund të arrihet edhe pajtueshmëria që funksioni i Kryetarit dhe Nënkyetarit të shtetit, të bëhen me rotacion. Në këtë mënyrë do pamundësohej edhe injorimi i shqiptarëve nga ky organ i rëndësishëm shtetëror.

Institucionet arsimore, informative, kulturore dhe të tjera kombëtare , që do udhëhiqeshin nga kuadro shqiptarë, do e përmirësonin gjendjen e vështirë të shqiptarëve në këtë drejtim. Sipas konceptit të tij për vendosje me pajtueshmëri të plotë mes shqiptarëve e maqedonasve, që do realizohej nga përfaqësuesit legjitim të këtyre dy komuniteteve, këto institucione shqiptare, që assesi nuk do jenë në dëm të atyre maqedonase, do merreshin me çështjet më të ndjeshme të fushës së kulturës, shkencës, artit etj, me interes për shqiptarët. Nga përvoja e gjertanishme, e veprimtarisë së përbashkët të këtyre fushave me interes nacional konstatonte ai, jemi bindur se këto veprimtari nuk e paraqitnin realizitetin e një shoqërie multietnike, duke i injoruar interesat e shqiptarëve, madje duke e falsifikuar edhe historinë tonë, për të na konsideruar si ardhacakë. Angazhimi i tij për eliminimin e këtij diskriminimi, pati sukses me themelimin e disa institucioneve, me udhëheqës shqiptarë dhe programe të fushave të ndryshme kulturore, shkencore e informative. Për këto të arritura dhe suksese të tij, dhe partisë që e udhëhiqte, u dasht shumë mund, mençuri dhe argument të forta se me këto institucione shqiptare, nuk do humbin asgjë maqedonasit, përkundrazi do fitojë shteti dhe e tërë shoqëria. Gjithsesi pa një konsensus me palën maqedonase përmes përfaqësuesëve të tyre politikë në parlament dhe qeveri nuk do kishin sukses këto të arritura.

Për konceptin e ndërtimit të shtetit dhe të stabilitetit të Maqedonisë mbi baza të vendosjes konsensuale të Arben Xhaferit, mendimin e vet e dhanë shumë analistë e profesorë universitar, të cilët vlerësuan se konsensualiteti për shoqërite multietnike, siç është edhe

Maqedonia e Veriut, është në interes të shtetit, stabilitetit afatgjatë dhe ardhmërisë së sigurtë. Përkundër përcipcionit se ai përmes angazhimit politik, interesohej vetëm për kauzën shqiptare, nga shumë intelektualë dhe specialistë të politikologjisë, u vlerësua si politikan që përmes zbatimit të demokracisë konsensuale të pushtetit, ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve, do forcohej edhe shteti i përbashkët i të gjithëve etniteteve tjera që duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat. Edhe profesoresha universitare e UEJL-it, Mirjana Maleska, në deklaratën dhënë Radio „Dojçe Ëele“, me rastin e ndarjes nga jeta të Arben Xhaferit, pat deklaruar: „Jemi pajtuar me te se si duhet të funksionojë Maqedonia si shtet, që do i përmirësonte marrëdhëniet ndëretnike të qytetarëve të saj. Ai mendonte se modeli i demokracisë konsensuale dhe ndarja e pushtetit mes maqedonasve dhe shqiptarëve, është zgjidhja më e mirë për Maqedoninë. Edhe konflikti që ngjau në këtë shtet përfundoi në frymën e idesë së tij dhe kësoi ai e stabilizoi shtetin, mendon Maleska. Kështu nuk mendon profesoresha e Universitetit „Shën cirili dhe Metodi“, Biljana Bankovska. Ajo konceptin e vendosjes me konsensus për barazi të plotë të shqiptarëve me maqedonasit, si duket, e konsideron më tepër si koncept nacionalist se sa demokrat, kur, po për „Dojçe Ëele“, ndër të tjera thekson se Arbën Xhaferi ishte lider i madh etnik dhe më pak demokrat i madh.

5.Kontributi i Arbën Xhaferit në krijimin e institucioneve të larta arsimore dhe atyre shkencore e kulturore

Arbën Xhaferi përvreç veprimeve të tij të gjithanëshme e të vazhdueshme politike e diplomatike, si kontribut i vazhdueshëm i tij në politikbërje, brenda dhe jashtë vendit, pa iu larguar në asnjë moment kauzës kombëtare, ishte gjithashtu i interesuar edhe për çështje të elementit identitar dhe ruajtjes së vlerave, që e karakterizojnë atë. i vetëdijshëm se pa arsimim dhe edukim në gjuhën amtare në të gjitha nivelet dhe pa institucionet e ndryshme që i ruajnë e kultivojnë këto vlera, nuk mund të kete as edhe komb me të gjitha atributet kombëtare. Ai problematikën e mungesës së këtyre institucioneve arsimore, shkencore e kulturore, për shqiptarët e Maqedonisë e ka trajtuar vazhdimisht, madje edhe para aktivitetit të tij politik, por nga koha e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pavarësisht të Maqedonisë, kur për studentët

shqiptarë të Maqedonisë dhe Universitetit të Prishtinës tani më kishte një kufi, kërkesat e shqiptarëve të këtij shteti për universitet sa vinin e intensifikoheshin. Kjo mungesë e infrastrukturës shkollore universitare, i shtyu shumë intelektualë shqiptarë, të udhëhequr nga Prof. Fadil Sulejmani që fatin e shkollimit në gjuhën shqipe ta marrin në duartë e veta. Kjo nismë serioze dhe këmbëngulëse, në qershor të vitit 1994, u kurorëzua me vendimin e themelimit të Universitetit të Tetovës, i cili vite të tëra punoi dhe veprroi jashtë sistemit të shtetit. Duke pasur një status ë këtyllë, ky universitet, kishte nevojë për njerëzit e politikës shqiptare, që në atë kohë vepronte në kushte të pluralizmit.

Angazhimi i Arbën Xhaferit dhe i partisë që e udhëhiqte, qoftë në pushtet, apo në opozitë, në vazhdimësi e pati përkrahjen për këtë vatër të arsimit të lartë në Maqedoni. Ai shpesh vendimet e rëndësishme për shtetin, që kishin nevojë për votën shqiptare, e kushtëzonte me njohjen e UT-së. Këtë institucion arsimor ai e përkrahu në të gjitha aspektet: politike, diplomatike, organizative, institucionale, jashtinstitucionale, i vetëdijshëm se kjo nismë patjetër të jetësohet e të legalizohet. Në vitin 1996, kur nga themelimi i tij kishin kaluar dy vite pune e sakrifice, Arbën Xhaferi me partinë që e udhëhiqte, në një mbledhje të Këshillit për themelimit të UT-së, mbajtur në zyrat e Forumit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Gostivar, paralajmëroi se kooperimin me sistemin do ta kushtëzojnë me zyrtarizimin e UT-së.¹³² Për këtë projekt, që duhej të legalizohej, ai bashkë me subjektet tjerë, angazhoheshin në aspektin politik, por edhe praktik për mbështetje me resurse njerëzore, si profesorë, anëtarë senati dhe aktivistë tjerë, si pjesë e logjistikës për grumbullimin e mjeteve materiale, që do e mundësonin funksionimin normal të procesit mësimor e hulumtues shkencor. Arbën fliste për UT-në dhe kërkesat për legalizim sa më të shpejtë, krahas angazhimit të tij edhe për përmirësimin e statusit politik të shqiptarëve: Duhet kuptuar se qëllimi i fundit nuk është vetëm UT-ja, por edhe përmirësimi i statusit politik të shqiptarëve, dhe arritja e mekanizmave që do të garantojnë interesin e tyre kombëtar, që do të pengonin tjetërsimin e tij”, do shprehej ai në të njëjtën gazetë. Në intervistën e dhënë në Tetovë më, datë 25.03.1996 për gazetën „Flaka” dhe „Euro Zëri”, arsyetimin e mosshkuarjes në Prilament, ai e arsyeton si reflektim të vrasjes së Abdiselam Eminit dhe burgosjes së disa aktivistëve të

¹³² Arben Xhaferi, gazeta „studenti”, Tetovë 1996, botuar edhe në librin, Arben Xhaferi, vepra 04, f.32

Universitetit të Tetovës. Ngjarjet rreth Universitetit të Tetovës, dhuna që përfundoi me vrasje, rrënimi i objekteve të UT-së, ishin shkak për tetë deputetë shqiptarë t'i dërgojnë një mocion Parlamentit të Maqedonisë, ku kërkohet zyrtarizimi i UT-së, i gjuhës shqipe në Parlament, lirimi i të burgosurve dhe dënimi i fajtorit për vrasjen e Abdilselam Eminit. Deri më tani, shprehet ai, asnjë nga këto kërkesa nuk është përfillur, por përkundrazi këto ditë janë intensifikuar orvatjet për rrënim nga brenda UT-së, vazhdon gjykimi shkallës së dytë për veprimtarët e UT-së.

Angazhimi i Arben Xhaferit që nga akti i themelimit të UT-së, më 17 dhjetor 1994, kur si kryetar partie, ishte ndër të parët nënshkrues të këtij akti, e deri pas zyrtarizimit, kur një periudhë kohore Ministër Arsimit në Qeverinë e Maqedonisë dhe Rektori i UT-së, ishin kuadro të partisë së Arbnit. „Lirisht mund të thuhet se periudha e PDSH-së në qeveri, me Ministrin e Arsimit dhe Rektorin e USHT-së, me kuadro të kësaj partie, është periudha e lulëzimit dhe avancimit të USHT-së në nivelet më të larta universitare, duke i siguruar financa dhe burime të tjera financiare për një zhvillim të hovshëm të UT-së, madje nuk vërehej ndonjë politizim i skajshëm nga ana e PDSH-së, sikur vepronte BDI-ja në periudhën e kaluar.¹³³

Një projekt tjetër shumë i rëndësishëm për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, për të gjithë shqiptarët e rajonit dhe të tjerët, që u realizua me angazhimin e Arbën Xhaferit, falë politikës largpamëse dhe diplomacisë së përkryer të tij, është Universiteti i Evropës Juglindore. Nga ky institucion i shkollimit të lartë me seli në Tetovë, që këto ditë mbushi 18 vjet pune të suksesshme, u diplomuan me mijëra të rinj e të reja, shumica nga të cilët janë të punësuar në vend dhe jashtë. UEJL që u themelua në Tetovë, në një hapësirë prej rreth 25 hektarësh tokë, në pronësi të shtetit, ishte projekt ndërkombëtarë, që kushtoi disa dhjetra milionë dollarësh, si donacione nga Qeveria e Holandës, shtetet tjera të Bashkimit Evropjan dhe SHBA-të. Ky projekt i një institucioni universitar, përpiluar sipas kritereve më bashkëkohore evropjane, që përmes komesarit të lartë, Vander Shtul, iu ofrua shqiptarëve, në kohën kur UT-ja ende nuk u zyrtarizua, ishte i mirëseardhur për shqiptarët e Maqedonisë. Teza se ky projekt u shpik me qëllim që ta pengojë UT-në, nuk mban, sepse ky universitet vazhdoi me veprimtarinë e vet hulumtuese shkencore edhe pas themelimit të UEJL-it, që në popull njihet edhe si „Universiteti i Shtulit“.

¹³³ Milaim Fejziu, Themelimi i Universitetit të Tetovës, hap historik. Tetovë 2017

Arben XHaferi, që edhe ishte më meritori për themelimin e UEJL-it, vazhdoi ta përkrah UT-në, madje sipas ish kryesëtorit të tij, në kohën e PDSH-së në qeveri, kur edhe Rektori dhe Ministri Arsimiti shte nga radhët e partisë së Arbnit, UT-ja e përjetoi lulëzimin më të madh, që nga themelimi. Projekti i UEJL-it dhe jetësimi i tij pikërisht në Tetovë, kishte për qëllim, studimin kultivimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Ky dedikim, që njëherit është edhe arsyeshmëria e hapjes së kësaj vatre të arsimit të lartë, pikërisht për shqiptarët, por pa ua mbyllur dyertë edhe të interesuarve tjerë, nuk ka humbur nga pesha edhe sot e kësaj dite, pas plot 18 viteve pune në veprimtarine hulumtuese shkencore. Ky universitet është model i vetëm në tërë rajonin, madje ndër të rrallët edhe në Evropë për sa përket risive në metodologjitë e mësimdhënies, qasjes së re të mësimdhënies e mësimnxënies dhe kushteve e mjeteve më bashkëkohore, për studime cilësore. Objektet e përshtatshme për realizimin e plan programeve, që mundësojnë lehtësi në realizimin e tyre, infrastruktura elektronike dhe shumë mundësi tjera që shfrytëzojnë studentët dhe profesorët, këtë qendër universitare e bëjnë tërheqës për studentë shqiptarë të mbarë hapësirave dhe të tjerëve që dëshirojnë të studiojnë këtu.

Ky universitet u themelua në vitin 2001, si projekt me karakter ndërkombëtar, që u përkrah fuqimisht nga Arbën Xhaferi, me një profesorat, tani më me përvojë, gjithsesi të ndihmuar edhe nga mësimdhënës ndërkombëtar, vazhdon drejt sukseseve dhe afirmimit në Evropë, SHBA dhe në shumë vende tjera. Për vlerat evropjane të këtij projekti, Arbën Xhaferi do shprehej:

*„Shkuarja në Evropë ka një kosto të madhe shpirtërore dhe sociale. Të gjitha këto mund të evitohen nëse përmbysset kjo rrjedhë, nëse kthehet në anën e kundërtë: Të sillet Evropa te ne. Kjo mrekullli ndodhi në Tetovë me hapjen e Universitetit të Evropës Juglindore. Evropa erdhi në mjedisin tonë me standadet e saja arsimore, arkitektonike, organizative duke krihuar mundësi për seleksionim pozitiv të kuadrit dhe të vlera. Universiteti i Evropës Juglindore na mundësoj që të jemi evropjanë në vendin tonë, na mundësoi të arsimohemi, ta ruajmë dinjitetin, statusin social, ngrohtësinë familjare, t'i kultivojmë vlerat kombëtare dh eta ndryshojmë pak nga pak mjedisin tonë me vullnet të mirë, me dëshirë dhe bindje”.*¹³⁴

¹³⁴ " Arbën Xhaferi, Vepra 02, Prishtinë 2016, f.350

Përveç këtyre dy projekteve madhështore universitare, Arbën Xhaferi me angazhimin e vet politik, por edhe diplomatik, duke bashkëpunuar në vazhdimësi me ndërkombëtarët për hallet e shqiptarëve, arriti t'i realizojë edhe disa projekte tjera me interes për shqiptarët në këtë shtet. Politika e mençur, aq sa edhe këmbëngulëse e tij për të arritur konsensus me partnerët e koalicionit qeveritar. Ai që në fillimet e angazhimit politik këtu në Maqedoninë e Veriut, ishte i interesuar për ngritjen e institucioneve shkencore e kulturore shqiptare, i bindur se vetëm në këtë mënyrë shqiptarët do e kenë më lehtë ta studiojnë historinë, etnologjinë, albanologjinë, folklorin, kulturën etj. Me kohë e demaskoi politikën demagogjike të palës maqedonase se Institucionet maqedonase janë të hapura për të gjithë etnitetet e këtij shteti. Ashtu si të gjithë shqiptarët, edhe partitë politike shqiptare, e kishin kuptuar se pa institucione të pavarura, nuk do mundemi ta njohin vehten, dhe se përmes studiuesve joshqiptarë, në vazhdimësi falsifikohet realiteti ynë. E tërë kjo dëshirë, një ditë duhej të realizohej, por ishte Arbni që dinte më së miri t'i shtrojë këto kërkesa, ishte ideja e tij për themelimin e Institutit të Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore me seli në Shkup. Ky institucion shkencor, që më tepër merret me hulumtime të fushës albanologjike, u themelua me vendim të Qeverisë së Maqedonisë, më 27.03.2007, në periudhën kur ai dhe partia e tij ishin pjesë e qeverisë. Ky institut, që nga themelimi e deri më sot, ka organizuar shumë konferenca shkencore nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, historisë, folklorit, etnologjisë, dhe shumë fyushave të tjera, me interes për shqiptarët, kudo qofshin ato. Në këtë qendër për studime albanologjike janë përruar edhe shumë botime të librave me autorë nga të gjitha hapësirat shqiptare.

Në kohën e bashkëqeverisjes së Arben Xhaferit në Qeverinë e Maqedonisë, në Tetovë u themelua edhe Galeria artistike, që u vendos në objektin e „Hamamit të vjetër”, objekt ky me vlera të jashtëzakonshme arqitektonike. Në hapësirat e bukura të restauruara, mbahen ekspozita të ndryshme, ku krahas profesionistëve, punimet e veta i ekspozojnë edhe shumë të rinj që janë të interesuar, e që kanë prirje për artet pamore. Ky objekt atraktiv, bashkë me Xhaminë e Pashës me tyrben aty pranë dhe Urën e gurit që tani më nuk ekziston, e formojnë kompleksin e veçantë turistik, si trashëgimi kulturore e periudhës osmane.

Në të njëjtën periudhë kohore, me insistimin e Arbnit, në Gostivear u hap edhe Qendra për konservim të trashëgimisë kulturore. Këto dy institucione të një rëndësie të

rëndësishme për ndriçimin, kultivimin dhe ruajtjen e vlerave kulturore, në masë të madhe, janë edhe interes të shqiptarëve dhe pasurisë së tyre materiale, që deri vonë as që kishin qasje në institucionet ekzistuese maqedonase, pa asnjë të punësuar shqiptar.

Meritë e një rëndësie të veçantë e Arbën Xhaferit, është edhe themelimi i Teatrit profesional të Tetovës. Kultura për artin skenik e banorëve të këtij qyteti, ishte e njohur, që nga kohëra më të hershme, kur grupe amatorësh të Shoqërisë kulturore artistike, „Xheladin Zeqiri”, dhe mësues dashamirë të teatrit, përgatitnin shfaqje të ndryshme të autorëve shqiptarë. Pas shumë tentimeve, të faktorit politik shqiptar, të pushtetit lokal dhe qëndror që edhe Tetova ta ketë një teatër profesionist, meqë në këtë kohë nga Fakulteti i Arteve, dega e aktrimit, të UT-së, ishin diplomuar mjaftë kuadro, Arbën Xhaferi ishte ai, që bashkë me bashkëpunorët e tij, të instaluar në institucione qeveritare, sidomos në Ministrinë e Kulturës, arriti ta realizojë këtë dëshirë të kahmoçme të tetovarëve. Edhe kjo fitore e tij dhe e politikës që e udhëhiqte, ishte gjithsesi rezultat i mirëkuptimit konsensual me partnerët e koalicionit. Ky teatër profesional shtetëror, u formua në vitin 2007, me seli në Tetovë. Mbi njëzet shfaqje teatrore të suksesshme, para publikut vendës, atyre të qyteteve tjera shqiptare dhe në shumë vende të rajonit, siç është edhe pjesëmarrja në Festivalin me renome ndërkombëta „MESS”, të Sarajevës, janë dëshmi e një pune serioze e profesionale e këtij teatri, që si i tillë, ndër më të rinjtë në vend, po hapëron drejt sukseseve të reja dhe afirmimit të plotë në hapësirat shqiptare e më gjerë. Për të shtatën herë me radhë ky teatër është organizator dhe nikoqir i Festivalit Ndërkombëtar, që mbahet në qytetin e Tetovës.

Një e arritur e madhe e tij ishte edhe kanali i tretë i RTM-së, dedikuar kryesisht shqiptarëve. Me këtë projekt tepër të rëndësishëm në fushë të informimit, dhe kulturës, shqiptarët nga katër orë në ditë, fituan njëmbëdhjetë orë program në gjuhën shqipe, të përpiluar nga autorë shqiptarë dhe të udhëhequr po nga kuadro shqiptare. Ky kanal i posaçëm u arrit në vitin 2001, me propozimin e Ministrisë së Informatave, që u përkrah nga Qeveria e Maqedonisë, si një ndër shumë pikat programore që e kushtëzonin formimin e qeverisë së përbashkët.

Në kohën e qeverisjes së koalicionit qeveritar, ku si pjesë e saj, ishte edhe partia e Arbnit, u bë një hap i madh edhe në themelimin institucioneve tjera, ose në emrimin e

udhëheqësve shqiptarë në ato ekzistuese, madje edhe në qytetet, ku me dekada nuk është dëgjuar zëri i shqiptarëve, si Manastiri, Krusheva, Velesi etj.

6.Marrëveshja e re politike maqedonase shqiptare në kohë paqe për një kohezion të përhershëm politik

Arben Xhaferi, që nga viti 1994, kur edhe e pranoi funksionin e Kryetarit të PPD-së,(krahu i Arbën Xhaferit) në Kongresin e parakohshëm, ishte në vazhdimësi të proceseve politike të Maqedonisë. Ai duke qenë aktori, ndër më kryesorët në politikbërjen e këtij shteti, edhe pse shumë procese kishin marrë epilogun përfundimtar, para ardhjes së tij, e dha kontributin e vet si shqiptar, intelektual, politikan dhe diplomat, deri në mbarim të jetës, por i zhgënjyer me pritshmëritë nga gjithë ato marrëveshje, që nga ajo e Ohrit. Kjo marrëveshje, e njohur si Marrëveshja Korrnizë e Ohrit, nga e cila pritej se do zgjidhen njëherë e përgjithmonë problemet ndëretnike në këtë shtet, e veçmas ato mes shqiptarëve e maqedonasve, nuk u realizua as për së afërmi nga afati i paraparë. Vonesa shumëvjeçare e jetësimit të saj, solli pesimizëm te shqiptarët se mund të realizohen ndonjëherë kërkesat e tyre. Rezistenca e palës maqedonase për realizimin e kësaj marrëveshjeje, por edhe barrierat politike të vazhdueshme që e pengonin jetësimin e saj, për Arbnin ishin të papranueshme, prandaj ai mendonte për një marrëveshje të re, që do arrihej në kohë paqeje, pa ngarkesën për ndërprerjen e luftës, që me të drejtë në atë marrëveshje ishte prioriteti kryesor. Ai gjatë gjithë asaj kohe si politikan, qoftë në pozitë, apo në opozitë, i vetëdijshëm së në mënyra parciale të marrëveshjeve, nuk mund të krijohen kushte normale që dy etnitetet më të mëdha të jetojnë si plotësisht të barabartë, me kohë e hodhi tezën se vetëm një marrëveshje e re, e ndërtuar mbi parime të pranueshme për dy palët, do krijoheshin kushte normale afatgjate që ky shtet të ndërtohet mbi bazën e shtetformimit nga maqedonasit dhe shqiptarët, me të drejta të pakicave, sipas të gjitha konventave ndërkombëtare. Këtë koncept të tijin, shumë subjekte politike në vend, madje edhe disa shqiptare, e konsideruan si nacionalist, por edhe për këto vlerësime ai ka spjegimin e vet, duke e konsideruar nacionalizmin koncept modern evropjan, doktrinë të kulturuar dhe të

vetëdijësuar. Nacionalizmi sipas tij mund të japë rezultate vetëm nëse mbi këto premisa ngriten institucionet përkatëse.¹³⁵ Këtë marrëveshje të re politike, që një ditë patjetër duhet të jetësohet, nga e cila nuk hoqi dorë deri sa u nda nga jeta, e mbështet në përvojën e tij politike si lider partie, si deputet dhe si njohës i mirë i teorive politike. Funksionimi i parlamentit mbi parime të majorizimit në një shoqëri shumetnike, mendon ai, e dëmton rëndë demokracinë. Margjinalizimi i vazhdueshëm etnik në dëm të etnitetit të dytë në vend, siç janë shqiptarët, për te është sinjal i keq dhe denigrues edhe për vet shtetin, që pretendon të jetë demokratik, prandaj kërkesa e tij për ripërkufizim të shtetit, mbi parime të barabarta të maqedonasve dhe shqiptarëve, duhet të jetë e pranueshme dhe të përqafohet sa më parë. Shtetet multietnike, sipas tij, janë të brishta dhe jo të qëndrueshme nëse nuk mbështeten në konsensus të plotë. Arbni këto bindje i spjegonte përmes argumenteve teorike dhe praktike, duke marrë edhe shembuj nga shtete tjera multietnike, të cilat me kohë i kishin stabilizuar këto raporte mes etnitetëve.

Kjo marrëveshje historike, nga e cila asnjherë nuk hoqi dorë Arben Xhaferi, njëherit është edhe platforma e tij, që do e stabilizonte edhe vet Maqedoninë. Ky koncept sipas tij duhej të kalonte në tri faza realizuese: hapi i parë do ishte marrëveshja historike e dy bashkësive etnike (maqedonase dhe shqiptare), që për herë të parë do e formonin shtetin e ri të pavarur të Maqedonisë, më emrin ekzistues ose me emër të ri, sipas marrëveshjes me Greqinë.


Hapi i dytë do ishte hartimi i kushtetutës së shtetit të ri, në bazëpremisave të marrëveshjes, ndërsa hapi i tretë, lojaliteti ndaj shtedit të ri.¹³⁶

„Metodologjinë që është përdorur deri më sot (kushtetuta, lojaliteti dhe marrëveshja në kuadër të institucioneve që ngërthejnë në vete ekskluzivisht interesin maqedonas), e quan si uzurpim të shtetit, territorit dhe të mirave tjera të përbashkëta. Ky uzurpim, mendonte Xhaferi, do të jetë gjeneratori i vazhdueshëm i krizës në Maqedoni, nëse ky shtet nuk do mblldh forcë për këtë marrëveshje, që do ishte historike me plot kuptimin e fjalës.

¹³⁵ Arben Xhaferi, vepra 02, Prishtinë 2016, f. 355

¹³⁶ po aty, 356

KAPITULLI

VI**ANALIZA EMPIRIKE NË LIDHJE
ME QËNDRIMET FILOZOFIKE DHE
POLITIKE TË ARBËN XHAFERIT**

1. Përshkrim i kampionit
2. Përshkrim i rezultateve
3. Komentim i rezultateve kundrejt hipotezave

1.Përshkrim i kampionit


Ky hulumtim është empirik kuantitativ, dhe grupi që janë anketuar, janë kryesisht qytetarë shqiptarë të Republikës së Maqedonisë, por edhe të viseve tjera shqiptare, në lidhje me personalitetin e Arbën Xhaferit si politikan dhe burrështetas. Në pjesën më të madhe është përdorur metoda e anketimit gjegjësisht anketimi online përmes aplikacionit “google forms” dhe një pjesë tjetër nëpërmjet plotësimit të pyetësorit në hard copy janë intervistuar 523 persona, nga grup moshë të ndryshme, me nivele të ndryshme të shkollimit. Të dhënat e Pyetësorit do të na shërbejnë për të kuptuar se sa realisht qytetarët e kanë njohuri për profilin e Arbën Xhaferit dhe konceptet e tija filozofike politike.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është ndriçimi i gjithanshëm i personalitetit të Arbën Xhaferit, nga opinione të të anketuarve moshash e nivelesh të ndryshme të shkollimit, në Maqedoninë e Veriut dhe në hapësirat tjera shqiptare.

- Përmes këtij hulumtimi, do konstatohet interesimi i qytetarëve vlerësimi i tyre për politikën, politikanët dhe mendimi konkret për figurën e këtij politikani e lideri që la gjurmë në politik bërjen e këtij vendi dhe jo vetëm.
- Të arrihet deri te të dhënat se sa është interesimi i qytetarëve për liderët e politikës shqiptare në këtë vend.
- Grumbullimi i materialit shkencor, si dëshmi për nivelin e politizimit të qytetarëve dhe përcaktimi i tyre për njërin apo tjetrin opcion politik në jetën politike të këtij shteti.
- Studimi i përgjithshëm mbi tezat kryesore të Arbën Xhaferit, siç është vendosja me konsensus mes maqedonasve dhe shqiptarëve, dhe shteti multietnik, me të drejta të barabarta mes komuniteteve më të mëdha etnike dhe të drejtat e pakicave tjera, sipas konventave ndërkombëtare.

- Pritet që ky kërkim, të sjellë të dhëna të bollshme për figurën që Arben Xhaferit, që do e vërtetonin si objektiv apo jo, vlerësimin e përgjithshëm për këtë mendimtar, politikan e diplomat.
- Hulumtimi është e një rëndësie të veçantë edhe për pasurimin e fondit të studimeve për personalitetin e politikanëve shqiptar, siç është edhe Arbën Xhaferi.

Graf. 6.1. Struktura gjinore e respondentëve




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, kampioni karakterizohet me një strukturë gjinore mjaft të balancuar, me vetë faktin se rreth 54.7% nga numri i përgjithshëm i respondentëve i përkasin gjinisë mashkullore dhe rreth 45.3% nga to, i përkasin gjinisë femërore.

Duke patur parasysh faktin se Arbën Xhaferi ka ndruar jetë në vitin 2012, pra afro tetë vite më parë, e duke u nisur nga tendenca për të kyçur në anketim persona të cilët në periudhën e veprimtarisë së tij kanë qenë së paku adoleshentë, në suaza të studimit të realizuar kanë qenë të kyçur vetëm persona të moshës së paku 30 vjeçare. Kjo me qëllim që personat e anketuar të

kenë patur mundësi të ndjekin veprimtarinë e tij së paku në pjesët përfundimtare të karrierës së këtij personaliteti.

Graf. 6.2. Struktura moshore e respondentëve




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, mostra është mjaft e balancuar edhe në kontekst të strukturës moshore të respondentëve, dhe duket kështu:

- Rreth 15%, përkatësisht 79 të anketuar i përkasin grup moshës 30-35 vjeçare.
- Rreth 11%, përkatësisht 56 të anketuar i përkasin grup moshës 36-40 vjeçare.
- Rreth 11.6%, përkatësisht 61 të anketuar i përkasin grup moshës 41-45 vjeçare.
- Rreth 14.7%, përkatësisht 77 të anketuar i përkasin grup moshës 46-50 vjeçare.
- Rreth 16%, përkatësisht 83 të anketuar i përkasin grup moshës 51-55 vjeçare.
- Rreth 11%, përkatësisht 56 të anketuar i përkasin grup moshës 56-60 vjeçare.
- Rreth 13%, përkatësisht 69 të anketuar i përkasin grup moshës 61-65 vjeçare.
- Rreth 8%, përkatësisht 41 të anketuar i përkasin grup moshës 36-40 vjeçare.

Analiza kumulative e strukturës moshore të anketuarve nxjerr në pah se rreth 37.5% nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar i përkasin grup moshave 39-45 vjeçare. Pra, bëhet fjalë për persona të cilët kanë arritur të ndjekin së paku veprimtarinë politike të Arbën Xhaferit dhe të Partisë Demokratike Shqiptare në periudhën e participimit të saj në Qeverinë e udhëhequr nga VMRO-DPMNE, PDSH dhe AD, në periudhën 1998-2002, periudhë kjo që ngërthen në vete periudhën e luftës për pavarësi të Republikës së Kosovës, Luftës së Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc në Serbi, dhe luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Republikën e Maqedonisë, tanimë Maqedoninë e Veriut. Krahas kësaj, edhe persona që kanë ndjekur veprimtarinë e Arben Xhaferit edhe pas përfundimit të luftës në Maqedonisë, gjatë periudhës së nënshkrimit dhe zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, gjatë iniciativës për krijimin e trupit koordinativ të partive politike të shqiptarëve në Maqedoni dhe gjithsesi gjatë periudhës së humbjes së pozitave politike në Partisë Demokratike Shqiptare në tregun politik shqiptar dhe shtetëror në përgjithësi, kundrejt Bashkimit Demokratik për Integrim, të krijuar dhe udhëhequr nga një pjesë e leadershipit politik dhe ushtarak të ish Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Afro 2/3 nga numri i përgjithshëm i të anketuarve i përkasin grup moshës 46 e më shumë vjeçare. Pra bëhet fjalë për persona të cilët krahas ndodhive të theksuara më lartë, kanë patur mundësinë të ndjekin veprimtarinë e Arbën Xhaferit në të gjitha periudhat paraprake, përfshirë këtu edhe kthimin e tij në Maqedoni dhe aktivizimin politik pas pavarësimit të Republikës së Maqedonisë, rolin e tij në ndarjen e Partisë për Prosperitet Demokratik, krijimin e Partisë për Prosperitet Demokratik Shqiptar, rolin e tij në zgjedhjet lokale të vitit 1996 e që në Tetovë u përmbyllën në vitin 1997, pozitat e tija kundrejt ndodhive të Gostivarit, paraprakisht ndodhive rreth themelimit të Universitetit të Tetovës, ndodhive të Ladorishtës e Bitpazarit të Shkupit, si dhe rolin e tij në bashkimin e bllokut opozitar shqiptar të kohës, përkatësisht bashkimit të Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve dhe Partisë Demokratike Popullore në Partinë Demokratike Shqiptare.


Por, kur bëhet fjalë për strukturën moshore të të anketuarve, duhet theksuar se në asnjë mënyrë përkatësia ndaj grup moshës më të re të kyçur në anketim, nuk nënkupton edhe mungesë të informative dhe të dhënave e as paaftësi për të ofruar mendime dhe për të patur qëndrime kritike rreth çështjeve që janë pjesë e hulumtimit të disertacionit të doktoratës.

Graf. 6.3. Struktura arsimore e respondentëve



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, kampioni është i dominuar nga kategoria e personave që kanë arsimim universitar, kundrejt kategorisë së personave që nuk kanë të kryer arsimim universitar. Kështu afro 1/5 nga numri i përgjithshëm i respondentëve janë persona që kanë të kryer vetëm shkollë fillore dhe diçka mbi 17% i takojnë kategorisë së personave që kanë të kryer vetëm shkollë të mesme. Vetëm 5% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë kryer vetëm shkollë të lartë, që nënkupton që nivel arsimor të dikurshëm, që me standardet e sodit mundet të klasifikohet si nivel në mes shkollës së mesme dhe fakultetit. Ashtu siç është mese e qartë nga vetë grafikoni, kampioni në masë të dukshme është i dominuar nga kategoria e personave që kanë të kryer fakultet, Në fakt, kësaj kategorie i përkasin diçka më shumë se 44% nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar. Nga ana tjetër rreth 1/10 e të anketuarve kanë të kryer shkollë të mesme dhe rreth 3% kanë të kryer studime të doktoratës. Pra, afro 58% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë të përfunduar së paku një nivel të studimeve universitare, që është njëkohësisht edhe një vlerë e shtuar e studimi,t që kontribuon në masë të duhur në ngritjen e cilësisë së vetë studimit.


Graf. 6.4. Shkalla e punësimit të respondentëve



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, pjesa dërmuese e personave që kanë participuar në studim janë persona të punësuar. Në fakt, 72% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë deklaruar se janë të punësuar dhe afro 30% janë deklaruar të papunësuar. Në këtë drejtim duhet theksuar dy aspekte që qëllimisht nuk kanë qenë pjesë e studimit. E para, në studim nuk është shqyrtuar çështja e natyrës së punësimit të respondentëve. Pra, nuk i është kushtuar rëndësi asaj se respondentët a janë të punësuar në sektorin publik ose në sektorin privat, meqë është vlerësuar si irelevante kundrejt vetë hipotezave të përcaktuara në disertacion. E dyta, pjesë e studimit nuk ka qenë përvoja në punë, meqë e njëjta nuk është konsideruar si relevante në ndërtimin e qëndrimeve mbi opusin e veprimtarisë së Arben Xhaferit. Në pyetësor nuk ka qenë i paraparë opsion për deklarim të pensionistëve, duke u nisur nga supozimi se të gjithë të anketuarit e grup moshës 65 e më shumë vjeçare janë persona të pensionuar ose në procedurë të pensionimit. Por, duhet theksuar se as edhe ky aspekt nuk ndikon në qëndrimin e respondentëve në ndërtimin e opinioneve mbi veprimtarinë politike të Arben Xhaferit.

Nga ana tjetër, aktiviteti politik i respondentëve është konsideruar si aspekt që duhet patur parasysh në diskutimin e qëndrimeve dhe relevancës së qëndrimeve të tyre mbi veprimtarinë politike të Arbën Xhaferit.

Graf. 6.5. Të dhëna mbi aktivitetin politik të respondentëve



Siç mundet të vërehet, nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm:

- Afro 24% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve dikur kanë qenë anëtarë të Partisë për Prosperitet Demokratik. Ndonëse bëhet fjalë për $\frac{1}{4}$ nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar, duhet theksuar fakti se bëhet fjalë për një parti politike që pikën e aktivitetit politik e ka arritur në vitet e para të pluralizmit, pas zgjedhjeve lokale të vitit 1996 dhe atyre parlamentare të vitit 1998, kur ka


humbur në masë të madhe pozitave politike. Krahas kësaj, duhet theksuar se një pjesë e respondentëve në periudhën e funksionimit të kësaj partie politike kanë qenë në një moshë jomadhore e cila nuk u ka mundur të jenë as anëtarë e as aktivistë të partisë në fjalë.

- Vetën 16% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë deklaruar se kanë qenë anëtarë të Partisë për Prosperitet Demokratik Shqiptar, parti kjo që pikun e aktivitetit politik e ka arritur në zgjedhjet lokale të vitit 1996, kur pas një viti, është transformuar në Partinë Demokratike Shqiptare pas bashkimit me Partinë Demokratike Popullore.
- Nga ana tjetër 37% nga numri i përgjithshëm i respondentëve kanë deklaruar se dikur kanë qenë anëtarë të Partisë Demokratike Shqiptare të udhëhequr nga Arbën Xhaferi.
- Rreth 70% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë deklaruar se aktualisht janë anëtarë të një partie politike.
- Rreth 14% nga numri i përgjithshëm i respondentëve kanë qenë aktivistë të Partisë për Prosperitet Demokratik Shqiptar dhe rreth 18% kanë qenë aktivistë të Partisë Demokratike Shqiptare.
- Rreth 40% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë preferuar të konsiderohen si aktivistë të ndonjëres nga partitë politike ekzistuese.

Në drejtim të analizave të mësipërme duhet theksuar dy elemente bazë. E para, shumë i vogël është participimi i aktivistëve të partive politike të udhëhequra nga Arbën Xhaferi në strukturën e të anketuarve. Por, kjo në fakt paraqet një aspekt pozitiv meqë shumë më të vogla janë gjasat që respondentët të jenë emocionalë në dhënie të vlerësimeve pozitive për veprimtarinë e tij politike, për shkak të mundësive eventuale të ndonjë lojaliteti të vjetërsuar. Pra, vetë struktura e respondentëve ofron më shumë garancë për objektivitet në ofrim të përgjigjeve nga ana e respondentëve. E dyta, qëllimisht në pyetësor aktiviteti aktual politik i respondentëve është trajtuar si një koncept i përgjithësuar, me qëllim të evitimit të vënies së respondentëve, ose së paku një pjesë të tyre në pozita delikate.

Gjithashtu duhet theksuar se kjo pjesë e pyetësorit ka konfirmuar edhe praktikisht shkallën e lartë të politizimit të popullsisë. Kjo dëshmohet me vetë faktin se 70% i respondentëve janë deklaruar si anëtarë të ndonjërës nga partisë politike dhe 40% si aktivistë të njëjës prej tyre.


Graf. 6.6. Burimi i informatave për ndërtim të qëndrimeve mbi veprimtarinë politike të Arbën Xhaferit



Ashtu siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, rreth 97% e respondentëve nuk e kanë njohur personalisht Arbën Xhaferin, që nënkupton se qëndrimet mbi veprimtarinë politike të tij i kanë siguruar në bazë të informatave nga të tjerët. Konkretisht, rreth 77% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë deklaruar se qëndrimet e tyre mbi opusin e veprimtarisë së politike të Arbën Xhaferit i kanë ndërtuar në bazë të asaj që kanë dëgjuar dhe siguruar si informatë përmes mjeteve të informimit, ndërsa në masë afro 1/5 nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, qëndrimet e tyre mbi opusin politik të Arbën Xhaferit i kanë ndërtuar në bazë të asaj që kanë dëgjuar nga të tjerët.

Me qëllim të sigurimit të një përfshirjeje më të gjerë gjeografike në suaza të studimit, është tentuar të kyçen persona nga të gjitha pjesët e vendit të populluara me popullsi shqiptare, graf. 6.7.

Graf. 6.7. Vendbanimi i të anketuarve




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, është bërë përpjekje për kyçje të respondentëve nga pjesa dërmuese e regjioneve të banuara me popullsi shqiptare. Sic shihet, në strukturën e të anketuarve dominojnë të anketuarit nga rajoni i Pollogut, përkatësisht, nga ai i Tetovës dhe Gostivarit, të ndjekur nga rajoni i Shkupit, Kumanovës dhe Strugës. Në anketim janë kyçur edhe respondentë nga vendbanime ku shqiptarët janë në pozitë jo të lakmueshme, ndonëse në numër më të vogël. Kjo është bërë me qëllim që të arrihet në të

dhëna, së paku bazike mbi refleksionin e politikave të Arbën Xhaferit edhe në vendbanimet ku popullsia Shqiptare është reduktuar në pakicë. Duhet theksuar se për arsye organizative, nuk është realizuar anketim në pjesën e Manastirit, e që paraqet një nga kufizimet në hulumtim.

2.Përshkrim i rezultateve

Me qëllim të ndërtimit të një koncepti më të tërësishëm dhe integrues mbi rolin e Arbën Xhaferit në shtetndërtimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, respondentëve u janë parashtruar një varg pyetjesh, me qëllim të studimit të qëndrimeve të tyre mbi veprimtarinë politike të Arbën Xhaferit në aspekte dhe situata të ndryshme.


Graf. 6.8. Perceptimi i respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në ndodhitë rreth përçarjes së Partisë për Prosperitet Demokratik



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, pjesa dërmuese e të anketuarve e vlerësojnë si domosdoshmëri të dobishme për shqiptarët ndarjen e PPD në dy fraksione. Kështu vetëm 14% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve vlerësojnë se ndarja e kësaj partie politike në dy krahë ka qenë veprim i gabuar. Në këtë drejtim duhet theksuar

se identifikimi i arsyeve për qëndrimet e kësaj natyre të shprehura nga ana e respondentëve i tejkalojnë kornizat dhe objektivat e disertacionit të doktoratës. Kjo pjesë e hulumtimit ka patur për synim të identifikojë në mënyrë të tërthortë qëndrimet e respondentëve mbi arsyshmërinë e veprimit politik në Arbën Xhaferit në periudhën e viteve 1993-1994 që në fakt ndiqej nga konflikte të brendshme me strukturat udhëheqëse të partisë në fjalë e që ka kulmuar me themelimin e Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve si partie mëvetësishme, si për nga struktura organizative ashtu edhe nga forma e organizimit të aktivitetit të saj dhe përmbajtja e platformës programore të ofruar.

Graf. 6.9. Perceptimi i respondentëve mbi nevojën e themelimit të Partisë për Prosperitet Demokratik Shqiptar




Pra, rreth 4/5 nga numri i përgjithshëm i të anketuarve vlerësojnë se themelimi i PPDSH ka qenë i nevojshëm, me çka në një mënyrë arsyetojnë dhe aktivitetet e ndërmarra nga Arbën Xhaferi për themelimin e partisë në fjalë. Nga ana tjetër, 92% nga numri i përgjithshëm i respondentëve të anketuar e kanë vlerësuar si të dobishme bashkimin e PPDSH dhe PDP në vitin 1997 në suaza të PDSH-së së udhëhequr sërish nga Arbën Xhaferi.

Tab.6.1. Perceptimi i respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni		
	n	%
Plotësisht pajtohem me qëndrimin se synim parësor i Arbën Xhaferit ka qenë konsolidimi i organizimit politik të shqiptarëve në Maqedoni.	254	48.6
Pjesërisht pajtohem me qëndrimin se synim parësor i Arbën Xhaferit ka qenë konsolidimi i organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	146	27.9
Nuk pajtohem me qëndrimin se synim parësor i Arbën Xhaferit ka qenë konsolidimi i organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	73	14.0
Plotësisht pajtohem me qëndrimin se synim parësor i Arbën Xhaferit ka qenë krijimi i përçarjes në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	29	5.5
Pjesërisht pajtohem me qëndrimin se synim parësor i Arbën Xhaferit ka qenë krijimi i përçarjes në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	63	12.0
Nuk pajtohem me qëndrimin se synim parësor i Arbën Xhaferit ka qenë krijimi i përçarjes në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	431	82.4

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, respondentët kanë qëndrime kryesisht pozitive kur bëhet fjalë për rolin e Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Kjo dëshmohe me vetë faktin se vetëm 14% i respondentëve nuk janë pajtuar me qëndrimin se synim i Arbën Xhaferit ka qenë konsolidimi i organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni dhe vetëm 17% nga numri i përgjithshëm i


respondentëve, janë përcaktuar për njërin nga opsionet me të cilët shprehet një dozë besimi, se roli i tij kundrejt organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni ka qenë përcarës.

Graf.6.10. Perceptimi i respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të shqiptarëve në Maqedoni në varësi nga përkatësia gjinore e tyre (në %)




Siç mundet të vërehet nga grafiku i mësipërm, nuk mundet të bëhet fjalë për dallime të shprehura në qëndrime, në varësi nga përkatësia gjinore e të anketuarve, kur bëhet fjalë për rolin e Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni, ndonëse duhte theksuar se komform rezultateve të studimit, meshkujt e anketuar kanë një dozë pak më të lartë të mendimit pozitiv rreth konstruktivitetit të Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni.

Graf.6.11. Perceptimi i respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni në varësi nga grup moshë e tyre (në %)



Pra, komform të dhënave të paraqitura në grafikun e mësipërm, mundet të vërehet se që të gjitha grup moshat kanë qëndrim pozitiv kur bëhet fjalë për synimet e Arbën Xhaferit për të konsoliduar organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Kështu një mendim të tillë ndajnë 91% të grup moshës 30-35 vjeçare dhe 41-45 vjeçare, 92% i respondentëve të grup moshës 36-40 vjeçare, 93% të grup moshës 56-60 vjeçare, 94% të moshës 51-55 dhe asaj mbi 65 vjeçare si dhe 96% të grup moshës 46-50 vjeçare. Por, me gjithë mosekzistimin e dallimeve shumë evidente, pjesa e poshtme e grafikut tregon dallime të caktuara në mes grup moshave më të reja dhe më të vjetra, me atë që, te grup moshat e reja haset një dozë pak më e lartë e pesimizmit kur bëhet fjalë për synimet e Arbën Xhaferit, për të konsoliduar organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Kështu një mendim të kësaj natyre ndajnë rreth 9% të grup moshave 30-46 vjeçare dhe afro 6% të grup moshave mbi 46 vjeçare.

Graf.6.12. Perceptimi i respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në konsolidimin e organizimit politik të Shqiptarëve në Maqedoni, në varësi nga niveli i arsimit të tyre (në %)



Pra, komform të dhënave të paraqitura në grafikun e mësipërm, mund të vërehet se të gjithë të anketuarit, pavarësisht nivelit arsimorë, kanë qëndrim pozitiv kur bëhet fjalë për synimet e Arbën Xhaferit për të konsoliduar organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Kështu një mendim të tillë ndajnë 90% të personave që kanë të kryer studime postdiplomike, 93% të personave që kanë të kryer fakultet dhe 95% të personave që kanë të kryer vetëm shkollë fillore ose vetëm shkollë të mesme. Me gjithgjtë dallimet e vogla, pjesa e poshtme e grafikut tregon dallime të caktuara në mes respondentëve, në atë që te respondentët me nivele më të larta arsimore, haset një dozë pak më e shprehur e pesimizmit, kur bëhet fjalë për synimet e Arbën Xhaferit për të konsoliduar organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Kështu një mendim të kësaj natyre ndajnë rreth 4% i respondentëve pa arsimim universitar dhe rreth 9% nga numri i përgjithshëm i respondentëve që kanë të kryer ndonjë nivel të arsimit universitar.

Tab.6.2. Qëndrimet e respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në organizimin politik në vend				
	Pajtohem		Nuk pajtohem	
	n	%	n	%
Me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	98	18.7	425	81.3
Paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në vend paraqet hap prapa në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	59	11.3	464	88.7
Arben Xhaferi dha një kontribut të shprehur në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.	497	95.0	26	5.0
Me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në funksionimin e politikës në shtet në përgjithësi.	119	22.8	404	77.2
Arben Xhaferi dha një kontribut në funksionimin e politikës në përgjithësi në Maqedoni.	423	80.9	100	19.1

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme respondentët në përgjithësi kanë qëndrime pozitive mbi rolin e Arbën Xhaferit si në skenën politike të Shqiptarëve në Maqedoni, ashtu si edhe në atë në nivel shtetëror në përgjithësi. Kështu, më pak se 1/5 nga numri i përgjithshëm i respondentëve janë të mendimit se me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në organizimin politik të hqiptarëve në Maqedoni dhe vetëm 11% i respondentëve janë të mendimit se paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në vend, paraqet hap prapa në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Nga ana tjetër, 95% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka dhënë një kontribut të shprehur në organizimin politik të hqiptarëve në Maqedoni. Megjithatë duhet theksuar se kur bëhet fjalë për rolin e tij në funksionimin e politikës në nivel shtetëror, ndonëse pozitive. qëndrimet e respondentëve janë pak më dekurajuese. Kështu që, afro 23% nga numri i

përgjithshëm i respondentëve janë të mendimit se me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në funksionimin e politikës në shtet në përgjithësi.

Tab. 6.3 Qëndrimet e respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në organizimin politik në vend në varësi nga përkatësia gjeografike e tyre (në %)

	1	2	3	4	5
Tetova	24	12	97	9	96
Gostivari	22	11	96	9	97
Kërçova	21	14	94	8	96
Struga	20	13	96	11	95
Ohri	17	11	95	21	93
Prespa	13	13	97	36	57
Resnja	16	12	96	38	56
Dibra	15	11	96	10	89
Shkupi	23	11	98	16	82
Kumanova	22	11	97	14	87
Velesi	14	11	91	38	66
Prilepi	10	12	93	41	65

1- Me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.

2- Paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në vend paraqet hap prapa në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.

3- Arben Xhaferi dha një kontribut të shprehur në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni.


4- Me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në funksionimin e politikës në shtet në përgjithësi.

5- Arben Xhaferi dha një kontribut në funksionimin e politikës në përgjithësi në Maqedoni.

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme:

- Rreth 24% i të anketuarveme origjinë nga rajoni i i Tetovës janë të mendimit se me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike nuk ndryshoi asgjë në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Një mendim të tillë ndajnë edhe 22% i të anketuarve nga rajoni i i Gostivarit, rreth 21% i të anketuarve nga rajoni ii Kërçovës, rreth 1/5 e respondentëve nga rajoni i Strugës dhe kështu me radhë.
- Rreth 14% nga respondentët nga rajoni i Kërçovës janë të mendimit se paraqitja e Arbën Xhaferit në skenën politike në vend, paraqet hap prapa në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Një mendim të tillë ndajnë edhe nga 13% i të anketuarve nga rajoni i Strugës dhe Prespës, si dhe nga 12% i të anketuarve nga rajoni i Resnjës dhe Tetovës.
- Rreth 98% i të anketuarve nga rajoni i Shkupit janë të mendimit se Arben Xhaferi dha një kontribut të shprehur në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni. Këtë mendim e ndajnë edhe 97% i respondentëve nga rajoni i Tetovës, Prespës dhe Kumanovëssi dhe 96% i respondentëve nga rajoni i Gostivarit, Dibrës, Strugës dhe Resnjës.
- Rreth 45% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve nga Krusheva dhe rreth 41% i të anketuarve nga rajoni i i Prilepit janë të mendimit se me paraqitjen e Arbën Xhaferit në skenën politike, nuk ndryshoi asgjë në funksionimin e politikës në shtet në përgjithësi. Këtë mendim e ndajnë edhe nga 38% i të anketuarve nga rajoni i Velesit dhe Resnjës, si dhe 36% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve nga rajonii i Prespës.
- Rreth 97% i të anketuarve nga rajoni i Gostivarit janë të mendimit se Arben Xhaferi ka dhënë një kontribut në funksionimin e politikës në përgjithësi në Maqedoni. Një mendim të kësaj natyre ndajnë edhe 96% i të anketuarve nga rajoni i i Tetovës dhe Kërçovës, si dhe 95 i të anketuarve nga rajoni i Strugës.


Graf. 6.13. Qëndrimet e respondentëve mbi rolin e Arbën Xhaferit në organizimin politik në vend, varësisht nga përkatësia gjeografike e tyre.



Grafiku i mësipërm në mënyrë ilustrative, nxjerr në pah ekzistimin e dallimeve në qëndrime në mes të anketuarve nga rajone të ndryshme në vend. Kështu ndonëse të anketuarit e të gjitha rajoneve kanë qëndrime të ngjashme kur është në pyetje impakti i Arbën Xhaferit në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni, eksitojnë dallime evidente në qëndrime kur bëhet fjalë për impaktin në politikbërjen në nivel shtetëror me atë që respondentët nga rajonet ku shqiptarët kanë mbetur pakicë për nga numri shprehin një skepticizëm më të lartë në këtë

drejtim. Kjo ndodh kështu, ndoshta për shkak se në këto pjesë, politikisht dhe realisht nuk ka ndryshuar shumë pozita e shqiptarëve në periudhën kohore në fjalë.

Graf. 6.14. Njohuritë e respondentëve mbi konceptet filozofiko-politike të Arbën Xhaferit



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, një pjesë shumë e vogël e respondentëve kanë lexuar veprat "PDSH-ja jo në letër" dhe "Sfidat e Demokracisë në Shtetet Multietnike". Në fakt vetëm 16 ose 3% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve i kanë lexuar veprat në fjalë. Nga ana tjetër rreth 3/5 nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë deklaruar se kanë lexuar kolumna të publikuara nga Arbën Xhaferi, 69% kanë deklaruar se i kanë ndjekur deklaratat publike të Arbën Xhaferit dhe 70% se i kanë ndjekur intervistat publike të Arbën Xhaferit. Pra, bëhet fjalë për një kampion mjaft të përshtatshëm në drejtim të kapacitetit për të dhënë vlerësime mbi konceptet filozofiko-politike të Arbën Xhaferit.

Tab.6.4.Qëndrimet e respondentëve mbi konceptet filozofiko-politike të Arbën Xhaferit

	1		2		3		4		5	
	a	b	a	b	a	b	a	b	a	b
Arbën Xhaferi ka patur koncepte origjinale politiko-filozofike.	14	2	14	2	264	57	302	59	301	67
Konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit kanë qenë shumë para kohës.	12	4	12	4	268	53	302	59	302	66
Konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një zhvillim të përshpejtuar të demokracisë.	15	1	15	1	285	36	298	63	303	65
Konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një funksionalitet më të mirë të sistemit politik në vend.	12	4	12	4	283	38	296	65	298	70
Konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar marrëdhënie ndëretnike shumë më të relaksuara.	13	3	13	3	301	20	311	50	328	40
Konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar marrëdhënie ndërjetare shumë më të relaksuara.	13	3	13	3	303	18	311	50	331	37

1- Respondentë që kanë lexuar veprën "PDSH-ja jo në letër"
2- Respondent që kanë lexuar veprën "Sfidat e demokracisë në shtetet multietnike"
3- Respondentë që kanë lexuar kolumna të publikuara nga Arbën Xhaferi
4- Respondent që kanë ndjekur deklaratat publike të dhëna nga Arbën Xhaferi
5- Respondentë që kanë ndjekur intervista publike të dhëna nga Arbën Xhaferi
a- Pajtohem
b- Nuk pajtohem

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme:

- Respondentët që kanë lexuar veprat e Arbën Xhaferit kanë qëndrime identike mbi konceptet filozofiko-politike të tij. Kështu 87.5% i tyre janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka patur koncepte origjinale politiko-filozofike, $\frac{3}{4}$ janë të mendimit se konceptete filozofiko-politike të Arben Xhaferit kanë qenë shumë para kohës kur janë dhënë, afro 94% vlerësojnë se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një zhvillim të përshpejtuar të demokracisë në vend, $\frac{3}{4}$ janë të mendimit se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një funksionalitet më të mirë të sistemit politik në vend, dhe 81% janë të mendimit se zbatimi i koncepteve filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar marrëdhënie ndëretnike dhe ndërftare shumë më të relaksuara.
- 82% i respondentëve që kanë lexuar kolumna në autorësi të Arbën Xhaferit janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka patur koncepte origjinale politiko-filozofike, 83 janë të mendimit se konceptete filozofiko-politike të Arben Xhaferit kanë qenë shumë para kohës kur janë dhënë, afro 89% vlerësojnë se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një zhvillim të përshpejtuar të demokracisë në vend, 88% janë të mendimit se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një funksionalitet më të mirë të sistemit politik në vend, dhe rreth 94% janë të mendimit se zbatimi i koncepteve filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar marrëdhënie ndëretnike dhe ndërftare shumë më të relaksuara.
- Afro 84% i respondentëve që kanë ndjekur deklarata publike të dhëna nga ana e Arbën Xhaferit janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka patur koncepte origjinale politiko-filozofike dhe se konceptete filozofiko-politike të Arben Xhaferit kanë qenë shumë para kohës kur janë dhënë, afro 82% vlerësojnë se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një zhvillim të përshpejtuar të demokracisë në vend dhe se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një funksionalitet më të mirë të sistemit politik

në vend, dhe rreth 86% janë të mendimit se zbatimi i koncepteve filozofiko-politike të Arben Xhaferit, do të kishin mundësuar marrëdhënie ndëretnike dhe ndërfitetare shumë më të relaksuara.


- Afro 82% i respondentëve që kanë ndjekur intervista publike të dhëna nga ana e Arben Xhaferit janë të mendimit se Arben Xhaferi ka patur koncepte origjinale politiko-filozofike, sepse ato koncepte filozofiko-politike të Arben Xhaferit, kanë qenë shumë para kohës kur janë dhënë dhe se ata koncepte të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një zhvillim të përshpejtuar të demokracisë në vend. Rreth 81% janë të mendimit se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një funksionalitet më të mirë të sistemit politik në vend, dhe rreth 9/10 janë të mendimit se zbatimi i koncepteve filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar marrëdhënie ndëretnike dhe ndërfitetare shumë më të relaksuara.

Graf. 6.15 .Analizë komparative e qëndrimeve të respondentëve mbi konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit (në %)



Grafiku i mësipërm në mënyrë ilustrative, nxjerr në pah ekzistimin e dallimeve në qëndrime në mes të anketuarve lidhur me efektet nga idetë filozofiko-politike të Arbën Xhaferit në sfera të ndryshme të organizimit të sistemit shoqëror në vend. Kështu, në mesin e respondentëve haset një dozë pak sa e lartë e optimizmit rreth impaktit që do të kishte patur zbatimi i koncepteve të Arbën Xhaferit në relaksim dhe marrëdhëniet ndëretnike në vend. Në këtë rast, duhet theksuar se të gjithë të anketuarit e kategorive të mësipërme janë shprehur se idetë e Xhaferit mbi demokracinë koncensuale, nëse do zbatoheshin, do të kishin evituar një pjesë të madhe të problemeve në relacionet ndëretnike në Maqedoni.

Graf. 6.16. Qëndrimet e respondentëve që mendojnë se me figurën e Arbën Xhaferit identifikohet një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit plural të Republikës së Maqedonisë së Veriut.




Rëndësia historike e personalitetit të Arbën Xhaferit në zhvillimin e pluralizmit në Republikën e Maqedonisë, konfirmohet edhe me faktin se vetëm 9%, përkatësisht 48 nga numri i përgjithshëm i respondentëve shprehin mendim të kundërt.

Graf. 6.17. Qëndrimet e respondentëve mbi kapacitetet diplomatike të Arbën Xhaferit




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, respondentët i njohin dhe i pranojnë kapacitetet e aftësitë diplomatike të Arbën Xhaferit, që vërtetohet me vetë faktin se vetëm 14% nga numri i përgjithshëm i respondentëve janë të mendimit se ai nuk ka manifestuar kapacitete diplomatike të veçanta.

Graf. 6.18. Qëndrimet e respondentëve mbi rrethanat historike në të cilat i ka shpalosur Arbën Xhaferi qëndrimet e tija politike



Në mesin e të anketuarve siç mundet të vërehet nga grafiku i mësipërm dominon qëndrimi se Arbën Xhaferi konceptin e tij politik e shpalosi në kushte dhe rrethana të një klime të papërshtatshme për ndërtimin e Maqedonisë së Veriut si shtet multi-etnik (82%).


Graf. 6.19. Qëndrimet e respondentëve mbi tendencat për ndërtim të Maqedonisë si shtet i dominuar nga maqedonasit gjatë decenies së parë të zhvillimit plural të vendit, dhe jo vetëm



Synimi i të dhënave të paraqitura në grafikun e mësipërm është ofrimi i një pasqyre të bazuar në mendimet e respondentëve, lidhur me rrethanat e shtrirjes së veprimtarisë politike të Arbën Xhaferit gjatë dekadës së parë të zhvillimit të Maqedonisë si shtet i pavarur. Kështu, siç mundet të vërehet nga të dhënat mbi mendimet e respondentëve, rreth 99% i tyre janë të


mendimit se në dekadën e parë të zhvillimit të Maqedonisë si shtet i pavarur, elitat politike maqedonase kanë synuar t'i përjashtojnë shqiptarët si etnikumi i dytë për nga numri në vend nga shtetformësia. Jo vetëm kaq, por 96% i të anketuarve janë të mendimit se një pjesë e madhe e përfaqësuesve shqiptarë në përbërjen e pushtetit ekzekutiv kanë qenë në shërbim të qëndrimeve të tilla të elitave politike maqedonase. Po aq, shprehin mendimin se opozita Shqiptare e kohës nën udhëheqje të Arben Xhaferit ka luftuar për shndërrim të shqiptarëve në element shtetformues, pra ka qenë në kundërshtim me format zyrtare të funksionimit të pushtetit kundrejt popullsisë shqiptare në vend.

Graf. 6.20. Qëndrimet e respondentëve mbi disa aspekte të funksionimit të PDSH nën menaxhim të Arbën Xhaferit



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, respondentët kanë përshtypje pozitive mbi funksionimin e PDSH nën menaxhim të Arbën Xhaferit në dekadën e parë të funksionimit të Maqedonisë si shtet i pavarur. Kështu, mbi 95% e të anketuarve janë të mendimit se shikuar nga këndvështrimi i sotëm, bashkimi i opozitë shqiptare të asaj kohe ka qenë në dobi të intereseve kombëtare shqiptare, dhe 4/5 nga numri i përgjithshëm i respondentëve janë të mendimit se në periudhën 1998-2001, si rezultat i participimit të PDSH dhe Arbën Xhaferit në përbërjen qeveritare, ka ardhur deri në përmirësim të pozitës së shqiptarëve në Maqedoni dhe relaksim të marrëdhënieve ndëretnike në vend.


Graf. 6.21. Qëndrimet e respondentëve mbi rolin e PDSH nën menaxhim të Arbën Xhaferit gjatë luftës për çlirim të Republikës së Kosovës:



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm respondentët kanë fjalë miradije për rolin e Arbën Xhaferit gjatë luftës së Kosovës. Në fakt, 99.6% i respondentëve vlerësojnë se ai bashkë me partinë nën menaxhimin e tij, kanë luajtur rol


konstruktiv gjatë krizës së Kosovës, 95% se kanë luajtur rolin kryesor në sigurimin e trajtimit dhe 85% në sigurimin e strehimit për shqiptarët e zhvedndosur gjatë kohëzgjatjes së këtij konflikti.

Graf. 6.22. Shkalla e pajtueshmërisë së respondentëve me qëndrimin se ideja bazë e Arbën Xhaferit qëndron në konceptin se , mirëkuptimi ndëretnik, multikonfeksional dhe ndërkulturor i bazuar në tolerancë, de fakto dhe de Jure, duhej të paraqesin ide bazë për shtetndërtimin e Maqedonisë së Veriut?




Ashtu siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, studimi është në përkrahje të diskutimeve teorike të realizuara në pjesët paraprake të disertacionit, përkatësisht faktin e Arbën Xhaferi e shihte të ardhmen e Maqedonisë si një shtet multi-etnik, multifetar me një shkallë të lartë të dallimeve dhe specifikave të tjetrit. Mu këto parime, shikuar nga këndvështrimi i qytetarëve të anketuar, janë parime në bazë të cilave është dashur të ndërtohet dhe të funksionojë Maqedonia në vazhdimësi, që nga themelimi i saj si shtet i mëvetësishëm e deri më sot.

Graf. 6.23. Qëndrimi i respondentëve për profilin politik të Arbën Xhaferit




Pjesa dërmuese e respondentëve Arbën Xhaferin e konsiderojnë si një politikan të moderuar (afro 79%), kundrejt atyre që konsiderojnë se ai ka qenë politikan radikal 21%).

Graf. 6.24. Pikëpamjet e Arbën Xhaferit për karakterin e Maqedonisë si shtet i pavarur, shikuar nga këndvështrimi i qytetarëve të anketuar




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, qytetarët e anketuar janë të mendimit se konceptet e Arbën Xhaferit kanë shkuar në drejtim të ndërtimit të Maqedonisë si shtet multietnik, multifetar dhe si shtet të qytetarëve të barabartë para ligjit dhe institucioneve. Me këto qëndrime nuk pajtohen vetëm 5% nga numri i përgjithshëm i respondentëve.

Graf. 6.25. Qëndrimet e qytetarëve mbi rolin e ideve të Arbën Xhaferit në ndërtimin e Maqedonisë si shtet multietnik:




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, rreth 51% nga numri i përgjithshëm i respondentëve pajtohen plotësisht dhe diçka më shumë se 43% pajtohen pjesërisht se konceptet politike dhe filozofike të Arbën Xhaferit, përveç kauzës shqiptare ndihmonin për një stabilitet të qëndrueshëm për ndërtimit multietnik të Maqedonisë së Veriut. Vetëm afro 5% nga numri i përgjithshëm i respondentëve nuk ndajnë një mendim të tillë, përkatësisht nuk besojnë se konceptet politike dhe filozofike të Arbën Xhaferit, përveç kauzës shqiptare ndihmonin për një stabilitet të qëndrueshëm për ndërtimit multietnik të Maqedonisë së Veriut.

Graf. 6.26. Qëndrimet e qytetarëve mbi përputhshmërinë e ideve të Arbën Xhaferit me vlerat perëndimore



Respondentët, në përgjithësi janë të mendimit se qëndrimet përkatësisht idetë politike dhe filozofike të proklamuar nga ana e Arbën Xhaferit janë në përputhje me vlerat e proklamuar nga ana e demokracive të zhvilluara bashkëkohore. Kështu, 70.5% nga numri i përgjithshëm i respondentëve ndajnë mendimin se idetë e Arbën Xhaferit janë tërësisht në përputhje me vlerat bazë, dhe 24% se ato janë pjesërisht në përputhje me vlerat bazë të proklamuar nda demokracitë e avansuara perëndimore. Një opinion të kësaj natyre nuk ndajnë rreth 5% i të anketuarve të cilët janë të mendimit se idetë e Arben Xhaferit nuk kanë qenë në përputhje me vlerat bazë të proklamuar nda demokracitë e avansuara perëndimore.

Graf. 6.27. Arbën Xhaferi mbi konsensualitetin



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, rreth 44% nga numri i përgjithshëm i respondentëve janë të mendimit se Arbën Xhaferi gjithmonë i mbeti besnik idesë së konsensualitetit dhe po aq janë të mendimit se Arbën Xhaferi kohë pas kohe sipas nevojës e riaktualizonte idenë e konsensualitetit. Nga ana tjetër rreth 12% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi nuk ka ndërmarrë asgjë që praktikisht të zbatojë idenë e konsensualitetit.

Në mesin e ideve të shumta të proklamuar nga ana e Arbën Xhaferit është edhe ajo se shoqëritë moderne funksionojnë në rregull, në qoftë se përmbushin tri kërkesa themelore: kohezionin e brendshëm të shoqërisë (harmoninë mes të qytetarëve), mirëqenien ekonomike dhe demokracinë liberale.


Me qëllim të analizës së aktualitetit dhe shkallës së pajtueshmërisë së respondentëve me qëndrimet e kësaj natyre, të njëjtët janë lutur të deklarojnë pajtueshmërinë ose mospajtueshmërinë e tyre lidhur me idetë në fjalë, tab.6.5.

Tab.6.5.Qëndrimet e respondentëve mbi parakushtet për garantim të funksionalitetit të rendit shoqërorë.

	Plotësisht pajtohem		Pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem	
	n	%	n	%	n	%
Arbën Xhaferi ka patur të drejtë në besimin se kohezioni i brendëshëm është një nga parakushtet kyç për garantimin e funksionalitetit të një shoqërie bashkëkohore.	276	52.8	236	45.1	11	2.1
Arbën Xhaferi ka patur të drejtë në besimin se mirëqenia ekonomike është një nga parakushtet kyç për garantimin e funksionalitetit të një shoqërije bashkëkohore.	260	49.7	254	48.6	9	1.7
Arbën Xhaferi ka patur të drejtë në besimin se demokracia liberale është një nga parakushtet kyç për garantimin e funksionalitetit të një shoqërije bashkëkohore.	259	49.5	219	41.9	45	8.6

Pra, pjesa dërmuese e respondentëve pajtohen me qëndrimet e Arbën Xhaferit se shoqëritë moderne funksionojnë në rregull, në qoftë se përmbushin tri kërkesa themelore: kohezionin e brendshëm të shoqërisë (harmoninë mes të qytetarëve), mirëqenien ekonomike dhe Demokracinë liberale. Kjo dëshmohet me vetë faktin se vetëm 2.1% i numrit të përgjithshëm të respondentëve nuk janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka patur të drejtë në besimin se kohezioni i brendshëm është një nga parakushtet kyç për garantimin e funksionalitetit të një shoqërie bashkëkohore, vetëm 1.7% nuk ndajnë mendimin se Arbën Xhaferi ka patur të drejtë në besimin se mirëqenia ekonomike është një nga parakushtet kyç për garantimin e funksionalitetit të një shoqërije bashkëkohore dhe vetëm 8.6% nuk vlerësojnë se Arbën Xhaferi ka patur të drejtë në besimin se demokracia liberale është një nga parakushtet kyç për garantimin e funksionalitetit të një shoqërie bashkëkohore.

Graf. 6.28. Personaliteti i Arbën Xhaferit gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, respondentët e perceptojnë pozitivisht rolin që ka luajtur dhe qasjen që ka patur Arbën Xhaferi gjatë konfliktit të vitit 2001 në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Mbi 93% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka luajtur rol pozitiv gjatë konfliktit të vitit 2001.
- Rreth 96% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi si pjesë e qeverisë ka ndihmuar në zvogëlimin e gjasave për eskalim të skajshëm të konfliktit në luftë të plotë qytetare.
- Rreth 41% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka gabuar që nuk e ka lëshuar qeverinë gjatë konfliktit të vitit 2001.


- Rreth 94% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka vepruar pozitivisht me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prizrenit
- Afro 98% i të anketuarve theksojnë se sipas mendimit të tyre Arbën Xhaferi përmes institucioneve të sistemit ka ndihmuar në menaxhimin më të lehtë të konfliktit të vitit 2001

Sa i përket çështjes së aktivitetit politik të Arbën Xhaferit në periudhën pas përfundimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001, e përqendruar në disa pika ky dhe mjaft problemore, studimi ka nxjerr në pah se:

- Rreth 87% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e negociatave për përfundimin e konfliktit të armatosur të vitit 2001.
- Rreth 76% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka luajtur rol të rëndësishëm në përcaktimin e përmbajtjes së Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.
- Rreth 87.5% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi gjatë negociatave dhe përpilimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit ka qenë në shërbim të intereseve kombëtare shqiptare në vend.
- Rreth 99.6% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka luajtur rol pozitiv me aktin e nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.
- Rreth 46% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi ka bërë lëshim me aktin e vendimin për mospjesëmarrje në Trupin koordinativ të faktorit shqiptar në Maqedoni të iniciuar nga lidershipi i ish UÇK-së.
- Sipas 95.7% të anketuarve Arbën Xhaferi me sukses e ka menaxhuar PDSH-në në vitet e para pas përfundimit të konfliktit të armatosur edhe pranë rezultateve të pavoritshme zgjedhore.
- Për 49% të anketuarve futja e PDSH në përbërjen qeveritare 2006-2008 ka qenë gabim.
- Rreth 61% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi kë shpejtuar me largimin nga pozita e liderit të PDSH në vitin 2007.


- Rreth 99.6% i të anketuarve janë të mendimit se Arbën Xhaferi me largimin vullnetar nga kreu i PDSH ka dhënë shembull që duhet ndjekur edhe nga liderë tjerë në Maqedoni dhe regjion

Graf. 6.29. Qëndrime të respondentëve lidhur me aktivitetin e Arbën Xhaferit pas konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Pra, edhe qytetarët e anketuar, në përgjithësi konfirmojnë një qëndrim pozitiv mbi mënyrën e veprimit politik të Arbën Xhaferit, në periudhën pas përfundimit të konfliktit të armatosur të vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut. Kështu, respondentët në përgjithësi vlerësojnë se ai ka luajtur një rol shumë konstruktiv dhe të rëndësishëm në zhvillimin e negociatave dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, dhe në këtë mënyrë ka ndihmuar përmbylljen e konfliktit para se i njëjti të shndërrohej në luftë ndëretnike dhe ndërfaqetare të një shkallë të lartë. Siç mundet të vërehet, madje edhe sot, mendimet e qytetarëve janë të ndarë rreth asaj se a është gabuar në moskrijimin e trupit koordinativ të partive pas përfundimit të konfliktit dhe a ka qenë gabim futja e PDSH së drejtuar nga Arbën Xhaferi në përbërjen qeveritare që doli nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2006 dhe përfundoi me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 në vend. Por, edhe respondentët, madje, gati të gjithë janë të mendimit se Arbën Xhaferi është i vetmi në mesin e politiknëve shqiptarë i cili në një moment ka ofruar dorëheqje nga pozita dhe se ky akt atë e bën të veçantë karshi liderëve politik të tjerë shqiptarë në vend dhe në region.

Graf. 6.30. Pikëpamjet e Arbën Xhaferit si alternative e qëndrueshme në shtetndërtimin e Maqedonisë së Veriut



- Jam i mendimit se zbatimi i plotë i ideve të Arbën Xhaferit për vënien e themeleve të Maqedonisë si shtet i qytetarëve të barabartë do ishte garancë për zhvillim të përshpejtuar të vendit
- Sikur që në fillim të ishin zbatuar idetë dhe qëndrimet e Arbën Xhaferit Maqedonia që moti do ishte pjesë e integrimi Euro-Atlantike
- Sikur që në fillim Maqedonia të ishte ndërtuar në parimet e drejtësisë së barabartë për të gjithë sot shumë më mirë do të kishte funksionuar sistemi i drejtësisë në vend
- Edhe sot politika shqiptare lufton në vazhden e ideve mbi Maqedoninë si shtet i qytetarëve të barabartë

Mbi 99% i të anketuarve janë të mendimit se zbatimi i plotë i ideve të Arbën Xhaferit për vënien e themeleve të Maqedonisë si shtet i qytetarëve të barabartë do ishte garancë për zhvillim të përshpejtuar të vendit, afro 89% i të anketuarve janë shprehur se sipas mendimit të tyre sikur që në fillim të ishin zbatuar idetë dhe qëndrimet e Arbën Xhaferit, Maqedonia që moti do ishte pjesë e integritimeve Euro-Atlantike dhe afro 98% i të anketuarve janë të mendimit se sikur që në fillim Maqedonia të ishte ndërtuar në parimet e drejtësisë së barabartë për të gjithë sot shumë më mirë do të kishte funksionuar sistemi i drejtësisë në vend. Duhet theksuar se 99.6% i të anketuarve vlerësojnë se edhe sot politika shqiptare lufton në vazhden e ideve mbi Maqedoninë si shtet i qytetarëve të barabartë.

Pra, në esencë qytetarët e anketuar janë të mendimit se zgjidhja e çështjes së karakterit të shtetit që në filllet e pluralizmit në vend, od t'i kishte dhënë një kahe krejt më ndryshe zhvillimit të Maqedonisë. Kështu, në esencë, qytetarët e anketuar janë të mendimit se sikur Maqedonia që në fillim të ishte ndërtuar në parimin e shtetit të qytetarëve të barabartë të çliruar nga tendenca permanente për fajësim të etnikumit tjetër për çdo gjë, në atë rast ky shtet sot do të ndodhej në një pozitë shumë më të lakmueshme në krahasim me pozitën në të cilën ndodhet. Pra, respondentët janë të mendimit se mungesa e një vizioni të ngjashëm me atë të Arbën Xhaferit edhe në mesin e politikanëve përkatësisht lidërshipt politik Maqedonas në vend, ka qenë pengesa kyç për zhvillimin e Maqedonisë si shtet dhe funksionalitetin e sistemit shoqërorë në përgjithësi.

Krahas kësaj, respondentët kanë shprehur qëndrimin se edhe vetë sistemi gjyqësor në vend, është shkatërruar fillimisht për shkak të tentimit sistemor për trajtim të jomaqedonasve si më pak meritore për drejtësi.

Studimi vërteton një ide gjenerale dhe që është shumë e qarë, pra faktin se edhe eksponentët tjerë politikë të shqiptarëve në Maqedoni edhe sot, disa vite pas vdekjes së Arbën Xhaferit, ende shqiptarëve u premtojnë barazinë me maqedonasit, si alternativë e vetme për zhvillimin e shtetit, ndërsa elitat maqedonase ende barazinë vazhdojnë ta shohin si diçka që është në dorën e tyre që si lëmshë mund tua japin ose të refuzojnë tua japin bashkështetasve të tyre shqiptarëve, në vitin e fundit të decenies së dytë të shek.XXI.

3.Komentim i rezultateve kundrejt hipotezave

Të dhënat e paraqitura në tabelën 6.2 të disertacionit qartë dëshmojnë një qëndrim gati koncensual (95% i të anketuarve) në mendimin se Arben Xhaferi ka dhënë një kontribut të shprehur në organizimin politik të Shqiptarëve në Maqedoni dhe afro 81% kanë vlerësuar se Arben Xhaferi ka dhënë një kontribut në funksionimin e politikës në përgjithësi në Maqedoni. Komfor të dhënave të paraqitura në tab. 6.4 të disertacionit të doktoratës. Mbi 80% i respondentëve ndajnë mendimin se konceptet filozofiko-politike të Arben Xhaferit do të kishin mundësuar një zhvillim të përshpejtuar të demokracisë , një funksionalitet më të mirë të sistemit politik në vend si dhe marrëdhënie ndëretnike dhe ndërftare shumë më të relaksuara. Krahas kësaj, të dhënat e paraqitura në graf.6.25 të disertacionit të doktoratës dëshmojnë se sipas mendimit të qytetarëve të anketuar, vetëm afro 5% nuk besojnë se konceptet politike dhe filozofike të Arbën Xhaferit, përveç kauzës shqiptare ndihmonin për një stabilitet të qëndrueshëm për ndërtimit multi-etnik të Maqedonisë së Veriut. Pos kësaj, siç është paraqitur në graf.6,26 respondentët janë të mendimit se zbatimi i plotë i ideve të Arbën Xhaferit për vënien e themeleve të Maqedonisë si shtet i qytetarëve të barabartë do ishte garancë për zhvillim të përshpejtuar të vendit, se sipas mendimit të tyre sikur që në fillim të ishin zbatuar idetë dhe qëndrimet e Arbën Xhaferit Maqedonia që moti do ishte pjesë e integritimeve Euro-Atlantike, se sikur që në fillim Maqedonia të ishte ndërtuar në parimet e drejtësisë së barabartë për të gjithë sot shumë më mirë do të kishte funksionuar sistemi i drejtësisë në vend.

Duke patur parasysh argumentet e mëlartme mundet të konsiderohet se studimi i përfshirë si pjesë e disertacionit qartë ofron përgjigje afirmative në hipotezën kryesore të disertacionit “A ofronin pikëpamjet e Arbën Xhaferit alternativë të qëndrueshme në shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut?”

Tërësija e përmbajtjes së disertacionit të doktoratës, qëndrimet e analistëve të paraqitura në suaza të shtojcës, si dhe përvojat e shteteve multi-etnike evropiane, qartë tregojnë se hipoteza e

parë ndihmëse “Koncepti i Arben Xhaferit në shtetin multietnik a ishte pro perëndimor?” ka përgjigje meritorë afirmative.

Një argument pro në këtë drejtim ofron edhe fakti se komfor të dhënave të paraqitura në graf.6.26 të disertacionit të doktoratës respondentët në përgjithësi marrë janë të mendimit se qëndrimet përkatësisht idetë politike dhe filozofike të proklamuar nga ana e Arbën Xhaferit janë në përputhje me vlerat e proklamuar nga ana e demokracive të zhvilluara bashkëkohore. Një opinion të kësaj natyre nuk ndajnë rreth 5% i të anketuarve të cilët janë të mendimit se idetë e Arben Xhaferit nuk kanë qenë në përputhje me vlerat bazë të proklamuar nda demokracitë e avancuara perëndimore. Meqë ideja bazë e Arbë Xhaferit mbeti demokracia konsensuale si alternativë reale për zhvillimin afatgjatë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, po këto të dhëna mundësojnë ofrimin e qëndrimit afirmativ edhe për hipotezën e dytë ndihmëse të disertacionit të doktoratës “Demokracia konsensuale që proklamonte Arbën Xhaferi a ishte në përputhje të plotë me konceptet bashkohore mbi demokracinë?”

Të dhënat e paraqitura në graf. 6.21, konfirmojnë se rreth 92% e të anketuarve konfirmojnë qëndrimin se Arbën Xhaferi e kundronte të ardhmen e Maqedonisë si një shtet multietnik, multifetar me një shkallë të lartë të dallimeve dhe specifikave të tjetrit. Mu këto parime, shikuar nga këndvështrimi i qytetarëve të anketuar janë parime në bazë të cilave është dashur të ndërtohet dhe të funksionojë Maqedonia në vazhdimësi që nga themelimi i saj si shtet i mëvetësishëm e deri më sot. Të dhënat e paraqitura në graf. 6.23 qartë dëshmojnë se qytetarët e anketuar janë të mendimit se konceptet e Arbën Xhaferit kanë shkuar në drejtim të ndërtimit të Maqedonisë si shtet multietnik, multifetar dhe si shtet të qytetarëve të barabartë para ligjit dhe institucioneve (Rreth 95% i të anketuarve ndajnë këto mendime).

Andaj, vlerësohet se mundet të ofrohet përgjigje afirmative edhe në hipotezën e tretë ndihmëse të disertacionit të doktoratës “Bashkëjetesa, multikulturalizmi, multilingualizmi dhe multikonfeksionalizmi a ishin pjesë përbërëse e ideve të Arbën Xhaferit për ndërtimin e një shteti me perspektiva të qëndrueshme euroatlantike?”.

Të dhënat e paraqitura në graf. 6.27 qartë dëshmojnë se pjesa dërmuese e të anketuarve (88%) velrësojnë se Arbën Xhaferi asnjëherë nuk ka hequr dorë nga ideja e tij për ndërtimin e konsensualitetit në vendimmarje në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Tërësia e studimit të

përfshirë në këtë disertacion dëshmon qartë një konsekuencë të shprehur kohore të Arbën Xhaferit në kontekst të qëndrimeve të tija për parimet mbi të cilat duhej të ndërtohet dhe zhvillohet Republika e Maqedonisë së Veriut si shtet i mëvetësishëm. Në këtë drejtim, kur bëhet fjalë për hipotezën e fundit ndihmëse të disertacionit të doktoratës “A kishte evoluim të qëndrimeve politike të Arbën Xhaferit, si rezultat i ndodhive konkrete në Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë” mundet të theksohet se ai kurë nuk komprometoi qëndrimet e tija bazë për një Maqedoni multietnike, multifetare dhe multikulturore. Pra, për një shtet të qytetarëve të barabartë.

Përfundime

Punimi i doktoratës : Konceptet Filozofike-Politike të Arbën Xhaferit në shtetndërtimin e Maqedonisë së Veriut, për momentin është i pari i kësaj natyre dhe shpreh një nivel të lartë të origjinalitetit. Ky punim në vehte ngërthen dy momente tejet të rëndësishme shiquar si nga aspekti teoriko-shkencor, ashtu edhe nga aspekti praktik.

Në në dy kapitujt e parë bëhet një analizë e thuktë dhe shumë cilësore e kushteve dhe rrethanave të lindjes së pluralizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në të njejtin moment janë përpunuar kontraditat e shumta sociale, ekonomike, kulturore fetare, dhe mbi të gjitha ato ndëretnike.

Në këtë punim zbërthehet gjithashtu kriza politike brenda shqiptare, e reflektuar përmes Partisë më të madhe të asaj kohe, Partisë për Prosperitet Demokratik.

Aspekti tjetër po aq dëmthënës i këtij punimi ka të bëjë me daljen në skenën politike të njërit ndër personalitetet më karizmatikë të politikës shqiptare në përgjithësi, Liderit të Partisë Demokratike Shqiptare Arbën Xhaferi. Arbën Xhaferi doli në skenën politike në një moment të veçantë historik në momentin kur organizimi politik i shqiptarëve gjendej në udhëkryq. Shikuar nga aspekti teorik i veprimit të partive politike në periudha para daljes së Arbën Xhaferit në skenën politik, ishte një periudhë e cila i përgjigjet gjuhës së Shekspirit : “To be or not to be” (të rrfosh apo të mos rrosh). Udhëheqësit shqiptarë të asaj kohe, gati se i kishin harxhuar të gjitha idetë, që mund ta lëviznin çështjen shqiptare. Ata, organizimin politik të shqiptarëve në Maqedoni e fushin nën ombrellën e koncepteve pastër maqedonase mbi ndërtimin e shtetit.

Mund të konstatojmë se idetë tejet konstruktive të Arbën Xhaferit mbi shtetndërtimin organizimit politik të shqiptarëve në Maqedoni, i dhanë një kuptim tjetër, një kuptim të plotë një kuptim modern, ndryshe thënë, një kuptim që garantonte ardhmëri të qëndrueshme për një shtet të vogël që rënkonte nga problemet e natyrave të ndryshme të grumbulluara ndër vite dhe dekada.

Qëndrimet e Arbën Xhaferit, në lidhje me të ardhmen e Maqedonisë si shtet dhe shoqëri, ishin para se gjithash, rezultat i njohurive të thella filozofiko-politike të tij, në kuptimin e shtet ndërtimin në përgjithësi dhe ndërtimin e Maqedonisë së Veriut në veçanti.

Arbën Xhaferi konceptim e vetë mbi shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut e bazonte në teoritë më moderne mbi shtetin, duke pas çdoherë parasyshë shtete me përbërje të përafërt me ato që paraqiste politika e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Konkretisht ai në shqyrtimet e veta i merrte parasyshë shtetet në Evropë, me një larami etnike, konfenskinale, kulturore dhe funksionalitetin e tyre të qëndrueshëm.

Arbën Xhaferi si njohës i mirë i rrethanave politke në nivel global, ishte thellë i vetëdijshëm për dallimet socio-ekonomike ndërmjet Maqedonisë dhe shteteve tjera, para së gjithash Zvicra Belgjika, por për ate me rëndësi primare ishte ndërtimi i skeletit të shtetit meqë ai shtetin çdo herë e analizonte si kategori dinamike, gjegjësisht si kategori në zhvillim e sipër. Ndryshe thënë, Arbën Xhaferi asnjëherë nuk e idealizonte shtetitn si institucion mbi institucionet por kishte një qëndrim aristotelian dhe çdo herë fliste për shtet më të mirë në kushte dhe rrethana konkrete.

Angazhimi i Arbën Xhaferit në formësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Maqedonisë së Veriut duke e marrë parasysh çdoherë statusin e pa zgjidhur të “pakicës” së madhe në luftë permanente me konceptin e “shumicës së vogël” zhvillohej përmes pasqyrimin sa më të qartë dhe sa më objektiv të ndodhive në këto hapësira dhe prezentimin e tyre para faktorit ndërkombëtar nga njëra anë, afirmimi i ideve dhe gjetja e mirëkuptimit brenda për brenda shtetit se Maqedonia nuk mund të ketë ardhëmri të qëndrueshme me injorimin dhe pa zgjedhjen e drejt të statusit të shqiptarëve nga ana tjetër. Në planin brenda shqiptar angazhimi permanent i Arbën Xhaferit ishte politika , i tejkalimit të krizës “brenda llojit”, duke i dhënë mundësi një homogjeniteti real brenda shqiptar. Për Arbën Xhaferin ndikimi i Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në zgjedhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni ishte dukuri e natyrshme bile edhe e domosdoshme.

Arbën Xhaferi, shumë qartë i identifikonte dhe interpretonte shpërputhjet mes shtetit multi-etnik dhe konceptit etnocentrik të ndërtimit të tij. Ai tërë kohën potenconte se tendencat e

elitës politike Maqedonase në afat më të shkurtër apo më të gjatë do të provokonin konflikte, përfshirë këtu edhe konfliktin e armatosur, që do të çonin drejt stagnimit, dhe kthimit prapa.

Arbën Xhaferi edhe pse është perceptuar si personalitet politik që synonte shkatërrimin e Maqedonisë si shtet, vepra e tij si në teori, ashtu edhe në praktikë, dëshmon qartë se ai angazhohej për një Maqedoni të bazuar në të arriturat më të larta në aspektin e shtetndërtimi, gjegjësisht për një Maqedoni me perspektiva të qëndrueshme euro-atlantike. Megjithatë qartë potenconte së një gjë e atillë ishte e pamundur pa ndërtimin e mekanizmave që do të siguronin bashkëjetesë multikulturalizëm, multikonfeksionalizëm, multilingualizëm dhe multi etnicizëm, në bazë të parimit të një barazie të qëndrueshme dhe objektive. Andaj Arbën Xhaferi insistonte në një rregullim shtetëror ku toleranca dhe konsensualiteti do të ishin shtyllat kryesore të shtetndërtimit, që do të bëhej duke filluar me ndryshimin e Kushtetutës arbitrare të miratuar në vitin 1991, të cilën Arbën Xhaferi e cilëson si etnocentrike dhe provokuese të krizave politike në vend.

Analizat objektive të takimeve të punës, intervistave dhe aktiviteteve të ngjashme me faktorët relevantë ndërkombëtar flasin qartë se Arbën Xhaferi e ka afirmuar çdoherë idenë e evropizimit të Maqedonisë së Veriut, duke i sulmuar me fuqinë e argumenteve “konceptet feudaliste mbi ndërtimin e shtetit”.

Arbën Xhaferi, Maqedoninë dhe perspektivat e shqiptarëve në Maqedoni nuk i shihte përmes politikave separatiste por përmes një barazie e cila secilit qytetar të Maqedonisë së Veriut. Në këtë kontekst, Arbën Xhaferi asnjëherë nuk fshihej pas konceptit qytetar të ndërtimit të shtetit meqë etnitetet, religjionet dhe kulturat e ndryshme i trajtonte si përparësi në politikat shtetndërtuese duke potencuar se ideja gjenerale duhet të bazohet në përbërjen ekzistuese duke krijuar një klimë për peshën dhe relevancën e çdo etniteti feje dhe kulture.

Koncepti i Arbën Xhaferit mbi ndërtimin e shtetit nuk nënkupton në asnjë mënyrë mos perspektivat e shteteve multietnike, përkundrazi ideja e Xhaferit se shtetet multietnike kushtojnë shumë, ka të bëjë me integrimet euroatlantike si një domosdoshmëri për perspektivat e Maqedonisë së Veriut. Në fakt, Arbën Xhaferi me fjalorin e tij filozofik e shpreh këtë konceptin Zvicëran mbi ndërtimin e shtetit, por edhe idenë Bashkimit Evropian. Njohësit e mirë të historisë më të re evropiane e kanë të qartë se Zvicra dhe Bashkimi Evropian, si ide fillestare i kanë patur integrimet ekonomike të cilat kanë paraqitur mjet efikase në tejkalimin e problemeve politike.

Në këtë mënyrë Arbën Xhaferi i konceptonte perspektivat e Maqedonisë së Veriut, qëndrueshmërinë e shtetit, që është gati e pamundshme pa ndihma ekonomiko- financiare, të një asociacioni siç është në rastin konkret BE-ja.

Arbën Xhaferi, i cili me bindje ishte më djathtist në mesin e majtstëve dhe më majtis në mesin e djathtistëve, dha një kontribut të pakontestueshëm të koalicionit të parë djathtist. Kontributi i tij zhvillohej në dy drejtime, në drejtim të brendshëm ia doli që përmasa të kënaqshme t'ua imponojë partnerëve të koalicionit këndvështrimin e vet në lidhje me ardhmërinë e shtetit. Në plan të jashtëm kontributi i Arbën Xhaferit identifikohet edhe me përpjekjet e tija për të krijuar fqinjësi të mirë politike respektivisht duke tentuar t'i tejkalojë konestetet ndërfaqinësore me Bullgarinë dhe Greqinë, të cilat ishin pengesë serioze e Maqedonisë për në BE. Këto ide të Arbën Xhaferi si nevojë dhe doemosdoshmëri erdhe si shprehje të plota me formimin e Qeverisë së fundit të Maqedonisë së Veriut.

Një çështje tjetër që duhet veçuar, është kontributi i Arbën Xhaferit në menaxhimit e konfliktit në Kosovë. Në këtë aspekt Arbën Xhaferi përmes rrugës diplomatike e ushqente faktorin ndërkombëtar me idenë se konflikti në Kosovë shumë lehtë mund të marrë përmasa ballkanike dhe më të gjera që do ta rrezikonte paqën globale. Nga ana tjetër, falë këmbëngulësisë, atdhetarizmit, dhe dinakërisë politike me shumë suksës e menaxhoi fluksin e refugjatëve që paraqiste një problem serioz demografik, social.

Kontributi i Arbën Xhaferit, i bazuar në konceptet e tija filozofike-politike erdhi në shprehje të plotë gjatë konfliktit të armatosur në RMV, që shumë më herët e kishte paralajmëruar si të mundshëm Arbën Xhaferi, duke e vënë në pikëpyetje konceptin e Gligorovit, Maqedonia "Oazë e paqës". Ai gjatë Konfliktit të armatosur prej fillimi e deri në përfundim me syçelësi dhe korrektësi të skajshme i ndoqi ndodhitë, duke kontribuar në mospërhapjen e konfliktit dhe marrjen e përmasave të një lufte qytatare dhe vëllavrasëse. Ai u vu në krye të partive politike shqiptare të Maqedonisë dhe së bashku Imer Imerin dhe Ali Ahmetin në Prizren i përcaktuan kornizat e zhvillimeve në të ardhmen duke mbajtur llogari që konflikti në Republikën e Maqedonisë së Veriut të mos provokojë konflikte në mënyrë sinxhirore në rajon.

Si njëri ndër menaxhuesit e konfliktit, Arbën Xhaferi së bashku me ekipin e vet, dha një kontribut të dalluar në përpilimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Për publikun e rëndomtë, çdoherë mbëtet e paqartë dëshprimi i Arbën Xhaferi nga kjo marrëveshje e arritur si dhe ideja për dorëheqjen e nënshkrimit nga Marrëveshja e Ohrit. E gjitha kjo paraqet një enigmë e cila mund të sqarohet vetëm përmes faktit të mos respektimit të zbatueshmërisë së marrëveshjes nga elitat politike maqedonase, të cilat synojnë zbehjen e marrëveshjes dhe krijimin e një atmosfere defetiste të popullata shqiptare në Maqedoni duke i trimëruar forcat nacionaliste anti shqiptare.

Në bazë të analizës empirike e cila është realizuar nga metodologjia e e anketimit, të anketuarit në masë të madhe janë pajtuar se konceptet politike filozofike të Arbën Xhaferit janë në korelacion të plotë me vlerat euro-perëndimore.

Gjithashtu shumica absolute e të anketuarve kanë vlerësuar se Demokracia konsensuale dhe vendimarrja konsensuale për ndërtimin e Maqedonisë verut ka qenë ideja bazë e Arbën Xhaferit.

Të anketuarit, gjithashtu në shumicë absolute janë pajtuar me qëndrimet e Arbën Xhaferit se shoqëritë moderne funksionojnë në përmbushjen e tri kërkesave themelore edhe atë: kohezionin e brendshëm të shoqërisë, (harmoninë mes qytetarëve), mirëqenien ekonomike dhe demokracinë liberale.

Nga pjesa teorike e punimit por edhe nga analiza kuantitative bëhet më se e qartë se Konceptet-filozofike politike të Arbën Xhaferit në lidhje me shtet ndërtimin e Maqedonisë së Veriut, në asnjë mënyrë nuk janë të vjetruara dhe paraqesin një udhërrëfim për politikën e ardhshme të elitave shqiptare në Maqedoninë e Veriut.

Arbën Xhaferi dhe idetë e tija janë garantuese për perspektivat e qëndrueshme të çdo individi dhe kolektiviteti etnik në këtë vend.

Dhe për fund të konstatojmë se me këtë studim, i kemi vërtetuar në përgjithësi hipotezat e parashtruara. Jemi të vetëdijshëm se do të kishte qenë si punim ende më i plotë po t'ia arrinim qëllimit ta realizonim edhe analizën kualitative që ishte pjesë e idesë fillestare. Vlerësojmë se kjo doktoranturë nuk nënkupton shterimin e plotë në këtë sferë, dhe se i njëjti në periudhën e ardhshme do të kontribuojë edhe më shumë në ndriçimin e personalitetit të Arbën Xhaferit si diplomat dhe udhëheqës politik.

Literatura

- Arbën Xhaferi Vepra Kombi, identiteti, Shteti 01, Prishtinë 2017
- Arbën Xhaferi , Vepra Kauza Shqiptare në Maqedoni, 02, Prishtinë 2017
- Arbën Xhaferi, Vepra Marrëdhëniet Shqiptaro-Sërbe, Cështja e Kosovës, 03, Prishtinë 2017
- Arbën Xhaferi, Vepra, Intervista 1995-2005, 04, Prishtinë 2017
- Arbën Xhaferi, Vepra Intervista 2006-2012, 05 Prishtinë 2017
- Enver Robeli, Arbën Xhaferi rrëfen në Tetovë në Kërkim të kuptimit, Prishinë 2011
- Rudina Xhunga, 12 Porositë e Arbën Xhaferit, Tiranë 2012
- Etem Aziri, Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë, Tetovë 2012
- Etem Aziri, Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni, Teovë 2004
- Etem Aziri, Partitë politike dhe demokracia, 2004, Tetovë
- Etem Aziri, Rëndësia e Implementimit të Marrëveshjes Kornizë për demokratizimin e shoqërisë maqedonase, botuar në librin: Implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, Shkup 2003
- Dokumenti i Marreveshjes së Ohrit, 2001
- Marreveshja e Prizrenit, 22 Maj, 2001
- Arsim Bajrami, Teoria dhe praktika parlamentare, Shkup 2000
- Dimitar Bajallxhiev, Politologjia, Shkup, 2012
- Denko Malevski, Sovremeni politicki sistem, Shkup, 1986
- Dimitar Mircev, Dramata na Pluralizacijata, Shkup 1981
- Savo Klimovski, Ustaven i politicki sistem, Shkup, 1997
- Cane Mojanovski, Socialen i politicki profil na partite vo Makedonija, Shkup 1997
- Bllagoja Ninevski, Partite i masmedumite vo Makedonija, 2001
- Giovanni Sartori, Edhe njëherë për Teorinë e Demokracisë, Tiranë 1993
- Giovanni Sartori, Parties and party System, Kembrixh 1976

- Arend Lijphart “ Constitutional designs for divided societies” Journal of Democracy 2004
- Arend Lajhpart, Modeli Demokratije, Beograd 2003
- Arnd Lijphart, Parlamendtarna ili pedsjednicka vlast?
- Andreë Heyëood: Politika, Prishtinë, 2008
- Afrim Krasniqi, Partitë politike dhe sistemet politike, Tiranë
- Fehmi Agani: Gjuha e dhunës dhe zëri i arsyes, Peje 2002
- Zhan Zhak Ruso: Kontrata shoqërore: Mbi Origjinën dhe bazat e pabarazisë midis njerëzve
- Hasan Jashari, (Agron Rustemi, Marika Apostolova, Burim Ismaili): Hulumtimi i opinionit publik për Marrëveshjen e Ohrit. 10 Vite kornizë e Ohrit, UEJL, Tetove, 2011
- Etem Aziri. The Development of Democratic Capacities: A Precondition for Building a Functional Multi-ethnic society in the Republic of Macedonia. In Social Movements in Central and Eastern Europe: Dynamics of protest 25 years after the fall of communism, pp. 520-529. Editura Universitatis Din Bukuresti, Bukurest, 5 / 2015
- Etem Aziri. Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet zgjedhore. SEEU, Tetovo, 4 / 2015
- Etem Aziri, Bilall Lutfiu. The Stands of the Political Parties in the Republic of Macedonia towards the 2001 Armed Conflict and the Signing of the OFA Agreement. In Academic Journal of Interdisciplinary Studies, pp. 388-392. MCSER Publishing, Rome, Italy, 7 / 2014
- Etem Aziri, Oreta Saliaj. Filozofia e ndarjes së pushtetit: Faktor i rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë. In Vizione: Revistë e Shkencave Shoqërore, pp. 81-97. Shoqata e Intelektualëve "Klubi Demokratik", Shkup, Shkup, 8 / 2012
- Etem Aziri. Sistemet politike. Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, 1 / 2012
- Etem Aziri. Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik. Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, 1 / 2012
- Etem Aziri. Inter-ethnic relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement. In Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures, pp. 131-156. Epoka University, 10 / 2011
- Blerim Reka: Marrëveshja e Ohrit –filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multi-etnik, botuar në 10 Vite Marrëveshja Kornizë e Ohrit, UEJL, Tetovë 2011

- Perspektivat rajonale të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, si një model për përmirësimin e bashkëjetesës në një shtet multi-etnik. Botuar në Librin: 10 Vite Marrëveshja Korniza e Ohrit, UEJL, Tetovë 2011
- Balkan Insight, 2006
- Gazeta Shqip, Tiranë, 2006
- Gazeta Express, Prishtinë 2006
- Gazeta shqiptare, Tiranë, 2006
- Agjencia televizive shqiptare ATSH, Tiranë 2006
- Gazeta “Dnevnik”, Shkup 2006
- Infopress, Prishtinë, 2006
- Gazeta “ Shekulli” Tiranë.14.07. 2005
- Gazeta “Epoka e Re” 2007
- Agjencia Fokus, Bullgari 2007
- Gazeta “Forum” 2007
- Gazeta “Dello”,2010
- Gzeta “ Albania” Tiranë 2009
- Gazeta “Fakti” 25.12.2005, Shkup
- Gazeta “Lajmi” 15.12.2005 Prishtinë
- Revista “ABC” 04.09.2005
- Agjencia “Fokus” 9.12.2004, Shkup
- Revista “ Java” Prishtinë, 18.3.2004
- Gazeta “Hapi” 17.02.2004, Tetovë
- Gazeta “Flaka” Shkup, 24.02.2003
- Agjencia “Kosova live” 13.01.2003
- Gazeta “Fakti” Shkup, 23.12.2002
- Gazeta”Koha Ditore” Prishtinë, 31.1.2002
- Revista “ Kombi” Prishtinë, 23.12.2001
- Revista Pasqyra, Prishtinë, 05.07.1999
- Gazeta “Nova Makedonija” Shkup, 30.6.1999

- Gazeta “ Bota Sot”, Prishtinë, 29.12.1998
- Gazeta “ Makedonsko Vreme” Shkup, 17.9.1998
- Die Welt, 19.8.1998
- Die Tageszeitung (TAZ) Berlin, 8.8.1998
- Zëri i Amerikës, 1.7.1998
- Revista “Interesi nacional” 26.04.1998
- Gazeta “ Zëri” Prishtinë. 15.04.1998
- Gazeta “ Kosova Sot” 1998
- Gazeta “Koha” 24.7.1997 Shkup
- Agjencia rajonale AIM, Shkup, 1.4.1997
- Gazeta “ Rilindja” Prishtinë 22.12.1996
- Gazeta “Zëri i Shqipërisë” Tiranë, 11.6.1996
- Televizioni bavarez ARD, 15.10.1999
- Revista “Studenti” 3.6.1996, Tetovë
- Arhivi i Radio Televizioni i Kosovës RTK
- Arhivi, Radio Televizionit Shqiptar TVSH
- Arhivi, Televizion Klan, Opinion,
- Arhivi, Televizioni Top-Chanel, Emisioni Shqip
- [www. sobranie.com.mk](http://www.sobranie.com.mk)
- www.ina-online.net
- www.botasot.info
- www.telegrafi.com
- www.gazetaexpress.com
- www.portalb.mk
- www.fax.al
- www.epokaere.com
- www.gazetatema.mk
- www.shekulli.al
- www.gazeta-shqip.com

- www.ballkani.info
- www.flaka.com.mk
- www.gurra-pdsh.org
- www.bdi.mk
- www.aleanca.eu
 - **Dokumente të Partive Politike:**
 - Programi dhe Statuti i Partisë Demokratike Shqiptare
 - Platforma politike e PDSH
 - Platforma Politike e Partisë për Prosperitet Demokratik
 - Raport për aktivitetin e PPD mes Kongresit II-III Tetovë 199
 - Statutet dhe programet e partive politike relevante në Kosovë
 - Statutet dhe programet e partive politike relevante në Shqipëri
 - Statuti i Partisë Demokratike Popullore
 - Statuti i Partisë për Prosperitet Demokratik
 - Statuti i Partisë Demokratike Kombëtare
 - Statuti i PPDSH

Shtojca

Të tjerët për Arben Xhaferin

Ismail Kadare:

“Ishte një lajm tepër i hidhur. Një nga mendjet më të gjera, më të guximshme e më të ndriçuara e la sot kombin shqiptar. Kam pasur fatin ta njoh, ta takoj e të këmbë mendime me të disa herë në rrethana dramatike. Siç ndodh shpesh, njerëz të tillë ikin atëherë kur janë më të nevojshëm se kurrë. Arbëni ishte i tillë, i domosdoshëm, pikërisht tani. Ndaj si rrallëkush do t’u mungojë të gjithëve”

Dritëro Agolli:

“Njerëzit si Arbën Xhaferi vdesin vetëm fizikisht. Ata mbeten të gjallë mes nesh. Na duket se kanë shkuar me shërbim dhe do kthehen përsëri. Në kujtesën tonë mbetet i gjallë Arbën Xhaferi me veprën e tij të shquar, politike, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës”

Kryetari i Partisë Socialiste, aktualisht Kryeministër i Shqipërisë Edi Rama:

Arbën Xhaferi ishte një shqiptar jotipik që tha të vërteta të mëdha e hapi rrugë të pashkelura me trimëri të jashtëzakonshme intelektuale. Vdekja e tij është humbje e madhe për botën shqiptare në disa përmasa, që veç Arbën Xhaferi i mishëronte në njeri të vetëm. U prehtë në paqe!

Lideri i Vetëvendosjes, aktualisht kandidat për Kryeministër të Kosovës Albin Kurti:

“Arbën Xhaferi ka lënë një vepër të jashtëzakonshme për gjithë shqiptarët, vepër që shtrihet si në rrafshin politik dhe organizativ, ashtu edhe në atë teorik e socio-kulturor. Arbën Xhaferit nuk ka mundur askush asnjëherë t’ia t’ia ndërrojë mendjen për shkak se ai mendimet i ka pasur shumë të thella dhe gjërat i ka pasur të menduara mire. Ai ka qenë dijetar në politikë”

Ish Kryeministri i Kosovës, aktualisht President i Kosovës Hashim Thaçi:

“Arbën Xhaferi ishte profil i lartë i politikanit, mendimtarit dhe vizionarit, që la gjurmë të ndritur dhe kontribut të çmuar në jetën politike, jo vetëm në Maqedoni, por edhe në tërë hapësirën shqiptare. Arbën Xhaferi shquhej për mprehtësinë politike, thellësinë intelektuale, transparencën e ideve dhe konceptimin global të çështjes shqiptare. Me vdekjen e Arbën Xhaferit u shua një nga mendjet më të ndritura të qytetërimit shqiptar”

Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta:

“Ndajmë dhembjen për humbjen e Arbën Xhaferit, një politikan i shquar, që mbrojti të drejtat e shqiptarëve. Arbën Xhaferi ka lënë një trashëgimi mjaft të vyer, e cila do shërbejë jo vetëm për ta kujtuar atë, por edhe për të pasur në konsideratë gjithmonë urtësinë e tij, vizionin e tij, mençurinë e tij për faktorizimin e shqiptarëve përmes një politike të mençur”

Ish Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha:

“Me ndarjen nga jeta të Arbën Xhaferit, bota e mendimit dhe elita e kombit, humbën njërin prej personaliteteve më të shquara të dekadave të fundit. Vlerat dhe kontributi thelbësor i Arbën Xhaferit janë një trashëgimi tejet e çmuar në emancipimin kombëtar dhe shoqëror të kombit tonë, që meritojnë mirënjohjen e thellë të të gjithë shqiptarëve, për sot dhe brezat që vijnë”

Pandeli Majko, ish kryeministër i Shqipërisë:

“Arbën Xhaferi ishte një pasardhës i Rilindjes Kombëtare, sepse realisht ishte një njeri që diti të ruajë standardin e vet dhe të rithemelojë atë që unë e konsideroj si patriotizëm të ri të shqiptarëve, një patriotizëm që është i nevojshëm si gjaku për trupin, jo vetëm këtu në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri dhe në të gjitha trevat shqiptare. Ky njeri i letrave dhe i politikës gjithmonë kur fliste dëgjohej nga të gjithë shqiptarët, kudo që janë, sepse mendja e tij fliste për të gjithë”

Ish Presidenti i Shqipërisë, Bujar Nishani:

“Si një politikan vizionar, Arbni përdori me mjeshtri dialogun dhe diplomacinë edhe në momentet kur paqja dukej më e pashpresë se kurrë. Arbën Xhaferi do na mungojë të gjithëve, por ai la pas një shembull dhe eksperiencë që do ta bëjnë të jetë gjithmonë i pranishëm mes nesh”

Ish Presidenti i Shqipërisë Bamir Topi:

“Arbën Xhaferi ishte një intelektual i klasit të lartë. Ishte një rilindas i kohës moderne. Humbja e Arben Xhaferit është humbje kombëtare. Çdo shqiptar ndjen trishtim për filozofin e krijuesin. Fat që e kemi njohur, lexuar e dëgjuar Arbën Xhaferin”

Ish Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga:

“Humbja e tij do të lërë zbrazëti jo vetëm për familjarët dhe bashkëpunëtorët e tij, por edhe për të gjithë ata që e njohën dhe e vlerësuan qëndrimin e tij politik”

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa:

“Me hidhërim të thellë mësuam për ndarjen nga jeta të z. Arbën Xhaferit, themeluesit të Partisë demokratike shqiptare, prijësit të shqiptarëve dhe intelektualit të shquar. Z. Arbën Xhaferi do mbahet mend përherë për veprën e madhe në shërbim të kombit. Ai i dha frymë intelektuale dhe evropjane sjelljes politike të shqiptarëve në Maqedoni”

Përfaqësuesi i AAK-së, Daut Haradinaj:

“Ideja e Arbën Xhaferit, puna dhe angazhimi i tij do të mbeten në breza, që do ta kuptojnë dhe do ta imlementojnë në një shtet funksional demokrtatik me popull të lirë. Kemi humbur një ideolog të politikës në Kosovë dhe Maqedoni, një njeri të madh për mbarë kombin shqiptar”

Kryetar i Aleancës për Shqiptarët Ziadin Sela:

“Njerëzit e mëdhenjë lindin për të mos vdekur kurrë. U ndave nga kjo jetë para shtatë vitesh Arbën Xhaferi. Je i gjallë dhe frymon akoma nëpërmjet porosive që na le. Kisha nderin që të pata Kryetar dikur dhe kam privilegjin sot të vazhdoj rrugëtimin tënd bashkë me mijëra bashkëmendimtar që ti i krijove”.

Ish Ministri i Punëve të Jashtme, Edmond Panariti:

“Vlerat e këtij patrioti të madh, një pasuri që do të trashëgohet nga kombi shqiptar dhe mendimi i tij patriotik progresist do mbeten udhërrëfyes të elitës së mendimit shqiptar për një kohë të gjatë. Arbën Xhaferi e vuri të gjithë jetën e tij në shërbim të çështjes shqiptare në mbrojtje të interesave dhe dinjitetit të popullit shqiptar në Maqedoni dhe rajon”.

Kryetari i PDS-së , Paskal Milo:

“Ishte një zë që dëgjohej me respekt dhe fjala e tij zinte vend dhe nuk fliste vetëm për shqiptarët e Maqedonisë. Ka qenë një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të nacionalizmit pozitiv shqiptar, që ka reflektuar në të gjitha trojet shqiptare”

Ish Kryetar i PSD-së, Agim Çeku:

“Ndarja nga jeta e Arbën Xhaferit është një humbje e madhe, jo vetëm për familjen e tij dhe PDSH-në, por edhe për mbarë kombin shqiptarë. Urojmë që idealet e të ndjerit Arbën Xhaferi, të bëhen realitet”

Behxhet Pacoli, Biznismen, Kryetar i AKR:

“Ai ishte njeriu që kishte shndërruar në alternativa politike qeverisëse dy Lëvizje çlirimtare, atë të Kosovës dhe atë të Maqedonisë si këshilltar, si protagonist i këtyre shndërrimeve properëndimore të kombit shqiptar. Ai i paraprinte proceseve emancipuese të kombit shqiptar me idetë e veta, me platformën e tij kombëtare, me kritikën e vet për dukuritë degraduese, me aksionin e vet politik”.

Ali Ahmeti, Kryetar i BDI:

“Ka pasur gjëra për të cilat jemi pajtuar por edhe shumë gjëra për të cilat kemi pasur qëndrime të ndryshme, por ajo të cilës i jemi përmbajtur gjithnjë, ka qenë niveli njerëzor i komunikimit tonë personal dhe politik. Duke u bazuar në këto vlera konsideroj se largimi nga kjo jetë e Arbër Xhaferit, është një humbje për politikën dhe mendimin intelektual shqiptar jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë”

Analisti dhe Gzetari Mustafa Nano:

“Arbëni ishte patriot; ishte shumë patriot; ishte patriot deri në atë masë, sa ky fakt qëllonte që ia lëndonte disi integritetin e mendimtarit të lirë, ia njolloste e komprometonte tek-tuk kokëçarjet metafizike mbi botën, dhe e mbante ndonjëherë të ndryrë në realitete parokiale, por atij aq i bënte. Nuk vuante prej ndërdyshjesh në këtë pikë, ndonëse duhet të ketë qenë njeri ndërdyshjesh. Kombi ish për të fe, filozofi, arsye ekzistence. Midis së vërtetës dhe interesit kombëtar, ai mbronte këtë të dytën. Përpara interesit kombëtar, aspirata për demokraci dhe betejat për të, i dukeshin çikërrima”

Publicisti, Politikani Veton Surroi:

“Arben Xhaferi ka qenë rilindës në kuptimin mendor e shpirtëror dhe një sens të thelluar politik dhe përgjegjësi të madhe kombëtare. Dhe për një dallim të liderëve të tanishëm, Arben Xhaferi nuk ka ndaluar se lexuari me të perfunduar lektura shkollore. Kam frikë se do të gabonim të kërkonim përsëritjen e Arbërit sepse është i papërsëritshëm. Atë çka i duhet shqiptarëve në Maqedoni, janë liderët e rinj, që kanë qëllim integrimin e Maqedonisë në Be dhe NATO”

Publicisti dhe shkrimtari Prec Zogaj:

“Arbën Xhaferi – Një fenomen intelektual në politikë...Intelektualë që përfshihen në politikë ka patur e ka kurdoherë mjaftueshëm. Por intelektualë që arrijnë të krijojnë një kauzë politike, të bëhen liderë, të votohen, të fitojnë dhe mandej ta ruajnë deri në në fund përmasën e tyre intelektuale ka më pak.

Një nga shembujt më emblematikë të fenomenit intelektual në politikë është rasti i ish presidentit të Çekisë, Vasilav Havel, Ibrahim Rugova dhe Arbën Xhaferi.

Arbën Xhaferri, një lider i përdritjes intelektuale, që doli dhe qëndroi në krye jo si disa që zënë kreun të ndihmuar nga rrethanat dhe nuk e lëshojnë pa i shkuar flaka në qiell, por si prijës i arsyes, i asaj arsyeje që nuk ka nevojë për banda, nuk ka nevojë për xhungël, nuk ka nevojë të çirret. Arsyes, të cilën Monteskie e identifikonte me virtytin në politikë, i mjafton zëri i ulët dhe e folura e matur si ajo që përcolli trajektoren prej meteori të Arbën Xhaferit në politikën shqiptare”

Vebi Bexheti, Profesor Universitar:

“Mençuria dhe largpamësia e Arbën Xhaferit, gjithmonë e bazuar në filozofinë e së drejtës dhe nevojës së lirisë së plotë të kombeve në këto hapësira të trazuara të Ballkanit, gjithsesi do t’i kontribuonte mirëkuptimit, tolerancës dhe marrëveshjeve konsensuale mes kombesh, që historikisht njihen për raporte armiqësore mes veti. Veprmi i mençur politik, e veçmas ai diplomatik i tij u dha legjitimitet të plotë kërkesave të shqiptarëve gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001, që përfundoi me një marrëveshje paqësore ndërkombëtare, e njohur si Marrëveshja e Ohrit, që për fat të keq shumë shpejt e humbi kuptimin për të cilin ishte arritur, duke u zbehur vazhdimisht nga partnerët politikë të qeversijes së vendit, pa Arben Xhaferin dhe partinë që udhëhiqte.